

Dr. Nuhi Veselaj

**ÇËSHTJE TË SHQIPES STANDARDE NË FUSHË TË
LEKSIKUT DHE TË FJALËFORMIMIT**

I

Prishtinë, korrik 1996

**RRETH KONSOLIDIMIT TË MODELEVE
TË CAKTUARA EMËRFORMUESE MBI BAZË TË DISA
PRAPASHTESAVE TË SPECIFIKUARA**

P ë r m b a j t j a

Parathënie 5

1. Përsosja e shqipes standarde faktor integrues në jetën tonë kombëtare 7

2. Rreth përcaktimit të rregullës për formimin e emrave prejfoljorë të vepruesit më -(ë)S në shqipen letrare kombëtare 15
Pasqyra 16

3. Formanti -AS si ndajshtesë e specializuar për emërtimin e e njerëzve sipas vendbanimit a prejardhjes ne shqipen letrare kombëtare 23
Përfundim 36

4. Rreth formimit me prapashtesim të emrave të sendeve në shqipen letrare 37
Hyrje në temë 37

Konstatimet nga gramatika normative 38

Si qëndron gjendja e lëndës së tillë në burimet leksikografike: FGJSH (1954) dhe FSHS (1984) 40

Pasqyra e numrit të emërtimeve me prapashtesim të sendeve sipas FGJSH (1954) dhe FSHS (1984) 40

Sqarimet e nevojshme lidhur me të dhënat nga "Pasqyra" 41

Pasqyra e përqindjes dhe ndryshimi i numrit të emrave me prapashtesim të sendeve sipas radhës së përparësisë për nga sasia 42

A. Veçori të shembujve sipas prapshtesave të cekura në gramatikë 45

B. Veçori të shembujve me disa prapshtesa të tjeras të pacekura në gramatikë 55

Formantet e tjera si dëshmi dhe nxitje për trajtim më të përimtuar të temës 60

Skema e emërimit me prapshtesim të disa em,rave të sendeve 60

Përfundim 62

Përmbyllje (rezyme) 65

5. Formanti -TORE, prapashtesë e mëvetësishme në shqipe me prirje specializimi për emërtimin e vendshërbesave 67

H y r j e 67

a) Rreth përkufizimit të termit "vendshërbesë" 68

b) Vendshërbesat me -TORE në sytë e gjuhëtarëve tanë 69

c) Qëllimi i objektit të studimit 73

(1). Vërtetesa mbi mëvetësinë e prapashtesës -TORE, parakusht për specifikimin e saj 75

Tabela e numrit të emërtimeve me prapashtesën -TORE 75

Skema e përdorimit të prapashtesës -TOR/TORE në Fjalorin e K.

Kristoforidhit 78

- (2), Gjuhët në takim si shtytës motivues për rritjen
e numrit të emërtimeve të vendshërbesave
me -TORE 81

Pasqyra e emërtimeve barasvlerëse të vendshërbesave të këtyre
gjuhëve (në kontakt) 82

- (3). Rivaliteti dhe përparësitë e formantit -TORE
kundrejt prapashtesave sinonimike konkurruese
për emërtimin e vendshërbesave 85

Pasqyrë e emërtimeve të vendshërbesave me prapashtesat
konkurruese 86

- (4). Raporti kundërvënës brenda prapashtesave simotra:
-ORE, -ATORE dhe -TORE 92

Pasqyrë e numrit të emrave me -ATORE, -ORE dhe
-TORE në FGJSSH 92

- (5). Prirja rreth përcaktimit të trajtave të temës
fjalëformuese edhe në dy rastet e brishta të
emërtimeve të vendshërbesave me -TORE 100

Tabela e numrit të emërtimeve të vendshërbesave
me -TORE sipas temës fjalëformuese përkatëse 102

Skema e raportit: temë fjalëformuese foljore +
prapashtesa = emri prejfoljor 109

Skema e zhvillimit të foljeve me temë në zanore e
togzanore sipas raportit: pjesore + prapashtesë =
prejpjesori 112

- (6). Semantika e përkufizimit aktual si kriter
vlerësues për qëndrueshmërinë e disa emërtimeve
të vendshërbesave me -TORE 115

- (7). Vendi i formantit -TORE në kuadër të strukturës
së prapashtesave speciale në vargun e formimit
të emrave nga tema e njëjtë fjalëformuese 123

Skema e zhvillimit të disa temave fjalëformuese në bazë
të prapashtesave speciale 124

- (8). Rreth përcaktimit të disa rregullsive të
përgjithshme mbi përdorimin e vendshërbesave
me -TORE në shqipen standarde kombëtare 127

P ë r f u n d i m i 131

P ë r m b y l l j e (rezyme) 135

L i t e r a t u r a 137

Përmbyllje (rezyme) (vëll. I) 139

P a r a t h ë n i e

Si në çdo fazë të zhvillimit të qenies sonë kombëtare edhe në fazën të cilën po e kalojmë, detyrë parësore e gjuhësisë sonë është të trajtuarit dhe të ndjekurit e mbarëvajtjes së gjuhës sonë letrare, përkatësisht të bëhet qëmtimi i rregullsive të gjuhës standarde. Siç dihet rregullsitë e tilla kanë mbështetje në rregullat e drejtshkrimit, të drejtë-fjalëformimit dhe të formëzimit të fjalëve dhe të shprehjeve në lëmin leksikogramatikor e semantik dhe në konstatimin, favorizimin dhe parapëlqimin e modeleve brenda strukturave të caktuara në veçanti dhe në kuadër të nënsistemeve dhe të sistemit gjuhësor në përgjithësi.

Kur dihet fakti se çdo gjuhë të zhvilluar e karakterizojnë gjedhet e përpunuara formëzuese e fjalëformuese, andaj edhe vëmendja e gjuhëtarëve tanë s'duhet të ngelë vetëm brenda rrahëve të trajtimit dhe zbatimit të rregullave drejtshkrimore (të cilat në pika të caktuara mund të rivlerësohen dhe duhet të rivlerësohen në pikëpamje të përplotësimit), por ajo duhet të përqëndrohet pikërisht në rregullsitë që dalin në fushën e fjalëformimit dhe të shprehjes në të gjitha rrafshet në plan të gjerë.

Kur është fjala të fjalëformimi në gjuhën tonë, si disiplinë më vete, pa i mohuar rezultatet e arritura në këtë drejtim, mund të thuhet se ka mbetur edhe shumë punë për t'u bërë e për t'u konsoliduar. Ende ka raste që edhe vetë gjuhëtarët tanë (madje edhe ndonjëri me përgatitje të lartë) nuk e kanë të qartë se sa i dëmshëm është identifikimi i parrezervë i prapashtesave: (-Ë)S me -AS, -ORE/-ATORE/-TORE/-TOR/ ndërmjet tyre, ashtu si edhe -TOR e -TAR, -TAR e -AR, -OR e -AR, -AN me -ANT, -AN -CI/EN -ENT, (Ë)SI me -SHMËRI, -OR me -ORE, -S me -SE etj., edhe pse dihet se ka prova mjaft bindëse që dëshmojnë se secili formant është specializuar a del me prirje specializimi për nënfushën e veçantë semantike. Po e cek këtë çështje, sepse mjaft konsiderata e rregullsi që tashmë teorikisht e praktikisht mund të quhen të zgjidhura dhe të arrira, qoftë sipas rregullave të drejtshkrimit të ri, qoftë sipas rregullave drejt-fjalëformuese sipas doracakëve normativë, tashmë në praktikë nuk po përfillen sa duhet e qysh duhet. Së këtajmi del

e nevojshme që njohuritë lidhur me zgjidhjet e tilla domosdo të përthellohen dhe të risforcohen, sidomos nga pikëpamja teorike në mënyrë që të gjejnë zbatim edhe shtrirje më me lehtësi në gjuhën tonë letrare kombëtare.

Dihet fakti se gjuha jonë standarde për të kryer sa më me lehtësi dhe më me sukses misionin e saj si mjet komunikues gjithëkombëtar dhe integrues në raport me gjuhët e huaja duhet t'i ketë të përpunuara edhe rregullsitë e fjalëformimit, prandaj në kuadër të këtij fakti janë shkruar edhe këto katër-pesë punime që po jepen këtu nën titullin *RRETH KONSOLIDIMIT TË MODELEVE TË CAKTUARA EMËRFORMUESE MBI BAZË TË DISA PRAPASHTESAVE TË SPECIFIKUARA*, ku pas një paraqitjeje përgjithësuese "*Përsosja e shqipes standarde faktor integrues në jetën tonë kombëtare*", trajtesë kjo që mund të shërbejë si parathënie edhe për përmbledhje të tjera lidhur me temën bosht "**Çështje të shqipes standarde në fushë të leksikut dhe të fjalëformimit**", në katër punimet vijuese trajtohet mjaft përhollësisht funksioni i formanteve përkatëse në konsolidimin e modeleve të caktuara emërformuese sipas nënfushave përkatëse semantike, si p.sh.:

- "Rreth përcaktimit të rregullës për formimin e emrave prejpjesorë të vepruesit më -ËS në shqipen letrare kombëtare", qoftë nga tema e pjesores së letrarishtes së sotme, qoftë nga tema e pjesores së ish-shqipes letrare mbi baze të gegërishtes;

- "Formanti -AS si ndajshtesë e specializuar për emërtimin e njerëzve sipas vendbanimit a prejardhjes", ku kjo prapashtesë vërtet del në funksion mbizotërues për këtë qëllim ndaj simotrave të tjera;

- "Formimi me prapashtesim i emrave të sendeve", ku pas analizës së shembujve të regjistruar në dy burime leksikografike FGJSH 1954 ndaj FSHS 1984 dhe krahasimit të tyre, qoftë brenda vetë burimit, qoftë në krahasim me njëri tjetrin, dolën rezultate prapashtesa të specifikuara që më përpara funksioni i tyre specifikues nuk dilte i qartë;

- Formanti -TORE, prapashtesë e mëvetësishme në shqipe me prirje specializimi për emërtimin e vendshërbesave", ku në përhollësi u trajtua ky formant, i cili nuk del mbizotërues a me konkurrencë të fituar ndaj simotrave të veta në gjuhën shqipe, por del si një barasvlerës i arrirë ndaj formanteve përkatëse të gjuhëve të huaja për këtë nënfushë semantike, siç është formanti **-teke** i greqishtes, **-hane** të turqishtes, **-eria** të italishtes dhe **-nica** të serbishtes.

Mendoj se konstatimi dhe konsolidimi në përdorim i ndajshtesave dhe sindajshtesave speciale a me prirje specializimi, siç është funksioni i formanteve të trajtuara në punimet e sipërcekura duhet të jetë preokupim i gjuhëtarëve dhe i intelektualëve tanë përgjithësisht, ngase veprimet e tilla janë

parakusht i domosdoshëm nga i cili duhen dalë edhe mbështetjet për rregullsitë e rekomandueshme rreth formëzimit të modeleve të caktuara fjalëformuese.

Padyshim një rrugë të tillë trajtimi lypset ndjekur edhe për zgjidhjen e temave të tjera të mprehta po të kësaj natyre.

Prishtinë, korrik 1996

Autori

1. PËRSOSJA E SHQIPES STANDARDE FAKTOR INTEGRUES NË JETËN TONË KOMBËTARE

/Trajtesë e paraqitur në Simpoziumin me temën bosht "Letërsia shqipe dhe gjuha letrare", Prishtinë, nëntor 1996. Është botuar në revistën "Koha", më 17.IV.1996/

Nën rrethanat e zhvillimit dhe të ndryshimeve që po kalon shoqëria jonë shqiptare është gjë krejt normale kërkesa që edhe norma e gjuhës sonë të njësuar letrare t'i shtrohet verifikimit, qoftë me qëllim të risforcimit të rregullave të caktuara tashmë në fuqi, qoftë me qëllim të përsosjes dhe të përplotësimit të saj në pika të caktuara. Dihet se përveç faktorëve të tjerë, për ndërmarrje të tillë përsosjeje, në radhë të parë si synim orientues duhet të shërbejë faktori integrues që nënkupton interesin kombëtar të bashkësisë folëse, faktor ky që për mendimin tim qëndronte një si dritë e ndezur edhe në duart dhe mendjet e intelektualëve dhe të veprimtarëve tanë me gjuhëtarët në krye, edhe në Konsultën gjuhësore të Prishtinës (1968), kur u deklarua botërisht se nga shqiptarët e këtij kufirit do të pranohet ajo normë e gjuhës letrare, e cila do të miratohej në vendin "ëmë", edhepse, siç dihet, te ne mbizotëronte deri atëherë shqipja letrare mbi bazë të gegërishtes, ndërsa në Shqipëri favorizohej varianti letrar mbi bazë të toskërishtes, gjë që shihej qartë edhe nga *Fjalori i gjuhës shqipe* (1954).

Çështja se me një veprim të tillë më tepër u ndihmua kauza kombëtare apo aparaturore pushtetore "parti-shtet" e kohës, edhepse shfytëzimi i ndërsjelltë del qartë, mendoj se interesi kombëtar del parësor dhe i padiskutueshëm.

Sidoqoftë, është e vërtetë, se njëzimi *i gjuhës së sotme*

letrare, i cili u bekua në Kongresin e Drejtshkrimit (1972) nuk mbeti vetëm si një dëshirë e shprehur, por ajo u kompletua, siç lypset, shkencërisht, me aktet përcjellëse normative të domosdoshme që e karakterizojnë çdo **gjuhë letrare kombëtare** të zhvilluar, siç janë: rregullat e drejtshkrimit (1974), gramatika normative (1976), fjalori drejtshkrimor (1976) dhe fjalori përshkrues normativ: (1980) / (1984), akte këto që u kompletuan edhe me një varg doracakësh e veprash të tjera të botuara në mbështetje të kësaj të mbërrime madhore, qoftë në Tiranë, qoftë në Prishtinë e Shkup, por edhe gjetiu.

Të mohohet sukcesi i tillë historik me interes gjithëkombëtar që u arrit me atë njësim është absurditet, ashtu siç mund të quhet absurditet edhe mendimi i dikujt se me normën e tillë janë zgjidhur njëherë e përgjithmonë të gjitha çështjet **e shqipes standarde kombëtare**.

Kemi mendimin se norma e **gjuhës letrare kombëtare** sot, edhe pse nuk ka aq moshë të madhe, nuk del më aq e brishtë sa që po të kritikohet në ndonjë pikë apo po të vihet gishti në ndonjë të metë të saj strukturore me qëllim përsosjeje, ajo do të çahet si gatarja nga ujë i valë! Por me këtë vlerësim nuk do të thotë se atë nuk duhet ta bëjmë edhe më të shëndetshme edhe më kombëtare.

Ç` është e vërteta, analiza të tilla kritike me qëllim të përsosjes së normës së kësaj gjuhe në pika të caktuara janë bërë edhe më përpara. Mbase do të keni pasur rast të vëreni edhe ndonjë shkrim të botuar te ne.

Këtë rast nga ky kompleks çështjesh të hapura, mendoj se ia vlen të shkëputet, sëpaku, diçka si përgjigje në këto katër pyetje:

1) a ka formante fjalëformuese që kanë mbetur ende të pavërejtura a të papërfshira në doracakët përkatës normativë të gjuhës sonë letrare;

2) cilat veprime, modele dhe prirje fjalëformuese lypset favorizuar me qëllim të përsosjes së shqipes standarde?

3) çfarë qëndrimi duhet mbajtur ndaj përvojës dhe praktikës gjuhësore të deritashme te ne (në Kosovë) si dhe angazhimi i mëtejshëm i kuadrit tonë në drejtim të përsosjes së shqipes standarde kombëtare?

4) a ka çka të marrë ende letrarishtja e sotme nga gegërishtja, përkatësisht nga ish-shqipja letrare mbi bazë të gegërishtes?

1) Gjatë analizës së sistemit fjalëformues të shqipes, qoftë në sistemit emëror, qoftë atij foljor kam vërejtur ndonjë zbraztësi.

a) Nga nënsistemi emëror po vë në spikatje dy raste:

Së pari, rastin se pjesëza **si** sheshazi del në funksion të parashtesës emërformuese, qoftë si zëvendësim i qëlluar i siprapashtesës së huaj -O/ID (si p. sh. siprapashtesë/sufiksoid), qoftë në farkëtime të pavarura të fjalëve të brumit vendës. Shembujt: sikarth, sivëlla, siujdhesë etj. e dëshmojnë këtë. Madje shumimin e emrave të tillë e siguron vetë nënfusha e qartë semantike.

Së dyti, po e përmend kalimthi sirregullën a prirjen kundërvënëse emërformuese mbi bazë të foljeve më -Oj dhe -EJ, kështu që: mbi emër-temat më -IM formohen emra abstraktë me prapashtesën -SI (tipi pajtimësi, shkëlqimësi), ndërsa mbi pjesoren e foljeve më -UE / -YE emrat e tillë formohen me prapashtesën -SHMËRI (tipi: pajtueshmëri, shkëlqyeshmëri). Në këto raste secili nëntip mbulon koncept të veçantë semantik.

Këto dhe rastet si këto nga ky nënsistem duhet të vlerësohen.

b) Edhe nga nënsistemi foljor po përmend dy raste jo pak të vërejtshme, por që ende nuk kanë zënë vend në burimet tona përkatëse normative:

Së pari, krahas prapashtesave foljeformuese të njohura -OS, -IT, -IS (-S) lypset vlerësuar edhe: -IJ, -AS dhe -EJ. Shembujt si p.sh.: djersij, gjëllij, mërij, nxij, ndrij, mpij, shpij; pikas, trokas; fërfëllej, shëmbëllej etj. arsyetojnë kërkesën e tillë.

Së dyti, po kështu duhet të vlerësohen, pos prapashtesave të tipit -O- me zgjerim: -TO-, -LLO-, -SO- e -ZO- edhe 13 të tjera, sivariantet: -NO-, -MO-, -RRO-, -LO- -IZO-, -CO- si dhe formantet e tjera të diskutueshme: -KO-, -SHO-, -SHTO-, -ÇO-, -ZHO-, HO-, -JO-.

2) Në çdo gjuhë të zhvilluar favorizohen ndërgjegjesisht modelet fjalëformuese, të cilat shënohen edhe në burimet e caktuara normative. Paraqitja e tillë në gramatikat tona aktualisht nuk është as për afërsisht e plotë. Në vazhdim po jap disa nga vëzhgimet e mia që dalin nga analiza fjalëformuese, qoftë e nënsistemit emëror, qoftë të atij foljor të gjuhës sonë, vëzhgime këto të cilat duhen pasur në konsideratë:

a) Prapashtesat autoktone emërore më të dalluara dalin të specifikuar sipas këtyre nënfushave semantike:

1. -TAR, -AR, -Ë/S, - për emërtimin e njerëzve sipas profesionit a veprimtarisë;

2. -AS, -(J)AN, - për emërtimin e njerëzve sipas vendbanimit a prejardhjes;

3. -OR, -ORE, -(Ë)S, -(Ë)SE, -CË, -URINA etj. kryesisht për emërtimin e sendeve a të mjeteve konkrete;

4. -TORE për emërtimin e vendshërbesave;
5. -I, -SI, -SHMËRI, TË + pjesore + T për nocione abstrakte etj.
6. -ATORE, -ESHË dhe -E - emërtimin e grave sipas veprimtarisë etj. etj.

Për mendimin tim mosnjohja dhe mosrespektimi i rregullsive të tilla tashmë të ravijëzuara është dëm shumë i madh.

b) Prapashtesat autoktone foljeformuese priren të specifikohen për këto nënfusha semantike. Kështu që:

1. foljet me prapashtesat: -it, -is, -as; -o-, -to-, -no-, -ho-, -jo- si dhe huazimet me -izo- e -ifik-o- përkundër specifikave që ka ndonjëra prej tyre, zakonisht përdoren me kuptim neutral pa shkallëzim të theksuar stilistik;

2. foljet me prapashtesat: -co-, -ço-, -ko- kryesisht shprehin kuptim deminutiv, paksa ngjashëm sikurse edhe mbiemrat a emrat me prapashtesat -C(Ë), -Ç e -K(Ë);

3. ato me prapashtesën -sho- po ashtu me kuptim deminutiv, por të karakterit të hapur, ndërsa prapashtesën -mo- të karakterit të mbyllur, ngjashëm me mbiemrat më -SHËM, përkatësisht -M;

4. foljet me prapashtesën -ro- (pa u kundërvënë me prapashtesën -no-) priren të shprehin koncepte të fytyruara nga bota e njeriut, me prapashtesën -lo- koncepte të stilit të butë, të gjuhës fëmijënore, ndërsa foljet më -llo- shprehin dukuri me kuptimësi të karakterit keqësues, përgjeshës. Po kësi koncepti disi shprehin edhe foljet me -OS;

5. foljet me prapashtesat: -rro- dhe -zho- shprehin intensitet të shkallës së lartë, ashtu si edhe prapashtesa -so-, por kjo më tepër ruan kuptimësinë me ngjyresë cilësie;

6. me prapashtesën -zo- foljet zakonisht shprehin procese të ndërlikuara (kimiko-teknologjike), ku nënkuptohet, si të themi, ndërrimi substancës, ndërsa me prapashtesën -shto- foljet shprehin kuptimësi shumimi.

Siç del nga konstatimet e mësipërme, vërtet kemi të bëjmë me risime, edhe pse "të guximshme" në dukje, të cilat duhen vlerësuar.

Po ashtu lypsen vlerësuar edhe rastet e asociacionimit, goftë edhe në nuanca të funksioneve të formave në raportin prapashtesë / prapashtesë foljeformuese si p. sh.:

lëkuq/kuqëloj; përskuq/kuqëron; tëhumboj/humbëtoj;
 tëholl/holloj; përshepirt/shpirtëroj; zbrap/prapësoj,
 thithmoj/përthith/; spastroj/pastërtoj;
 sforcoj/forcëroj; mësyj/syjoj; nxij/zijon;

ngjall/gjallon; stërholl/hollësoj;
 shpërmalloj/mallëngjej; mallshtoj/mallëzoj; dhelatoj/dhelkoj;
 ngalkoj/kalëroj; zhdrang/drangëzhoj;
 ngurroj/gurëzhoj;
 mundshtoj/stërmundoj; stërkeq/keqëson etj.

Kjo ka rëndësi për të gjitha stilet funksionale, por në mënyrë të veçantë për stilin letrar-poetik. Sa për kërshtëri po e cek faktin se vetëm në FGJSSH janë shënuar nja 9 trajta foljore mbi hazë të temës fjalëformuese **-kuq-**, kështu që përveç kuq, skuq, lëkuq përskuq; kuqërris e kuqon dalin edhe trajtat: kuqëlon, kuqëson e kuqërron, mirëpo në bazë të sirregullave të sipërcekura varësisht nga konteksti mund të dalin pothuajse fare natyrshëm edhe trajtat si: ndajskuq. ndërskuq, tejskuq, stërskuq. tëkuq etj., por edhe kuqëllon, kuqëron, kuqshtoj, kuqshoj, tëkuqoj, lëkuqmoj, kuqëton, kuqëzon etj. Një mundësi të tillë zhvillimi e kanë pothuajse të gjitha fjalë-temat fjalëformuese të gjuhës sonë, prandaj këtë dhuratë që na jep struktura fjalëformuese e gjuhës sonë është mëkat mos ta njohim dhe mos ta shfrytëzojmë si duhet. Pra këtë mundësi, siç thuhet, duhet ta kenë vëth në vesh poetët tanë, por edhe të gjithë intelektualët e dashamirësit e gjuhës sonë.

3) Kur është fjala se çfarë qëndrimi duhet mbajtur ne sot, qoftë ndaj përsosjes së gjuhës letrare kombëtare, qoftë ndaj realitetit tonë gjuhësor kosovar, opinionin tim po e shpreh në këto tri pika:

Së pari, ne duhet të mbajmë qëndrim aktiv e jo pasiv në sforcim të moto-idesë "një komb - një gjuhë letrare", por tash duke ndihmuar aktivisht përsosjen e saj. Kështu që në harmonizimin e terminologjisë së caktuar të të gjitha degëve të disiplinave të caktuara të ofrohen për vlerësim të gjitha ndihmesat tona pozitive të formëzuara në realitetin tonë gjuhësor, letrar e shkencor, kuptohet të farkëtuara mbi bazë të ligjësisë të vetë gjuhës sonë letrare, kur dihet fakti se në ndonjë segment shoqëror ne ishim të ballafaquar më përpara në krahasim me lëvizjet e fundit në Shqipëri, siç janë b.f. emërtimet që lidhen me biznesin e vogël, me shqipërimin e disa termave nga fusha tekniko - teknologjike e shkencore etj.

Së dyti, të vazhdohet me paraqitjen e realitetit tonë gjuhësor popullor më mirë e më me përkushtim se deri tashti, d.m.th. pa i artificializuar tipizimet, qoftë në paraqitje gazetareske, qoftë në literaturën shkencore e artistike. Vërtet, në këtë segment vërehen qalime të mëdha.

Së treti, të kërkohet më me ngulm nga disa intelektualë tanë

që të heqim dorë a të lirohen nga përdorimi pa vend i disa fjalëve që bien ndesh me normën leksiko-semantike të letrarishtes së sotme, siç janë b. f. kalkëzimet a ndërndikimet asociacionore nga serbishtja:

1. kyç kyçje (uklju_iti uklju_ivanje) që në shqipe ka sinonimi me trajtat: mbyll, mëshel, ndryj, burgos e jo: futje, ndërlihdje, përfshirje, inkuadrim etj. për çka po përdoret te ne(!);

2. përflas përfolje (prerpri_a(va)ti prepri_avanje) që në shqipe ka sinonimet: përçesh, përçmoj, shpif. etj. e jo: ritregoj, parafrazoj, e them me fjalë të mia etj., siç e ka barasvlerësi i serbokroartishtes (!);

3. nism nismë (po_etak) që në shqipe ka për sinonim ndërkombëtarizmën iniciativë e jo emrat: nisë, zanafillë, fillim etj., siç po përdoret te ne(!);

4. përkujtoj përkujtim (podse_ati podse_anje) që në shqipe ka sinonim fjalën ndërkombëtare premomarje e jo: kujtoj, theksoj, rikujtoj, sjell ndërmend etj., siç po përdoret te ne. Nuk di pse disa gazetarë (në vende kyçe) te ne nuk e kanë fare trajtën kujtoj a rikujtoj që ta përdorim për konceptin në fjalë, por po e përdorin vetëm atë kontestuesen: përkujtoj (!) etj.

Po i shtoj këtij vargu vetëm shprehjen sintaksore të diskutueshme: "më mirë thënë" a "shkurt thënë" /bolje re_i (re_eno), kratko reci (re_eno)/, shprehje a fjali të ndërmjetme këto që më mirë në shqipe do të dilnin në versione të tjera. Le të krahasohet b.f. fjalia e më poshtme: "**Shkurt** (të themi, **me thënë**, thënë), **fitorja do të jetë jona**".

Për mendimin tim dy versioneve të para të normëzuara mund t'i shtohet edhe versioni i tretë: "**më mirë**" a "**shkurt** **me thënë**", por jo: "më mirë" a "shkurt" *thënë*", ngase këtu në versionin e katërt, kemi të bëjmë me amputimin apriori, krejt pa nevojë, të trajtës së paskajores me + pjesore.

I përmenda vetëm këta shembuj karakteristikë, edhe pse ka edhe shumë e shumë të tjerë, me dhjetra e qindra, sidomos nga fusha e "gjuhës teknike".

Një pyetje shtrohet para përdoruesve të fjalëve të tilla te ne (shumica intelektualë me emër): a s' po din, a s'po duan apo s' po mund ta harrin këtë barë të keq nga kopshti i bukur i gjuhës sonë letrare? Njëherazi lidhur me këtë u drejtoj vërejtje kuadrove kompetente në Shqipëri, pse ata nuk po reagojnë si duhet e sa duhet ndaj lëshimeve të tilla, por po rrinë indeferent, gjoja se kjo na qenka karakteristikë e "gjuhës kosovare"! Thuase ne kemi të drejtë të hibridizojmë shqipen në "tjetër gjuhë"! E disa, e them me keqardhje, po i pranojnë trajtat e tilla pa rezervë, kështu që, si

të thuash, po infektohen nga shprehjet e tilla, vërtet të panevojshme dhe të dëmshme për njësimin e gjuhës letrare përgjithësisht.

4) Në vazhdim do të prek paksa edhe pikën më të mprehtë, më të ndjeshme, por edhe më interesante dhe me interes të gjuhësisë sonë aktualisht që është: raporti **shqipe letrare kombëtare** në njërin anë, **gegërishtja**, përkatësisht **ish-shqipja letrare mbi bazë të gegërishtes**, në anën tjetër, apo të përgjigjem në pyetjen e shtruar: A ka çka të marrë ende letrarishtja e sotme nga gegërishtja apo ish-shqipja letrare mbi bazë të gegërishtes?

Për mendimin tim kritikuesit e normës së letrarishtes së sotme në raportin ish-shqipe letrare mbi bazë të gegërishtes / gjuhë e sotme letrare, s`di sa kanë të drejtë kur si lëshim vënë në dyshim edhe zgjidhjet kompromise jo të paqëlluara siç janë: përdorimi i Ë-së në rastet kur "kjo zanore e theksuar i përgjigjet historikisht një A-je të ndjekur nga një zanore hundore" (tipi hënë) e në rastet si te shembulli **një** (nja, njo, nji, një, njô, njâ, nje); favorizimi i trajtave herë me togzanorin UE e herë më UA, herë me rotacizëm, herë me nazalizëm etj., por nuk mund të quhet e padrejtë kërkesa e kuadrove të caktuar që në gjuhën e njëzuar standarde kërkojnë të fuqizohet për koncepte a nuanca të reja prania e trajtave karakteristike kryesisht me origjinë gege, sidomos në fushë të leksikut siç janë p. sh.: foljet më -NO- (tipi: pleqnoj, shtalbnj) e -MO- (tipi: thithmoj, ermoj), emrat më -NI (tipi: mirëni, pleqni), prejpjesorët më -Ë (tipi: pritë, (v)dekë) dhe -TAR (tipi mihtar, ngrohtar), emrat e mbiemrat paranyjorë, tipi: e pame, e varme, e ardhme etj. si dhe të bëhet (ri)integrimi i formës së paskajores me + pjesore.

Në këtë kuadër problemore del vetëm paskajorja me "me", "formë kjo e vetme (e gegërishtes) që nuk e kanë të folmet e dialektit jugor", siç e pohon prof. Sh. Demiraj. Lidhur me këtë pikë, për mendimin tim, ka keqkuptim e paqartësi, qoftë në interpretim, qoftë në qëndrim lidhur me etiketimin përçmues "e mënjanuar nga norma e gjuhës së sotme letrare", edhe pse dihet se pragmatikisht a sipas normës tradicionale asnjë formë e pazëvendësueshme e gjuhës së gjallë në situata të caktuara s'mund "të mënjanohet", përkundrazi ajo duhet të jetë e lejueshme sa herë që ndjehet e nevojshme të përdoret në gjuhën standarde. Ç`është e vërteta, sot për sot ajo, në rrethana të caktuara, përveç tipizimeve të zakonshme (e drejtë kjo që s'mund të diskutohet), vazhdon të përdoret (dhe për këtë kërkon legalizim) edhe në këto katër nënfusha të nëpërdukshme semantike:

E para, në funksion të përfaqësimit (së paku plotësues) të

foljes së caktuar, sidomos në raport me infinitivin e gjuhëve të huaja, p. sh. kur t`u shpjegohet b.f. mësimarrësve për infinitivin e latinishtes **legere** a të serbishtes **_itati** - lexoj (me lexue a me lexuar) kundrejt trajtës së të tashmes së dëftores b. f. lat. **lege**, serb. **_itam** - (unë)**lexoj**, s' ka arsye që së paku si mjet konkretizues të mos përmendet **me + pjesorja: me lexue a me lexuar**, si barasvlerës i vetëm i mirëfilltë në shqipe ndaj infinitivit të gjuhëve të huaja. Aq më tepër kur një formë të tillë ata edhe e kanë të ravijëzuar në sistemin e tyre ligjërimor të përditshëm?!

E dyta, në shprehje frazeologjike të një abstraksioni të lartë, kur nuk ceken kategoritë foljore të kohës, vetës, numrit, mënyrës, tipi: *Mos me folë me thumba se kthehen me plumba. Me u sjellë mirë nuk është ku me dijtë se çka, por me dalë me faqe të bardhë e pa u koritë (a koritur) është diçka* etj.

E treta, për qëllime ideo-estetike, kur paskajorja me "me" mund të shërbejë si "një mollë e ndaluar" por joshëse për përdoruesin, goftë në stilin letrar, goftë në atë politik etj. dhe

E katërta, në funksione sinonimike për disa koncepte semantike, siç ishte b. f. rasti "më mirë me thënë" a "shkurt me thënë" etj. Nuk është fjala vetëm për ndonjë formë ndër-këmbëse të lidhore, por edhe për mëse tetë forma të tjera ndër-këmbëse.

Për mendimin tim (ri)integrimi i formës së tillë (pra si rast i veçantë, kuptohet, pa paradigmën shoqëruese dialektore) aspak nuk e dëmton strukturën bazë ekzistuese të gjuhës letrare kombëtare, përkundrazi e bën atë më të sforsueshme dhe më kombëtare. Fundja, me një veprim të tillë, nuk kërkohet ndryshimi i normës në fuqi, por kërkohet zbutja e qëndrimit apo vetëm përplotësimi i saj, goftë për koncept a nuancim të ri, goftë si sinonim konkurrues.

Mbase, hëpërhë, te ndonjë adhurues "i përflakët" i normës së sotme dhe të bazës ekstreme të saj (ku mund të ndodhet ende i pashlyer edhe emri im), mund të shkaktojë ndonjë paqartësi të përkohshme?! Personi i tillë do të bindet lehtë posa t`i rikujtohet fakti se, fundi i fundit, tashti nuk kemi të bëjmë më me variantin letrar të toskërishtes, por kemi të bëjmë me një sistem krejt të ri, më të përpunuar, më të gjerë e më të niveluar, d.m.th. kemi të bëjmë me **shqipen standarde kombëtare** të njëzuar, e cila si pronë e gjithë shqipërdoruesve, pa marrë parasysh bazën dialektore të tyre merr tiparet e një gjuhë standarde të zhvilluar, e cila edhe e ka si detyrim jo vetëm të lejojë, por edhe të përfshijë, të shfrytëzojë e njëherazi edhe të ushqejë me gjirin e vet tërë thesarin pozitiv të trashëguar nga dialektet, sociolektet, idiolektet e variantet e caktuara të gjuhës, të cilën edhe e

përfaqëson dhe vetëm pastaj në rast nevojë mund të bëjë risime dhe huazime të domosdoshme nga gjuhët e huaja për konceptet përkatëse.

Sidoqoftë, kjo çështje e diskutueshme nuk është mirë të lihet zvarë. Fundja, nuk shtrohet pyetja tashti a bën pa të, po a mos është më mirë me të? Me fjalë të tjera, njeriu mjaft gjëra mund të shohë edhe me një sy, por kur i ka të dy pse mos t`i shfrytëzojë që të dy. Dihet fakti se po të mohosh sinoniminë do të thotë të pranosh varfërimin e gjuhës?! Sigurisht kur kemi parasysh faktorët psikolinguistikë dhe sociolinguistikë është më mirë të mos shikohen gjërat si kjo vetëm me syrin e toskërishtfolësit, por me të dytë, me të tretë e me të katërt, pra edhe me syrin e objektivitetit shkencor dhe me atë të politikës a të planifikimit gjuhësor, sidomos kur kemi parasysh faktin, siç po thuhet, se mëse 3/4 e bashkësisë folëse e njohin apo e kanë të ravigjësuar në sistemin e tyre liggjërimor formën e tillë dhe se në ish-shqipen letrare mbi bazë të gegërishtes kjo cilësohej, si me thënë, si shtyllë kurrizore e sintaksës së asaj gjuhe (sot variant ende i gjallë jo vetëm dialektor), këtë e dëshmojnë, pos tjerash, edhe veprat e klasikëve të gjuhës sonë, madje kjo formë ishte e pranishme edhe në veprat e shkrimtarëve më të spikatur toskë: Naim Frashëri, F. Konica, Asdreni, M. Grameno etj. Me një përdorim të tillë ata nuk nderuan vetëm gegërinë, por nderuan në radhë të parë artin e vet gjuhësor e letrar.

* * *

Po përfundoj me konstatimin nga sa u tha më lartë se gjithësi me përsosjen e normës së shqipes letrare dhe me përplotësimin e formave të caktuara të bazës së saj, të të gjitha niveleve, njëzimi i saj do të jetë ndërgjegjësish edhe më i pranueshëm, politikisht më i përqaftueshëm dhe kombëtarisht më i integrueshëm.

Për krejt këto që u cekën më sipër, siç thonë në zhargonin ekonomik, unë kam mbulesë, madje shfrytëzoj rastin, jo për të sfiduar, por për të bërë me dije opinionin si dhe auditorin e nderuar se pikërisht lidhur me çështjet e mprehta të gjuhës sonë letrare që paksa u cekën këtu, kam shkruar disa punime, të cilat pjesërisht i kam botuar, por shumicën e kam dorëshkrim. Materialin e tillë e kam mbarështruar njëherëpërnjëherë në tetë vëllime nën mbtitullin e përbashkët "**Çështje të shqipes standarde në fushë të leksikut dhe të fjalëformimit**", vepër kjo që pret fatin e bardhë që mbase një ditë jo të largët të fillojë ta shohë dritën e shtypit.

**2. RRETH PËRCAKTIMIT TË RREGULLËS PËR FORMIMIN
E EMRAVE PJEJPJESORË TË VEPRUESIT MË -(ë)s
NË SHQIPEN LETRARE KOMBËTARE**

/Trajtesë e paraqitur në Konferencën shkencore me temën
bosht "Gjuha letrare kombëtare dhe bota shqiptare sot", Tiranë
nëntor 1992. E botuar në "Gjurmime albanologjike", sek. shk.
fil., nr. 24/94, Prishtinë/

Në kuadër të strukturës së formimit të emrave sipas veprimtarisë së tyre vend të dukshëm zënë emrat prejfoljorë të vepruesit. Këta emra në mesin e tipave kuptimorë të emërtimeve të njerëzve sipas profesionit në shqipen e sotme letrare zënë vendin më të madh për kah numri. Madje ky numër vjen duke u rritur dita - ditës, ngase sipas rregullit prej çdo folje (kalimtare) në kontekste të caktuara mund të përftohet emri i vepruesit. Të gjithë emrat prejpjesorë të vepruesit që emërtojnë njeriun sipas procesit të punës që kryen a mund të kryejë <§F Lidhur me këtë dhe të dhëna të tjera më gjerësisht në disertacionin e doktoratës të N. Veselajt me titull "Struktura fjalëformue e emërtimeve të njerëzve sipas profesionit në gjuhën shqipe" (dorëshkrim), Prishtinë 1991.> , formohen me prapashtesën speciale -(ë)s, pos një numri jo të madh që e kanë marrë prapashtesën -tar, si: mbathtar, mihtar, ngrohtar etj. Mënyra e tillë e formimit me prapashtesën -(ë)s është e cekur në të gjitha burimet përkatëse normative të gjuhës sonë letrare dhe konstatimet lidhur me këtë nuk dalin të kontestueshme, d.m.th. janë të drejta përgjithësisht. Madje nuk është problemor as fakti se për formimet e emrave të tillë sipas tipave të foljeve si temë fjalëformuese shërbejnë dy variante trajtash të pjesores :

1. pjesorja e gjuhës së sotme letrare dhe
2. pjesorja e ish-gegërishtes letrare.

Mirëpo pikërisht në këtë pikë, si më duket, çështja ka mbetur e pasqaruar deri në fund. Pra, rreth përcaktimit të trajtës përkatëse të pjesores, qoftë e shqipes së sotme letrare, qoftë e ish-gegërishtes letrare sipas temave fjalëformuese të pjesoreve del e nevojshme të jepen sqarime plotësuese, të cilat nuk i ndeshim në burimet normative të deritashme. Mbase edhe po, por unë nuk i di.

Sidoqoftë, kjo çështje meriton trajtim më të plotë. Lidhur me këtë po paraqes pasqyrën e të gjitha trajtave të foljeve të gjuhës sonë, sipa Fjalorit të gjuhës së sotme shqipe (1980) si dhe emrin prejpjesor të vepruesit të përftuar sipas tipave të foljeve përkatëse, si shembuj përfaqësues, sipas këtyre rubrikave:

1. Tipi i foljes.
2. E tashmja e dëftores.
3. Pjesorja temëfjalëformuese.
4. Emri i vepruesit.
5. Prejardhja e temës fjalëformuese.
6. Prapashtesa e shfrytëzuar e ish-gegërishtes letrare.
7. Prapashtesa e shfrytëzuar e letrarishtes së sotme.
8. Prapashtesa e pashfrytëzuar e letrarishtes së sotme.

P A S Q Y R A

Tipi i foljes	E tashmja e dëft.	Pjesorja temë-fjform.	Emri i vepr.	Prejar. e temës fj.form.	P r a p a s h t e s a		
					e shfr. geg.	e shfr. l. s.	e pashfr. l. s.
1	2	3	4	5	6	7	8
I. Foljet me temë në zanore e togzanor:							
1) -oj	mësoj mbroj	mësue mbrojtë	mësues mbrojtës	G* G	zero -ë		-(ua)r -ur
2) -uaj	shkruaj shuaj ruaj	shkrue shuar ruejtë	shkrues shuarës ruajtës	G L ** <\$F	zero -r		-(ua)r -r
	ruejtë) si dhe dhënë, sotme.>	lënë etj.(geg. -ë	dhanë, lënë) -ur		Trajta më -ua/j ruajtës (geg. janë veçori të letrarishtes së		
3) -ej	shpërblej vërej blej mbrej	shpërblje vërejtë blerë mbrehë	shpërbljes vërejtës blerës mbrehës	G G L G	zero -ë		-(ye)r -ur -rë -ur
4) -ij	shkrij arrij	shkrirë arritë	shkrirës arritës	L G		-rë	-ur
5) -uj	buj	bujtë	bujtës	G	-ë		-ur
6) -ëj	bëj	bërë	bërës	L		-rë	
7) -yj	fryj	fryrë	fryrës	L		-rë	
8) -aj	laj mbaj	larë mbajtë	larës mbajtës	L G		-rë	-ur
9) -yej	kryej	kryer	kryerës	L		-r	

1o) -iej	zief	zier	zierës	L		-r
----------	------	------	--------	---	--	----

II. Foljet vokalike me mbaresë zero:

vë	vënë	vënës	L		-në	
ngre	ngritë	ngritës	G	-ë		-ur

III. Foljet e parregullta:

jap	dhënë	dhënës	L		-në	
vete	vajtë	vajtës	G	-ë		-ur

IV. Foljet me temë në bashkëtingëllore:

a) 1)	mat	matë	matës	G	-ë		-ur
2)	marr	marrë	marrës	L		-ë	
b)	-s	mpiks	mpiksë	mpiksës	G	-ë	-ur
	-is	pajis	pajisë	pajisës	G	-ë	-ur
	-os	palos	palosë	palosës	G	-ë	-ur
	-it	radhit	radhitë	radhitës	G	-ë	-ur

Gjithsej shembuj përfaqësues:	28	17	11
-------------------------------	----	----	----

* G - prejardhja e temës fjalëformuese nga ish-gegërishtja letrare;

** L - prejardhja e temës fjalëformuese nga letrarishtja e sotme.

Siç po shihet nga pasqyra e mësipërme ndër 28 shembuj përfaqësues të tipave të foljeve përkatëse në 17 raste emri i vepruesit është formuar mbi trajtën e pjesores së ish-variantit letrar të gegërishtes, ndërsa në 11 raste në mbështetje të trajtës së pjesores së letrarishtes së sotme. Sipas një kriteri tjetër, nëse tri rastet: dy më **-në** dhe një më **-ë**, konsiderohen të trashëguara nga ish - shqipja letrare mbi bazë të gegërishtes, raporti del 20 me 8 në dobi të variantit të gegërishtes. Sidoqoftë, edhe raporti 17 me 11 nuk duhet shikuar si një raport përpjestimor sa i përket numrit, ngase te shumica e tipave të foljeve kemi të bëjmë me numër të kufizuar të foljeve. Siç dihet, numër i pakufizuar foljesh del vetëm te tipi i foljeve më -oj si dhe te ai me temë në bashkëtingëllore (pos nëntipit apofonik) dhe kur kihet parasysh se tema fjalëformuese edhe te këta dy tipa formohet mbi bazën e ish gegërishtes letrare, atëherë s'ka dyshim se numri më i madh i emrave të vepruesit del mbi këtë temë. Në 14 raste nuk është përfillur prapashtesa temëformuese e pjesores së letrarishtes së sotme më **-ur** që do të thotë se 14 herë është përdorur prapashtesa -

ë, karakteristike kjo e pjesores së ish-gegërishtes letrare. Të gjitha këto raste përfshijnë fojet me temë në bashkëtingëllore e në këtë kuadër edhe ato folje vokalike, të cilat e zgjerojnë temën me elementin -t, -jt- në pjesore dhe në të kryerën e thjeshtë. Në tri raste nuk është përfillur prapashtesa -r e letrarishtes së sotme, ndërsa në vend të saj ka vazhduar përdorimin e ashtuquajtura prapashtesë zero e ish-gegërishtes letrare. Në dy raste është respektuar prapashtesa -në dhe në një rast prapashtesa -ë, formante këto të përbashkëta për të dy ish- dialektet letrare: gegërisht, toskërisht. Në tetë raste respektohet prapashtesa përkatëse e letrarishtes së sotme, prej tyre 3 me prapashtesën -r (nga tema togzanore) dhe 5 raste me prapashtesën -rë (nga foljet me temë në zanore), për të gjitha këto në ish-gegërishten letrare kryesisht përdorej prapashtesa zero, përkatësisht trajta e ashtuquajtur e shkurtër e pjesores së gegërishtes për dallim ndaj trajtës tjetër të zgjeruar me prapashtesën -m (ë) si p.sh. : shue/shuem : shuar, zie/ziem : zier, krye/kryem : kryer, ba/bamë : bërë, shkri/shkrimë : shkrirë, ble/blemë : blerë, la/lamë " larë, fry/frymë : fryrë.

Për pika të caktuara nga pasqyra e mësipërme dalin çështje, që lypset sqaruar më tej, madje edhe ato mund të jenë të natyrës së morfologjisë historike, gjë që i kalojnë kompetencat e mia, megjithatë në vazhdim do të përqëndrohem në këto tri çështje:

e para, lidhet me raportin prapashtesë -ë të shfrytëzuar ndaj prapashtesës -ur të pashfrytëzuar;

e dyta, ka të bëjë me rastin e përdorimit të prapashtesës zero të ish gegërishtes letrare, kundrejt prapashtesës -r (dyzanor +r) të letrarishtes së sotme dhe

e treta, lidhet rreth parapëlqimit të prapashtesës -r përkatësisht -rë, kundrejt prapashtesës zero, përkatësisht trajtës së shkurtër të pjesores së ish-gegërishtes letrare.

1

Prapashtesa -ë e përdorur në të gjitha rastet kur në gjuhën e sotme letrare përdoret prapashtesa -ur gjithsesi nuk është përftim i rastësishëm. Nuk është supozim i pabazë fakti se pikërisht prapashtesa e tillë do ta ketë burimin te "formanti i pjesores me -të" që shihet i përftuar si infiks në formën -t-, -jt- te pjesoret dhe te tek e kryera e thjeshtë e foljeve me temë të zgjeruar me këtë element, siç janë shembujt: ruajtë/ruajtur, mbrojtë/mbrojtur, bujtë/bujtur, mbajtë/mbajtur. Prapashtesa -ë, siç e thekson prof. Shaban Demiraj "gjatë shekujve në të folmen gege është shtrirë për analogji edhe te pjesoret e të gjitha foljeve me temë në bashkëtingëllore" <§F Shih: Shaban Demiraj, Gramatika historike e gjuhës shqipe, Prishtinë 1988, f. 947.> . Lidhur me këtë nuk është i parëndësishëm konstatimi i prof. Idriz Ajetit se te Buzuku "vërtetohen trajtat:

ngjallunë dhe ngjallë" <\$F Shih: Idriz Ajeti, Studime gjuhësore në fushë të shqipes III, Prishtinë 1985, f. 189.> Sidoqoftë, vetë stabiliteti dhe përgjithësimi i variantit të pjesores më -ë si temë fjalëformuese për emrat në shqyrtim, tregon paqëndrueshmërinë e prapashtesës -ur (gegërisht -un) dhe njëherësh nbështet mendimin e A. Xhuvanit, i cili thekson qartë se "trajtat e pjesores me -të si mbajtë, ruejtë etj. janë primare dhe ato më -tur a -tun si mbajtur, ruejtun etj. janë sekondare" <\$F Shih: Aleksandër Xhuvani, Vepra I, Tiranë 1980, f. 251.>

Trajtës së tipit ruajtës, mbrojtës nuk mundi t'i qëndrojë në konkurrencë as mënyra e formimit të emrave mbi temën e së tashmes së dëftores, siç janë shembujt: ruanjës (nga S. Frashëri), mbronjës (nga Asdreni) e ndonjë tjetër, fakt ky që tregon qëndrueshmërinë e trajtave të pjesores me prapashtesën temëformuese -ë.

2

Sa i përket pranimit të pjesores së ish-gegërishtes letrare si temë fjalëformuese për emrat e vepruesit të tipit të foljeve më -oj dhe të një grupi më -ej të përfillur me prapashtesën zero -UE, përkatësisht -YE, kundrejt trajtës së papërfillur të letrarishtes së sotme: -UA/r, përkatësisht -YE/r, vlen të dihen këto dy fakte:

e para, që lidhet me paqëndrueshmërinë e prapashtesës dhe e dyta, që ka të bëjë me traditën e modelit fjalëformues.

Prof Shaban Demiraj ka konstatuar se edhe te ky tip i foljeve, përkatësisht te "pjesoret e gegërishtes më -oj dhe -ej si sulmuom / sulmuem, toskërisht: sulmuar, rrëfyem tosk. rrëfyer, prapashtesa -m (-r) nuk del si tregues i qëndrueshëm". Është e vërtetë se në toskërishte formimi i emrit të vepruesit nuk është praktikuar të bëhet mbi temën e pjesores së tillë, por mbi temën e trajtës të së tashmes së dëftores, siç është tipi i emrave sulmo(n)jës, rrëfenjës. Në gegërishte, siç është vërtetuar, që në krye të herës, del si të themi, si model u vijëzua formimi i emrave të vepruesit mbi formën e pjesores me mbaresë zero -UE, -YE, të tipit: sulmues, rrëfyes. Edhe në toskërishte, sipas modelit të gegërishtes pati ndonjë përfitim si: shpëtua, liruas, krijuas, por këta mbetën shembuj të papërgjithësuar. Sa i përket raportit sulmues / sulmonjës konkurrencën e fitoi trajta e parë, kështu që parashikimi i Mehmet Çelikut se "ngritja në normë e trajtës më -(ë)s e mënjanimi i trajtës -onjës do të shënonte një kristalizim dhe më të madh të strukturës fjalëformuese të gjuhës letrare shqipe" <\$F Mehmet Çeliku, Mbi ngritjen në normë të emrave e të mbiemrave të tipit sulmues (të botuar në librin "Norma letrare kombëtare dhe kultura e gjuhës" I), Tiranë 1973, f. 149.> u bë realitet, madje siç shkruan në gramatikën e gjuhës së sotme letrare "duke hyrë në gjuhën letrare format e këtij tipi kanë shërbyer edhe si model për

të krijuar fjalë të reja" <§F Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe II, Tiranë 1976, f. 102.>

Lidhur me paqëndrueshmërinë e prapashtesës -m (-r) te foljet e tipit më -UE, -YE fundor është mjaft simptomatik shfaqja e prapashtesës -t te pjesoret e tipit në -uaj, -ej dhe -oj që del në shkrimet e J. Bagerit, si p. sh. (me) kërkuet, gënjyet, mbaruet, gzuet, mësuet etj. <§F Sipas Sh. Demirajt vepra e cituar nën shënimin 3., f.942.> Te Fjalori i K. Kristoforidhit: i shquet i shuat <§F K. Kristoforidhi, Fjalor shqip-greqisht, rib., Prishtinë 1977, f. 347.> (i shuar) si dhe ne disa të folme të toskërishtes: shkrojtur, paguajtur, përlyetur etj. <§F Gjuha letrare shqipe për të gjithë, Tiranë 1976, 136 - 137.>

3

Vëmendje të posaçme zgjon çështja e parapëlqimit të pjesores së letrarishtes së sotme si temë fjalëformuese për tipin e emrave në shqyrtim, kundrejt trajtave të ish-gegërishtes letrare, të cilat nuk janë pa gjurmë edhe sot e kësaj dite. Arsytet për një parapëlqim të tillë mund të jenë të natyrës jashtëgjuhësore si dhe të asaj brendagjuhësore. Si arsye jashtëgjuhësore për favorizimin e kësaj trajte po përmend faktin se gjuha e sotme letrare në parim mbështetet kryesisht mbi bazë të toskërishtes dhe pikërisht në këtë bazë gjen mbështetje arsyeja fonemo - morfologjike, ngase trajta e pjesores së toskërishtes, përkatësisht tash e gjuhës së sotme letrare, paraqitet më e qëndrueshme ndaj asaj të gegërishtes. Derisa në të folmet e gegërishtes për tipat e foljeve në shqyrtim pjesorja del heterogjene shumëtrajtëse, si p.sh. nga folja shuaj del shue, shu, shuem, shuemun, shuenen; nga folja bëj: ba, bam, bamë, banen, bamun, bae, bë etj. në toskërishte kjo trajtë del njëformëshe: shuar, bërë dhe së këtejmi edhe emri i vepruesit me prapashtesën -(ë)s del: shuarës, bërës. Pra del më i kapshëm sesa b.f. shues, shus, shuemës ose bas, bamës etj. Lidhur me një parapëlqim të tillë po e shtoj edhe një fakt jo të parëndësishëm, i cili ka të bëjë me modelin që del nga vargu fjalëformues i prejpjesorëve në gjuhën e sotme letrare e në këtë kuadër ka rëndësi a ndikim të madh sidomos emri përkatës i veprimit.

Krahaso:

- (shuaj) shuar: shuarje, shuarës, i shuar, të shuarët,
e shuara, të shuarit;
- (kryej) kryer: kryerje, kryerës, e kryer, të klryerët, të kryerit;
- (bëj) bërë: bërje, bërës, i bërë, të bërët, të bërit etj.

Është e vërtetë se në ish-gegërishten letrare si më e përdorur dhe më e normëzuar dilte trajta e emrave të vepruesit si: shues, kryes, bles, shkris etj. d.m.th. të formuar mbi të ashtuquajturën

trajhtë të shkurtër të pjesores a të "formantit të shkurtër të participit të gegërishtes", siç e shënon prof. Idriz Ajeti <§F I. Ajeti, vepra e cituar në shënimin 4, f.189.> Çështë e drejta, në gegërishte si kundërvënie e trajhtës së tillë dilte edhe ajo e formuar mbi trajtën e zgjeruar të pjesores: shuemës, bamës, blemës, por që mbeten pothuajse trajta arkaike a sporadike. Është mirë që ta kemi në konsideratë dhe të mbajmë qëndrim për disa trajta si blues, kryes, shkris etj., të cilat i ndeshim në burime përkatëse dhe herë-herë edhe në përdorim të përditshëm. Trajttat e tilla për koncepte të caktuara (si terma), si të thuash, mbesin të ngurosura, por kur është fjala për koncepte të reja ato, sipas rregullit nuk aktivizohen më, ngase siç u tha më sipër, bien ndesh me prirjen fjalëformuese. Me fjalë të tjera trajta eventuale si blues, kryes etj. nëse ka arritur të fitojë cilësinë e një termi, mbetet të luftojë a të konkurrojë si rast i vetmuar për konceptin e caktuar e jo në kuadër të modelit. Modeli siç u tha, i favorizon trajttat e ndërtruara mbi pjesoren e letrarishtes së sotme, e cila shërben si temë fjalëformuese për tipin e foljeve të sipërcekura.

Lidhur me trajttat e tipit kryes, prus vërehet edhe një dukuri që ka të bëjë me dyfishimin e prapashtesës -(ë)s si b.f. kryesës, prusës, lasës <§F Lidhur me një dukuri të tillë shih: gazeta "Bujku", 2.II.1992 (dorasës), 22.VII.1992 f. 5 (kryesës), Asdreni përdor trajtën prusës, në Fjalorin shqip-serbokroatisht (1981) del trajta **gërgas** (f. 327), ndërsa në FGJSSH (1980) **gërgasës** (f. 546).> mbase si ngasës, vrasës, dorasës, dukuri kjo që nuk ka se si të ngjajë te trajttat b.f. kryerës, prurës, ngarës, vrarës, blerës, fryrës etj.

Gjithsesi parapëlqimi i trajttave të emrit të vepruesit mbi pjesoren e letrarishtes së sotme si temë fjalëformuese ndihmohet e ndërndikohet nga trajta gjegjëse e emrit të veprimit, i cili del në kuadër të vargut fjalëformues të pjejpjesorëve si model. Krahaso: kryerje/kryerës, fryrje/fryrës, larje/larës, e kështu me radhë.

Jam i vetëdijshëm se lidhur me temën ka mbetur edhe ndonjë çështje për t'u sqaruar më tej, por edhe kjo që u paraqit këtu besoj se mjafton sa për të tërhequr vëmendjen a sa për ta diskutuar ndonjë paqartësi rreth temës fjalëformuese të emrave në shqyrtim siç del b.f. në tekstin normativ "Gjuha letrare shqipe për të gjithë", ku me të drejtë thuhet se "si temë fjalformuese për emrat djegës, shitës (...) shërben pjesorja" <§F Sipas veprës së cituar në shënimin 10, f. 211.> por ilustrimi për formën e pjesores jepet: djegur-ur, shit-ur e jo: djegë, shitë, siç u cek këtu.

Pra, nga sa u tha më sipër, rregulla e paralajmëruar në titull mund të formulohet kështu:

I. Me pjesoren e ish-gegërishtes letrare emrin e vepruesit me prapashtesën -(ë)s e formojnë këta tipa të foljeve:

a) foljet me zanore të tipit -oj, -ej dhe -uaj me mbaresë zero në pjesore (-UE, YE), tipi: mësues, shpërblyes, shkrues;

b) foljet vokalike (të gjitha) me zgjerim të temës me -t-, -jt-, me prapashtesën -ë në pjesore, të cilat në letrarishten e sotme marrin prapashtesën temëformuese -ur, tipi: mbrojtës, ruajtës, vërejtës, mbajtës, bujtës, ngritës, vajtës;

c) një grup i vogël foljesh me -ej të cilat e zgjerojnë pjesoren me një -h- epentetike, siç është tipi: mbrehës si dhe

ç) të gjitha foljet me temë në bashkëtingëllore me prapashtesën -ë, e cila në letrarishten e sotme del -ur, tipi: matës, marrës, mpiksës, pajisës, palosës, radhutës.

II. Me pjesoren e shqipes së sotme letrare emrin e vepruesit me prapashtesën -(ë)s e formojnë këta tipa foljesh:

a) foljet me togzanor të tipit: shuar: shuarës, zier: zierës, kryer : kryerës;

b) foljet me temë në zanore të tipit që e bëjnë pjesoren me prapashtesën temëformuese -rë, tipi: fshirë: fshirës, bërë : bërës, larë : larës, blerë : blerës, fryrë : fryrës;

c) foljet me prapashtesën -në në pjesore, tipi: dhënë: dhënës, lënë : lënës dhe

ç) foljet apofonike me prapashtesën -ë në pjesore, tipi : marrë: marrës, vjelë : vjelës.

* * *

Nëse kam arritur me këtë paraqitje që sadopak të jap ndihmesë rreth përcaktimit të rregullës për formimin e emrit prejpjesor të vepruesit me prapashtesën -(ë)s në gjuhën tonë letrare kombëtare, synimin tim do ta quaja të arrirë. Marr guxim të them se zgjidhja e këtij problemi ndër-dialektor i vogël në dukje në kuadër të sistemit gramatiko-fjalëformues të gjuhës sonë letrare si sistem mbidialektor na i ofron premisat për zgjidhjen edhe të çështjeve të tjera më të mëdha në dukje, siç është edhe çështja e integritit të paskajores me + pjesore në shqipen letrare të standardizuar.

(nëntor 1992)

**3. FORMANTI -AS SI NDAJSHTESË E SPECIALIZUAR
PËR EMËRTIMIN E NJËRËZVE SIPAS VENDBANIMIT
A PREJARDHJES NË SHQIPEN LETRARE KOMBËTARE**

/ Punim studimor i botuar në revistën Jehona (Shkup), nr.9 -
10/95 dhe në "Gjurmime albanologjike, ser. e shk. fil.,
(Prishtinë), 25/95 /

Çdo gjuhë të zhvilluar e karakterizojnë modelet e qëndrueshme fjalëformuese e në këtë kuadër ndajshtesat e specializuara zënë vend të ndjeshëm. Edhe në procesin e zhvillimit të gjuhës sonë të standardizuar vërehen karakteristika të tilla. Lidhur me këtë para gjuhësisë sonë shtrohen detyra që jo vetëm të bëhen konstatime, por edhe të favorizohen zhvillimet e tilla. Në këtë kontekst këtu do të trajtohet funksioni i prapashtesës -AS dhe vendi i saj në strukturën e formimit të emrave të prejardhur në gjuhën tonë. Ç'është e vërteta, këtu do të përqëndrohem te prapashtesa -AS, e cila, si të themi, përdoret vetëpërvetëm për formimin e "emrave prej emrash" <§F Shih: A. Xhuvani - E. Çabej, Prapashtesat e gjuhës shqipe, te A. Xhuvani, Vepra I, Tiranë 1980, f. 446.> që si tema fjalëformuese janë kryekëput emra gjeografikë të përveçëm e të përgjithshëm, për dallim nga forma dyvariantëshe -AS/AZI me të cilën "formohen vetëm ndajfolje" <§F Gjuha letrare shqipe për të gjithë, Tiranë 1976 f.446.> prej temash të ndryshme. Emrat me -AS semantikisht i takojnë klasës së emrave të njerëzve që "tregojnë banorin e një vendi ose prejardhjen e tij nga një vend" <§F Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe II, Tiranë 1976 f.103.> , të cilët i ndeshim të formuar edhe me prapashtesa të tjera, siç janë: -JAN (-AN, -IAN), -AR, -AK (-NAK), -JOT (-OT), -OR, -A/LLI e ndonjë tjetër, mirëpo, siç thuhet në gramatikën tonë normative "më e përhapur ndër to është prapashtesa -AS" <§F Po aty f. 103.> . Konstatimi i mësipërm del faqeza e sforcohet edhe nga lënda e përfshirë në "Fjalorin e shqipes së sotme" e botuar si shtojcë me titull "Emërtimet e njerëzve sipas vendbanimit a prejardhjes" <§F Shih: Fjalori i shqipes së sotme, Tiranë 1984, shtojca me titull "Emrat gjeografikë, emërtimet e njerëzve sipas vendbanimit a prejardhjes dhe mbiemrat që lidhen me to" f. 1425 - 1460.> , ku shembujt përfaqësues me prapashtesën -AS zënë vend më shumë për kah numri se të gjithë shembujt me prapashtesat e tjera së toku. Gjithsesi formimi i emrave të tillë paraqet një model të qëndrueshëm fjalëformues në kuadër të strukturës së formimit të

emrave të prejardhur përgjithësisht në shqipe. Procesi i kristalizimit të një gjedheje të tillë fjalëformuese për emrat që tregojnë "banorin vendës të një shteti, qyteti, krahine a fshati a që ka prejardhje nga një vend" <\$F Po aty f. 1424.> mund të quhet përfundimisht i kryer për shumicën absolute të emërtimeve që kanë temë prodhuese një emër të përgjithshëm vendi dhe sidomos për ato emërtime që dalin nga një emër i përveçëm gjeografik, si p.sh. prishtinas (Prishtinë), tiranas (Tiranë), beratas (Berat) etj. Kështuqë sot për sot, për këtë tip emërtime mund të quhet i vjetëruar konstatimi i N. Joklit (që përmendet edhe nga Xhuvani - Çabej) <\$F Xhuvani - Çabej, vepra e cituar në shënimin 14, f. 447, 476, 513.> që ka të bëjë me supozimin se prapashtesa -AS dhe ajo -ËS janë identike a të barabarta dhe për këtë shënohet shembulli beratas beratës, ashtu si edhe vendas e vendës. Në letrarishten e sotme këto dy prapashtesa dalin të specializuara për nënklasa të ndryshme emrash: e para **për emrat e banorëve**, ndërsa e dyta **për emrat e vepruesit**.

Lidhur me emrat e vepruesit po e cek rregullën paksa më të plotë, e cila mund të përmblihet kështu: "Emrat e vepruesit, përkatësisht emërtimet e njerëzve sipas veprimtarisë a përkatësisë së tyre, nga temat fjalëformuese të burimit vendës, formohen me prapashtesën -S, kur tema është një folje (zakonisht në pjesore) dhe me prapashtesat -AR, -TAR (më shpesh) dhe -(Ë)S (më rrallë), kur tema fjalëformuese është një emër".<\$F Më gjerësisht në disertacionin e doktoratës të N. Veselajt me titull "Struktura e formëzimit të emërtimeve të njerëve sipas profesionit në gjuhën shqipe" (dorëshkrim), Prishtinë 1991.>. Si rezultat i një kundërvënijeje të tillë ndërmjet prapashtesave -AR, -TAR dhe -(Ë)S dhe asaj -AS të gjithë emrat si emërtime të njerëzve sipas veprimtarisë a përkatësisë së tyre nga e kaluara që mund të ndeshen në burime të caktuara të formuar me prapashtesën -AS <\$F Trajtat: **pelas, kambas, kankas** i ka shënuar ndër të tjera S. Shuteriqi si fjalë të leksikut të shqipes para Buzukut, shih te "Gjurmime albanologjike" 19/89, f. 324, 325, 348; te N. Frashëri, Vepra 6, Prishtinë 1978, ndeshim: mësimdhënas; A. Santori ka përdoror: qerras, zarritas, shih te revista" Jeta e re" nr 2/84; Te Fjalori i H. Bariqit ndeshim: yshtas, kullotas, kryeqytetas (na_elnik), Zagreb 1950); te Fjalori i gjuhës shqipe, Tiranë 1954: përbalcash, bashkëkohas. Trajta **rilindas** ndeshet në Fjalorin frëngjisht shqip të V. Kokonës (1977), në Fjalorin serbokroatisht - shqip (1974); në Fjalorin shqip - serbokroatisht të M. Ndrecës (1976), në Fjalorin shqip - greqisht të N. Gjinit (1971), në Fjalorin shqip - anglisht (Duro-Haso), rib. Prishtinë 1988 etj., ndërsa në Fjalorin shqip - serbokroatisht, Prishtinë 1981, janë shënuar të dyja trajtat, por aty trajta **rilindës** del e favorizuar.> si p.sh. pelas, kankas, kambas, qerras, zarritas, mësimdhënas, përbalcas, yshtas, kullotas, kryeqytetas (është fjala për udhëheqës qyteti), bashkëkohas,

rilindas e ndonjë tjetër në shqipen e sotme nuk dalin me -AS, por me prapashtesën tjetër përkatëse si: pelar, këngëtar, këmbës, qerrtar, zërritës (zë + rritës - thërritës), mësimdhënës, përbaltës, yshtës, kullotës, kryeqytetës (= kryetar bashkie), bashkëkohës, rilindës - e kështu me radhë.

Edhe pse ende do të ketë mbetur ndonjë paqartësi për ndonjë pikë rreth ndarjes së nënfushave të veprimit në letrarishten e sotme mund të thuhet me plotëgojë se çdo emër i formuar me prapashtesën -AS perceptohet pa mëdyshje si emërtim banori, prandaj lidhur me këtë mund të nxirret i drejtë gjykimi se formanti -AS në shqipen e sotme letrare ka karakteristikën e ndajshtesës së specializuar për formimin e nënklasës së emrave me të cilët tregohet njeriu sipas vendbanimit a prejardhjes nga ai vend.

Kjo që u tha më sipër është e saktë, por është i saktë edhe fakti se ndonjëri nga shembujt ilustrues që u cekën më sipër, siç janë trajtat përbalças, bashkëkohas e rilindas ende mund të paraqesë dilemë tek individë të caktuar. Trajta **përbalças** (si trajtë dialektore) e trashëguar nga P. Bogdani, arrin të regjistrohët në FGJSH (1954) përkrah trajtës **përbaltës**, të cilës në burimet e mëpastajme edhe i lëshon vendin përfundimisht. Trajta **bashkëkohas**, si trajtë e vetme përveç në FGJSH (1954) ndeshet e regjistruar edhe në burime të tjera, por në Fjalorin drejtshkrimor <§F Fjalori drejtshkrimor i gjuhës shqipe, Tiranë 1976, f. 62.> nuk figuron më në atë trajtë. Aty del vetëm në trajtën me -ËS **bashkëkohës**, trajtë kjo që vazhdon kështu të shkruhet edhe në burime të tjera normative. Trajta **rilindas**, edhe pse nuk është e regjistruar fare në FGJSH (1954), ndeshet pothuajse në të gjithë fjalorët zakonisht dygjuhësh të botuar në vitet '60 e '70, por në Fjalorin drejtshkrimor del në trajtën me -ËS **rilindës** <§F Po aty f.554. Po në këtë trajtë e ndeshim të shënuar në FGJSSH dhe në Fjalorin e shqipes së sotme (1984). > dhe kështu vazhdon në burimet e tjera normative. Vlen të tërhiqet vërejtje lidhur me këtë se përkundër kodifikimit të tillë, trajta **rilindas** vazhdon të përdoret me prapashtesën -AS relativisht shpesh, madje edhe nga autorë që kanë emër në punë shkencore. Relativisht shpesh kjo trajtë kështu po ndeshet edhe në gjuhën e shtypit <§F Shih te revista "Zëri" Prishtinë më 5.XI.1992, f.20; te gazeta "Zëri i popullit", 21.XI.1993, f. 4; gazeta "Shkëndija" (Prishtinë), 8.III.1993 f. 6 e 7; gazeta "Bujku", 7.III.1993, f.3 e 4; 18.III.1993, f. 7 etj.>. Lidhur me paqëndrueshmërinë e trajtave me -AS mjafton të ritheksoj rregullën që u tha në fillim se temat fjalëformuese: kohë-, rilindë-, përbaltë- nuk janë emra gjeografikë, por e para është emër kuptimi dhe dy të tjerat janë pjesore të foljeve përkatëse: rilindë (me rilindë), përbaltë (me përbaltë), prandaj nga temat e tilla, sipas rregullës që u tha, nuk mund të shprehet nocioni i njeriut sipas vendbanimit, por vetëm

nocioni i njeriut sipas veprimtarisë a përkatësisë (qoftë dhe në mënyrë figurative). Vërtet, emrat e tipit bashkëkohës, rilindës, përbaltës tregojnë njeriun sipas veprimtarisë së caktuar në një epokë të caktuar kohore a pjesëmarrjen e tyre në lëvizje të caktuara shoqërore dhe s' kanë të bëjnë fare me njeriun sipas vendbanimit. Pra, siç po shihet, kemi të bëjmë me fusha krejtësisht të ndryshme semantike, fusha këto që mund të nënkuptohen si të modifikuara edhe me ndihmën e prapashtesave të specializuara, përkatësisht -AS, -ËS. Prandaj është vepruar drejt në Fjalorin drejtshkrimor, ku sanksionohet ndarja a kristalizimi i funksioneve të prapashtesave, si të rastet e tipit: *beratas, prishtinas, tiranas* etj., ashtu edhe të rastet e tipit: *rilindës, përbaltës, bashkëkohës, zgjidhje* kjo që del e kodifikuar dhe e sanksionuar edhe sipas burimeve të tjera normative <§F Me burime normative kuptojmë në radhë të parë Fjalorin drejtshkrimor të gjuhës shqipe (1976), FGJSSH (1980) dhe FSHS (1984).>.

Në kuadër të rasteve që tërheqin vëmendjen, përveç asaj që u tha më sipër, specifikë të veçantë paraqet treshi sinonimik paralel i formuar nga tema e përbashkët prodhuese: **vend:** vendas vendar vendës, **katund:** katundas katundar katundës, **qytet:** qytetas qytetar qytetës, dhe **shtet:** shtetas shtetar shtetës, sidomos raporti ndërprapashtesor dhe semantik i trajtave që lidhet me këto ndajshtesa.

Me qëllim që ta kemi më të qartë rolin modifikues të ndajshtesave në fjalë lidhur me lëvizjet kuptimore, në vazhdim po paraqes skemën prej katër rubrikash duke e tërhequr vëmendjen të zberthimi dhe përkufizimi i dhënë:

Prapashtesa speciale	Shembujt	Zberthimi	Përkufizimi
1	2	3	4
-AS	vendas, katundas, qytetas, shtetas;	Ai që është banor i (+ emri temë-fjalëformues).	Emërtime të njerëzve sipas vendbanimit
-AR	vendar, katundar, qytetar, shtetar;	Ai që është veprimtar i (+ emri temëfjalëformues).	Emërtime të njerëzve sipas veprimtarisë (politiko - shoqërore)
-ËS	vendës, katundës, qytetës, shtetës.	Ai që është pjesëtar i popullësisë (+ emri temë fjalëformues)	Emërtime të njerëzve sipas përkatësisë (të popullsisë)

Siç po shihet nga skema prapashtesa -ËS del në kundërvënie

edhe ndaj prapashtesës -AR dhe që të tria janë në konkurrencë për të formuar emra paralelë të njerëzve nga tema e njëjtë fjalëformuese, por te secila vërehet njëfarë prirje për t'u specifikuar sipas nënfushës së caktuar semantike.

Pasi që ndarja e tillë funksionale e trajtave emërore sipas prapashtesave në fjalë nuk del qartë në burimet tona të sotme normative, por ka mbështetje si në traditë ashtu edhe në kërkesat e ditës e shoh të arsyeshme që në vazhdim të jap ndonjë sqarim a vërejtje lidhur me këtë.

E para, prapashtesa -AS, e cila del mbizotëruese në formimin e emrave të banorëve nga emrat e përveçëm gjeografikë, siç u tha më sipër, ka shtrirje përdorimi edhe tek emrat e tjerë të përgjithshëm gjeografikë, madje me tiparin e ndajshesës së specializuar, si p.sh.: bregas, bregdetas, breglumas, bregdrinas; anas, anadrinas, anamalas, prapamalas, tejmalas; tejdetas, përtejdetas etj, madje edhe nga tema ndajfoljore: lartas, përtejas <§F Shembujt janë vjelë nga burimet e sotme normative leksikografike.>, me të cilët tregohet emërtimi i njeriut sipas vendbanimit ku jeton a ka prejardhje që lidhet kuptimisht me temën fjalëformuese. Prandaj nuk ka kurrfarë arsye që të mos përdoren a aktivizohen trajtat me -AS si qytetas, katundas, vendas, ashtu siç është parapëlqyer edhe trajta shtetas. Po për konceptin përkatës mund të përdoren edhe kompozitat si: bashkëqytetas, bashkëkatundas, bashkëvendas ashtu si edhe bashkështetas. Me një sforcim të tillë përdorimi vetvetiu do të zhgarkoheshin nga kuptimi i tanishëm leksikor trajtat katundar, qytetar, vendës për atë pjesë të konceptit që ka të bëjë me banorin duke u lënë trajtave të tilla nën mbulesë vetëm koncepti i domosdoshëm që përshtat me specializimin e prapashtesës përkatëse, sipas përkufizimit nga skema e mësipërme.

Jo vetëm sa për kërshëri, po del e udhës të përmendet fakti se K. Kristoforidhi në Fjalorin e tij e shënon vetëm trajtën **qytetas**¹ çka do të thotë se shtrirja a zgjerimi i kuptimit të trajtës qytetar është i më vonshëm. Po ashtu trajta katundas nuk është e panjohur. Përmendet si shembull përfaqësues nga Xhuvani - Çabej "i **katundas**" <§F Xhuvani - Çabej, vepra e cituar në shënimin 14 të këtij punimi., f. 446.> dhe si emërtim banori përmendet jo vetëm në gjuhën e popullit, por edhe në Fjalorin e shqipes së sotme (1980), f. 1439 dhe 1443.

Sigurisht vlera e trajtave me -AS do të qartësohet edhe më, pasi të shihet roli i elementit modifikues i prapashtesave të tjera në shqyrtim.

E dyta, prapashtesa -AR, e cila ka karakter polisemik, përdoret edhe për emërtimin e njerëzve sipas vendbanimit, si p. sh.

¹ Shih: Fjalori i K. Kristoforidhit, f. 295.

korçar, kosovar, myzeqar etj; për emërtimin e veglave e të sendeve, si: koshar, grunar, kallamar etj., po si prapashtesë aktive në emërtimin e njerëzve sipas profesionit, e cila në konkurrencë me prapashtesën -TAR del edhe mbizotëruese në krijimet "popullore", siç është rasti te tipi kuptimor "sipas produktit të punës" <§F Sipas disertacionit të cituar në shënimin 21 të këtij punimi.> si p.sh.: opingar, poçar, vorbar etj., mirëpo pa konkurrencë paralele me simotrën -TAR kjo prapashtesë përdoret për emërtimin e njerëzve sipas veprimtarisë a pozitës politiko - shoqërore të tyre, si p. sh. familjar (kryefamiljar), pushtetar, kështjellar, kuvendar, urdhënar, pronar etj. dhe pikërisht në këtë nëntip emrash bëjnë pjesë edhe emërtimet: shtetar, vendar, katundar, qytetar.

Në burimet tona normative vetëm fjala **shtetar** është e sqaruar veçan në përputhje me përkufizimin e dhënë prej nesh. Fjala **vendor** del e regjistruar që në Fjalorin e K. Kristoforidhit e këtej dhe është pak e habitshme pse nuk u aktivizua për emërtimin e njerëzve të pushtetit në këshillat e vendeve, përkatësisht të bashkësive lokale, pasi që funksionalisht si term i përgjigjet organit pushtetor përkatës vendor. Sidoqoftë, një emërtim i tillë s' ka arsye të mos aktivizohet në stile të caktuara. Fjala **katundar** për konceptin "udhëheqës katundi" është e shënuar edhe në fjalorët normativë. <§F Shih edhe te Fjalori i shqipes së sotme, Tiranë 1984, f. 802.> Të kujtojmë faktin se Sami Frashëri termat **katundar** **nënkatundar** <§F Sami Frashëri, Vepra 2, Prishtinë 1978, f. 115, 118.> i përdor për nocionin kryetar nënkryetar bashkie (qyteti), gjithsesi shtrirja a ngurtësimi kuptimor i kësaj fjale vetëm si emërtim banori është i mëvonshëm. Për që trajta **qytetar** edhe sot e kësaj dite mbart konceptin e një veprimtari politiko - shoqëror mjafton të përmend togfjalëshat e qëndrueshëm: "qytetar nderi", "qytetar i dalluar", "qytetar i parë", "të drejtat e qytetarit" <§F Shih edhe te FGJSSH (1980), f.1424.> etj. veçori këto që nuk mund të thuhet se i përkasin banorit, sipas kuptimit asnjans.

Gjithsesi trajtat me -AR kanë ose mund të mbartin gjithandej konceptin e emërtimit të njeriut sipas veprimtarisë a pozitës shoqërore - politike, gjë që nuk mund të thuhet për trajtat me prapashtesën -AS.

E treta, edhe prapashtesa -(Ë)S ka tipare polisemike. Përdoret për emërtimin e veglave e të mjeteve, si p. sh.: përdorëse, çelës, petës, etj. Është prodhimtare dhe e specializuar për emërtimin e njerëzve sipas profesionit a veprimtarisë, zakonisht nga tema foljore, tipi: korrës, mësues, pyetës etj., por edhe nga tema emërore si p.sh. mullis, gjykatës, vorbës, lëkurës, lajmës etj. e në këtë kuadër hyjnë edhe emërtimet e njerëzve sipas përkatësisë së

popullsisë si dhe sipas pjesëmarrjes së tyre në lëvizjet e caktuara shoqërore - politike. Ndonjë emër i prejardhur me prapashtesën -ËS mund të ketë në vete të ngërthyer edhe konceptin e banorit si p.sh.: ndenjës, rrënjës, ashtu si edhe trajta vendës, por gjithsesi numri del fort i kufizuar. Te shembujt në shqyrtim semantikisht prapashtesa -Ë/S qëndron, pothuajse, ndërmjet prapashtesave -AS dhe -AR. Kjo ndërmjetësi del e dukshme edhe nga vetë përkufizimi që u dha në skemën më sipër, sepse te koncepti njeriu si pjesëtar aktiv i popullsisë vetvetiu nënkupton njeriun sipas veprimtarisë, por edhe njeriun si banor që jeton e vepron në atë vend. Kjo tejdukje del më e qartë me rastin e formimit të fjalëve të reja si dhe me rastin e përdorimit të fjalës me ndryshim kategorial, herë si emër e herë si mbiemër (i panyjshëm). Sa për ilustrim mjafton të konsultojmë përkufizimin që jepet për trajtën e favorizuar **vendës** në FGJSSH, ku emri vendës ngërthen dy kuptime, kuptimin e parë mjaft përgjithësues dhe të dytin disi më përcaktues. Aty saktësohet se me fjalën **vendës** emërtohet nën 1. banori i një vendi... anas, rrënjës dhe nën 2. "banori i një fshati, qyteti, krahine a shteti të caktuar... ku jeton e punon prej kohësh". Mirëpo kjo dykuptimësi vërehet edhe më qartë nga hartuesit e Fjalorit shqip - serbokroatisht (1981), ku për kuptimin e dytë shënohet fjala sqaruese "bashkëvendas" serb. stanovnik), kurse për kuptimin e parë shënohet togfjalësh i sqarues "ai që është i vendit, jo i huaj" (serb. meštanin) <§F Shih te Fjalori shqip - serbokroatisht, Prishtinë 1981, f. 990.>, d.m.th. shprehet koncepti për njeriun si pjesëtar i popullsisë, koncept ky që nuk ndalon në nocionin e thjeshtë të banorit, por kalon edhe në funksionin e aktivitetit të tij. Le të krahasohen në këtë kontekst shprehjet: "është vendës" d.m.th. "jo i huaj" e së këtejmi: gjuhë vendëse, biznesmen vendës - vendës; "është vendës" d.m.th. "jo ardhës"; milic (polic) vendës - vendës. Po kështu: kuadër vendës - vendës etj. Po kjo ecuri mund të zbatohet edhe për shembuj të tjerë në shqyrtim. Pra sikurse gjuhë e vendit/gjuhë vendi/gjuhë vendëse - vendëse, po ashtu mund të dalë edhe valle e katundit/valle katundi/valle katundëse - katundëse ose valle e qytetit/valle qyteti/valle qytetëse - qytetëse, ashtu sikurse ka qenë praktikuar: shkollë katundi / shkollë katundëse - katundëse (shkollë), ashtu siç quheshin në të vërtetë shkollat e katundit (3-vjeçare) ndaj shkollave të qytetit - qytetëseve (4-vjeçare) <§F Shih edhe te Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, Tiranë 1980, f. 1624.>. Sikurse trajtat: katundës, qytetës, vendës, trajta këto që janë të regjistruara në burimet normative, supozoj se mund të dalë analogjikisht edhe trajta **shtetës**, edhepse nuk ndeshet e regjistruar kështu në asnjërin nga burimet përkatëse normative të gjuhës sonë. Pra ngjashmërisht me trajtat: banori i shtetit = shtetas, burri i shtetit = shtetar edhe pjesëtari "qytetari" i shtetit mund të quhet shtetës. Dalja e fjalës **shtetës** në situata të caktuara njëherazi e sforcon por edhe e diskuton qëndrueshmërinë e

trajtave **shtetas** dhe **shtetar**. Sipas mendimit tim për nocionin që ka të bëjë me emërtimin e njeriut si pjesëtar aktiv i popullsisë dhe që lidhet me të drejtat dhe detyrimet e "qytetarit" fare natyrshëm mund të dalë trajta shtetës. Së këtejmi "qytetarët" që marrin dy shtetësi, ata gjithsesi nuk mund të jenë shtetas me kuptimin "banorë" të dy vendeve, por mund të jenë **shtetës** të atyre dy vendeve (shteteve) dhe për këtë si qytetar aktivë (pra si shtetës) kanë përgjegjësitë, detyrimet, por edhe të drejtat e tyre, por edhe shteti, më drejt shtetet, në anën tjetër, kanë detyrim ndaj tyre d.m.th. ndaj shtetësve të vet. Mendimi im del më i qartë, pikërisht kur trajtohet qëndrueshmëria e emërtimit **nënshtetas**. trajtë kjo që del e diskutueshme për arsye se bërthamat fjalëformuese në këtë fjalë dalin pa lidhshmëri logjike. Dihet se parashtesa e specializuar fjalëformuese **nën-** mbart në vete konceptin e varësisë, të përlules a të nënshtrimit dhe në rastin konkret kjo varësi qëndron ndaj bërthamës temëformuese, fjalës **shtet** e jo ndaj fjalës **shtetas**. Sipas konceptit që shprehet fjala e tillë do të hynte te tipi i emrave të formuar me para -prapashtesim njëherazi, siç është b.f. emri nëpunës, meditës etj., pra forma në fjalë sipas rregullit duhet të dilte **nënshtetës** (nën+shtet+ës) e jo nën + shtetas nënshtetas. Në të vërtetë, nocioni që shpreh fjala e tillë përputhet me barasvlerësit përkatës të fjalëve të huaja, si p.sh. it. suditto, seggetto, fr. syjet, gjerm. Untertan, serbokr. podanik, podlo_nik, të cilat sidomos si mbiemra tregojnë njeriun "nënshtetës" d.m.th. të nënshtruar ndaj shtetit (pra jo ndaj shtetasve!). Prandaj trajta shtetës për një koncept të tillë del e arsyeshme dhe gjithsesi e nevojshme për mos me thënë e domosdoshme. Trajta shtetës e sidomos nënshtetës (me prapashtesën -ËS) mund të përlligjet nga pikëpamja fjalëformuese dhe nga emri shtetësi, pasi që prapashtesa -ËSI është një "konglutinat" nga -ËS + I, siç e thotë N. Jokli, përkatësisht emri i tipit shtetësi "është një zgjerim i emrave të vepruesit me -ËS me anë të prapashtesës -I", si: gjakës gjakësi, grykës grykësi, katundës katundësi, siç e theksojnë Xhuvani - Çabej <\$F Xhuvani - Çabej, vepra e cituar në shënimin 14 të këtij punimi, f. 480.>. Në rastin konkret gjithsesi del më e përlligjur trajta me -ËS: nënshtetës, shtetës, ndërsa trajta shtetas (por jo nënshtetas) mund të mbetet vetëm për pjesën e nocionit që ka të bëjë me banorin e shtetit e jo për koncepte të tjera.

Përkundër faktit se te trajtat me -AS ku kuptimi pothuajse nuk lëviz, te trajtat me -Ë/S kuptimi lëviz, priret të kalojë në fusha të tjera semantike, siç janë edhe rastet: administratë vendëse (vendore a vendësore) <\$F Trajtën **vendësore** për "lokale" e shënon prof. A. Kostallari në punimin "Gjuha letrare kombëtare dhe epoka jonë", shih te Studime mbi leksikon ... III, Tiranë 1989 f. 20.> në vend administratë lokale, komunikacion qytetës <\$F FGJSSH f. 1624.> a qytetor në vend komunikacion urban, komunikacion

ndërqytetës a ndërqytetor në vend komunikacion ndërurban etj.

Shkaku pse në burimet normative të gjuhës sonë nuk janë shënuar qartë përkufizimet si dhe trajtat, siç u cekën këtu, sipas gjykimit tim, qëndron në faktin se kjo çështje nuk është trajtuar deri më tash me kompetencën e seriozitetin që meriton. Favorizimi i trajtave të veçanta si vendës: katundar, qytetar, shtetas, siç del në FGJSSH, kundrejt trajtave të tjera paralele si: vendas, katundas, qytetas, shtetës, mund të quhet i rastësishëm dhe jo me mbështetje të forta. Mendoj se në të ardhmen nuk do të ketë asnjë të keqe, nëse trajtat e tashme të pafavorizuara në burimet përkatëse të shënohen sipas diferencimit semantik që shprehin a prirjen të shprehin, ashtu siç po theksohet këtu. Një diferencim i tillë mbase tashpërtash mund të jetë jo aq i dukshëm, por besoj se në të ardhmen do të jetë më i vërejtshëm dhe gjithsesi edhe i nevojshëm, kur kemi parasysh kërkesat në rritje që shtrohen para gjuhës sonë për të shprehur ide e nocione edhe më të ndërlikuarat, siç janë edhe ato që sapo u ceken pak përpara në këtë punim.

Nga tërë kjo që u tha më sipër mund të nxirret si përfundim se emrat e formuar me prapashtesën -AS lidhen kryekëput me nocionin e banorit, ndërsa ata me -AR dhe -ËS, mbartin në vete elemente të nocionit të tillë, por njëherësh përthithin e shprehin edhe koncepte të tjera, për çka në të vërtetë, dalin të ngarkuar a të specializuar, siç është nocioni i emërtimit të njeriut sipas veprimtarisë, ai sipas përkatësisë, pozitës shoqërore etj. Në rastet e tilla nocioni i emërtimit të njeriut sipas vendbanimit, edhe pse nuk duket i zhdukur ai mund të jetë i errësuar sadokudo sa i përket qartësisë, siç u përpoqëm ta dëshmojmë te shembujt: vendës, qytetar, katundar. Sidoqoftë, sipas normës së sotme letrare te rastet e tilla, ku nocioni i banorit shprehet, qoftë me prapashtesën -AR, qoftë me prapashtesën -Ë/S, nuk paraqet kurrfarë lajthitje, ndërsa ngjan e kundërta, nëse b.f. nocioni i njeriut sipas veprimtarisë a përkatësisë shprehet me prapashtesën -AS, siç ishin trajtat rilindas, bashkëkohas etj. d.m.th në raste të tilla kemi shkelje të normës semantike dhe drejt-fjalëformuese. Në këtë vazhdë vlen të përmendet si lajthitje e rëndë përdorimi, pa vend pra, i trajtës **shtetas** vetëpërvetëm, por edhe në kompozitën **burrështetas**, e cila po ndeshet jo rrallë te ne për konceptin e njeriut sipas veprimtarisë a pozitës.

Shembuj të tillë eklatant patëm rastin të lexojmë edhe në gazetën "Bujku", të datës 22.II.1993 f. 1, ku shkruhej se në Tiranë "u zhvillua një dialog në mes të gazetarëve dhe të shtetasve T. Ozal dhe S. Berisha". Sigurisht në vend të fjalës **shtetas** "**shtetasve**" (!) është dashur të jetë fjala **shtetar** "**shtetarëve**". Po për një koncept të tillë nuk qëndron as kompozita në formën **burrështetas**, e cila po ndeshet mjaft shpesh në gjuhën e shtypit te ne si p.sh. te gazeta "Shkëndija" e datës 26.X.1992, f. 8; te

revista "Zëri", datë 13.III.1993, f. 10 si dhe në mjaft numra të gazetës "Bujku", siç patëm rast të lexojmë edhe në atë të datës 23.II.1993, f. 1, ku shkruhej se "dr.Rugova u bëri homazh dy krijuesve dhe burrështetasve të mëdhenj shqiptarë" (F. Nolit dhe F. Konicës).

Te kompozita **burrështetas** nuk kontestohet komponenti i parë **burrë-**, fjalë kjo e cila figurativisht në kontekste të caktuara mbart ngjyresat stilistike që shprehen edhe me togfjalëshat si: burrë fisi, burrë bese, burrë ode, burrë fjale e së këtejmi edhe **burrë shteti** me kuptimin "njeri i shquar në veprimtarinë shtetërore e shoqërore", por kontestohet komponenti i dytë: fjala në trajtën **shtetas**, e cila i është pranëvënë fjalës burrë-, pothuajse, në mënyrë arbitrare, sepse nuk u qëndron kriterëve semantike e as atyre fjalëformuese, sepse është rast pa model dhe bie ndesh me vetë kuptimin e brendshëm të bërthamave fjalëformuese të kompozitës. E kemi të njohur faktin se për të shprehur emërtimin e njeriut sipas veprimtarisë nga fjala temëprodhuese shtet- përdoret trajta **shtetar**, që u përmend më përpara, e cila shpjegohet me barasvlerësin: "**burrë shteti**" (shumës burra shteti a burra të shtetit dhe që të dyja këto forma njëjës: shtetar e burrë shteti në kontekste të caktuara e shprehin nocionin në fjalë, prandaj nuk di sa del e nevojshme dhe e arsyeshme të farkëtohet edhe ndonjë sinonim tjetër, mirëpo po deshëm të krijojmë sinonime, të cilat në stile të caktuara kurrë nuk janë të tepërta, atëherë më natyrshëm do të dilte kompozita në trajtën **burrështetës** sesa ajo burrështetas.

Për këtë ka argumente të forta logjike. U tha më përpara se personaliteti i tillë është burrë (veprimtar) i shtetit: burrë shteti, veprim ky që lidhet kushtëzimisht me punët e shtetit, përkatësisht lidhet me fjalën **shtet** e jo me fjalën **shtetas**. Ai, ç'është e drejta, nuk është burrë i shtetasve (!), d.m.th. i banorëve, por siç u tha është "personalitet që udhëheq e drejton" <§F Po aty f. 201.> punët e shtetit. Supozimi se fjala e tillë mund të arsyetohet me "burrë shtetas" a "shtetas burrë" si "shtetas trim" nuk qëndron, nuk ka kurrfarë modeli, ndërsa trajta burrështetës, sikurse nënshtetës, edhe pse nuk duket se i takon një modeli të specializuar aktiv mund të krahasohet me rastet e ngjashme si p.sh. kryegjykatës, shtypshkronjës, lugëlëngës, bashkëkohës, dalzotës, nënujës etj. Gjithsesi bën pjesë në strukturën a sistemin fjalëformues të modelit: temë emërore + formanti -Ë/S, tipi lajmës (lajm + ËS lajmës).

Sipas mendimit tim, nuk ka kurrnjë të keqe nëse zbatohet po ky kriter edhe për rastet debatikas, kastriotas, teknikumas, skënderbegas <§F Trajtat **debatikas teknikumas** që i ndeshim të shënuar në FGJSSH (1980) nuk dalin të regjistruar në Fjalorin e shqipes së sotme 1984, mbase edhe ky fakt flet për pasivizimin e

trajtave të tilla më -AS. Fjalën **kastriotas** (jo si emërtim banori) e ndeshim në Fjalorin shqip - serbokroatisht (1981) f. 413, ndërsa trajta **skënderbegas** (e kemi me të dëgjuar), përdorej për emërtimin e nxënësve (kadetëve) të një shkolle ushtarake të Tiranës.> , fjalë - terma këta të së kaluarës, me të cilët emërtohej pjesëtari i një organizate politike a shkollore. Prandaj po që nevoja të ripërtërihen a të përdoren fjalët e tilla e të ngjashme me to, më drejt do të ishte, për arsyet që u thanë më sipër, që të përdorej trajta me -ËS (njëjës edhe shumë): debatikës, kastriotës, teknikumës, skënderbegës, sesa ajo me -AS.

Në rastet dysore, siç janë trajtat e formave nga tema e njëjtë fjalëformuese, mendoj se zgjidhja më i mirë do të ishte që të dyja trajtat të jenë të lejueshme, por të përdoret trajta me -AS kur mbizotëron kuptimi i banorit si p. sh. bashkëkombas, <§F Në FGJSSH është shënuar trajta më -ËS: bashkëkombës (f. 112), ndërsa në Fjalorin e shqipes së sotme trajta më -AS: bashkëkombas (f. 67).> bashkëfisas, bashkëvendas, bashkështetas, kryeqytetas - ndërsa me prapashtesën -ËS kur mbizotëron kuptimi i tiparit që lidhet me emërtimin e njeriut sipas veprimtarisë a përkatësisë si p. sh: bashkëkohës, kryefis a kryefisës, bashkëvendës, burrështetës, nënshtetës, kryeqytetës.

Hiq shembujt që u diskutuan më sipër mund të deklaroj me përgjegjësi se në letrarishten e sotme nuk del aktiv asnjë emër vepruesi i formuar me prapashtesën -AS. Në këtë kontekst nuk duhet të na hutojë emri **doras**, term ky i trashëguar nga e drejta kanunore që ka kuptimin "ai që vriste dikë me dorën e vet", edhe pse nga pamja e jashtme mund të zbërthehet si një emër i prejardhur: dorë + AS. Në të vërtetë, fjala e tillë është një kompozitë e përbërë prej dy emrash: dorë dhe ras (rënës, ramës) - **dorëras** <§F Për trajtën dorëras, shih *Kanuni i Lekë Dukagjinit*, Gjeçovi, Vepra I, Prishtinë 1985 f. 51, 160 etj.> . Pra kemi të bëjmë me një përngjizje të dy fjalëve me elidim brenda tyre, pra dorëras do të thotë "ai që binte (godiste) me dorë dikë". Etimoni i kësaj fjale të përbërë është: leksema DORË- + emri prejpjesor -RAS (nga pjesorja -RA + prapashtesa -S).

Sikurse emri **ras** <§F Më gjerësisht shiko në disertacionin e cekur në shënimin 21 të këtij punimi.> (i ndërtuar nga tema e trajtës së shkurtër të pjesores së gegërishtes me prapashtesën -S) në burimet e caktuara të gjuhës sonë mbi bazë nga dialekti i gegërishtes ndeshen mjaft shembuj si: vras (vrasës, vrasës a vramës), las (larës a lamës), das (ndarës a ndamës), gërgas (gërgasës a gërgamës) etj.

Gjithsesi konstatimet a vërejtjet që u dhanë këtu duhet të kihet në konsideratë edhe nga kuadrot kompetentë si dhe ata të

shtypit, në mënyrë që mos të bëhen lajthitje. Strukturës së modelit fjalëformues të tipit: temë emërore + formant duhet t' i shtohet edhe nëntipi i veçantë: temë emërore + formanti -AS <§F Jani Thomaj në veprën me vlerë "Prejardhja semantike në gjuhën shqipe", Tiranë 1989, në *Pasqyrën* e strukturës së prejardhjes semantike (f. 254), ndër tipat temë emërore + formant = emër, nuk e shënon veçan tipin më -AS. Aty jepet shembulli: **beratas**, bashkë me atë **dibran**.> duke e përcaktuar qart si model për emërtimin e njerëzve sipas vendbanimit a prejardhjes dhe njëherësh të tërhiqet vërejtje lidhur me përdorimin pa vend të trajtave si rilindas, bashkëkohas në vend të trajtave të normëzuara me prapashtesën -Ë/S: rilindës, bashkëkohës etj. Gjithashtu duhet të favorizohen edhe trajtat debatikës, teknikumës, skënderbegës etj. e jo ato me -AS, si dhe njëherësh duhet të tërhiqet vërejtje për mos ngatërrimin e trajtave shtetas me shtetar dhe të kristalizohet, nëse del e nevojshme përdorimi i trajtës burrështetës kundrejt asaj burrështetas, e cila nuk duhet të përdoret fare. Në këtë kontekst duhet të tërhiqet vërejtje që emërtimet e njerëzve sipas vendbanimit për rastet ende të pasanksionuara që ndërtohen nga emrat e përveçëm gjeografikë, mos të ndërtohen me prapashtesë çfarëdo, si b. f. me prapashtesat: -Ë/S, -OR, -Ë, madje edhe -AR e -AK, po në radhë të parë ato të bëhen me prapashtesën -AS. Lajthitje të tilla pata rast të ndesh p. sh. në emërtimin "kapëshnicësit" për banorët e Kapëshnicës, një lagje të Pejës, në vend "kapëshnicasit"; opojarët, për banorët e Opojës (krahinëz e Dragashit), në vend opojanët a opojasit; "kuvajtjarët" në vend "kuvajtjanët"; "fushë - krutanët" për banorët e Fushë-Krujës, në vend "fushëkrujasit". Pastaj "abricasit" në vend "abriasit" (pra pa c-në epentetike(!)) për banorët e fshati Abri (Obri) <§F Shembujt e diskutueshëm janë ndeshur në burime të ndryshme, por më tepër në gazetën "Bujku", si p. sh.: **kapëshnicësit** më 23. II. 1993, f. 6; **opojarët**, më 19. I. 1993 f. 8; **kuvajtjarët**, më 28. II. 1993, **abricasit**, më 12. I. 1993; te gazeta "Fjala" nr. 6/93 f. 2: "**fushë-krutanët**" etj.> etj.

Shembujt, si më sipër, të cilët nuk janë në numër të vogël, shtrojnë kërkesën që çështja e emërtimit të njerëzve sipas vendbanimit a prejardhjes, përkatësisht çështja e përzgjedhjes dhe e favorizimit të prapashtesave të caktuara duhet të shqyrtohet më me kompetencë.

Ç' është e vërteta, nga një vështrim jo sipërfaqësor që i kam bërë çështjes së konkurrencës së prapashtesave sinonimike që shërbejnë për emërtimin e njerëzve sipas vendbanimit kam arritur në përfundimin se poqese favorizohet në mënyrë të vetëdijshme prapashtesa -AS në kooperim me prapashtesën -JAN (që të dyja polisemisht të pangarkuara) do të plotësonin të gjitha kërkesat për emërtimet në fjalë. Madje jo vetëm për çdo rast të ri, por edhe për

raste të tjera të diskutueshme. Me një fjalë, me një veprim të tillë do të mund të pasivizoheshin prapashtesat e panevojshme me origjinë të huaj si: -A/LLI, -JOT (-OT), -IT, madje edhe ndonjë vendëse minore për këtë nëntip, si: -OR, -Ë/S, -ËR etj. dhe njëherësh do të kristalizohej më mirë përdorimi apo jo i prapashtesës -AR si dhe të asaj -AK për këtë nëntip emërtime.

Në fund marr guximin të shpreh mendimin tim se nuk duhet të konsiderohen shkelje e rregullave fjalëformuese, nëse parapëlqehen trajtat me -AS e -JAN te rastet që mund të integrohen në këtë model si p. sh.: **kaçinaras** për kaçinarës, **shkrelas** për shkrelës, **qelezjan** për qelezor, **mirditas** për mirditor, **ashtjan** për ashtësor, **osnatas** për osnatër, **krasniqas** për krasniq, **kolshjan** për kolsh, **drenicas** a **drenicak** për drenicar, **shikjan** për shikjor, **shkalljan** për shkalli <§F Shembujt që diskutohen janë nxjerrë nga Shtojca e cituar në shënimin 18 të këtij punimi.> etj., edhe pse trajtat e tilla të diskutueshme mund të ndeshen si trajta të lejueshme në burimet përkatëse normative, siç është edhe Fjalori i shqipes së sotme (1984).

Me parapëlqimin e prapashtesave përkatësisht; AS e -JAN për emërtimet në fjalë prapashtesat jo të favorizuara për këtë nëntip emërtime do të jenë të lira të konkurrojnë e të aktivizohen për tipa e nëntipa të tjerë në fushat përkatëse semantike.

Sidoqoftë, prapashtesa -AS ka të gjitha karakteristikat e një ndajshtese të specializuar për nënfushën semantike të emërtimeve të njerëzve sipas vendbanimit a prejardhjes në shqipen standarde kombëtare.

P ë r f u n d i m

Në kontekst të strukturës së fjalëformimit të emrave të prejardhur zë vend të dukshëm edhe prapashtesa -AS, e cila në formimin e emërtimeve të njerëzve sipas vendbanimit a prejardhjes, qysh me kohë ka marrë karakteristikat e një ndajshtese të specializuar. Në zhvillimin e një procesi të tillë vërehen dy dukuri: e para me karakter integrues, ngase gjithnjë e më shumë po kristalizohet modeli dhe po shtohet numri i emërtimeve në fushën semantike në fjalë dhe e dyta, ka të bëjë me karakterin kundërvënës, sepse me favorizimin e prapashtesës -AS vetëm për fushën e përmendur janë përjashtuar, përkatësisht në letrarishten e sotme dalin të diskutueshme të gjitha trajtat e emrave me -AS që i takojnë ndonjë fushe tjetër semantike, siç janë rastet rilindas, bashkëkohas, nënshtetas, burrështetas, madje edhe teknikumas, debatikas etj., të cilat sipas rregullës që po theksohet në këtë punim marrin a duhet të marrin prapashtesën -Ë/S, të specializuar për fushën semantike të emërtimeve të njerëzve sipas veprimtarisë a

përkatësisë ose pozitës së tyre në shoqëri: rilindës, nënshtetës, bashkëkohës, teknikumës, skënderbegës etj.

Ndër çështjet e diskutueshme a ende të pakristalizuara në punim u veçua treshi paralel i emrave që dalin nga tema e njëjtë fjalëformuese si: vend: vendas, vendar, vendës; katund: katundas, katundës, katundar; qytet: qytetas, qytetës, qytetar dhe shtet: shtetas, shtetës, shtetar. Me këtë rast u konstatua se me prapashtesën -AS ekskluzivisht shprehet koncepti i njeriut sipas vendbanimit a prejardhjes së tij, ndërsa me prapashtesat -AR dhe -Ë/S, përkatësisht shprehet koncepti i emërtimit të njeriut sipas veprimtarisë ose përkatësisë së tij. Nga ky këndvështrim si dhe nga këndvështrimet e tjera argumentohet fakti se prapashtesa -AS paraqitet jo vetëm si ndajshtesë e dalluar, por edhe e specializuar për formimin e emërtimeve të njerëzve sipas vendbanimit a prejardhjes dhe se në strukturën e modeleve fjalëformuese duhet të zërë vendin përkatës si tip i veçantë.

Gjithsesi një fakt të tillë duhet ta kenë në konsideratë autoritetet tona kompetente të gjuhësisë dhe ta favorizojnë këtë prirje në kuadër të strukturës përkatëse të gjuhës sonë standarde kombëtare.

4 . RRETH FORMIMIT ME PRAPASHTESIM TË EMRAVE TË SENDEVE NË SHQIPEN LETRARE

Hyrje në temë

Ndonëse rreth formimit me prapashtesim dhe përgjithësisht të emrave të sendeve, d.m.th. emërtimit të gjësendeve a gjërave të lëndëta nga bota jo e gjallë si dhe të mjeteve të llojllojshme, veglave, përdorëseve, aparateve, pajisjeve, makinave dhe të pjesëve të tyre, qoftë të thjeshta qoftë të përbëra, në gjuhën tonë, me sa dihet, nuk ndeshet ndonjë punim i veçantë, kjo temë nuk del e paprekur a e patrajtuar fare në burimet përkatëse teorike të gjuhësisë sonë.

Ç'është e vërteta, në gramatikën normative të gjuhës sonë letrare (Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe II, botim i ASHSH, Tiranë 1976), gjë që është shumë pozitive për kohën kur është botuar, emërtimet e sendeve zënë njërin nga pesë grupet e emrave të merenduar "sipas kuptimit që kanë". Në këtë burim, i cili do të jetë strumbullar mbështetës gjatë shtjellimit të këtij punimi, emërtimet e grupeve përkatëse ashtu si edhe ato të grupit të sendeve shoqërohen edhe me shembuj konkretë sipas prapashtesave "të specifikuar" përkatëse për secilin grup veç e veç, skemë kjo, të cilën shkurtazi të përmbledhur po e paraqit fill, pasi që kjo pikënisje do të na shërbejë një si bazë për ta kuptuar më lehtë dhe më drejtë objektivin që synohet të arrihet në këtë punim.

Skema e grupimit të emrave sipas kuptimit me prapashtesat e specifikuar

-
1. **emra personash** sipas mjeshtërisë që ushtrojnë ose vendit ku banojnë: -(ë)s; -ar, -tar, (-atar); ak, -as; -(j)an, -it, -jot (iot);
 2. **emra sendesh**: (ë)s; or(e), -ar; -esë, -je; -ishte, (ë)sir(a), -urin(a), ac, ace, -e;
 3. **emra vendesh**: ishte (-ishtë), -ore, -tore, -inë, -ajë; -i, -si.
 4. **emra nocionesh abstrakte**: -i, (ë)si, (ë)ri; -shmëri;
 5. **emra emocionalë**:
 - a) **zvogëlimi, përkëdheljeje**: -th, -zë, -ush, -ushkë, -kë, -ickë, -ko, -çe;
 - b) **keqësues a përbuzës**: -ac, -acuk, -alaq, -aluq, -alec, arash, -avec, -aman, -arash e disa prapashtesa të tjera më të rralla.

Pra, siç po shihet nga grupimi i mësipërm "emrat e sendeve" përbëjnë grupin e dytë sipas radhës, por sa i përket specifikimit të prapashtesave aty përzgjedhja nuk del fort e qartë, madje as në analizën që pason për secilin grup emrash veç e veç, shikuar sipas gjendjes dhe kritereve të sotme, paraqitja nuk është complete. Pos disa të dhënave jo të parëndësishme paraqitja përgjithësisht nuk del e plotë as lidhur me emrat me prapashtesim të sendeve, edhe pse aty jepen konstatime jo me pak interes.

Konstatimet nga gramatika normative

Ndër të tjera nga gramatika në fjalë del me vend konstatimi se për formimin e emrave të sendeve në "gjuhën e sotme letrare" përdoren "prapashtesa të ndryshme", madje edhe ato që duken të angazhuara a të specifikuar edhe në nënfusha të tjera semantike. Është për t'u vënë re për të mbarë fakti se në këtë "analizë" për ilustrim jepen shembuj përkatës përfaqësues sipas prapashtesave të cekura me konstatimet përkatëse, të cilat vështruar nga koha e sotme, siç do të vërtetohet, jo të gjitha dalin me qëndrueshmëri të padiskutueshme.

Së pari, shënohen prapashtesat: **-(Ë)S**, **-OR(E)** dhe **-AR**, të cilat, siç thuhet aty, "shërbejnë për të formuar edhe emra personash".

1. Si shembuj ilustrues me prapashtesën **-(ë)s** që tash në analizë del e shënuar **-(ë)s(e)** jepen emrat: *çelës, matës, ndezës, petës; grykëse, ndenjës, përparës*. Nga vetë trajta e shkruar me (e) në kllapa: **-(ë)s(e)** nënkuptohet se funksionalisht kemi të bëjmë me dy prapashtesa të mëvetësishme: mashkullorëzuesen **-(Ë)S** dhe femërorëzuesen **-(Ë)SE**.

2. Edhe te trajta tjetër **-or(e)** nënkuptohen dy formante të pavarura, të mashkullores **-or** dhe të asaj femërore **-ore**, por sipas sqarimit, përkatësisht shembujve të regjistruar aty, shihet qartë se me përparësi numri qëndrojnë emrat me prapashtesën **-ore**, ngase "me anën e prapashtesës **-or(e)** - siç thuhet aty - formohen sidomos emra të gjinisë femërore dhe pak emra mashkullorë, që emërtojnë sende të ndryshme, midis tyre edhe vegla, sipas lëndës (materialit) ose shërbimit që kryejnë" dhe për ilustrim jepen shembujt: *akullore, avullore, fletore, gushore, qafore, qarkore, rregullore, verore dhe qumështor*.

Përfaqësimi i emrave më **-OR** vetëm me një shembull, me shembullin *qumështor* e dëshmon konstatimin e mësipërm.

3. Edhe lidhur me prapashtesën tjetër në vazhdim **-ar** që në tekst tash shënohet **-ar(e)** nënkuptohet e njëjta gjë, d.m.th. funksionalisht dalin dy prapashtesa të mëvetësishme: **-ar** dhe **-are**. Aty jepet konstatimi se "formimet me prapashtesën **-ar(e)** janë të pakta".

Për ilustrim jepen shembujt: *ditar, koshar, vjetar* si dhe *dritare*. Në bazë të shembujve të dhënë edhe këtu shihet se përparësi u jepet trajtave të formuara me prapashtesën **-ar**, pasi që me të jepen tre shembuj përfaqësues, ndërsa vetëm një jepet me femërorëzuesen **-are**.

Së dyti, jepen shembuj edhe me formantet **-ESË** dhe **-JE**, të cilat cilësohen si "prapashtesa të emrave abstraktë".

1. Si shembuj ilustrues me prapashtesën **-esë**, jepen këta emra sendesh a "veglash": *fërgesë, fshesë, kullësë, shkresë, urdhëresë*.

2. Lidhur me formimin e emrave të sendeve me prapashtesën **-je** edhepse thuhet se "janë të paktë", aty jepen këta këta katër shembuj ilustrues: *këmbje, sheshje, mbathje, veshje*.

Së treti, me **-ISHTE**, e cila del e angazhuar edhe për emrat e vendeve, ashtu si edhe prapashtesa tjetër **-AC (-ACE)**, e përfshirë në grupin e emrave emocionalë keqësues, shembujt ilustrues nuk janë të shumtë.

1. Për formimet me **-ishte** që thuhet se "janë të pakta", për ilustrim jepen këta dy shembuj: **barishtet/t, farishte/t** që, siç shihet nga forma jepet edhe sqarimi se "përdoren zakonisht vetëm në shumës".

2. Në "Shënim" si emra sendesh me prapashtesën **-ac** jepen shembujt: *thumbac, kupac*.

Së katërti, jepen shembuj ilustrues edhe me trajtat e përbëra prapashtesore: **-(ë)sir(a), -urina** si dhe ajo e thjeshta **-e**.

1. Me "prapashtesën **-(ë)sirë**, siç konstatohet aty, formohen emra që karakterizojnë një send nga pikëpamja e një tipari të tij, të shprehur nga një mbiemër" dhe për ilustrim jepen shembujt: *ëmbëlsirë, kalbërsirë, vjetërsirë, vogëlsira/t*.

2. Me prapashtesën **-urina**, e cila, siç thuhet aty "është prapashtesë prodhimore", ngase "me anë të së cilës", formohen emra që tregojnë "zakonisht një shumicë llojesh të ndryshme të një sendi ose sendesh të një lënde", si p. sh: *degurina, halurina, hekurina, mbeturina, pemurina, plaçkurina, qelqurina, shpesurina*.

3. Edhe me prapashtesën **-e**, jepen vetëm dy shembuj karakteristikë: *argjende, bakëre*, raste këto kur formanti **-E** ka marrë vlerë të prapashtesës fjalëformuese. Për këta dy emra thuhet

se "përdoren vetëm në shumës dhe kanë kuptim kolektiv".

Së pesti, në analizë (Shënim) pikërisht lidhur me emrat e sendeve ceken edhe dy prapashtesa të tjera: **aç(e)** dhe **-ashkë** që nuk dilnin të shënuara në paraqitjen e mësipërme, siç e pamë te skema e grupimit të emrave sipas kuptimit.

1. Me prapashtesën **-aç(e)** jepen shembujt ilustrues: *gemaç, lugaç; furkaçe, ngarkaçe;*

2. Me prapashtesën **-ashkë**, jepen shembujt: *dorashkë, gjurmashkë.*

/Mungesa e prapashtesave **-aç(e)** dhe **-ashkë**, në skemën e sipërshënuar, por që dalin në "analizë", ku jepen edhe shembujt përfaqësues ilustrues, mbase do konsideruar si gabim shtypi, gjë që s' mund të thuhet ashtu edhe për trajtat: **-(ë)se** dhe **-are./**

Sidoqoftë, lënda e paraqitur në këtë burim sigurisht do të shërbejë mirëfilli si një bazë e fortë prej kah duhet mbështetur në çuarjen më tej si dhe në zberthimin për së mbari të çështjes në shqyrtim.

Si qëndron gjendja e lëndës së tillë në burimet leksikografike: FGJSH 1954 dhe FSHS 1984?

Për të pasur ide edhe më të qartë rreth problematikës që po trajtohet këtu me qëllim të verifikimit të të dhënave të cekura më sipër, si dhe për të konstatuar qoftë prirjet rreth shumësisë (prodhimtarisë) së emërtimeve të sendeve sipas prapashtesave përkatëse, qoftë për të njohur më për së afërmi specifikimin e formanteve të caktuara ekskluzivisht për këtë profil të nënfushës semantike, u vol dhe u trajtua materiali përkatës nga dy burime të mirëfillta të leksikografisë sonë: nga *Fjalori i gjuhës shqipe*, Tiranë 1954 (në tekstin e mëtejme: **FGJSH 1954**) dhe nga *Fjalori i shqipes së sotme*, Tiranë 1984, (në tekstin e mëtejme: **FSHS 1984**) duke përfshirë kështu një periudhë kohore 30 vjeçare mjaft intensive të jetës dhe të zhvillimit të emrave në shqyrtim në kuadër të shqipes letrare të prezentuar në burimet në fjalë.

Përveç 12 prapashtesave të sipërcekura në pasqyrën e mëposhtme u morën në konsideratë edhe 11 të tjera, të cilat për arsye të ndryshme dalin të vërejtshme lidhur me temën e shtruar. Sa ishte e drejtë përzgjedhja e tillë le të gjykohet sipas të dhënave që dalin në pasqyrën e mëposhtme dhe mbi bazë të sqarimeve që jepen lidhur më to:

PASQYRA E NUMRIT TË EMËRTIMEVE MË PRAPASHTESIM TË SENDEVE

SIPAS FGJSH (1954) DHE FSHS (1984)

Nr. rendor	Prapashtesa FGJSH 1954	Burimi leksikografik FSHS 1984	Vërejtje
A. Prapashtesa të cekura:			
1. a)	-(Ë/UE)S	30 a 6.9%	160 a 17.0%, 5.03 herë më shumë;
b)	-(Ë/UE)SE	4 a 0.9%	90 a 9.5%, 22.5 herë më shumë;
2. a)	-OR	5 a 1.1%	27 a 2.8%, 5.6 herë më shumë;
b)	-ORE	50 a 11.5%	150 a 15.9%, 3.0 herë më shumë;
3. a)	-AR	10 ose 2.3%	27 a 2.7%, 2.8 herë më shumë;
b)	-ARE	18 ose 4.1%	30 a 3.1%, 3.2 herë më shumë;
4.	-ESEË	21 ose 4.8%	40 a 4.2%, 1.07 herë më shumë;
5.	-JE	4 ose 0.9%	24 a 2.5%, 6 herë më shumë;
6.	-ISHTE/ISHTE	3 ose 0.6%	8 a 0.8%, 2.6 herë më shumë;
7.	-(Ë)SIR(A)	3 ose 0.6%	5 a 0.5%, 1.6 herë më shumë;
8.	-URINA	10 ose 0.6%	24 a 2.5%, 2.1 herë më shumë;
9.	-C/ÇË (AC/ACE)	30 ose 6.9%	20 a 2.1%, 1.05 herë më pak;
10.	-ASHKË	3 ose 0.6%	7 a 0.7%, 2.3 herë më shumë;
11.	-Ç/ÇË (AÇ/AÇE)	15 ose 3.4%	28 a 2.9%, 1.9 herë më shumë;
12.	-E	19 ose 4.3%	26 a 2.7%, 1.4 herë më shumë.
B. Prapashtesa të tjera:			
1.	-(Ë)Z a ZË	80 a 18.4%	130 a 13.8%, 1.6 herë më shumë;
2.	-TH	10 a 2.3%	10 a 1.0% pa ndryshim numri;
3.	-ËL a LË	12 a 2.7%	15 a 1.5% 1.2 herë më shumë;
4.	-EZË	4 a 0.9%	4 a 0.4% pa ndryshim numri;
5.	-IM	6 a 1.3%	24 a 2.5% 4 herë më shumë;
6.	-K a KË	11 a 2.5%	9 a 0.9% 1.2 herë më pak;
7.	-(A)NIK	4 a 0.9%	10 a 1.0% 2.3 herë më shumë;
8.	-INË	3 a 0.6%	8 a 0.8% 2.6 herë më shumë;
9.	-(N)ICË	13 a 3.0%	3 a 0.3% 4.3 herë më pak;
10.	-Ë	40 a 9.2%	56 a 5.9% 1.4 herë më shumë;
11.	-ULL	25 a 5.7%	25 a 2.6% pa ndryshim numri;
Gjithsej:		433	941

Sqarimet e nevojshme lidhur me të dhënat nga "Pasqyra"

Nga shuma e tërësishme e numrave për secilin burim veç e veç u nxor përqindja për secilin formant, pastaj u krahasua shuma në të dyja burimet duke konstatuar për secilin formant të dhënë: sa herë më shumë, pa ndryshim numri ose sa herë më pak.

Sic po shihet nga shuma e tërësishme që arrin shifrën 941 në

FSHS (1984) dalin 508 shembuj më shumë kundrejt shumës 433 nga FGJSH (1954). Ç'është e vërteta, sa i përket saktësisë, numri i caktuar, në një farë mënyre, mund të jetë i diskutueshëm për këto katër arsye:

e para, ka raste që varësisht nga kriteri i vlerësuesit duke u bazuar në temën e qartë motivuese fjalëformuese, një formant herë konsiderohet i mirëfilltë e herë jo;

e dyta, për hir të praktikës së punës variacionet e caktuara rrumbullakësohen në një trajtë si p. sh. -ël e -lë, -c(ë/-ac/e), -(a/n)icë, -ç (-aç/-çë/çe /açe), -k (-kë, -ak) etj., edhe pse në raste të caktuara, secili variant mund të konsiderohet prapashtesë më vete;

e treta, ndonjë shembull mund të jetë trajtuar se i takon formimit me prapashtesën përkatëse, edhe pse tema a primitivi i fjalës së caktuar del apo ka mundësi të dalë vetëm asociacionisht në bazë të modelit, madje ndodhin raste kur një trajtë në burim të caktuar ndeshet e shënuar si emër i grupit tjetër kuptimor, por në praktikë si dhe analogjikisht del a mund të dalë normalisht edhe si emërtim sendi dhe

e katërta, mbase gjatë njehësimit ndonjë shembull mund t'i ketë ikur syrit të vjelësit pa qëllim.

/Këtu në mjaft raste nuk është hyrë, pra, në mundësinë e reflektimeve figurative si dhe polisemike e homonimike të emrave të caktuar./

Sidoqoftë, edhe nëse del i vërejtshëm ndonjë lëshim nga arsyet e mësipërme, për mendimin tim, nuk do të ketë pësojë të rëndë në konkluzionet e përgjithshme, madje edhe në konstatime të veçanta që do të jepen në punim, ngase 2 a 3 shembuj, më shumë ose më pak, për lëndën që po trajtohet, përkatësisht për objektivin që synohet, mund të jenë të tolerueshëm. Këtu e kam fjalën, qoftë sa i përket përqindjes së nxjerrë, qoftë në raportin e shumësisë (prodhimtarisë) për më pak a për më shumë, edhe pse nuk mohohet atraktiviteti i shembujve të veçantë.

Vërejtjet eventuale lidhur me këtë pikë do të jenë të mirëpritura.

Para se të japim ndonjë veçori karakteristike për secilin formant veç e veç, po jap edhe njëherë pasqyrën e mësipërme, por në version tjetër, ku të dhënat vlerësohen sipas destinimit në këto katër rubrika:

1. vendi i prapashtesave sipas radhës, varësisht nga sasia e

numrit të emërtimeve që vlen për tri rubrikat e tjera;

2. dhe 3. përqindja e përbërjes sipas burimit përkatës dhe

4. raporti i ndryshimit që del nga krahasimi i lëndës ndërmjet këtyre dy burimeve.

Pasqyra e përqindjes dhe ndryshimi i numrit të emrave me prapashtesim të sendeve sipas radhës së përparësisë për nga sasia

Radhitja e prapashtesës		B u r i m i		N d r y s h i m i	
		FGJSH	FSHS		
		(443 shembuj)	(941 shembuj)		
1	2	3	4		
1. -zë	18.4%	-(ë)s	17.0%	-se, më shumë për	22.5 herë
2. -ore	11.5%	-ore	15.9%	-je	6.0 "
3. -ë	9.2%	-zë	15.8%	-or	5.6 "
4. -s e -cë nga	6.9%	-se	9.5%	-(ë)s	5.03 "
5. -ull	5.7%	-ë	5.9%	-im	4.0 "
6. -esë	4.8	-esë	4.2%	-are	3.2 "
7. -e	4.3%	-are	3.1%	-ore	3.0 "
8. -are	4.1%	-aç(e)	2.9%	-ar	2.8 "
9. -aç(e)	3.4%	-or	2.8%	-inë dhe -ishtë	2.6 "
10. -(n)icë	3.0%	-ar e -e	2.7%	-ashkë dhe -(a)nik	2.3 "
11. -ël	2.7%	-ull	2.6%	-urina	2.1 "
12. -k(ë)	2.5%	-je, -urina dhe nga	2.5%	-aç(e)	1.9 "
13. -th e -ar nga	2.3%	-c(ë)	2.1%	-(ë)sirë	1.6 "
14. -im	1.3%	-ël	1.5%	-ë dhe e	1.4 "
15. -or	1.1%	-th e -(a)nik) nga	1.0%	-lë	1.2 "
16. -je, -(ë)se, -ezë, dhe nga	0.9%	-k(ë)	0.9%	-esë	1.07 "
17. -ishtë, (ë)sirë, -urinë, -inë e nga	0.6%	-inë e ishtë nga	0.8%	-th, -ull e -ezë	pa ndryshim numri më pak për 1.05 herë
18. -	-	-ashkë	0.7%	-(a)C	
19. -	-	-(ë)sirë	0.5%	-k(ë)	1.2 "
20. -	-	-ezë	0.4%	-(nicë)	4.3 "
21. -	-	-(n)icë	0.3%	-	-

U manipulua me gjithsej 26 prapashtesa, me 443 shembuj në

FGJSH 1954 dhe 941 shembuj në FSHS 1984.

Lidhur me paraqitjet e mësipërme nga pasqyrat e të dy versioneve del e nevojshme të jepen disa sqarime apo më mirë të ritheksohen të dhënat me interes të cekura në Pasqyrë:

1. Siç po shihet ndërsa në FGJSH 1954 numër më të madh emërtimeve ndeshim me prapashtesën **-zë** (80 ose 18.4%), më **-ore** (50 ose 11.5%), më **-ë** (40 ose 9.25%), më **-(ë)s** (30 ose 6.9%), **-cë** (30 ose 6.9%), **-ull** (25 ose 5.7% e kështu me radhë, në FSHS del radhitje tjetër. Aty numrin më të madh e ndeshim me prapashtesën: **-(ë)s** (160 ose 17.0%), **-ore** (150 ose 15.9%), **-zë** (130 ose 13.8%), **-se** (90 ose 9.5%), **-ë** (56 ose 5.9%), **-esë** (40 ose 4.2%) e kështu me radhë.

2. Nga krahasimi i numrit të emërtimeve sipas burimeve përkatëse për secilin formant veç e veç doli se:

a) Shtim më të madh të shembujve kemi te formimi me prapashtesën: **-se**, shih raporti 4 me 90, që do të thotë për 22.5 herë më shumë, **-je**, për 6 herë më shumë, **-or** për 5.6 herë më shumë, **-(ë)s** për 5.03 herë më shumë, **-are** 3.2 herë më shumë, **-ore** 3 herë më shumë... dhe kështu me radhë.

b) Numër të njëjtë a pa ndryshim numri ndeshim te formimet me prapashtesat: **-ezë**, **-ullë**, **-th**, po kjo nuk do të thotë se nuk ka emra të rinj të formuar me këto formante.

c) Numër më të vogël emrash të sendeve ndeshim te formimi me prapashtesën **-k(ë)** (11 me 9 ose 1.2 herë më pak), me prapashtesën **-(n)icë** (13 me 3 ose 4.3 herë më pak dhe më **-c(ë)** (30 me 20 që do të thotë 1.05 herë më pak). Mirëpo te rasti i fundit kemi të bëjmë me pakësim numri të varianteve të ndryshme me elementin **-C** e jo aq me trajtën **-cë**, siç do të shohim në vazhdim.

Siç mund të shihet, në dhjetëshin e parë, sipas radhës së shumës së përqindjes së numrit në të dyja burimet qëndrojnë këto prapashtesa: **-ore**, **-ëz**, **(ë)s**, **-ë**, **-esë**, **-are**, **-aç** dhe **-e**, të cilat mund të cilësohen si prapashtesa me vazhdimësi specifikimi, edhe pse në gramatikë të cekura qartë a si të favorizuara, në një farë mënyre, dalin vetëm prapashtesat: **-ore**, **(ë)s**, dhe **-esë**. Madje e cekur por jo e favorizuar del edhe prapashtesa **-e**. Siç po shihet nga lënda e trajtuar nga dy burimet e konsultuara "u zbuluan" prapashtesat e mirëfillta prodhimitare: **-ëz**, **-ë**, **-are**, **-aç** që nuk ishin të shënuara në skemë. Në FSHS 1984, gjithashtu "u zbulua", prodhimitaria e emërtimeve të sendeve me prapashtesën **-se** (22.5 herë), **-je** për 6.0 herë, **-or** (5.6 herë etj.) si dhe pakësimi i formimeve me prapashtesën **-icë** (4.3 herë). Këto risi që dalin nga krahasimi i lëndës së përfshirë në FSHS 1984 kundrejt asaj në FGJSH

1954 që nuk dalin të shënuara në burimet tona normative të fjalëformimit, sigurisht do të kihen parasysh në të ardhshmen, ngase të dhënat e tilla "të reja" plotësojnë sadokudo imazhin rreth specifikimit të prapashtesave lidhur me emrat e sendeve në gjuhën letrare shqipe.

Sido që të jetë, rezultati që doli nga vjelja e materialit, vetvetiu i bën të diskutueshme mjaft konstatime që dilnin të cekura në gramatikën normative të sipërpërmendur dhe shtron nevojën për sqarime të nevojshme plotësuese që disa prej tyre do të përpiqem t'i jap më poshtë:

1) Siç po shihet nga Pasqyra, tri formantet e para (ë)s(e), -or(e) dhe -ar(e) në këtë punim u zbërthyen në gjashtë sosh:
-(ë)s, -(ë)se, -or, -ore, -ar, -are.

Pikërisht është funksioni ai faktori i rëndësishëm si dhe numri relativisht i madh i shembujve në kundërvënie që duhen pasur në konsideratë me rastin e arsytimit të një gjykimi të tillë, d.m.th. për përligjien e mëvetësisë së ndajshtesave në fjalë.

2) Siç dihet emrat e sendeve kanë vetëm gjini gramatikore e jo edhe atë natyrore, siç e kanë emrat e njëjërve dhe të kafshëve, prandaj del krejt e natyrshme që në emërtimin e sendeve prapashtesa përkatëse të mos jetë e kushtëzuar në raportin koncept-objekt, ku do të jetë e përfshirë edhe kategoria e gjinisë natyrore: qoftë mashkullore, qoftë femërore, megjithatë po të shikohet çështja nga një prizëm më i gjerë dhe njëherazi dhe më i ngushtë, ndarja e prapashtesave sipas gjinisë së emrave natyrorë ka lidhje dialektike të tërthortë edhe me emërtimin e sendeve të pagjini. Kështu në mjaft raste kemi të bëjmë me emërzimin mbiemrave, të cilët siç dihet përshtatin domosdo sipas gjinisë së emrit përkatës, pastaj edhe te emërtimet e sendeve asociacionisht ndikon gjinia gramatikore e emrit, me një fjalë edhe nga ky aspekt formal del e pranishme dukuria e kundërvënies prapashtesore.

3) Në gjuhë është i njohur fakti se kur sendi zëvendëson funksionalisht vepruesin - subjektin njeri, ai asociacionisht merr trajtën e emërtimit të vepruesit, kështu që, fjala vjen, kur personi njeri në bazë të veprimtarisë që kryen quhet b.f. **shkrues** dhe po këtë funksion a ngjashëm me të e kryen një aparat (send), atëherë edhe ai send normalisht mund të quhet **shkrues** (edhepe mbart në vete homonimi (ngatërresë kjo mbase fillimisht e vogël), mirëpo në anën tjetër nëse kemi të bëjmë me një vegël a makinë që paksa ndryshon për nga funksioni, është krejt e natyrshme dhe e pranueshme logjikisht e gjuhësisht që për t'i ikur homonimisë emërtimi i sendit (veglës, makinës) zakonisht të dalë në gjininë tjetër: femërore b.f. **shkruese** (vegël a makinë shkruese) apo në raste të veçanta të marrë zgjerim prapashtesë, siç mund të dalë

trajta: **shkruesor** a **shkruesore**.

Një zgjidhje e tillë me kundërvënie gjinie, si me thënë, është praktikuar në praktikën e deritashme të shkrimit të emërtimeve të njerëzve sipas profesionit a veprimtarisë së tyre. Profesionet, përkatësisht emërtimet e njerëzve sipas veprimtarisë zakonisht i ndeshim të shënuara në gjininë përfaqësuese mashkullore. Kështu dalin pothuajse në të gjitha emërtesat (nomenklaturat e profesioneve). Përjashtim bën vetëm ndonjë rast i rrallë. Mbase kjo praktikë është, si të thuash, njëri nga faktorët që ka ndikuar, sidomos në kohë të vona, që në shqipen letrare nga prapashtesat **-ës, -ar, -tar** e ndonjë tjetër (që konsiderohen si prapashtesa të mirëfillta të emërtimeve të njerëzve sipas profesionit) për nga funksioni, të shkëputen si kundërvënie, me një fjalë të mëvetësohen plotësisht prapashtesat femërorëzuese: **-(ë)se, -ore, -are** dhe të specifikohen ato për emërtimin e sendeve etj. Për këtë gjykim mbase mjaftojnë të dhënat nga Pasqyra e mësipërme. Të gjitha formimet me këto prapashtesa shënojnë rritje të dukshme.

4) Fakti i mëvetësisë së prapashtesave në fjalë del qartë sidomos në emërtimin e sendeve edhe nga vetë ndërkundërvënia e tyre në kuadër të strukturës së numrit të tërësishëm të formimeve me prapashtesim, siç po shihet sadokudo edhe në Pasqyrën e sipërparaqitur, ku secili formant del me karakteristika të veçanta, siç do të shohim në vazhdim.

A. Veçori të shembujve sipas prapashtesave të cekura në gramatikë

Në vijim do të japim pikërisht karakteristikat më të dallueshme që dolën nga krahasimi i materialit të regjistruar në të dy fjalorët e sipërcekur normativë sipas formanteve prapashtesore të cekura në gramatikën normative të gjuhës sonë letrare.

1) Është i njohur fakti se prapashtesa **-(ë)s** del si prapashtesë e specializuar për emërtimin e emrave prejfoljorë të vepruesit, por kjo prapashtesë del e angazhuar edhe mbi fjalë-tema emërore.

Kjo rrugë fjalëformuese do të zbatohet komplet edhe për emrat e sendeve. Në burimet e sipërcekura gjendja e emrave të sendeve më **-(ë)s** del si vijon:

a) Mbi bazë të temës emërore ndeshim shembujt: barkës, cfytës, gishtës, krahës, kripës, okës, lugës, rojës, skupës, shkumës, tymës, shalës (FGJSH); kularës, dhëmbës, gurës, grykës, dorës, kokës, trupës, shilarës, shulës, ujës etj. (FSHS).

b) Mbi temë foljore: çelës, hollonjës, kapës, larës, livarës, matës, mblatës, mbyllës, mëshils (mbëshils), ngrehës (ngrefës),

spërkatës, tundës (FGJSH); dhenës, fryrës, endës, gdhendës, gërries, hipës, heqës, lëkundës, marrës, mbathës, mbushës, mbështjellës ndarës, ndëzës, ndërçelës, nxehës, kapërcyes, përheqës, lidhës, lagës, larës, lëvarës, lyrës, ndjellës, ngrehës, ngjitës, rrahës, stërllagës, stërfytës; shpërndarës, shtyrës, shtytës, tredhës, zbardhës, thithës, zënës, shfryrës, shkrehës, shkrepës, shpëllarës, shtjellës, shuarës, tundës, ushqyes (FSHS); si dhe mbi temë të foljes më -Oj; krues (me krue) (FGJSH); ajruës, bombarduës, drejtues, çues, dezinfektues, gërmues, grumbullues, latues, ndriçues, ngacmues, ngjyruës, nivelues, numëruës, orientues, përçues, përrshpejtues, rikumbues, rregullues, pikues, përforcues, kallëzues, lëshues, lirues, lyrësues, veçues, vërtetues, udhëzues, tbardhues, shkarkues, shkruës, shpejtues, shumëzues, tokëzues (FSHS);

c) Në formime kompozitash ndeshim: radiomarrës dhe ujësjellës (FGJSH); ndërsa në FSHS: ajkëmatës, ajërmatës, ajërftohës, ajërnxjerrës, akullçarës, akullthyes, avullsjellës, avullmatës, erëmatës, erëregues, dendurimatës, brazdëhapës, gazmatës, gazsjellës, gurhedhës, naftësjellës, gurëmprehës, gurshkrepës, gjysmëpërcjellës, gjysmëpërçues, kanalhapës, kohëmatës, ngrohësimatës, plisathyes, rrufepritës, qiellgërvishtës, radiodhënës, ujësjellës, shimatës, voltmatës, valëpritës, valëthyes, shtyllërrokës, vetëshkrues, vetveprues, vëllimmatës, insektvrasës, ujëshkarkues.

Sa i përket shumë së numrit vërehet rritje në të gjitha nëntipat, por sidomos mbi temë të foljeve më -Oj si dhe te kompozitat.

Edhe pse homoniminë me emrat e njerëzve sipas veprimtarisë e zbut sadokudo vetë konteksti, po e cek sa për kërkësi të dhënën se ndërsa në FGJSH (1954) numri i emrave të sendeve më -S dhe i njerëzve sipas veprimtarisë ishte pothuajse i barabartë 30 me 27, në FSHS (1984), ky numër ndryshon në dobi të emërtimeve të njerëzve sipas profesionit, kështu emrat e sendeve më -s kapin shumë 160, ndërsa emrat e njerëzve sipas veprimtarisë me këtë formant arrin në 390 shembuj, d.m.th. 230 shembuj më shumë, pa përmendur rastet kur edhe në Fjalor jepet rekomandimi se emërtimi i sendit (mjetit) se përparësi i jepet trajtës me femërorëzuesen -se.

2) Lidhur me prapashtesën **-(ë)se** raporti i numrit të emërtimeve del kështu:

Në FGJSH 1954 ndeshim vetëm pak raste: kapëse, ndenjëse, përdorëse edhe përparëse, ndërsa në FSHS 1984 numri i tyre shënon rritje të dukshme, del për 22.5 herë më shumë, kundrejt burimit të parë, kështu që:

a) mbi temë emërore dalin këta shembuj: anëse, barkëse, birëse, gjunjëse, grykëse, krahëse, tymëse dhe përparëse e përfundëse (mbi temë ndajfoljore);

b) mbi temë foljore (në temë në bashkëtingëllore): fryrëse, fshirëse, gërryese, hedhëse, kositëse, krehëse, grirëse, kapëse, korrëse, kositëse, lagëse, lidhëse, lyese, mbajtëse, mbushëse, mbështjellëse, mjelëse, ndenjëse, ndjellëse, ngjitëse, përzierëse, prerëse, përtypëse, prashitëse, përdorëse, përfundëse, përmbrojtëse, rrahëse, rrëshqitëse, spërkatëse, shirëse, shkrepëse, shpërndarëse, shkrifëse, shtypëse, tharëse, thyerëse, varëse, zënëse; si dhe mbi temë të pjesores së foljes më -OJ: pastruese, çuese, kruese, gatuese, ngarkuese, shtruese.

c) në bazë kompozite: ajërshpërndarëse, akullmbajtëse, akullthyesë, dallgëpritëse, darëprerëse, duarlidhëse, dhëmbkruese, gazhedhëse, letërpërcjellëse, letërthithëse, letërprerëse, zjarrfikëse, rrobalarëse, xhamprerëse, duarlarëse, dhenxjerrëse, enëlarëse, farëhedhëse, gurëthyese, libraprerëse, lulembajtëse, petkalarëse, pjatalarëse, pluhurthithëse, tapënxjerrëse.

Siç po shihet nga numri i shembujve të shënuar pikërisht me këtë prapashtesë kemi të bëjmë me shumim numri dhe si duket arsyeja del, siç u tha paksa më sipër, jo vetëm për të mos krijuar homonimi të panevojshme me emrat e njerëzve të gjinisë mashkullore, si gjini kjo përfaqësuese "zyrtare" për emërtimin e njerëzve sipas profesionit, por edhe për faktin se vetë mjetet (sendet) dalin të llojllojshme dhe kështu bëjnë trysni që të dallohen edhe në të shkruar edhe nga llojet e tjera të profilizimit të veglave brenda vetë strukturës së emrave të sendeve, por edhe të vetë veglave që, varësisht nga destinimi, ndryshojnë qoftë për nga forma, qoftë për nga funksioni etj.

3) Me prapashtesën **-or** në FGJSH 1954 i ndeshim vetëm pesë emërtime të sendeve mbi temë të qartë fjalëformuese: bishtor, fjalor, lakror, uror dhe vargor, ndërsa në FSHS 1984 ndeshim një shumim të konsiderueshëm, katër herë më shumë, siç janë shëmbujt: armor, cingor, djathor, fiçor, gardhor (gardhënor) kungullor, qumështor, pasqyror, shalor (shalator) shelqeror, shilor, thartor, veçor, si dhe shëmbujt: ajkëtor, kraharor, shelqeror, vizgator, por edhe më -(ë)sor: anësor, ballësor, njehësor, pyetësor etj.

Në praktikën tonë gjuhësore numri i emërtimeve të tilla del edhe më i madh. Sido që të jetë, shihet njëfarë shumimi të formimeve me këtë formant, kundrejt FGJSH 1954.

Edhe lidhur me këtë formant sa për kërshëri po cek faktin se prapashtesa -OR nuk është aktive në formimin e emrave të njerëzve sipas veprimtarisë mbi fjalë-tema vendëse. Në FGJSH dalin të

shënuara vetëm 7 raste, ndërsa në FSHS një më pak 6. Kjo mund të jetë edhe arsyeja e shumimit të emrave të sendeve me këtë formant që reflektohet edhe në FSHS 1984 për afro 6 herë më shumë. Njëherazi u tërhiqet vërejtje "nevojtarëve" që mos të ngurrojnë në "pagëzimin e emrave" të mjeteve me këtë formant, për gjoja se edhe ky ndeshet i ngarkuar tepër për emërtimin e njerëzve sipas veprimtarisë?!

Në këtë kuadër nuk duhen ngatërruar emrat e huazuar më -OR a - TOR fundor, që janë mjaft të përhapur në gjuhën tonë si terma tekniko-shkencorë, qoftë për emërtimin e njerëzve sipas profesionit (tipi: operator, konduktor), qoftë për emërtimin e aparateve a të veglave të caktuara teknike (tipi: motor, transistor).

S`mund të anashkalohet një dukuri jo e favorizuar në fjalorët normative përshkrues, por që e ndeshim në burime profesionale. E kam fjalën për trajtat si p. sh. zbulor për detektor, dallor për diskriminator, krahasor për komparator, kullor për filter etj., nëntip ky mbi bazë foljore, por mbase mu për shkak të mungesës së temës së qartë të drejtprëndrejtë prodhuese nuk del si model i favorizuar. Krahaso zgjidhjet më të parapëlqyera që jepen në burimet normative leksikografike: zbulues, dallues, krahasues, kulluese a kullore.

4. Me prapashtesën **-ore** numri i emërtimeve të sendeve del relativisht i madh edhe në FGJSH 1954. Aty ndeshim shembujt: akullore, avullore, balgore, barkore, bishtore, brezore, cilore, çerekrore, faqore, dritore, fletore, fishekore, gardhore, groshore, gushore, javore?, kalore, kandore, kanunore, kashtore, kosore, kreshmore, kupshore, kullore, latore, lakore, lugore, mangore, maknore, palcore, parzmore, palore, përkore, përmendore (pomendore), piskatore?, rregullore, supore, shakullore, tërthore, trazore, shtalore, trupore, verore, shtratore, qarkore, qafore, thekore, vegjore.

Hiq trajtat: dritore, balgore, kandore, kupshore, pomendore, shkullore, shkullore - që nuk janë të regjistruara në këtë trajtë në FSHS 1984, të tjerat përsëriten dhe përveç tyre aty ndeshim edhe këta shembuj më -ORE: anore, bajgore, ballore, belore, bërrore, bllacore, brimore, brucelore, cingore, çajore, çerepore, dhëmbëzore, dhëmbore, fajkore, farkore, fillore, freskore, frutore, frikëllore, gazmore?, gishtore, grathore, grykore, hapore, harkore, hinore, jakore, kripore, kupore, lotore, ngujore, pengore, peshore, pagëzore, pambukore, përkujtimore, pjergullore, rrethore, strehore, shkumore, shkurtore, shpatullore, shpinore, shpuzore, tharbore, uthullore, valore, vargore, veglore, verore, veshore, vizore, vjegore, vjetore, xixëllore.

Gjithsesi shihet një prodhimitari mjaft e ndjeshme e formimeve me këtë prapashtesë mbi temë të qartë fjalëformuese, qoftë mbi bazë emërore si p.sh. akullore, avullore, qoftë mbi bazë foljore si p. sh: ngujore, pagëzore, përmendore. Sidoqoftë, më lehtë po dalin

trajtat më -ORE se ato më -OR. Krahaso edhe termat e nënfushave të tjera semantike si p. sh. lakore, ndryshore etj.

Përimtimi i mëtëjeshëm, lidhur me nënfusha a profilime të caktuara do të na sillte rezultate edhe më të specifikuar. Ja disa shembuj sa për orientim, me të cilët emërtohen b.f.:

- 1) enë: çajore, piperore, pagëzore..
- 2) veshje: grykore, barkore, mëngore etj.
- 3) mjete transporti: avullore, tërkuzore;
- 4) vepra skulpture: shtatore, përmendore;
- 5) vegla punë: si p. sh.: vizore, vjegore, veglore, freskore etj.

Mbase mund të ketë edhe profilime të tjera. Gjurmimet në këtë rrugë si dhe përimtimet përkatëse mbi bazë të prapashtesave të tjera sigurisht do të japin fryte të paparashikueshme, gjithsesi pozitive.

5. Prapashtesa **-ar**, e cila është e njohur si e pa konkurrencë për disa emërtime të njëjzve sipas veprimtarisë a sipas prejardhjes del e ngarkuar edhe për emërtimin e sendeve.

Në FGJSH 1954 ndeshim këto emërtime sendesh: grazhdar, gozhdar, grunar, kulmar, laskar, landar, tullar, palcar, qenar.

Në FSHS 1984, përveç emërtimeve të sipërpërmendura dalin edhe: llampadar, blozar, ditar, gramar, gjokshar, kalamar, okar, ngjeshar, kulmar, pitar, sqepar, sqetullar, shular, thesar, visar, okatar (?), abetar(?).

Tek emërtimet e njerëzve sipas veprimtarisë a profesionit ky formant del disi më prodhimtar, kështu që në FGJSH ndeshim 31 shembuj, kurse në FSHS 73, shumë kjo që është dukshëm më e madhe kundrejt emrave të sendeve me këtë formant, në FGJSH 1954 raporti del 10 me 27.

6. Diçka më e ngarkuar se ajo -ar del prapashtesa **-are**. Me këtë prapashtesë në FGJSH 1954 ndeshim këta shembuj: dritare, grazhdare, gjashtare, kambanare (kumbonare), kulmare, koshare, lugare, lumare, pllumbare, rrotullare, përkrenare, shkallare, trijare, vargare, xamare, zamare, cungare, okatare, abetare, ndërsa në FSHS 1984 dalin edhe këto emërtime "të reja": datare, furrare, kashtare, kollare, landare, luhare, lugare, palamare, rruzare, shoshare, shalare e ndonjë tjetër.

Gjithsesi edhe ky formant si prapashtesë e mëvetësishme për emërtimet e sendeve duhet të shënohet edhe në gramatikën normative, aq më tepër kur kemi parasysh faktin se ajo objektivisht ekziston. Do të thotë se ekziston si prapashtesë e pavarur, prandaj nuk ka arsye të lihet përherë nën hijen e fomantit -ar, edhe pse nuk

mohohet prejardhja e saj nga -ar + -E: **-are**.

7. Prapashtesa **-ESË**, e cila përdoret edhe për emërtimin e emrave abstraktë zë vend të konsiderueshëm edhe në emërtimin e sendeve. Kështu që në FGJSH 1954 ndeshim këto emërtime: ankesë, arnesë, dëftesë, dërgesë, (fill)presë, fërgesë, ftesë, fshesë (mëshesë), mëlmesë, ndërresa/t, ngarkesë, shkresë, vemesë, lajmesë, mëkresë, pengesë, urdhëresë, gërresë, hesë. Në FSHS 1984 numri i emrave të tillë del pothuajse i dyfishuar. Ja disa shembuj të "rinj": armatesë, aktmartesë, gërresë, kundërkërkesë, fillesë, ftesë, kresë, gërmesë, kresë, kulesë, kumtesë, lëmesë, mbishartesë, nënshartesë, mbulesë, përkujtesë, parashtresë, përgatesë, presë, shklesë, shtresë, shtrëngesë, trajtesë.

Të gjitha ose shumica absolute e emërtimeve të tilla mund të të kenë të shprehur edhe konceptin përkatës të emrit të kuptimit, prej nga edhe është sendëzuar kuptimi i caktuar, p.sh. ankesë (kuptimi i ankimit, dhembjes), dhe ankesë (d.m.th. fletankesë) si emër i sendit konkret, term ky që përdoret në fushën e terminilogjisë administrativo-juridike.

Sa për kërshëri po e cek faktin se në të dyja burimet që u konsultuan numri i emrave abstraktë me këtë prapashtesë që nuk kanë pësuar zhvillim, siç janë shembujt e pandryshuar të tipit: anesë, dëgjesë, shërbesë etj., d.m.th. që nuk janë sendëzuar në emra konkretë, është pothuajse i njëjtë me shumën e cekur në Pasqyrë si emërtime të sendeve më -esë.

8. Prapashtesa **-JE**, me të cilën formohen emra të veprimit zakonisht prejppjesorë për të gjitha foljet me temë në bashkëtingëllore, sipas burimeve që konsultuam del mjaft aktive për formimin e emrave të sendeve edhe mbi bazë të një emri konkret. Madje në burimin e fundit shihet një rritje e dukshme numri. Kështu, ndërsa në FGJSH 1954 ndeshim vetëm këta emra: barkje, bishtje, leje e ndonjë tjetër në FSHS 1984 ndeshim: gishtje, kripje, okje, rrethje, dorje, çerekje, anije, ballje, lejedalje, lejehyrje, këmbje, padije, haje, karthje, balltje, bukje, hardhje, rrethje, shufje, shkurtje.

Nuk di arsyen e shumimit të emrave mbi fjalë-tema emërore me këtë prapashtesë të specifikuar për emra abstraktë prejppjesorë. Sidoqoftë, vetë fakti i shumimit të emrave të tillë të sendeve për 6 herë e bën të diskutueshëm konstatimin që del i cekur në gramatikën në fjalë se gjoja "emrat e sendeve, të formuar me prapashtesën -je, janë të paktë".

9. Edhe prapashtesa **ISHTË/ISHTE** përmendet ndër të tjera si prapashtesë që shërben për emërtimin e sendeve. Vërtet, në FGJSH 1954 ndeshen këto emërtime: dishtë? (govatë), kathishte,

plorishtë, zjarrishtë, ndërsa në FSHS 1984: akullishtë, arnishtë, dherishtë, gardhishtë, hellishtë, kaishtë, kallishtë, hullishtë, kadishtë, telishtë e ndonjë tjetër. Për mendimin tim, edhe pse ka njëfarë rritjeje për kah numri, shembujt e tillë nuk paraqesin ndonjë farë modeli joshës për shembuj të tjerë. Gjykimin a rezervën e tillë e mbështet në faktin se kjo prapashtesë del si prapashtesë speciale për emërtime të vendeve, zakonisht të pyjeve me druj që emërtohen në temën fjalëformuese, prandaj, përkundër njëfarë shumimi që ka kjo për emërtimin e sendeve, mendoj se kjo nuk ka arsye të favorizohet për emërtime të reja për nënfushën semantike të sendeve, kur kemi parasysh prapashtesat e tjera më të ofrueshme dhe më të prirshme për specifikim që po dalin sheshazi këtu.

Për mendimin tim trajta -ISHTE ndaj asaj -ISHTE nuk duhet të favorizohet a të ndërkeqmbetet për emërtime përgjithësisht, pra, edhe për emërtimin e sendeve, pos ndonjë rasti që tashmë ka zënë vend, siç është fjal-termi *punishte*, si emërtim vendshërbese e ndonjë tjetër.

10. Prapashtesa **-(ë)sir(a)**, edhe pse del e shënuar në gramatikën në fjalë me nënfushë pothuajse "të përcaktuar" send me tipare semantike mbiemërore, ajo për hir të numrit të vogël të emrave të formuar me të, nuk mund të konsiderohet si prapashtesë prodhimore. Kështu del sipas burimeve që konsultuam. Në FGJSH 1954 i ndeshim të shënuar vetëm këta dy emra: *kalbësisirë, vjetërsirë*. Ne i shtuam edhe trajtën (gege) *vogëlsina/t* të shënuar po në atë fjalor. Në FSHS 1984 vërtet del trajta: *ëmbëlsirë*, por e shoqëruar me sinonimin *ëmbëlsiqe* si dhe me të *ëmbelat* (po me kuptim sendi), pastaj del e shënuar trajta: *vogëlsira* bashkë me sinonimin *çikërrime, vjetërsira* e shoqëruar edhe kjo me sinonimin *vjeturina, kalbësisirë* me sinonimin *kalbësiqe* dhe *copërina* me sqarimin *copa të thyera*.

Me një fjalë sipas lëndës që u pasqyrua më sipër del se kjo prapashtesë nuk ka gjetur përdorim të gjerë, por ekziston vetëm si një mundësi që mund të shfrytëzohet në rast nevoje, kur duam që ta emërtojmë një send nga "pikëpamja e tiparit të tij" do me thënë që motivisht lidhet me një mbiemër.

Siç u pa nga shembujt, është e vërtetë se trajta e tillë **-ËSIRË** ndeshet në konkurrencë ndërkeqmbimi jo vetëm me trajtën (gege) **-(ë)sinë**, pastaj me atraktiven **-siqe**, siç u pa në dy shembujt e mësipërm, por konkurrohet edhe nga forma të tjera siç është edhe prapashtesa **-URINA a -ËRINA**, e cila, siç do të shohim më poshtë ka më shumë arsye favorizimi, ngase mbulon pothuajse nënfushë semantike të ngjashme a të përafërt me të.

11. Në FGJSSH 1954 me prapashtesën **-URINA** janë shënuar këta shembuj: *degurina, lakrurina, qelqurina, shkarpurina, mbeturina,*

pemurina, plaçkurina, vjeturina, por edhe kockërina. Ndërsa në FSHS 1984 janë shënuar: argjendurina, fshesurina, kashturina, kockurina, lakrurina, leckurina, njomurina, pemurina, plaçkurina, qelqurina, qethurina, rroburina, shkarpurina, shkresurina, vjeturina; por edhe cergurinë, djegurinë, halurinë, hedhurinë, lëngurinë, mbeturinë, balturinë (baltovinë), thekurinë e ndonjë tjetër.

Pra, siç po shihet ka rritje numri, por ka edhe thyerje sirregullsie, pasi që kjo prapashtesë del edhe në trajtën e njëjësit, siç janë shëmbujt: leckurinë, thekurinë, mbeturinë etj. Ndodh gjithashtu që edhe -U-ja fillestare mbështetëse të jetë e ndër-këmbyeshme me -Ë-në mbështetëse, siç është shembulli *kockërinë* që nuk është rast i vetëm në këtë drejtim.

Sidoqoftë, kjo prapashtesë "toskërishte", siç e quajnë Xhuvani - Çabej (sigurisht sipas shembullit: mbet/UR+INË - mbeturinë etj.), ia vlen të favorizohet, pasi që duket se tashmë ka zënë vend të merituar në strukturën emërformuese të sendeve, zakonisht për të treguar shumësinë e gjërave të emërtuar në temën fjalëformuese.

12. Çështja del jo aq e thjeshtë lidhur me emërtimet e sendeve që lidhen me prapashtesën **-C a CË** dhe të varianteve: -AC, -ACE, siç dalin të shënuara në gramatikën normative.

Më poshtë po i shënojmë shembujt që u volën nga dy burimet në fjalë, sipas varianteve prapashtesore përkatëse:

a) Me -C në FGJSH 1954 ndeshim: ujc/at, ngulc, stërfyc, shkalc, shkrolc, vjerrc, zanc, zgrrojc; Në FSHS 1984 del vetëm shembulli: horc. Raporti del 7 me 1.

b) Me -CË: FGJSH (1954): ballcë, krahcë, luhacë, krypcë, kullojçë, mëkrejçë, ngojçë, milcë, mjalçë, njicë, përparcë, shpalcë, vencë, shporcë, tërthorcë, tërfurcë, shtojçë;

Në FSHS përveç ballcë, nuk dalin të shënuar shembujt e tjerë, por dalin formime "të reja" si p. sh.: barrcë, bricë, brojçë, bramcë, brumcë, ferrcë, gatojçë, gropcë, lacë, milcë, pengcë, tërfurcë. Raporti del: 17 me 13.

c) Me -AC: akullac, qullac, setac, thumbac (FGJSH); Në FSHS 1984: gërrac, lakrac, sitac; Raporti del : 4 me 3.

d) Edhe pse në gramatikë shënohet prapashtesa -ACE ne nuk ndeshëm emra të formuar me këtë prapashtesë pos trajtës tullumbace që e ndeshim në FSHS 1984.

dh) Pos këtyre ndeshëm edhe trajtat më -ACË: puhacë e furracë si dhe llacë.

e) Po i përmend edhe disa raste më -EC, si p. sh. FGJSH 1954 shkodhec, shtypec, thumbec, por edhe sigurecë (që në burimin tjetër del siguresë). Në FSHS 1984 ndeshim shembujt: biralec, karkalec, guralec, lidhurec.

Sidoqoftë, pa i mohuar përftimet më -AC dhe variantet e tjera

mendoj se varianti -CË zgjon interesim më shumë se të tjerët. Në të dyja burimet arrin në 30 shembuj të ndryshëm që mund të jenë në përdorim e sipër në stile të caktuara.

Kur kemi parasysh mbështetjen në temën e qartë fjalëformuese foljore, e cila del kuptimisht me profilim më të ravijëzuar semantik, ndaj formimeve mbi temë emërore, atëherë mund të nxirret gjykimi se formimet me këtë formant priren të paraqesin model apo ofrojnë një simundësi të tillë.

Supozimin e mësipërm e mbështet e dhëna se në të folmet e gjalla popullore te ne, sipas fjalorëve doracakë *Fjalorth fjalësh të rralla* të A. Zymberit (Prishtinë 1979) dhe *Leksiku bujqësor e blegtoral i të folmeve shqipe të Malit të Zi* (Prishtinë 1997), ashtu si dhe atij *Fjalor fjalësh e shprehjesh popullore* (botim i Institutit Albanologjik të Prishtinës, Prishtinë 1982), ndeshim përafërsisht nga 20 shembuj me këtë prapashtesë. Prej shembujve të tillë po veçoj:

së pari, mbi temë foljore: shtrëngojcë, ngrehcë, shtojcë, mbathcë, shkrepçë, endcë, mbajcë, therçë, shpojçë, marrcë, rrënojçë, gjujçë, n(d)rrojçë, mjelcë, lidhcë, gavllojçë, gatojçë, pshtjellcë, ngarkojçë, herrcë, përpicë, vjelcë, shkalçë teprojçë; dhe

së dyti, mbi temë emërore etj.: nërgojcë, gojçë, spilcë, mkrekcë (nga krye), larcë, mbren(d)cë, nërskamcë, kamcë, ancë, brincë, cycë, krahcë, mbramcë etj.

Nga shembujt e mësipërm del sirregulla që arsyeton supozimin e shprehur më sipër rreth favorizimit të formimeve me formantin -cë, sidomos për nënfushën semantike që del mbi bazë të fjalëtemave foljore, por pa u përjashtuar edhe rastet e ngulitura mbi bazë të temës emërore.

Ndërsa b. f. me emrat prejfoljorë më -Ë si p. sh. gatojë, kullojë, shtrëngojë, shtojë, shpojë; mbathë, mbajë, therë, endë, ngrehë - tregohen gjëra a gjësende konkrete që nënkuptohen nga veprimi i foljes që del si temë motivuese (zakonisht njëjësi i dëftores), trajta më -CË, siç del në shembujt e mësipërm ndihmon formimin e emrave me të cilët tregohet vegla me të cilën arrihet a lidhet kuptimisht me rezultatin e caktuar si send konkret të cekur me trajtën e caktuar foljore më -Ë. Me fjalë të tjera, nëse një vig (konkret) f.v. mbi një përrua mund të quhet, sipas modelit që na servohet, **kalojë**, siç patëm rast ta dëgjonin në një fshat tonin, atëherë shkopi i gjatë që ndihmon kaluesin për t'u mbajtur a për të kërcyer mbanë, mund të quhet pothuajse normalisht **kalojçë**.

Pra, përkundër faktit se prapashtesa -CË në FGJSH 1954 bashkë me prapashtesën -S zinte vendin e katërt për nga radha e shumësisë së numrit dhe se në FSHS (1984) prapashtesa -S del në vendin e

parë, ndërsa -CË-ja del në vendin e 13, mendoj se varësisht nga konteksti mund të favorizohen formimet me prapashtesën **-CË**, përkatësisht **-Ë**. Me një veprim të tillë do të lehtësohej paksa përdorimi enorm i prapashtesave të tjera përkatëse sinonime -se, -zë si dhe i disa varianteve të tjera jo aq të parapëlqyera, siç është prapashtesa **-së**, e cila i kundërvihet në raste të caktuara prapashtesës **-cë**, por nuk është më popullore dhe prodhimore se ajo.

Gjithsesi kjo çështje përgjithësisht e veçantisht ia vlen të ndiqet dhe të vlerësohet.

13. Në FGJSH 1954 me prapashtesën **-ashkë** ndeshim vetëm tre emra si emërtime të mirëfillta të sendeve: *dorashkë*, *grykashkë* dhe *gjurmashkë*, ndërsa në FSHS 1984 hasim shtatë sosh: *bujashkë*, *dorashkë*, *erashkë*, *farashkë*, *grykashkë*, *gjurmashkë*, *kruashkë*, *trokashkë*.

Emërtimet me këtë prapashtesë s' di sa mund të quhen si model prodhimit për pa u përcaktuar më parë profili i nënfushës semantike, edhe pse shihet një rritje e konsiderueshme numri. Këtë sidyshim po e shpreh duke e pasur parasysh faktin se, sipas shembujve konkretë, nuk shihet qartë arsyeja e motivimit brenda strukturës fjalëformuese nga formanti i përbërë **-ASH+KË** -ashkë, p.sh. dorë + ashkë etj.

14. Në gramatikë ceket prapashtesa **-AÇ (E)** që nënkupton trajtat **-AÇ** dhe atë **-AÇE**. Duke pasur për bazë elementin **-Ç** si prapashtesë me variacionet që formohen me të, gjendja del kështu:

a) Në FGJSH 1954: më **-AÇ** ndeshim: *armaç*, *çokaç*, *gjylaç*, *kësaç*, *lugaç*, *satraç*, *thikaç*, ndërsa në FSHS 1984 përveç *armaç*, *lugaç*, *thikaç*, ndeshim edhe: *akullaç*, *bakraç*, *gërraç*, *kungullaç*, *thundraç*; Raporti del: 7 me 9.

b) Në variantin më **-AÇE** ndeshim *bigaçe* dhe *tarkaçe* në (FGJSH 1954, ndërsa *furkaçe*, *ngarkaçe* në FSHS 1984. Raporti del: 2 me 2. Për mendimin tim këtij nëntipi me **-AÇE** duhet t'i bashkohet edhe trajta tullumbace, që dilte si rast i vetmuar te formimet mbi bazë të formantit **-C**.

c) Me variantin **-Ç** ndeshim: *copç*, *grremç*, *dejç*, *zymbç*, *hellç* (FGJSH), ndërsa përveç: *grremç* në FSHS ndeshim edhe: *ballç*, *gërreç* *greqç*; Raporti del 5 me 4.

ç) Gjithashtu vihen re edhe formimet më **-ÇË**: *zjerrçë*, *fillçë*, *rrahçë*, *ndezçë* (1954) dhe *ndezçë*, *dejçë*, *brumçë*, *nallçë*, *rrahçë*, *plumbçë* në FSHS 1984, raporti del: 4 me 6, gjë që shihet njëfarë prierje shumimi.

d) Po ashtu ndeshim edhe formime me variantin **-ÇE**: *fundçe*, *majçe*, *plumbçe*.

Sidoqoftë, edhe pse asnjëra prej këtyre varianteve nuk dallohet

si mbizotëruese që do të mund të cilësohej si model që të mund të përthithte a të mbizotëronte ndaj varianteve të tjera, emërtimet mbi bazë të prapashtesëm -AÇ (-Ç/AÇE) ashtu si edhe ato më -CË ia vlen të ndiqen më tej dhe sipas prirjes të favorizohen për nënfusha a profile të caktuara semantike.

Prirja që prapashtesa -AÇ të jetë prodhimtare mbi bazë të fjalë-temave emërore, ndërsa ajo -CË mbi bazë të fjalë-temave foljore nuk është e padiktueshme. Kjo dukuri vërehet edhe nga shembujt përfaqësues që u paraqiten në këtë punim, por edhe në mbështetje të lëndës së vjelë nga A. Zymeri (sipa veprës së dytë të lartcituar), ku janë shënuar afro 16 shembuj me variacionet e kësaj prapashtese dhe të gjithë shembujt pothuajse janë të përfutur mbi bazë të një teme emërore. Krahaso: faraç, laraç, thepç, balç, arrç, fun(d)ç, lugç etj. dhe asnjë shembull mbi temë foljore.

15. Prej dy shembujve të cekur në gramatikën në fjalë me prapashtesën **-e** në burimet që konsultuam del e shënuar vetëm fjala *kallaje*, ndërsa ajo *argjende* në FGJSH del *argjandsina*, ndërsa në FSHS *argjendurina*. Mirëpo me këtë prapashtesë në FGJSH dalin mjaft shembuj të tjerë si p.sh.: bote, bute, çereke, nënbishte, çifte, dore, dyshe, floke, ende, hunde, kryqe, gishte, (ngishte, ngjishte), njëshe, prapse, rrethe, rrype, shelqe, sheshe, ndërsa në FSHS edhe bakere, behare, çape, dashe, drudhe, gjashtëshe, kurrize, qype, rishte, shkalle, tjerre, treshe e ndonjë tjetër.

Gjithsesi shihet se me këtë prapashtesë është formuar një numër i konsiderueshëm i emrave të sendeve, prandaj ky fakt duhet të konstatohet dhe të pasqyrohet më mirë në burimet tona teorike mbi fjalëformimin.

B. Veçori të shembujve me disa prapashtesa të tjera të pacekura në gramatikë

Më sipër pamë disa nga veçoritë e emërtimeve të sendeve me prapashtesat që dilnin të cekura në gramatikën tonë normative (1976). Sigurisht këto ishin vetëm "disa" më të përzgjedhurat, sepse prapashtesat sendore në shqipe jo vetëm se janë "të ndryshme", por janë të shumta dhe të shumëllojshme. Në punimin e mirënjohur të Xhuvani- Çabejt "Prapashtesat e gjuhës shqipe" (1961) nga shembujt e paraqitur aty funksionalisht dalin edhe nja 50 formante të tjera, me të cilat formohen emrat e sendeve (konkrete).

Ky fakt del i verifikueshëm edhe nga konsultimi i materialit që iu bë dy burimeve të sipërcekura leksikografike, mirëpo për këtë punim e pamë të arsyeshme të përfshijmë në trajtim formimet edhe me

11 prapashtesa të tjera, të cilat na u dukën më të vërejtshme për syrin tonë, pasi që faktikisht me to del një numër i konsiderueshëm i emrave të sendeve ose që zgjojnë interesim të posaçëm për ndonjë arsye tjetër të natyrës psikolinguistike.

Kështu që, siç shihet nga Pasqyra, përveç emrave të sendeve me prapashtesat e ashtuquajtura zvogëluese siç janë prapashtesat **-ZË** e **-TH**, u trajtuan edhe emrat e sendeve me prapashtesa të tjera si: **-ël a -lë, -ezë, -im, -k a kë, -nik, -inë, (a)nicë, -ë** dhe **-ull**.

Ja disa nga veçoritë karakteristike që dalin lidhur me formantet në fjalë:

1. Sa i përket aktivitetit të prapashtesës **-ËZ** fillimisht po theksoj faktin se përfaqësohet a diçka më tepër ajo del e angazhuar në formimin e emrave që tregojnë nënfusha të tjera semantike, goftë emra të bimëve, të kafshëve, të sëmundjeve si dhe fjalë-terma të fushës së gjuhësisë, teknikës etj. sesa që tregojnë emra të sendeve, megjithatë numri i emërsendëve është i konsiderueshëm, madje në FGJSH (1954), e zë vendin e parë për nga numri, kurse në FSHS vendin e tretë. Kur kemi parasysh këtë fakt nuk di arsyen pse nuk është vlerësuar në burimet tona teorike të deritashme, sa e si duhet nga gramatikanët tanë funksioni emërformues i sendeve të këtij formanti.

Me prapashtesën **ËZ** (**ZË**) në FGJSH 1954 ndeshim këto emërtime të sendeve: amzë, bigzë, bishtëz, çikzë, dorzë, dredhëz, drugzë, gishtzë, dhenzë, endzë, erzë, fletzë, frerzë, furkzë, gojzë, gunzë, gellzë, gjuhëz, këmbzë, kallzë, kizë?, kapzë, katramzë (tokzë), kordhëz, kryqzë, lëpizë, lugzë, mollzë, ninzë, nënbarkzë, nuskzë, piskzë, palzë, pipzë, petzë, pllumzë, qafzë, qajgzë, qelzë, rranzë, rraskzë, sorrzë, supzë, syzë, sheqzë, shkojzë, shkrehzë, shkurtzë, shndrizë, shpunzë, shqezë, shokzë, tejzë, shpatzë, shqerzë, shtjekzë, tokzë, tragzë, trazë, tufzë, thikzë, turizë, thumbrizë, veshzë, vjegzë, zemza/t, unzë, urzë, vezë, vizë, zogzë.

Në FSHS 1984 ndeshim: amzë, barkzë, berzë, bishtëz, bletzë, bobzë, brombëz, bubzë, buzë, bythzë, çiftzë, dërrasëz, dritarëz, dritzë, drudhëz, dhëmbzë, dhomzë, falzë, fitzë, fytzë, fyzë(fejzë), gërsherzë, grykzë, gunzë, hënzë (hanzë) hijzë, hundzë, jakzë, katramzë, kërrabzë, kunjzë, lidhëz, lopatzë, gërshëtzë, mullzë, nyjzë, njomzë, pëlhurzë, sharrzë, nënqafzë, nëngrykzë, nënkëmbzë, ngojzë, pengzë, tokzë, rrjetzë, rrogzë?, syrëz, shkallzë, shkelzë, shkronjzë, shpinzë, shqimzë, udhëz, ujzë, urzë, vorbëz etj.

Është me interes të përmendet fakti se disa trajta më **-ËZ** nga FGJSH 1954 nuk përsëriten në FSHS 1984, si p.sh.: dhenzë, piskzë, namzë?, lënjzë, rraskzë, supzë, sorrzë, shkrehzë, shokzë, madje

ndonjëri prej shembujve ndryshon trajtën shkrimore të prapashtesës ose ndonjë ndryshim tjetër si p. sh.: amëz - amzë, kujza - kunjëz, qajgëz - qajkëz, shpinzë - shpinëz, shkelëz - shkelc etj.

Edhe dy gjera, për mendimin tim, ia vlen të theksohen lidhur me emërtimin e sendeve me këtë prapashtesë:

E para, në rastet kur sendëzohet koncepti me prapashtesën -ZË a ndonjë formant tjetër zvogëlues, ai koncept përgjithësohet dhe, si me thënë, prapashtesa tashti funksionalisht e tjetëron paksa karakterin zvogëlues, ngase duke u lidhur plotësisht me konceptin e sendit që emërton nuk paraqitet më me ngjyresë zvogëluese, por në radhë të parë si koncept i sendit konkret, duke e lënë karakterin zvogëlues tashti disi nën hije. P.sh. nga fjalë-tema *pip*, ka dalë emërtimi *pipëz* (si mjet muzikor), nga *shpinë* ka dalë *shpinëz* (karrige), nga *amë* *amëz* (libër a fletore), nga *sharrë* *sharrëz* (përdorëse pune), por tash *pipëzat*, *shpinëzat*, *amëzat*, *sharrëzat* mund të kenë forma të ndryshme, mund të jenë të llojllojshme dhe madhësisht të ndryshme, më të mëdha e më të vogla e ku ta di, në krahasim me mesataren "zvogëluese" të përfutur fillimisht. Me një fjalë, së pari kujtohet tashti koncepti i sendit e jo dukuria e zvogëlimit të një pipi, sharre, figurativisht të një shpine, ame etj.

E dyta, kjo prapashtesë femërore që formon emra femërore nuk mbështetet vetëm mbi fjalë-tema të emrave femërore, por edhe mbi tema të emrave mashkullorë (gramatikorë). Kjo dëshmohet qartë nga shembujt: çift - çiftëz, gisht - gishtëz, fre - frerëz, bark - barkëz, sy - syzë, shtjek - shtjekëz, vesh - veshëz, un - unëz, kunj - kunjëz etj., shembuj këta që, siç po shihet, nuk janë në numër të vogël.

2. Me prapashtesën **-TH** janë formuar edhe disa emërtime sendesh.

Në FGJSH 1954 ndeshim këto emërtime: çekth, fjalorth, lakth, mallth, makth, syth, sendth, shejth, shtekth, zdrukth, qerth, ujkth, spikth e ndonjë tjetër.

Numër të njëjtë ndeshim edhe në FSHS 1984: pos fjalorth, zdrukth ndeshim edhe trajtat: brith, hithëth, lënguth, qekth, pipth, pulith, rremth, pikth, syth, shtegth, shtreth, thimth, ujth, zjarrth, zogth, barth, bishtth, druth, gjembth, gjumth, korith, kurth e ndonjë tjetër.

Edhe formimet më -TH janë të përhapura në nënfusha të tjera semantike, por nuk duken se janë aq me perspektivë (nëse ka pushuar dukuria e eufemizmit). Është interesant se formimet e sendeve më -TH zvogëluese nuk kanë shënuar rritje numri në raportin FSHS (1984) ndaj FGJSH (1954), përkundrazi simotra e këtij formanti

-zë del më prodhimore.

Ç`është e drejta, në parim edhe formimet me këtë formant shënojnë rritje reale, kur kemi parasysh faktin se mjaft emërtime të sendeve që nuk shënohen në burimin e fundit, faktikisht nuk do të thotë se nuk janë në përdorim e sipër në ligjërimin tonë. Madje mjaft emërtime "të reja" me këtë formant tregojnë jo pasivitetin, po aktivitetin dhe prodhimtarinë e formimeve të tilla.

3. Prapashtesa **-ËL a -LË** është e pranishme në njëfarë dore në formimin e emrave të sendeve. Shembujt që i ndeshim në FGJSH 1954: ashkël, bimël, cefël, cifël, kokël, dhenël, prekël, vegël, vigël, zhangël, tokël, thepël, si dhe përfaqësohet po aq a diçka më tepër që ndeshim të regjistruara në FSHS 1984 e dëshmojnë këtë. Në FSHS përveç: ashkël, bimël, cefël, cifël, kokël, prekël, vegël, tokël dalin edhe: petël, heqël, kuqël, shtypël, yçkël, pykël, qukël.

Formimet me këtë prapashtesë për raste të caktuara nuk është keq të favorizohen, përkundrazi është mirë. Të vihen re formimet "e reja" që nuk ishin të regjistruara në FGJSH 1954.

4. Me prapashtesën **-EZË** nuk ndeshim numër të madh emrash të sendeve. Në FGJSH 1954 ndeshim: librezë, shqezë, ushezë, urezë mbase edhe vezë e varrezë, ndërsa në FSHS 1984, vetëm përsëriten fjalët e mësipërme. Siç po shihet nuk shënohet rritje numri, megjithatë emërtimet e tilla kanë përdorim normal dhe në mjaft raste tregojnë atraktivitet dhe ka mundësi të joshin formime të reja mbi këtë bazë.

5. Edhe me prapashtesën **-IM**, e cila del si prapashtesë e specializuar për emërtimin e prejfoljorëve nga foljet më -OJ dhe të një grupi më -Ej si emra të veprimit, përdoret për të emërtuar edhe ndonjë send që del, qoftë si rezultat i veprimit, qoftë edhe si përfitim i pavarur. Në FGJSH 1954 dalin këta emra sendesh: lajmërim (lajmim), lejekalim, pajime!, therime!, si dhe në FSHS 1984: lajmërim, ndriçim, shkarkim, ngarkim, pajime e bukërrime, thërrime pastaj kompozitat: aktpërfaqësim, fletëshoqërim, dorëshkrim, lejeqarkullim, letërnjoftim, urdhërsërbim, urdhërxhirim, vetëshkarkim. Emërtime këto që kanë shënuar prodhimtari në fushën e terminologjisë administrativo - juridike.

/Ndonjë trajtë më -IME për arsye thjesht pragmatike nuk u përfill në pikë të veçantë./

Edhe pse në mjaft raste prapashtesa **-ESË** e tipit shkresë, fërgesë etj. mund të jetë më e parapëlqyer ndaj simotrës **-IM**, është fakt se ky formant gjithnjë e më shumë po ndeshet në përdorim në stilin administrativo-juridik, sidomos në emërtime të përbëra.

6. Prapashtesa **-K a -KË** del e pranishme në emërtimin e sendeve në të dy burimet e sipërcekura. Në FGJSH 1954 vërehen shembujt: çafkë, boçkë, nuskë, shofkë (pasqyrë), qajkë, qeskë, furkë, shkulkë, troshkë, xhufkë. Në FSHS 1984 edhe çajkë, boçkë, nuskë, rrotkë.

Si duket, për arsye subjektive parimore, në FSHS (1984) kjo prapashtesë nuk del e favorizuar për emërtimin e sendeve, sigurisht jo aq sa simotrat e tjera që u cekën më përpara, por trajtat si -uk, -ok etj., ku elementi -k del i pranishëm nuk mund të quhen si trajta shterpe.

7. Me prapashtesën **-NIK** i ndeshim të formuar disa emra të sendeve konkrete si p.sh. ballnik, çajnik, palanik, rodhanik, çetanik, drithnik, veshnik, dredhanik, kripësnik, mbrapanik, paranik, dhallanik, faranik, gazanik, gllanik, gjethanik, gjizanik, kungullnik, leqenik, leshnik, gjalpanik. etj. Në FSHS 1984 ndeshim edhe: çajnik, gjalpanik, kripanik, paranik, veshnik, misernik(e), qullanik.

Gjithsesi emërtimet më **-NIK** nga fusha e gjellëtarisë (si sende ushqimore) që i ndeshim në gjuhën popullore s' ka pse të mos shfrytëzohen. Megjithatë mund të thuhet se edhe kjo prapashtesë s' ka nevojë të dalë e favorizuar për emërtimin e veglave të punës a të pjesëve të tyre, së paku edhe për hir të origjinës së saj jo vendëse edhe për faktin se funksionin e tillë po e kryejnë me sukses prapashtesat e tjera vendëse.

8. Me prapashtesën **-INË** ndeshim një numër të konsiderueshëm të emërtimeve të sendeve.

Në FGJSH: kofshinë, pishinë, rrapinë, shkardhinë, ngrehinë, shakullinë, shpatullinë, zhelinë.

Në FSHS: ballinë, bykëtinë, kryesinë, kullinë, rrugallinë, rrungullinë, rrogzinë, ngrehinë, hullinë, gëlqerinë, kaplluçinë, llapërçinë, gastarinë, shkallinë, ku vihen re edhe mjaft emra "të rinj".

Meqenëse kjo prapashtesë më tepër është specifikuar për emërtimin e vendeve, të bimëve e të pjesëve të trupit etj, madje edhe për disa koncepte abstrakte, atëherë për emërtimin e sendeve (si mjete pune) nuk di sa ka nevojë të favorizohet.

Në disa raste kjo ndeshet a ndërkëmbehet me trajtën **-IRË**, por përgjithësisht mbizotërojnë trajtat më **-INË** edhe në nënfushën e emërtimit të sendeve.

9. Me prapashtesën **-(N) ICË** në FGJSSH 1954 ndeshet një numër i konsiderueshëm i emrave të sendeve si p. sh. arnicë, bollicë, dokanicë, paricë, qyqenicë, petkicë, tumjanicë, trupicë, tulicë,

vajanicë, mbulicë, furkulicë, zhulicë, ndërsa në FSHS 1984 ndeshim të regjistruar fare pak si. p. sh. bishtnicë, furkulicë, laricë, zhangëllicë, zhulicë. Madje do shikuar se a është reflektuar në rastet e tilla prapashtesa e gjuhës serbe -(N)ICA apo kemi të bëjmë me ndonjë kontaminim të trajtave përkatëse të burimit vendës.

Sido që të jetë, kjo prapashtesë, e cila me të drejtë nuk favorizohet në FSHS 1984, nuk duhet ta favorizojmë as në burime të tjera në të ardhmen, edhe pse te ne nuk është pa gjurmë sidomos në të folme popullore.

10. Me prapashtesën **-Ë** dalin mjaft emra prejfoljorë me të cilët emërtohen sende a gjëra konkrete si p.sh. blejë, dredhë, grihë, kapë, llapë, mbathë, mburojë, ngecë, dalë, lojë, pasë, peshojë, ndërlikë, ngrehë, pjekë, qethë, rrjepë, rrënojë, rritë, rrjedhë, rrokë, rrethojë, shtrojë, tjerrë, thinjë, thithë, veshë, zgjedhë e ndonjë tjetër që ndeshen në FGJSH. Po ashtu edhe në FSHS pos këtyre me ndonjë përjashtim dalin edhe emërtime të reja si p.sh.: cirkojë, çelë, çerrë, dallojë, endë, falë, fryjë, hedhë, kalojë, këputë, lëkojë, mbulojë, ndalë, ndezë, rrallojë, rreshkë, ndërrojë, shpojë, shtojë.

Siç po shihet edhe nga shembujt paksa "të rinj" në FSHS 1984, kjo prapashtesë që shërben për emërtimin e gjërave konkrete, po jo mjete pune, shënon rritje, sidomos mbi temat foljore (zakonisht nga e tashmja e dëftores). Nga shembujt e sipërcekur del e dallueshme prirja a vijëzimi i nënfushës semantike që ka të bëjë me emërtimin e sendeve përgjithësisht që lidhen kuptimisht me foljen temë fjalëformuese. Siç është cekur edhe më sipër mbi këtë bazë a lidhur me të shihet prirja e daljes së emrave të veglave me prapashtesën **-cë**, fjalë këto që kuptimisht lidhen me temën motivuese fjalëformuese që shprehet me folje, përkatësisht me prejfoljorin me prapashtesën **-Ë**.

Rreth një mundësie a dukurie të tillë d. m. th. të kundërvënies **emër sendi** (si gjësend konkret) ndaj **emër vegle** (si mjet pune), gjithnjë sipas fjalorëve përkatës dhe prirjes së hetuar po e cek një shembull konkret lidhur me fjalë-temën **rrotë-**, ngase nga fjalë-tema e tillë dalin emërtimet si:

- a) *sende* (llojesh të ndryshme): rrot, rrotojë, rrotullojë, rrotaç, rrotull;
- b) *vegla pune* (llojesh të ndryshme): rrotë, rrotëz, rrotkë, rrotojsë a rrotojçë (tel si krrabëz), rrotullak, rrotullakëz, rrotullamë, rrotullojë, rrotullues, rrotulluese.

Pra, çka është edhe qëllimi i sjelljes së shembullit, edhe

lloji i sendit konkret ashtu si edhe mjeti i punës si send i specifikuar dallohen a mund të dallohen qartë nga kundërvënia prapashtesore, dukuri kjo që lypset ndjekur më tutje.

Gjithsesi është mirë që ky fakt të zgjojë interesimin e studiuesve, të vlerësohet si duhet dhe të zërë vend në burimet tona teorike, çështje kjo që, siç është cekur edhe më përpara, lidhet me formimin e mjeteve me prapashtesën -cë, prandaj edhe njëherë tërheq vëmendjen që të krahasohet verigu fjalëformues: veprim/send/mjet (pune):

shpoj / shpojë / shpojçë,
 hedh / hedhë / hedhçë,
 këput / këputë / këpucë!,
 rrotoj / rrotojë/ rrotojçë,
 rrotulloj / rrotullojë / rrotullojçë etj.

11. Prapashtesa **-ULL** që nga Xhuvani - Çabej vihet në dukje si prapashtesë me të cilën formohen emra "sendesh a gjërash konkrete" në burimet e sipërcekura që u konsultuan del në numër të konsiderueshëm. Kështu që në FGJSH ndeshëm këta emra: brushtull, daskull, frushkull, fshikull, kërbotull, korbull, kutull, ngecull, petull, pjekull, pizgull, prefull, qarkull, rrokull, rrotull, strofull, strukull, shkandull, vishkull, zgjetull. Ndërsa në FSHS ndeshim shembuj "të rinj": cipull, garbull, rriskull, rrumbull, shakull, shpargull, vorbull, zgarbull e ndonjë tjetër, shembuj pothuajse të gjithë me tëmë jo aq të qartë fjalëformuese.

Sidoqoftë, shembujt e tillë jo fort të nëpërdukshëm sa i përket temës motivuese sipas gjasave në mënyrë analoge mund të përthithin edhe shembuj të tjerë, madje edhe me sforcim a dyfishim prapashtese.

* * *

Edhe pse mund të trajtohen edhe shembuj të tjerë me prapashtesa të tjera lidhur me emrat e sendeve ne po përfundojmë trajtimin e kësaj teme me konstatimin se sipas asaj që konsultuam, pa e mohuar ndonjë prapashtesë a formim atraktiv, prapashtesat e tjera ashtu si edhe disa që u trajtuan këtu nuk paraqesin ndonjë model të vërejtshëm fjalëformimi për emërtimin e sendeve në shqipen letrare. Së paku kështu del sipas lëndës që volën në këto dy burime.

***Formantet e tjera si dëshmi dhe nxitje
 për trajtim më të përimtuar të temës***

Për të dëshmuar faktin se edhe ky punim nuk është shterues dhe

për t'u nxitur sadokudo kërshërinë studiuesve dhe dashamirësve të gjuhës të të gjitha profileve për të vazhduar punën mbi këtë temë, në vazhdim po jap skemën e zhvillimit të emrave të sendeve të katër-pesë shembujve, edhe mbi bazë të fjalë-temës emërore, edhe mbi bazë të fjalë-temës foljore, siç ndeshen a mund të ndeshen në burimet përkatëse:

Skema e emërtimit me prapashtësim të disa emrave të sendeve:

 Fjalë-tema Emrat e prejardhur me prapashtesim
 fjalëformuese

I. Mbi temë emërore:

1. bisht- bisht, bishtajë, bishtak, bishtake, bishtalec,
 bishtar, bishtarak, bishtëz, bishtarake, bishte,
 bishtje, bishtje/t, bishtnicë, bishtok, bishtor,
 bishtore, bishten(?), bishtth, bishtoke,
 bishtuk, bishturina; bishtpenë, nënbishte,
 bishtagyp, bishtpallakare.
2. peng- peng, pengashkë, pengatë, pengcë, pengesë,
 pengë, pengëz, pengim, pengojë, pengojcë, pengore,
 pengues, penguese(?).
3. dor(ë)- dorë, dorak, dorake, dorashkë, dorashtë,
 dorezë, dorëz, dorëshkrim, dorëshkresë, dorës,
 dorje, përdorëse.
4. gardh- gardhec, gardhë, gardhën, gardhënor, gardhim,
 gardhiqe, gardhishte, gardhnajë, gardhnojcë,
 gardhole, gardhore,
5. veg(ë)- veg, vegë, vegël, veglëri, veglore,
 vegsh, vegjë, vegjore, vjegë, vjegëz.

II, Mbi temë foljore:

1. shkruaj shkresë, shkresori, shkresurinë, shkrim,
 (shkr-) shkrolë, shkrolës, shkronjë, shkronjëz, shkrues,
 shkruese, shkruesor.
2. shtoj shtesë, shtim, shtojë, shtojcë, të shtuarat,
 (sht-) shtues, shtuese, shtuesor(?)

3. prek- prekë, prekël, prekje, ndërprekës, prekëse,
 prekësor? (sikur njehësor) etj.
4. mbaj- mbajtës, mbajtëse, mbajcë(!), mbajtësor,
 mbajtësore.

Për këta shembuj përfaqësues, ndër të tjera, u shfrytëzuan edhe të dhënat nga FGJSSH (1980).

Siç po shihet fjalë-temat mbi bazë emërore kanë mundësi më të madhe zhvillimi, por edhe ato mbi temë foljore nuk janë pa prirje. Nga shembujt që u dhanë më sipër dolën edhe këto 13 prapashtesa të tjera, të cilat nuk u trajtuan në punimin tonë: **-ajë** (bishtajë, gardhnajë), **-ak** (bishtak, **-ake** (bishtake), **-arak** (bishtarake), **-en** a **ën(?)** (bishten!, gardhën!), **-oke** (bishtoke), **-uk** (bishtuk), **-atë** (pengatë), **-iqe** (gardhiqe), **-ole** (gardhole), **-sh !** (vegsh), **-ori** (veglori, shkresori) **-sor** (prekësor), **-ashtë** (dorashtë).

Këto dhe mjaft prapashtesa të tjera u bëjnë sfidë studiuesve që të përthellohen më tej në trajtimin a kësaj teme më me përkushtim. Shumëllojshmëria e formanteve prapashtesore, por edhe të formave të tjera në emërtimin e veglave vjen nga vetë nevoja a natyra e shumëllojshmërisë së sendeve, goftë si gjëra a gjësende të lëndëta nga bota jo e gjallë, goftë si mjete të ndryshme të jetës e të punës, si përdorëse, vegla, pajisje, aparate e makina të automatizuara e të kompjuterizuara etj., të cilat si asnjëherë më parë jo vetëm se ndeshen në përdorim të përditshëm, por edhe po përftohen çdo çast.

Njohja dhe përdorimi i prapashtesave të ndryshme për këtë nënfushë semantike pra del si punë e domosdoshme, mirëpo aty ku ekziston mundësia, përkatësisht kur kemi të bëjmë për koncepte të njëjta a të ngjashme ato edhe mund të thjeshtësohen, por pa i prishur harmoninë simfonisë së shumëllojshmërisë së formimit të emërtimeve të sendeve.

Për mendimin tim vjelja dhe sistematizimi i emërtimeve përgjithësisht dhe të atyre me prapashtesim sipas profilimeve më të ngushta, siç u cekën më sipër, del si kërkesë e ngutshme e kohës. Një veprim i tillë sigurisht do të na shpinte në rezultate edhe më të mira, edhe më të specifikuar.

P e r f u n d i m

Po përfundoj duke i sjellë ndërmend konstatimet më të përgjithshme që dalin si rezultat nga analiza e mësipërme rreth kësaj teme:

1. Si prapashtesa të mirëfillta për emërtimin e sendeve në shqipe mund të cilësohen në radhë të parë këto prapashtesa femërorëzuese: **-(ë)se** dhe **-ore**. E para dëshmohet me faktin se në krahasim me materialin e regjistruar në FGJSH 1954 ndaj FSHS 1984 ka rritje për 22.5 herë (krahaso: 4 me 90 shembuj), ndërsa e dyta, ishte e pranishme edhe më përpara dhe shënon kontinuitet rritjeje (krahaso: 50 me 150).

2. Është e vërtetë se edhe me prapashtesat **-s** dhe **-or** emërtohen sende, por prapashtesat e tilla nuk do të quhen ekskluzivisht si formante të specifikuara vetëm a kryesisht për këtë nënfushë semantike, pasi që ato përdoren si prapashtesa speciale më tepër për nënfusha të tjera semantike: e para për emërtimin e njerëzve sipas profesionit a veprimtarisë, sidomos mbi fjalë-tema foljore dhe e dyta si prapashtesë speciale përfaqësuese për emërtimin e mbiemrave mbi fjalë-tema emërore.

3. Vëretje të ngjashme mund të jepet edhe për formantet **-ar** e **-are**, **-ishtë** e **-ishte**, **-esë**, **-je**, **-im**, **-inë** e të tjera, ngase edhe këto kanë përdorim të ndjeshëm në nënfusha të tjera semantike.

4. Ndonjë prapashtesë, qoftë për shkak të origjinës etimologjikisht jo vendëse si p. sh. **-nik**, **-(n)icë**, qoftë për shkak të origjinës dialektore a ndonjë arsyeje tjetër si p. sh. ato mbi bazë të variacioneve me **-ç**, **-c**, **-ull**, **-lë** a **-ël**, **-th**, **-ashkë**, **-ësirë** etj., vetëm pjesërisht mund të cilësohet si prapashtesë e specifikuar për emërtimin e sendeve.

5. Për dallim nga formantet e sipërcekura prirje specifikimi ka prapashtesa **-cë** si emërtim sendi (vegla pune), angazhimi i së cilës priret të dalë edhe më e ravigëzuar mbi temë të njëjtë që dalin edhe emrat prejfoljorë me prapashtesën **-ë**, zakonisht nga njëjësi i dëftores, e cila del mjaft praktike në formimin e emrave të sendeve (gjërave konkrete). Në këtë kuadër shihet njëfarë prirjeje që prapashtesa **-aç** (**-ç(ë)**) të jetë më aktive mbi fjalë-tema emërore, ndërsa ajo **-cë**, mbi fjalë-tema foljore. Gjithashtu edhe prapashtesa **-urina** (**-urinë-a**) ia vlen të favorizohet për emërtimin e sendeve që kuptimisht lidhen me një shumësi sendesh që i lidh tipari i përbashkët.

6. Ç`është e vërteta, në dhjetëshin e parë sipas sasisë në të dy burimet e konsultura këto janë prapashtesat më prodhimtare për formimin e sendeve: **-ore**, **-zë**, **-ës**, **-ë**, **-esë**, **-are**, **-aç(e)** dhe **-e**. Në gramatikë, në një farë dore të favorizueshme dilnin vetëm formimet me prapashtesat: **-ore**, **(ë)s**, dhe **-esë**, të tjerat "u zbuluan" nga analiza e materialit nga dy burimet e konsultuara leksikografike: FGJSH 1954 dhe FSHS 1984. Sipas FSHS 1954 "u

zbulua" se shumim më të madh numri shënojnë formimet me prapashtesën **-SE** për 22.5 herë, më **-JE** për 6.0 herë, më **-OR** 5.6 herë etj., ndërsa pakësim më të madh shënuan formimet me prapashtesën **-icë** për 4.3 herë.

Nga krejt kjo që u trajtua deri këtu mund të nxjerrim përfundimin se prej 26 prapashtesave më prodhimore, përkatësisht më me prirje specifikimi për emërtimin e sendeve mund të veçohen këto 16, prej të cilave 10 janë prapashtesa femërore: **-se, -ore, -ëz, -are, -ë, -urina, -esë, -cë, -e** dhe **-je** dhe 6 janë prapashtesa mashkullore: **-(ë)s, -or, -aç, -th, -ar dhe -im.**

Përgjithësisht prirjet që dalin nga zhvillimi i brendshëm i gjuhës sonë duhet të jenë edhe më të vërejtshme nga studiuesit tanë kompetentë.

Mbase edhe për çështje të caktuara, siç është edhe përcaktimi i emërtimit me prapashtesim të sendeve në shqipe duhet të ngarkohet institucionalisht ndonjë ekip ekspertësh të profileve të caktuara.

Sigurisht ky punim do të ishte edhe më i përplotë si të ishin shfrytëzuar të dhëna edhe nga burime të tjera e sidomos nga kartoteka e fjalësit të gjuhës sonë letrare e popullore, por sidoqoftë së paku sa për orientim a riorientim në kushtet e sotme edhe me mundësitë që na lejuan edhe këto konstatime që u dhanë këtu, ma merr mendja, se nuk do të jenë të pavlera.

Përmyllje (Rezime)

Edhe pse, me sa dihet, mungojnë punime të veçanta rreth emërtimit me prapashtesim dhe përgjithësisht të emrave të sendeve, kjo çështje nuk del fare e paprekur apo e pa njohur në burimet teorike të gjuhës sonë letrare. Në gramatikën normative (Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe II, Tiranë 1979), emrat e sendeve përbëjnë një grup të veçantë në kuadër të emrave që ndahen sipas kuptimit dhe për këtë grup si më të përzgjedhura dalin këto prapashtesa: **-(ë)s, or(e), -ar, -esë, -je, -ishtë, -(ë)sirë, -urina, -ac(-ace), -e** si dhe në analizë (*Shënim*) jepen edhe dy prapashtesa të tjera **-aç dhe -ashkë**. Gjithsej 12 sosh.

Një paraqitje a përzgjedhje të tillë të prapashtesave gjithsesi duhet konsideruar si një punë pozitive, edhe pse paraqitja e tillë nuk ishte e plotë dhe konstatimet e dhëna lidhur me to nuk ishin krejtësisht pa të meta.

Për të pasur ide më të qartë rreth kësaj problematike d. m. th. rreth specifikimit të prapashtesave të caktuara edhe për këtë nënfushë semantike, gjithsesi aktuale për të gjitha kohët, por sidomos për kohën tonë, për këtë rast (për trajtimin e temës së shtruar) u konsultua materiali nga dy burime të njohura të gjuhës sone letrare: *Fjalori e gjuhës shqipe* (FGJSH) 1954 dhe *Fjalori e*

shqipes së sotme (FSHS) 1984 d.m.th. volëm emrat e sendeve me prapashtesim dhe nga analiza e kësaj pune nuk mbeti pa rezultate me interes.

Sipas gjendjes së numrit të emrave të sendeve, siç u dha, kah fillimi i këtij punimi, në Pasqyrën përkatëse, më poshtë po japim "pasqyrëzën e shkurtuar vetëm për 10 shembujt e parë, ku të dhënat vlersohen sipas destinimit a vendit të radhës sipas numrit të emërtimeve:

Skema e përqindjes dhe ndryshimi i numrit të emrave me prapashtesim të sendeve

Radhitja e prapashtesës	B u r i m i		N d r y s h i m i	
	FGJSH (443 shembuj)	FSHS (941 shembuj)		
1	2	3	4	
1. -zë	18.4%	-(ë)s	17.0%	-se, më shumë për 22.5 herë
2. -ore	11.5%	-ore	15.9%	-je " 6.0 "
3. -ë	9.2%	-zë	15.8%	-or " 5.6 "
4. -s e -cë nga	6.9%	-se	9.5%	-(ë)s " 5.03 "
5. -ull	5.7%	-ë	5.9%	-im " 4.0 "
6. -esë	4.8	-esë	4.2%	-are " 3.2 "
7. -e	4.3%	-are	3.1%	-ore " 3.0 "
8. -are	4.1%	-aç(e)	2.9%	-ar " 2.8 "
9. -aç(e)	3.4%	-or	2.8%	-inë dhe -ishtë 2.6 "
10. -icë	3.0%	-ar e -e	2.7%	-ashkë dhe -nik 2.3 " etj.

Në dhjetëshin e parë, pra, sipas shumës a përqindjes në të dyja burimet qëndrojnë këto prapashtesa: **ore, -zë, -(ë)s, -ë, esë, -aç dhe e**, të cilat mund të konsiderohen si prapashtesa me vazhdimësi specifikuuese. Në FSHS (1984) shumim më të madh kanë formimet me prapshtesën **-SE** (22.5 herë), më **-JE** (6.0 herë), **-OR** (5.6 herë) e kështu me radhë.

Ç`është e vërteta, prej 26 prapashtesave, siç po shihet nga pasqyra, më prodhimtare, përkatësisht me prirje specifikimi për emërtimin e sendeve mund të veçohen 16 sosh, 10 femërorëzueset: **-se, -ore, -ëz, -are, -urina, -esë, -ë, -cë, -e dhe -je** si dhe 6 mashkullorëzueset: **-(ë)s, -or, -aç, -th, -ar dhe -im**.

Këto të dhëna sigurisht do të shërbejnë së paku si bazë mbëshshtetëse a si pikë orientuese për vazhdimin e shtjellimit dhe të zbërthimit të mëtejshëm më të përimituar të kësaj teme, ngase vetë konteksti a zhvillimi i mëtejshëm do të vulosë fatin e rasteve të emërtimeve të caktuara.

Gjithsesi koncepti rreth specifikimit të formanteve të caktuara lidhur me emërtimin e sendeve mbi fjalë-temat vendëse të gjuhës sonë do të jetë më i qartë pasi ta lexohet me vëmendje materiali i shtruar në këtë punim.

Gjithsesi rezultatet dhe konstatimet e paraqitura nga analiza ma merr mendja se duhet t'i kenë në konsideratë jo vetëm gramatikanët, por edhe kuadrot përkatëse të profileve të ndryshme, të cilët po ballafaqohen me problematikën e emërtimeve të sendeve, në punën e tyre të përditshme, sfidë kjo e përditshme e jetës.

Prishtinë, maj 1996

5. FORMANTI -TORE, PRAPASHTESË E MËVETËSISHME NË SHQIPE ME PRIRJE SPECIALIZIMI PËR EMËRTIMIN E VENDSHËRBESAVE

H y r j e

Si në çdo gjuhë të zhvilluar e të përpunuar edhe në shqipen standarde para gjuhësisë shtrohet detyrë që në kuadër të "planifikimit gjuhësor" <§F Shih: Dubravko Škiljan, Pogled u lingvistici, Zagreb 1980. f. 102.>, i cili bëhet në suazat e politikës së përgjithshme gjuhësore, të qëmtojnë dhe të përkujdeset edhe për terminologjinë teknike - shkencore të të gjitha disiplinave përgjithësisht dhe të degëve, nëndegëve e profileve të caktuara veçantisht. Për t'u kryer sa më me sukses një punë e tillë

para gjuhëtarëve e specialistëve të disiplinave të caktuara shtrohet detyrë permanente që të hetojnë, analizojnë dhe të përpunojnë mënyrat ekzistuese të formëzimit dhe të fjalëformimit duke i vënë në spikamë prirjet e zhvillimit si dhe mundësitë e zbatimit të rregullive të caktuara në jetë, natyrisht duke i pasur parasysh si shtytësit e jashtëm që vijnë bashkë me ide e koncepte të reja, ashtu edhe mundësitë që dalin nga vetë sistemi i brendshëm i gjuhës me strukturat e saj.

Siç është i lëvërdishëm b.f. në industri a në ndërmarrje prodhimi realizimi i kampionëve (mostrave) në bazë të të cilëve do të bëhej i mundshëm prodhimi serik i artikujve a i pjesëve të caktuara ndaj prodhimit manual a jo serik, ashtu edhe në fushën e fjalëformimit është me interes që të vërehet dhe të mbështetet prirja e caktuar me qëllim të formëzimit të modelit të caktuar fjalëformues, ngase kjo shkon në dobi të pasurimit të leksikut, të shumëformësisë së aktit të të shprehurit dhe në rritjen e prestigjit të gjuhës tandarde dhe të normës së saj. Në të dyja rastet angazhimi dhe bashkëpunimi i specialistëve është i nevojshëm dhe i domosdoshëm.

Prandaj edhe çështja e terminologjisë tekniko - shkencore në gjuhën tonë nuk duhet lënë nën mëshirën e stihisë e të spontanitetit, por ajo duhet të trajtohet me kompetencën e duhur, qoftë nga faktorët e disiplinave të profilit përkatës, qoftë nga kuadrot kompetentë nga jeta shoqërore - politike e bashkësisë së caktuar që e përdor atë gjuhë. Po në këto suaza do parë edhe çështja e trajtimit të vendshërbesave me -TORE në gjuhën tonë, temë kjo që është objekt trajtimi në disa nëntituj të këtij punimi.

Para se të hyhet në analiza më të hollësishme rreth kësaj teme del e nevojshme të jepen këto tri sqarime paraprake:

e para, duhet thënë dy fjalë rreth përkufizimit të temës,
e dyta, sa e si është trajtuar kjo temë më përpara,
përkatësisht si është parë kjo çështje në sytë e gjuhëtarëve tanë
dhe

e treta, të sqarohet qëllimi konkret i objektit të këtij studimi.

a) Rreth përkufizimit të termit "vendshërbesë"

Me termin vendshërbesë (neologjizëm, ku gjymtyra "shërbesë" këtë rast merr konotacion përgjithësues) në këtë punim përfshihen dy koncepte të shkruara në një nocion, i cili mund të shprehet si vijon:

së pari, vendshërbesë do të quhet një lokal veprimësie <\$F Fjala **veprimësi** këtu është përdorur si term ekonomik kryesisht si

barasvlerës i fjalës biznes (afarizëm!), ser. poslovanje.>, punishtë (lokal afarist, lokal biznesi, zyrë a lokal pune /serbisht: poslovna prostorija, radnja, ital. bottega (di...); fr. boutique (de...), anglisht: (...)-shop; gjerm. Laden; spanjisht: tjenda; sued. butik; turqisht: dükân (dyqan)/) që mund të jetë zakonisht një ndërtesë a vendth çfarëdo, por gjithsesi i kufizuar e i shenjuar për një destinim (qoftë tregtar, qoftë shërbimes), ku përdorohet (prodhohet, përpunohet, shitet, kultivohet, ruhet, mirëmbahet, shfrytëzohet a grumbullohet) sendi i emërtuar në temën fjalëformuese të emërtimit përkatës;

së dyti, me termin vendshërbesë emërtohet lokali ku kryhet a mund të kryhet një veprim, një nevojë, një shërbim a një shërbimësi: profesion a zeje që është cekur në temën fjalëformuese dhe ka lidhje kuptimore me temën e tillë (foljore a emërore) të emërtimit përkatës.

Sipas një kuptimi më të gjerë nocioni i vendshërbesës përfshin edhe ndonjë vend që leksiko-gramatikisht shprehet me një emër të pamë konkret si p.sh. zyrë, shkollë, depo, fermë. dyqan, rreth, komunë etj. ku nënkuptohet ndërtesa që simbolizon emërtimin e caktuar, i cili në të vërtetë për t'u bërë vendshërbesë e mirëfilltë nevojitet të marrë ndonjë përcaktues si shenjë destinacioni. Nocioni i vendshërbesës mund të mbulohet edhe me shprehje perifrastike si p.sh. zyrë e këmbimit të valutave (këmbimtare), fermë për majmërinë e gjedheve a të viçave (majmëtare), vend ku lihen sendet peng (pengtare) etj. <\$F Format këmbimtare dhe pengtare janë marrë nga "Fjalori i termave dhe i shprehjeve ekonomike shqip -serbokroatisht" (H. Gorani, Prishtinë 1985 f. 130, 237.>, por ato më shumë e më natyrshëm leksiko-gramatikisht paraqiten në formë kompozite a me ndonjë togfjalësh të qëndrueshëm me prirje njëfjalëzimi të tipit: vendprirje, vendshkarkim, sallë - leximi, arkë - kursimi, bankë këmbimi etj., të cilat, si me thënë, bashkëjetojnë në sinonimi me emrat e prejardhur me prapashtesën përkatëse, që në këtë punim për shumicën e rasteve parapëlqehet emërtimi njëfjalësh me prapashtesën -TORE.

U parapëlqye si term trajta **vendshërbesë** e jo sinonimet e tjera të mundshme, sepse asnjëra nga emërtimet e deritashme si dyqan, punishte, lokal, zyrë + përcaktimi përkatës i destinacionit nuk mund të përgjithësoheshin për të mbuluar tërë nocionin e vendshërbesës, siç u përkufizua më sipër, madje as përgjegjësi "shërbim" a "vendshërbim", sepse fjala vendshërbim del e ngarkuar për koncepte të tjera, siç është koncepti b.f. i vendit ku kryhet shërbimi ushtarak (nëpunësor, zyrtar etj.), kurse me fjalën "shërbesë" a "vendshërbesë", sipas mendimit tim, mund të përthekohen edhe anët më periferike të nocionit që kanë të bëjnë me nevojat personale, siç janë shërbesat fetare, familjare, profesionale deri edhe ato fiziologjike etj., por edhe lokali ku

gjenden sendet a gjërat me të cilat bëhen përdorime (manipulime) si mjetet, kafshët etj. Gjithsesi sende e gjëkafshë konkrete.

Lidhur me çështjen e emërimit të vendshërbesave dhe sidomos rreth krijimit të fjalëve të tilla del e nevojshme të dihet tendenca a parimi fjalëformues se njëfjalëzimi është synimi i praktikës terminologjike përgjithësisht, prandaj edhe lidhur me temën që po trajtohet këtu duhen pasur parasysh mënyrat e njëfjalëzimit të shprehjeve perifrastike, qoftë me anë të kompozimit, qoftë me anë të prejardhjes.

Edhe pse lidhur me emrat e përbërë a të përngjitur për këtë tip emërimesh nuk është bërë ndonjë studim i posaçëm, nga shembujt që qëmtuam për këtë temë mund të rezultohet se emërtimet e tipit vendparaqitje, vendpushim, vetëshërbim si dhe togjet me prirje njëfjalëzimi si: shtëpi e lindjes, kënd për shlodhje, shtëpi - pushimi, vend - strehim, shteg - skijimi etj. dalin mbizotëruese ndaj tipave të tjerë të kompozimit si b.f. shtypshkronjë e të ngjashme. Po ashtu edhe emrat e prejardhur me prapashtesën -TORE janë mbizotërues ndaj formimeve me prapashtesat e tjera sinonimike për këtë tip emërimesh. Mirëpo çështja e formimit të emrave me prapashtesën -TORE do parë më në përhollësi, ngase kjo prapashtesë dhe formimet me të në shumicën e burimeve të deritashme normative të gjuhës sonë dalin jo sa duhet të qarta, qoftë nga ana praktike qoftë nga pikëpamja teorike.

b) **Vendshërbesat me -TORE në sytë e gjuhëtarëve tanë**

Në etapën e Rilindjes sonë Kombëtare nuk është e pahetueshme edhe "rilindja" e emrave me prapashtesën -TORE, madje në disa nënfusha kuptimore, ndër të cilat bën pjesë edhe nënfusha e emërtimeve të **vendshërbesave**, siç po quhen në këtë punim. Ndaj emërtimeve të tilla, të cilat në gjuhën e shkrimit patën përdorim të dukshëm, por, si të themi, të krijuara me kriter e pa kriter atëherë si edhe sot, pati reaguar në atë kohë studiuesi Aleksandër Xhuvani. Ç'është e vërteta, lidhur me emërtimet e vendshërbesave me prapashtesën -TORE ky autor atëherë ka shprehur rezervë. Kjo shihet nga një punimth i tij i shkruar që në vitin 1903 (Shih: "Kokrra gjuhe" në Studime filologjike" 4/86, Tiranë 1986) si dhe në artikullin "Shkronjë a shkrolë" të botuar në gazetën "Liri e Shqipërisë", Sofje 1912 (Shih: A. Xhuvani, Vepra I, Tiranë 1980). A. Xhuvani, atëherë mendonte se emërtimet si p.sh. "libërtore, sëmuretore, derdhëtore, qarkëtore, mësonjëtorë, shkronjëtorë, shkresëtore" me kuptim vendi "nuk dëftojnë atë që është për të thënë", sepse sipas tij kryesisht ato janë trajta femërore të emrave të vepruesit me -TOR (*-TUER, -TUAR) dhe për këtë sjell shembullin si shkronjëtor (mashk.) shkronjëtorë (fem.). Për të shprehur ndonjë emër vendi, sipas tij, më popullore d.m.th. më e pranueshme del prapashtesa -ISHTË e ndonjë tjetër, por jo -TOR+E.

Edhe pse nuk mbeti pa jehonë, për gjendjen e sotme të gjuhës sonë letrare, mendimi i A. Xhuvanit, mund të quhet i tejkaluar për segmente të caktuara. Siç na është e njohur në gjuhën e sotme letrare prapashtesa -TOR/E nuk është mbizotëruese për emrat e vepruesit, por ajo -TAR/E, kurse numri i vendshërbesave me -TORE vazhdon të ketë rritje prej burimi në burim. <§F Më gjerësisht në punimin "Struktura fjalëformuese e emërtimit të njerëzve sipas profesionit në gjuhën shqipe" (disertacion doktorate) e N. Veselajt, Prishtinë 1991 (dorëshkrim).>

Për qëndrimin e studiuesve të tjerë të asaj periudhe, sidomos të etapës së Pavarësisë, nuk di, <§F Nuk pata mundësi ta kisha në dorë dhe ta konsultoja Fjalorin e L. Logorecit. Pandeh se aty do të jetë evidente edhe prapashtesa -TORE.> por si duket qëndrimi i A. Xhuvanit i pranuar sipërfaqësisht mbetet i pranishëm, qoftë lidhur me kapërthimin e prapashtesës -TORE me -TOR, edhe pse kryejnë funksione të ndryshme të specifikuar, qoftë lidhur me kapërthyerjen a identifikimin e prapashtesës -TORE me prapashtesat simotra -ORE dhe -ATORE.

N. Gazulli në Fjalorin e tij (Shih: D. N. Gazulli, Fjalorth i ri, Tiranë 1941, f.27 - 40) nuk e shënon fare formantin -TORE në strukturën e prapashtesave, edhe pse i ka të shënuara fjalët me prapashtesën -TORE si **skjeptore, shkipëtore** etj. Me sa di unë, i pari që prapashtesën -TORE e rendit bashkë me prapashtesat e tjera si: -ORE, -INË, -ISHTË, është prof. Shaban Demiraj, i cili në gramatikën e tij për prapashtesat në fjalë thotë këto "në përgjithësi u shtohen temave të emrave konkretë për të formuar po emra konkretë që tregojnë vendin ku prodhohet a ku gjendet sendi i emëruar nga tema, të cilës i është shtuar prapashtesa" si p.sh: orizore, kripore, gurore, bulmetore, ushqimore, mengjessore etj.; gjellëtore, pijetore, nevojtoare; zallinë, rrapinë; ranishtë, ullishtë" (Shih: Sh. Demiraj, Morfologjia e gjuhës shqipe, Tiranë 1960, f.107, konstatim ky mjaft përgjithësues, por i shtruar drejt.

Në monografinë "Prapashtesat e gjuhës shqipe", Tiranë 1962 të bashkautorëve A. Xhuvani - E. Çabej, prapashtesa -TORE nuk del e perceptuar qartë, edhe pse funksionaliteti i saj nuk mohohet. Aty te prapashtesa -ATUAR, -ATUER fem.- TORE jepet shpjegimi se "-ATORE morfologjikisht është një variacion i prapashtesës -TOR; -TUER, fem. TORE" dhe se, siç thuhet aty, "kjo shihet nga identiteti i funksionit, sepse javatore, vajatore janë po ashtu nomina agentis si punëtore, blegtoare, prandaj edhe me ndonjë fjalë kemi të dyja format si vajatore vajtoare". Edhe më qartë për funksionin e prapashtesës -TORE autorët shprehen te prapashtesa -TOR (-TUAR, -TUER), ngase siç shpjegojnë ata "kjo prapashtesë (d.m.th. prapashtesa -TOR - sqarimi im) në disa emra e mbiemra formon rregullisht edhe gjininë femërore me -E", kështu pra sipas tyre -TOR+E "është produktive në gjuhë të shkrimit me funksion

lokal p.sh. duhantore, faltore, gjelltoore, pijetore, qebaptore, shkronjëtoore, therrëtoore" (Shih: A. Xhuvani, Vepra I, Tiranë 1980, f. 452 - 453).

Në gramatikën normative (1976) <§F Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe II, Tiranë 1976.> pranë prapashtesës -ORE përmendet edhe ajo -TORE dhe lidhur me të dyja këto prapashtesa jepet ky përkufizim: "me prapashtesat -ORE dhe -TORE formohen emra që tregojnë vendin ku mbillet, nxirret, përpunohet, shitet një send ose është i lidhur me një send a punë" dhe se këto "u shtohen temave emërore e më rrallë atyre foljore a mbiemërore" si p. sh.: "elbore, misërore, mengjesore, bulmetore, ëmbëltoore, gjelltoore". Aty jepet edhe ky konstatim: "Prapashtesat -ORE dhe -TORE për formimin e emrave të vendeve nuk janë prodhimore", konstatim ky që nuk përputhet me realitetin e sotëm për segmente të caktuara.

Në disa burime të tjera normative e shkencore prapashtesa -TORE ose nuk përmendet fare si prapashtesë prodhimore si p.sh. te doracaku "Gjuha letare për të gjithë", Tiranë 1976, te Studime gjuhësore në fushë të shqipes III të prof. I. Ajetit, Prishtinë 1987 ose del e shënuar si -TOR(E) d.m.th nën hijen e prapashtesës -TOR. Kështu e ndeshim edhe në veprën "Leksikologjia e gjuhës shqipe" të J. Thomajt, Prishtinë 1977, ku thuhet se "janë formuar me prapashtesën -OR(E) dhe -TOR(E) emrat e vendeve ku prodhohet a shitet diçka si kripore, gjelltoore, bulmetore (Aty f.67). Edhe në librin tjetër të këtij autori "Prejardhja semantike në gjuhën shqipe" (Tiranë 1989) në pasqyrën e modeleve fjalëformuese, prapashtesa -TORE shënohet në kllapa pas prapashtesës -ORE edhe te shembujt fjetore (f.250), gjellëtoore (f.254) dhe ëmbëltoore (f.258).

Studiuesi Josif Kole në punimin e tij me titull "Rreth emrave të prejardhur me -ORE (botuar në përmlendhjen: "Çështje të gramatikës së shqipes së sotme" II, Tiranë 1975) prek edhe çështjen e emërtimeve me -TORE, ku pos tjerash konstaton: "në gjuhën shqipe për të emërtuar ndërtesën, lokalin, institucionin etj., në të cilin kryhet një veprim ose për të emërtuar ku gjendet me shumicë, ku përpunohet ose shitet sendi i emërtuar në temën fjalëformuese, ka edhe mjaft emra të formuar me prapashtesën -TORE. Disa prej tyre si gjelltoore, pijetore, duhantore, nevojtoore, thertore, byrektore, ëmbëltoore etj. kanë përdorim të përgjithshëm, ndërsa disa të tjerë sipas tij, si: "barnatore, derdhëtoore, hietore, djathëtoore, sapuntore, gjumëtoore, bukëtoore (...) nuk patën jetë të gjatë në përdorim të përgjithshëm".

Hiq ndonjë vërejtje që mund të bëhet lidhur me përkufizimin siç është p. sh. konstatimi rreth: "jetëgjatësisë" si dhe të gjendurit "me shumicë", që për ne kanë vlerë relative për nocionin e vendshërbesës së mirëfilltë si dhe raportit jo të qartë rreth

prapashtesave simotra -ORE, -ATORE e -TORE (ngase aty pothuajse pranë e pranë pa u specifikuar semantikisht ndeshen trajtat si brumëtore, eshkëtore, tymtore, kuptore me ato piskatore, gjedhatore, pushkatore, ajarmatore që tregojnë sende si emra konkretë, në njëerën anë, po ashtu i ndeshim emrat ujëtore, veshtore, vajtore, bashkë me javatore, fshesatore, madje edhe stanore, si emërtime të grave sipas veprimtarisë, në anën tjetër), punimi në fjalë ka vlerë të padiskutueshme edhe sa u përket emrave me prapashtesën -TORE, jo vetëm pse ecuria rreth kristalizimit të emrave me prapashtesën -ORE metodisht është e zbatueshme edhe për emrat me -TORE, por edhe për arsye se aty në mënyrë më të plotë është përcaktuar kuptimi leksikor i vendshërbesës me -TORE d.m.th. vendi "ku kryhet një veprim", përkatësisht vendi "ku përpunohet ose shitet sendi i emërtuar në temën fjalëformuese".

Emrat me prapashtesën -TORE në mënyrë të veçantë i pati objekt trajtimi studiuesi Mehmet Halimi, në punimin e tij me titull "Mundësia e zgjerimit dhe e pasurimit të terminologjisë me prapashtesën fjalëformuese -TORE" (Shih: Gjendja e terminologjisë shqipe në Jugosllavi, IA, Prishtinë 1988). Edhe në këtë studim raporti kundërvënës ndërmjet prapashtesave simotra -ORE, ATORE dhe -TORE nuk del i qartë, edhe pse në bazë të materialit të prezentuar aty prapashtesa -TORE del me fizionomi më të qartë se kudo gjëtu dedikuar ekskluzivisht për emërtimin e vendshërbesave, ndërsa prapashtesa -ATORE del si formant i mëvetësishëm i sforcuar dhe i angazhuar kryesisht për emërtimin e grave sipas veprimtarisë së tyre. Sipas mendimit tim po t'i trajtonte veç emërtimet me prapashtesën -ATORE dhe veç ato me prapashtesën -TORE duke e pasur për bazë prirjen kundërvënëse të tyre, punimi do t'i dilte më cilësor. Lidhur me emërtimin e vendshërbesave në punimin në fjalë zgjojnë interes dhe kërshërinë këto çështje që sapo ceken nga autori:

a) përparësia semantike e temës fjalëformuese si kriter për emërtimin e vendshërbesës si p.sh. avulltore në vend kazantore, kur është fjala për vendin prej nga bëhet prodhimi i avullit për ngrohje;

b) zhvendosja e emërtimit çoraptore nga nënfusha e emërtimit të gruas në nënfushën semantike të vendshërbesës duke e nënkuptuar specializimin e prapashtesës -TORE për këtë nënfushë semantike;

c) për emërtimin e veprimit që kryhet parapëlqehet tema foljore ndaj asaj emërore si p.sh. përmjerrëtoare a pshurrëtoare kundrejt shurrëtoare dhe

ç) përfshirja e formave bulmetore, bujtore, rrojtore në grupin e emërtimeve më prapashtesën -TORE e jo -ORE, çka nënkupton raportin bulmet + TORE bulmetore ose bujtë + TORE bujt(ë)toare bujttore bujtore.

Sigurisht këto çështje të diskutueshme të sapocekura janë me interes të zërthehen më tej. Gjithsesi këto si dhe konstatime e propozime që jep M. Halimi në atë punim duhet të kihet në konsideratë, sidomos ajo moto-kërkesa që ka të bëjë me "zgjerimin dhe pasurimin e terminologjisë shqipe me mjete të veta leksikore" e që si mjet të tillë autori e konsideron më të drejtë pikërisht prapashtesën -TORE.

Siç u pa nga kjo paraqitje, edhe pse fare shkurtazi, lidhur me emërtimet e vendshërbesave me -TORE gjuhëtarët tanë patën qasje e qëndrime pak a shumë të ndryshme duke filluar nga shprehja e rezervës deri te mosfavorizimi për të arritur deri te favorizimi i tyre me qëllim "të pasurimit të terminologjisë teknike -shkencore", mirëpo pa u përcaktuar qartë nënfusha semantike.

Sipas kësaj që u paraqit mund të konstatohet se tema e tillë mbetet e hapur aktualisht, prandaj lidhur me këtë del e nevojshme të nxitet kërshëria dhe të zgjohet interesimi sidomos i studiuesve që të japin ndihmesën e tyre edhe praktike, në mënyrë që çështja në shqyrtim edhe praktikisht të gjejë zgjidhje të duhur.

c) **Qëllimi i objektit të studimit**

Duke u konsideruar çështja e emërtimeve të vendshërbesave me -TORE si një nga çështjet e mprehta të shqipes së sotme standarde, në këtë punim i vumë vetes si qëllim e detyrë të përpigemi të japim përgjigje në këto tetë pyetje, çështje këto që shtrohen në kontekst të trajtimit të temës sipas nëntitujve përkatës:

(1). Si mund dhe pse ia vlen të vërtetohet mëvetësia e prapashtesës -TORE?

(2). Cili qe shtytësi i jashtëm që motivoi dhe motivon shtimin e numrit të vendshërbesave me -TORE?

(3). Ç'farë përparësie ka formanti -TORE kundrejt prapashtesave të tjera sinonimike konkurruese?

(4). Si qëndron raporti kundërvënës ndërmjet prapashtesave simotra -ORE, -ATORE, -TORE?

(5). Si qëndron prirja rreth përcaktimit të trajtës së temës fjalëformuese në rastet e brishta të emërtimit të vendshërbesave me -TORE?

(6). Sa është e rëndësishme semantika e përkufizimit aktual si kriter vlerësues për qëndrueshmërinë e disa emërtimeve të vendshërbesave me prapashtesën -TORE?

(7). Çfarë vendi duhet të zërë formanti -TORE në kuadër të strukturës së prapashtesave speciale në vargun e fjalëformimit të emrave nga tema e njëjtë fjalëformuese si përcaktues i nënfushës së caktuar semantike?

(8). A mund të përcaktohen rregullsi të përgjithshme rreth përdorimit të vendshërbesave me -TORE në shqipen e sotme standarde?

Me një fjalë qëllimi i objektit të studimit tonë është jo vetëm të shtruarit e temës për diskutim, por edhe të japim ide rreth zgjidhjes së kësaj çështjeje, mbështetja e të cilave do të na shpiente drejt zgjidhjes përfundimtare të saj.

**(1) Vërtetesa mbi mëvetësinë e prapashtesës
-TORE parakusht për specifikimin e saj**

Ka mjaft burime e mundësi për t'u argumentuar mëvetësia e prapashtesës -TORE, mirëpo ne u mjaftuam me vjeljen dhe sjelljen në analizë të materialit përkatës nga këto katër burime leksikografike: 1) Fjalori i K. Kristoforidhit (FK 1094), 2) Fjalori i Bashkimit (FB 1908), 3) Fjalori i gjuhës shqipe (FGJSH 1054) dhe 4) Fjalori i gjuhës së sotme shqipe (FGJSSH 1980) <§F Në tabelë dhe në punim herë - herë janë përdorur këto shkurtesa: FK (1904) - Fjalori shqip - greqisht i K. Kristoforidhit, ribotim Prishtinë 1977; FB (1908) Fjalori i "Bashkimit" (shqip - italisht) ribotim, Prishtinë 1978; FGJSH (1954) - Fjalori i gjuhës shqipe, ribotim Prishtinë 1976; FGJSSH (1980) - Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, Tiranë 1980, ribotim Prishtinë 1981.> dhe nga trajtimi i lëndës së tillë, siç do të shihet në vazhdim, dolën të dhëna të pakontestueshme, nga të cilat mjaft bindshëm dëshmohet mëvetësia e prapashtesës -TORE, d.m.th. ky formant del i pavarur funksionalisht nga formanti i gjinisë mashkullore -TOR si dhe nga prapashtesat simotra të saj: -ATORE dhe -ORE. Madje si formant i tillë d.m.th. i pavarur del i përdorur në disa nënfusha semantike siç janë:

- a) nënfusha semantike e emërtimit të gruas sipas veprimtarisë;
- b) emërtimet nga nënfusha e botës bimore - shtazore;
- c) emërtimet e mjeteve dhe sendeve konkrete;
- ç) emërtimet si fjalë - terma nga nënfusha e terminologjisë gjuhësore (gramatikore) dhe
- d) emërtimet nga nënfusha e vendshërbesave.

Të gjitha këto numërikisht mund të shihen më qartë në tabelën e mëposhtme:

T A B E L A
e numrit të emërtimeve me prapashtesën -TORE

Nënfusha semantike	B u r i m i l e k s i k o g r a f i k			
	FK(1904)	FB(1908)	FGJSH(1954)	FGJSSH(1980)
1. Gruaja sipas veprimtarisë	4	3	2	3
2. Nga bota bimore-shtazore	2	1	2	3
3. Mjete, sende konkrete	-	2	2	5
4. Fjalë- terma gramatikorë	2	10	-	3
5. Vendshërbesat	-	4	11	38

Siç po shihet nga tabela e mësipërme në katër nënfushat e para semantike, sipas burimeve përkatëse të konsultuara, numri i emrave me prapashtesën -TORE është fare i vogël, vetëm, si të thuash, sa vërteton faktin e ekzistimit të tillë, ndërsa në nënfushën e pestë, në emërtimin e vendshërbesave shënon rritje suksesive, kështu që nga zero (0) në FK (1904), 4 në FB (1908), 11 në FGJSSH (1954), 38 në FGJSSH (1980), aktualisht numri i tyre, siç do të dëshmohet në këtë punim, arrin të kalojë dukshëm shifrën 100.

Megjenëse për emërtimet e vendshërbesave, sipas aspekteve të ndryshme, më në hollësi, do të bëhej fjalë në të gjithë nëntitujt vijues të këtij punimi, këtu në vazhdim e shoh të arsyeshme dhe të nevojshme të jap ndonjë sqarim a të shpreh ndonjë gjykim rreth emërtimeve me -TORE që përdoren në nënfusha të tjera semantike, siç u cekën më sipër d.m.th. jo si emërtime vendshërbesash.

1) Lidhur me emërtimin e njerëzve sipas profesionit a veprimtarisë së tyre na është i njohur fakti se emërtimet e tilla, në burimet përkatëse shënohen zakonisht në gjininë përfaqësuese femërore <\$F Shih, vepra e cituar në shënimin 4.> . Kështu ngjan edhe me emrat me -TOR të këtij tipi semantik. Ç'është e vërteta, emrat e tillë në gjuhën e sotme letrare shqipe janë në numër të vogël, mirëpo rregullsia e tillë është e pranishme, sepse nga emri punëtor, shërbëtor etj. që janë në mashkullorë, femërorja bëhet rregullisht duke ia shtuar formantit -TOR vetëm prapashtesë- mbaresën -E: punëtor+E punëtore, shërbëtor+E shërbëtore etj. Mirëpo rregullsia e tillë thyhet a ndërron drejtimin në raste, edhe pse në gjuhën e sotme janë të rralla, kur emërtimi i profesionit del ekskluzivisht në gjininë përfaqësuese femërore, raste këto kur prapashtesa -TORE funksionalisht del e pavarur nga trajta -TOR. Lidhur me këtë nga lënda e vjelë nga FK (1904) dhe FB(1908) dhe nga lënda përgjithësisht bien në sy nja tri çështje, të cilat na tërheqin vëmendjen.

Megjenëse që të tria këto çështje shkojnë në favor të vërtetesës mbi mëvetësinë e prapashtesës -TORE kundrejt asaj -TOR, më poshtë do t'i trajtojmë veç e veç:

së pari, po përmendim ngjashmërinë me formantin -TORE të italishtes;

së dyti, formën -TORE e cila në shqipe del e pa thyer dialektorisht kundrejt asaj -TOR (-TUAR, TUER, -TUR) të thyer dhe

së treti, do parë prirja jo e pavërejtshme që ka të bëjë me faktin kur emri në mashkullorë del me prapashtesë tjetër si -TAR, -AR e me ndonjë tjetër, d.m.th. ndryshe nga emri i gjinisë femërore, i cili mbetet i pandryshuar më -TORE (-ATORE).

T'i sqarojmë paksa, pra, këto tri fakte:

Së pari, edhepse përmendet ngjashmëria e formantit -TORE të shqipes e të italishtes, këtu as që na shkon mendja ta diskutojmë a ta sjellim në dyshim autoktoninë e prapashtesës -TOR të shqipes si dhe përputhjen e formës me prapashtesën -TOREM (-TOR) të latinishtes (i. e. *TĒR) <§F A. Xhuvani, Vepra I, Tiranë 1980, Prapashtesat e gjuhës shqipe, f. 553.> por do të cysim kërkshërinë rreth raportit -TOR, -TORE shqip dhe italisht. Lidhur me këtë le të krahasohen krijimet e rrënjësura, përkatësisht huazimet a përkimet e vjetra të fjalëve si p.sh. shq. punëtor/E it. lavoratore, shq. shërbëtor/E it. servitore; shq. murator it. muratore si dhe disa huazime të vona si: tornitor it. tornitore, frezator it. fresatore, montator it. montatore etj.

Ku qëndron, pra, dallimi a ku qëndron përkimi i formave të tilla?

Dallimi qëndron te fakti se me formantin -TORE italisht shprehet emri në gjininë mashkullore (femërorja ka tjetër prapashtesë), kurse në shqipe me formantin -TORE shprehet vetëm emri në gjininë femërore. E kur është fjala te huazimi transfer, siç po shihet te shembujt e sipërshënuar, në shqipe për gjininë mashkullore bëhet njëfarë modifikimi, sepse bie fundorja -E e italishtes, përkatësisht respektohet forma -TOR e latinishtes. Lidhur me këtë krahaso edhe këta dy shembuj: lat. traditor shq. tradhtar it. traditore; lat. versificator, shq. vjershëtar, it. versegjiatore.

Siç po shihet në shqipen e sotme letrare formimet e tilla dalin me prapashtesën -TAR: tradhtar, vjershëtar, prirje kjo që ka ndikuar në pakësimin i numrit të emrave me -TOR të gjinisë mashkullore, ndërsa për emrat e gjinisë femërore me -TORE, -ATORE, ndikimi i tillë nuk vërehet aq, të cilat në mjaft raste paraqiten të qëndrueshme, arsye kjo që vlen të gjurmohet më tej. Gjithsesi te shembujt e tillë hetohet njëfarë ndarje e formave -TOR e -TORE sipas funksionit që kryejnë dhe qëndrueshmërisë së tyre si tendencë për të ruajtur secila trajtë vendin e vet në strukturën e fjalëformimit.

Së dyti, e ngjashme me atë që u tha më sipër, por që mund të ndikojë si asociacion vizuel (shikimor) në favor të trajtës -TORE është edhe dukuria e thyerjes së formës -TOR, ndaj asaj -TORE të pathyer që ndeshet në disa shembuj te FK (1904), FB (1908) si dhe në burime të tjera e në të folmet dialektore. Të jem më i qartë, K. Kristoforidhi në Fjalorin e tij i shënon në skeda të veçanta këta emra grash më -TORE: punëtore, shërbëtore dhe vrapëtore, ku prapashtesa -TORE del shikimisht më e qartë nga ajo -TOR e mashkullores, edhepse kjo e fundit sot konsiderohet si trajtë përfaqësuese e emrit, sepse, siç u tha më sipër, pikërisht ajo del e thyer dialektorisht: -TUAR, -TUER, -TUR si p.sh. punëtuar,

punëtuer, shërbëtuar, shërbëtuer, shërbëtur, vrapëtuar etj.

Po kjo trajtë përfaqësuese e emrit shënohet edhe në raste kur fjala është shkruar në të njëjtin skedë në të dyja gjinitë si p.sh.: fjalëtuar f. fjalëtore, gjakëtuar f. gjakëtore, leshtuar leshtuer leshtur, f. leshtore, fajtuar fajtuer fajtur f. fajtore, ramtuar ramtuer ramtur, f. ramtore (bakërxhi remtar), f. remtare N.V.) etj.

Ja si del skema strukturore e përdorimit të prapashtesës -TOR, f. -TORE në të dyja gjinitë:

S k e m a
e përdorimit të prapashtesës -TOR/-TORE në FKK (1904)

Gjinia	Njëjësi i pashquar	Njëjësi i shquar	Shumësi i pashquar	Shumësi i shquar
Mashkullore	-TUAR -TUER -TUR	-TORI	-TORË	-TORËT
Femërore	-TORE	-TORJA	-TORE	TORET

Edhe në Fjalorin e "Bashkimit" ndeshen trajtat me formantin -TOR të thyer në trajtën përfaqësuese (njëjësin e pashquar të mashkullores) si p.sh.: blegtuer/blegtore, gaztuer/gaztore, harkëtuer/harkëtore, fjalëtuer/fjalëtore etj.

Pra kur kemi parasysh tërë strukturën e këtij formanti (sidomos trajtën përfaqësuese të emrit (d.m.th. njëjësin e pashquar të mashkullores) mund të nxirret përfundimi se në rrethana të caktuara kohore gjatë historisë, trajta e femërore -TORE, siç pasqyrohet në Fjalorin e K. Kristoforidhit (por edhe të F. Bardhit): m. shërbëtor, shërbëtuar f.shërbëtore), del më qartë dhe më e konsoliduar e stabile në krahasim me trajtën e mashkullores -TOR, e cila del e thyer dialektorisht. Së këtejmi pandehim se mund të kërkohet zanafilla e perceptimit të formës -TORE si një formant i pavarur, edhe në këtë nënfushë semantike e më gjerë siç del b.f. te shembujt vajtores, magjetore, shëmbëlltores (sipas burimeve të sipërcekura) pa e pasur paralel përgjegjësin përkatës të gjinisë mashkullore.

Së treti, në Fjalorin e K. Kristoforidhit emërtimet e femërores: lajëtores e lanjëtores përgjegjësen në mashkullore e kanë me prapashtesën -TAR, ashtu si emri ledhatores që ndeshim në Fjalorin e "Bashkimit", i cili në mashkullore del ledhatar. Edhe në FGJSSH (1980) ndeshim emërtime të ngjashme si p.sh. ujtore (f), ujar (m); cingëlatore (f), cingëlar (m); vajtores (f), vajtues (m)

etj. A. Zymberi nga terreni (Shih: Fjalorth i fjalëve të rralla, Prishtinë 1979) sjell emërtimet në femërore: fushatore, drithatore, herratore ndërsa në mashkullore: fushëtar, dorzëtar, herr(a)tar duke u dalluar kështu gjinia mbi bazë të prapashtesës përkatëse, ashtu siç ndodh edhe te shembulli stanar (m) / stanore (f) që del në FGJSSH f.1787 etj.

Nga shembujt e mësipërm dokumentohet fakti se me prapashtesat simotra: -TORE, -ATORE, -ORE janë formuar kryesisht a vetëm emra të gjinisë femërore, ndërsa me prapashtesat simotra -AR dhe -TAR janë formuar kryesisht a vetëm emra të gjinisë mashkullore, pa i përjashtuar ndërkëmbimet siç janë formimet e gjinisë femërore nga -TAR+E ose -AR+E si dhe formimet në ndonjë rast nga -TORE të gjinisë mashkullore duke i hequr fundorin -E formantit të caktuar -TOR.

Dukuria që u cek këtu që ishte e ndjeshme në të kaluarën, siç u pa nga shembujt e mësipërm, nuk ka kaluar pa lënë gjurmë edhe sot e gjithë ditën, jo vetëm në të folme dialektore, por edhe në gjuhën e shkrimit sot.

Kur është fjala te mëvetësia e prapashtesës -TORE vlen të përmendet fakti se disa trajta me -TORE që dilnin si emra në Fjalorin e K. Kristoforidhit si p.sh. vrapëto-re, leshtore, llaptore, zjarmëto-re, në FGJSSH 1980 dalin vetëm si mbiemra.

Duke i pasur parasysh faktet e sipërcekura nuk del i pabazë mëtimi se emrat me -TORE (-ATORE) në gjininë përfaqësuese femërore si emërtime të njerëzve sipas veprimtarisë mund t'u kenë prirë a të konsiderohen si faktor pararendës në disa raste ndaj emrave me -TOR (-ATOR) të gjinisë mashkullore të kësaj nënfushe semantike.

2) Sikurse te nënfusha e emërtimeve të grave sipas veprimtarisë së tyre edhe te nënfusha semantike e botës bimore -shtazore emrat me -TORE kanë shtrirje të kufizuar. Në FK (1904) është regjistruar emri shaptore e shapëto-re si dhe ai szeptore. Në FGJSH (1954) del emërtimi shullëto-re (emër dardhe), i cili nuk është përfshirë në FGJSSH (1980), po aty ndeshet një emër tjetër bime; gjalpëto-re. Nga kjo dëshmohet se emërtimet e bimëve dhe të shtazëve me -TORE nuk dalin as prodhimtare as aktive në burimet që u përmendën më sipër.

3) Siç po shihet nga tabela në FK (1904) nuk ndeshet asnjë emër sendi konkret me prapashtesën -TORE. Në FB (1908) shënuam dy emërtime të tilla: tyntore dhe knojto-re (për libër, e cila nuk u përgjithësua). Emrin tyntore e ndeshim edhe në FGJSH (1954) bashkë me emrin brumëto-re. Përveç këtyre dy emrave në FGJSSH (1980) i ndeshim edhe këta tre emra sendesh konkrete më -TORE: ajkëto-re, gjizëto-re, eshkëto-re. Ç` është e vërteta, tek emërtimet e tilla (këta tre të fundit), d.m.th. të sendeve konkrete, nuk përjashtohet

as perceptimi i konceptit të vendit, prandaj mund të thuhet se me prapashtesën -TORE nuk priren të formohen emra të sendeve konkrete.

4) Si fjalë - terma gramatikorë në FK (1904) hasëm dy emra me -TORE zantore dhe shkronjëtoare, ndërsa te Fjalori i "Bashkimit" i ndeshëm emrat apo, më mirë me thënë, mbiemrat e emërzuar: binntore, dhantore, xantore, emëntore, gryktore, lidhtore, linntore, përdhantore, venntore si dhe kompozitën dheshkronjëtoare. Pothuajse të gjitha këto nuk i ndeshim në burime të tjera me këtë prapashtesë, po me prapashtesën -ORE. Për këtë arsye në FGJSH (1954) nuk haset asnjë fjalë - term me prapashtesën -TORE, kurse në FGJSSH (1980) ndeshim këta tre shembuj: shkronjëtoare, nistore dhe mbylltore. Dy shembujt e fundit dhe emrin lëngëtoare i ndeshim në Fjalorin shqip - serbokroatisht (1981). <\$F Fjalor shqip - serbokroatisht, IA, Prishtinë 1981, f. 557, 636. Në tekstin e mëtejshëm: FSHSK (1981).>

Ç`është e vërteta, edhe nëse ndeshet ndonjë fjalë - term me -TORE si p.sh. "shkipëtoare" te N. Gazulli për "fjalën e qartë dhe të shkurtë shqipe" si dhe fjalën "udhëtoare" që e shënon A. Zymeri në Fjalorthin e tij si term në lojën e kapuçave, kjo nuk do të thotë se emërtimet e termave gramatikorë priren të formohen me prapashtesën -TORE. Si duket emërtimet e tilla plotësisht a kryesisht kanë gjetur konsolidim me prapashtesën -ORE.

* * *

Me sa u tha më sipër në këtë nëntitull mund të nxirret përfundimi se karakteri mëvetësues i prapashtesës -TORE, edhe pse në numër jo aq të madh shembujsh, vërtetohet në këto nënfusha semantike: në emërtimin e grave sipas veprimtarisë, në emërtimin e sendeve konkrete, në emërtime nga bota bimore e shtazore dhe në lëmin e fjalë - termave gramatikorë, mirëpo aktivitet e prodhimtari më të madhe kjo prapashtesë ka në formimin e emërtimeve të vendshërbesave, ku siç shihet edhe nga tabela që u dha në fillim të këtij nëntitulli, shënon rritje suksesive. Pikërisht mbi këto vërtetesa qëndron përmbushja e parakushtit për specifikimin e prapashtesës -TORE si prapashtesë e mëvetësishme në kuadër të strukturës së përgjithshme të prapashtesave aktive të shqipes standarde.

(2) Gjuhët në takim si shtytës motivues për
 rritjen e numrit të emërtimeve të
 vendshërbesave me -TORE

Si shkas për rritjen e numrit të emërtimeve të vendshërbesave me -TORE që nga Rilindja jonë Kombëtare e këtej, përveç nevojës që vjen nga zhvillimi i brendshëm i gjuhës patën dorë edhe faktorë të jashtëm, siç është edhe marrëdhënia e gjuhës sonë me gjuhë të tjera, sidomos me ato në takim të drejtpërdrejtë. Në të vërtetë, që në atë periudhë u rigjallëruan edhe emrat e mbiemrat me prapashtesën -TORE në kuadër të kërkesës që shtrohej para bashkësisë folëse në ato faza të zhvillimit të shoqërisë e të gjuhës së shqiptarëve, pasurimi i së cilës mbështetej në mjetet e veta fjalëformuese, qoftë ato autoktone, qoftë ato që moti të përvetësuar.

Prirja e tillë vihet re edhe në Fjalorin e "Bashkimit", ku prapashtesa -TORE del e përdorur pikërisht për emërtimin e vendshërbesave, për të zëvendësuar kështu formantin përkatës të turqishtes (osmane) **-hane**, të italishtes **-eria**, të greqishtes **-tekë** (-theke) etj.

Këtë prirje më së miri e ilustron këta dy shembuj karakteristikë: **smuntore** për **hastahane** të turqishtes dhe **biblëtore** për **bibloteka** e **libraria** të italishtes. <§F Fjalori i "Bashkimit" (1908), f.528.>

Për t'u kuptuar më mirë raporti ndërhuazues i gjuhëve në kontakt, përkatësisht ndikimi i gjuhëve të tjera ndaj gjuhës shqipe në këtë pikë, u konsultua materiali përkatës i gjuhëve: turke, italiane dhe të asaj serbokroate. <§F Përveç fjalorëve e burimeve përkatëse shqip - gjuhë e huaj e anasjelltas u konsultuan edhe fjalorët: Kurteš Agushi, tursko-srpski ili srpsko-turski, Istanbul 1980; M. Deanovi_ - J. Jernej, Talijansko - hrvatski ili srpski rje_nik, Zagreb 1980;

Re_nik ital;ijanski - srp[skohrvatski, srpskohrvatski - italijski, Cetinje, 1983; Fjalor serbokroatisht - shqip, IA,

Prishtinë 1974.>

Në vazhdim po japim një pasqyrë të disa shembujve të vendshërbesave të këtyre gjuhëve, të cilat kanë lënë vazhdë, qoftë drejtpërdrejt, qoftë asociacionisht tërthorazi në lindjen e emërtimeve në fjalë në gjuhën tonë.

Pasqyrë e emërtimeve barasvlerëse të vendshërbesve të katër gjuhëve (në kontakt

Turqisht	Italisht	Serbisht	Shqip
1	2	3	4
1. kahvehane	caffé (ristorante)	kavana	kafene, kafeteri, kafehane /kafetore
2. kasaphane /salhane, kanare/	mehelleria (becceheria)	mesara mesarnica (klaonica)	mishtore (thertore)
3. saraphane	birreria	pivnica (vinara)	birrari /birrëtore/
4. kÛrkÛhane	pelliceria	krznarija	gëzoftore
5. pastane (pastaci dÛkkâni)	pasticcieria	poslasti_arnica	ëmbëltore
6. ascihane	rostickeria	aš_inica (pe_enjarnica)	pjekëtore
7. eczane	spezeria (farmacia)	apoteka	barnatore
8. meyhane	trattoria (esteria)	kr_ma (gostionica)	pijetore
9. dersshane	classa	u_ionica	mësonjëtoje, klasë, (dhomë mësimi)
10. baruthane (cephane)	polveriera	barutana	barutore (kullë baruti)
11. sÛt dÛkkâni	lotteria	mlekarnica	qumështore
12. berberhane	barbieria	berbernica (brija_nica)	rrojtoje
13. basimevi	stamperia	štamparia	shtyptore (shtypshkronjë)
14. bekleme yeri	sala d`aspetto	_ekaonica	sallë e pritjes
15. yazihane	canceleria	kancelarija (pisarnica)	zyrë (shkresëtore)
16. dogumevi	casa di materita (ospedale di materita)	porodilište	lindëtore (shtëpi e lindjes)

17. kitablik	libreria	knji_ara	librari (libërtore)
18. kalhane dükÛmhane	fonderia	kalionica (topionica)	kalitore (shkritore)
19. demirhane	fucina	kova_nica	farkëtores
20. akuma yeri	sala di littura	_itaonica	salla e liximit (leximtores!)
21. sarrafhane	bottega di cambiovalute	menja_nica	këmbimtores (zyrë e këmbimit të valutave)
22. para birikterme kurumu	casa di risparmio	štedionica	kursimtores (banka e kursimit)
23. hastana (hastahane)	infermeria	ambulanta (bolnica)	infermieri (shërimtores!)
24. camasirhane (camasirlik)	lavanderia	perionica	lajtores (larëtores)
25. tabakhane	pelletteria	ko_arnica	lëkurëtores

=====

Siç po shihet nga shembujt e mësipërm, edhepse del ndonjë përjashtim, secila nga tri gjuhët e huaja për emërtimet në shqyrtim, pothuajse e ka të specializuar formantin përkatës, si p.sh. turqishtja (osmane) -hane, italishtja -eria, serbishtja -nica, ndërsa në gjuhën shqipe, edhepse në raste ende del e brishtë, mbizotëron prapashtesa -TORE.

Në vijim pikërisht për veçoritë e caktuara të prapashtesve të theksuara të huaja do të përpiqemi të japim ndonjë sqarim rasti, që më duket se është me interes për temën që po e trajtojmë.

1) Formanti **-hane**, në turqishten osmane ka hyrë si fjalë nga persishtja "hana" dhe duke shërbyer si gjymtyrë e dytë e kompozitave është bërë një siprapashtesë a sufiksoid special për të emërtuar nocionin e vetshërbesës. Në të vërtetë, fjala "hana", turqisht "hane" me kuptimin "shtëpi, ndërtesë" ka arritur të shtrihet në disa gjuhë të tjera duke kaluar në cilësinë e ndërkombëtarizmes së mirëfilltë, kështu që edhe në shqipe, siç u cek, me fjalën **han hani** është emërtuar një bujtinë ose "ndërtesë pranë udhës ose në qytete që shërbente si bujtinë për udhëtarët e që kishte edhe vend edhe për kafshët e tyre", siç thuhet në FGJSSH f.646. Në funksion të formantit a sufiksoidit special për emërtimin e vendshërbesave forma -hane përveç turqishtes ka kaluar edhe në gjuhë tjera, kjo dëshmohet edhe në gjuhën serbokroate, siç janë b.f. shembujt: kavana, kova_ana, _ajana etj.

Në gjuhën shqipe siprapashtesa -hane kishte përdorim aktiv, sidomos në periudhën para etapës së Pavarësisë. Mirëpo emërtimet e

tilla nuk ndeshen vetëm në burime të caktuara nga e kaluara, por ato i hasim edhe në përdorim të përditshëm edhe sot. Por ç'është e vërteta, ndërsa më përpara përdoreshin me kuptin neutral si p.sh. telegrafhane, kasaphane, kafehane, kumarhane, hapsanë, berberhanë, tabakhanë, avdeshanë etj. në kohën tonë shumica sosh ka kaluar në shtresën pasive të leksikut ose përdoret për nuanca të caktuara stilistike e kuptimore. Gjithsesi formanti i tillë si prapashtesë nuk e ka më prodhimitarinë e aktivitetin që e kishte dikur, kur edhe mbi fjalë-tema prodhuese të shqipes, pothuajse normalisht, përdorej ky formant për të formuar emra e mbiemra si p.sh. hekurhane, barnehane (që i ndeshim në FB 1908) duke kaluar edhe në kuptime tjera të tiparit të cilësisë së njeriut a të dukurisë si malsorhane, shqiptarhane etj.

2) Fjalët me -ERIA të italishtes i ndeshim të shtrira në gjuhën tonë që në etapën e Pavarësisë, por që vërshuan sidomos në vitet kur Italia okupoi Shqipërinë gjatë Luftës II Botërore, disa prej tyre mbetën në përdorim edhe sot e kësaj dite, siç janë b.f. huazimet transfer: gomesteri, pastiçeri, rostiçeri etj. por edhe paksa të modifikuara si p.sh. infermieri (it. infermeria), piteri (it. pizzeria). Në këtë kontekst vlen të përmenden edhe disa huazime hibride siç janë shembujt: birrari (it. birreria), librari (it. libreria) etj., ngase prapashtesa -ARI konsiderohet e burimit shqip, edhe pse ka ngjashmëri me formën -ARIJA të serbishtes (mbi bazë të latinishtes -ARIUS) siç del në atë gjuhë p.sh. shih edhe te rastet nga pasqyra jonë: krznarija, kancelarija etj.

Në Fjalorin shqip - serbokroatisht (1981) ndeshim trajtat: buceleri (bucelë+eri), pastiçieri (Krahaso: it. -eria, në rastet në shqip: IERI). Edhe ky fakt flet për ndikimin e italishtes, ndikim ky që nuk ka pushuar duke u paraqitur edhe sot si çështje e mprehtë, e cila kërkon zgjidhje a rivlerësim të duhur. Lidhur me këtë si zgjidhje më e mirë për këtë qëllim ofrohet angazhimi i prapashtesës -TORE, e cila edhe ka dhënë prova se mund të zëvendësojë plotësisht çdo prapashtesë gjegjëse, të huaj, prandaj edhe formantin -ERIA të italishtes.

3) Formimet e vendshërbesave me -NICA të serbishtes nuk dalin në shqipe drejtpërdrejt si huazime, por ndikimi i tyre i pamohueshëm del i tërthortë. Është e vërtetë se te ne formimet me -NICA të serbokroatishtes kanë ndikuar në shumimin e numrit të emërtimeve me -TORE, sidomos në gjuhën e shkrimit, por edhe në gjuhën e folur. Kështu që ndërndikimi i formave me prapashtesën -NICA më tepër është i karakterit kalkëzues dhe ka shtrirje krahinore sporadike. S'do mend se një numër i konsiderueshëm i emërtimeve me -NICA te ne gjetën zgjidhje më prapashtesën -TORE, si p.sh. mesarnica - mishtore, kova_nica - farkëtore, prodavnica - shitore, predionica - tjerrtore, štedionica - kursimtare, alatnica

- vegëltore, pevnica - këngëtore etj. Si të themi, vërtet prapashtesa -TORE doli si barasvlerës i përdorshëm, që mund të quhet, fuqiplot edhe për prapashtesa të tjera të serbishtes si p.sh. porodilište - lindëtore, sušara - tertore, krznarija - gëzoftore, nu_nik - nevojëtore, kotlana - ngrohëtore, kuhinja (narodna-) gjellëtore (popullore), svetilište a bogomolja - falëtore, preno_ište - bujtore etj.

Ma thotë mendja se zgjidhjet si më sipër: me prapashtesën -TORE është e udhës të mbështeten dhe të përhapen me ndihmën e gjuhës standarde kombëtare. Me fjalë të tjera, mënyra e tillë e fjalëformimit me kalkëzim duhet të kultivohet, sepse shkon në dobi të pasurimit të terminologjisë përkatëse teknike-shkencore të gjuhës sonë standarde.

Gjithsesi funksioni barasvlerës i formantit -TORE kundrejt formanteve përkatëse të gjuhëve të huaja as nuk duhet të mohohet, as nuk duhet të harrohet, përkundrazi mjeti i tillë fjalëformues vlen të favorizohet ndërgjegjesisht. Disa nga shembujt që u paraqiten në pasqyrën e mësipërme le të shërbejnë si vërtetesë bindëse se gjuha jonë nuk ka kurrfarë nevoje të rikthejë në përdorim formantin -hane të turqishtes osmane ose të përdorë formantin -ERIA të italishtes e të ngjashme, kur funksionin e tillë barasvlerës e kryen pa lënë gjë keq prapashtesa -TORE e shqipes, siç u vërtetua edhe në raportin e saj ndaj prapashtesës -NICA dhe të tjera të serbishtes.

**(3) Rivaliteti dhe përparësitë e formantit
-TORE kundrejt prapashtesave sinonimike
konkurruese për emërtimin e
vendshërbesave**

Në gjuhën tonë për formimin e emërtimeve të vendshërbesave me kuptim të gjerë, përveç prapashtesës -TORE përdoren edhe prapashtesa të tjera, të cilat në disa raste qëndrojnë si rivale, madje për nënfusha të caktuara ato dalin mjaft të konsoliduara, por ka raste që për segmente të veçanta formantet e tilla qëndrojnë të brishta duke u paraqitur e hapur konkurrenca në mes të tyre.

Nga lënda që qëmtuam kryesisht në FGJSSH 1980 për këtë nënfushë semantike ndeshëm këto emërtime me prapashtesat përkatëse që po i shënojmë në pasqyrën vijuese:

P a s q y r a
e emërtimeve të vendshërbesave me prapashtesat konkurruese

Prapashtesat:Shembujt:

- a) Prapashtesa -I: punëtori, drejtori, rrobaqepësi; llogari; bashki, ministri, sekretari, digasteri, tipografi, karabinjeri, polici, prokurori, argjipeshkvi, dispanseri, inifermieri, cinkografi, agjenci.
 -ARI: biletari, birrari, frutari, pulari, argjendari, këmishari, librari, shpendari, këpucari, biçikletari, usllishtari.
 -TARI: qëndistari, zdrukthëtari, prestari.
 -SI: kryesi, pleqësi, përfaqësi.
 -TI: pastërta.
- b) Prapashtesa -ISHTË (ISHTE): plehërishtë, fidanishtë, hekurishtë, zjarmishtë, farishtë, torishtë; lulishte, punishte.
- c) Prapashtesa -INË: bujtinë, ngrehinë, çmendingë, kthinë, godinë; magazinë, kantinë, ofiçinë.
- ç) Prapashtesa -ORE: cingëlatore, foshnjore, djathore (...); ushtrimore, ushqimore, dështimore, këshillimore, bulmetote, avokatore; fjetore, përgatitore, shëtitore.
- d) Prapashtesa të tjera:
- ATË: gjykatë, gjyshatë, themelatë; fortifikatë, konsullatë.
 -AT: sekretariat, inspektorat, mareshalat, drejtorat, dekanat, ekonomat, komesariat.
 -ESË: ndërtesë, banesë.
 -OJË: peshkojë.
 -SË: bimsë, rrethosë.
 -NIK: drithnik, çarranik.
 -OR: qarkor,
 -URË: prefekturë, kuesturë, ekspoziturë, avokaturë.
 -NAT: drithnat, elbnat, plehnat ...

Edhe pse formimet e emërtimeve të vendshërbesave me prapashtesat e sipërshënuara ndeshen në numër të kufizuar dhe relativisht të vogël në krahasim me formimet me -TORE, mendoj se del e nevojshme të jepet ndonjë sqarim sipas grupeve të prapashtesave të caktuara veç e veç, duke respektuar radhën, ashtu siç u paraqitën në pasqyrën e mësipërme.

a) Ndonëse Xhuvani - Çabej prapashtesën -I nuk e përmendin në funksion për formimin e emrave konkretë vendesh (vendshërbesash), sqarimi që japin ata lidhur me ndërtimin e emrave me këtë element është i qëndrueshëm edhe për shembujt që u shënuan më lartë në cilësinë e vendshërbesave. Kjo prapashtesë, theksojnë ata, "ka hyrë si element i dytë n'ata emra që kanë një prapashtesë tjetër (-ar, -ës, -or. -tar. -tor) duke dhënë kështu konglutinate që formojnë abstrakte e kolektive si p.sh. katundari, kalori, katundësi" etj. Po këta dy studiues të mirënjohur lidhur me emërtimin e vendshërbesave më qartë shprehen te prapashtesa -ARI. Prapashtesa -ARI sipas tyre del e përbërë nga -AR+I (ashtu si edhe -TAR+i -TARI, -(ë)S+I (Ë)SI, -T+I -TI), por që e trajtojnë si prapashtesë më vete. Prapashtesa -ARI, e cila, siç shkruajnë ata "është bërë produktive në gjuhë duke shënuar emra mjeshtërie dhe për analogji nganjëherë edhe vendin e ushtrimit të saj" si p.sh. "argjentari, bletari, kopshtari, librari, lulishtari, vreshtari" <\$F Shih: Prapashtesat e gjuhës shqipe, vepra e cituar në shënimin 9, f. 4446, 547.>.

Vlen të përmendet fakti se në burime të tjera si p.sh. në doracakun "Gjuha letrare shqipe për të gjithë" <\$F Gjuha letrare shqipe për të gjithë, Tiranë 1976, f. 221.> si dhe në gramatikën normative (1976) <\$F Vepra e cituar në shënimin 6, f. 106.> prapashtesa -ARI si dhe ajo -TARI dalin të rrafshuara në formantin -I, d. m. th. përmenden në kuadër të kësaj prapashtese. Në tekstin e parë thuhet "disa emra me këtë prapashtesë (d.m.th. me prapashtesën -I (sqarimi im) prej një teme emërore mund të tregojë një degë të ekonomisë, një profesion, një vend pune" p.sh.: blegtori, gazetari, rrobaqepësi, drejtori, sekretari", kurse në burimin e dytë theksohet "disa formime (...) me prapashtesën -I që tregojnë një mjeshtri, përdoren njëkohësisht edhe për të shënuar vendin ku punojnë njerëzit që ushtrojnë këtë mjeshtëri si p.sh.; argjentari, rrobaqepësi, zdrukhtari " (Aty f.106) etj.

Nga përkufizimet e mësipërme për temën që po trajtohet këtu është shumë me interes të vihet në spikamë konstatimi që ka të bëjë me temën fjalëformuese të emrave me -I, të cilët ndërtimisht lidhen me emërtimin e njeriut sipas veprimtarisë (profesionit). Pikërisht për këtë pikë del haptazi ballafaqimi i formimeve të vendshërbesave me -TORE me formimet e këtij lloji me prapashtesën -I. Kjo çështje do të trajtohet më qartë në një vend tjetër po në këtë punim, prandaj këtu do të ndalemi paksa të një dukuri tjetër që lidhet me ndikim ndër-gjuhësor. Në këtë kuadër patjetër duhet pasur në konsideratë faktin se prapashtesa -I del po me këtë funksion edhe në gjuhë të tjera, prandaj lypset dalluar formimet vetjake autoktone nga huazimet e caktuara transfer si dhe ato të karakterit hibrid.

Huazime të karakterit transfer do të quhen importimet si: disteleri, gemisteri, karteleri, salameri, noteri, prokurori, lamineri etj., të cilat edhe për nga forma e prapashtesës shihet se janë huazuar nga italishtja pa modifikime të dukshme në shqipe. Ndërsa si huazime hibride do të quajmë ato me prapashtesën -ARI, edhe pse formanti i tillë i referohet formës së latinishtes -ARIUS, siç është cekur pak më përpara në këtë punim, por nuk mohohet se autoktonia shqipe e formës së tillë. Le të krahasohen format e mëposhtme:

shqip: sekretar sekretari it.: segretario segreteria;
 shqip: biletashitës biletari it. : bigliettie biglietteria;
 shqip: librar librari it. libraio libreria etj.

S'mund të anashkalohej për pa u veçuar rasti i dytë biletashitës, siç është shënuar në FGJSSH 1980, sepse nga një fakt i tillë del paksa i diskutueshëm rrafshimi i prapashtesës -ARI në -I, siç është bërë në burimet normative që u përmendën pak më sipër, sepse në rastin e tillë mungon emri i njeriut sipas profesionit b.f. biletar të cilit sipas rregullit do t'i shtohet prapashtesa -I për të emërtuar një vendshërbesë. Si rasti në FGJSSH dalin edhe shembuj të tjerë si p.sh. shpend shpendtari, pulë pulari, frut frutari, ngase mungon si të themi hallka ndërlidhëse e verigut d.m.th. emri i njeriut sipas veprimtarisë. Edhe te shembujt si këmishar, këpucar nuk janë aktivë emrat e vepruesit më -AR, sepse dalin me prapashtesë tjetër ose në formë kompozite. Mbase pikërisht dobësimi apo këputja e kësaj hallke ndërlidhëse të vargut ka ndikuar që edhe për raste të tilla të shfaqet në konkurrencë forma me -TORE ndaj asaj me -I, përkatësisht -ARI si p.sh. këpucëtore këpucari, këmishëtore këmishari etj. Ndërsa te rastet si p.sh. vreshtar vreshtari, lulishtar lulishtari, pylltar pylltari formimet me -TORE nuk paraqiten si konkurrenca të forta që do të mund të rrezikonin qëndrueshmërinë e tyre.

Sido që të jetë puna dukuria e tillë vlen të ndiqet.

b) Me prapashtesën -ISHTË (-ISHTE) janë formuar zakonisht emra prej emrash që "tregojnë vendin, ku gjindet një shumicë sendesh nga ato që shënon fjala primitive ose ku gjindet me shumicë ajo që shënon fjala primitive" (Xhuvani - Çabej), përkatësisht "me anë të kësaj prapashtese që parpaqitet në dy variante (-ISHTË/ -ISHTE) formohen kryesisht emra që tregojnë një vend ku gjenden me shumicë sende të emërtuara nga tema fjalëformuese" ("Gjuha letrare shqipe për të gjithë", f. 220). Në analogji me emrat e caktuar kolektivë ka raste që me një formë të tillë të paraqitet edhe koncepti i vendshërbesës, "sidomos nga sfera e bujqësisë dhe e industrisë" si p.sh. pemishtë, fidanishtë, hekurishtë, lulishte, punishte etj.

Shikuar pak si përgjithësisht prapashtesa e tillë, sidomos në farkëtime të reja, nuk del fare e nevojshme e së këtejmi as e pëlqyer.

c) Prapashtesa -INË, siç thuhet në gramatikën normative (1976) "është prapashtesë dialektore, që ka fituar njëfarë përhapjeje edhe në gjuhën letrare" <\$F Vepra e cituar në shënimin 6 dhe A. Xhuvani, vepra e cituar në shënimin 13, f. 495, 497.> me të cilin janë formur edhe disa emra prej emrash me "kuptim vendi pajisur me sendin që tregon primitivi, si zallinë, llozhinë etj" (Xhuvani-Çabej), por që del me të edhe ndonjë emërtim vendshërbese, siç janë rastet bujtinë, çmendinë e ndonjë tjetër. Siç dihet me këtë formant kanë hyrë në gjuhën tonë edhe disa fjalë ndërkombëtare si: kantine, karantine, magazinë, ofiçinë. Xhuvani-Çabej konstatojnë se shumica e "emrave në shqip me -INË janë formuar nën ndikimin e emrave sllavë", atëherë mund të themi se mbase edhe ky motiv si asociacion ka ndikuar që kjo prapashtesë të mos jetë e favorizur për emërtimin e vendshërbesave të mirëfillta, pos rasteve që u ceken: bujtinë e çmendinë. Ç'është e drejta edhe këto dy raste goditen nga barasvlerës të tjerë si p.sh. në vend të fjalës **bujtinë** në burime të caktuara janë parapëlqyer më fort trajtat **bujtore** e ajo **fjetore** sesa ajo bujtinë. Kurse për emërtimin **çmendinë** e formur sipas një cilësie të temës mund të themi se ka pengesa semantike për të qëndruar si emërtim i mirëfilltë vendshërbese. Për konceptin e tillë d.m.th. për të emërtuar vendin ku mjekohen të sëmurët psikikë (të çmendurit) a ku organizohet përkujdesja ndaj tyre më mirë do të qëndronte ndërkombëtarizma: spitali neuropsikiatrik ose neologjizmat sinonime: **mjekimtore** e të sëmurëve psikikë ose **përkujdestore** e të çmendurve a e të sëmurëve psikikë, e ku ta di unë!, sesa çmendinë.

Fjala **çmendinë** mbase mund të përdoret pangurrim vetëm me konotacion keqësues, d.m.th. jo vend ku shërohen të sëmurët psikikë, por aty ku çmenden njerëzit?! Kështu del zbërthimi kuptimor sipas rregullsisë që praktikohet për shembujt e ngjashëm në bazë të përkufizimit që ka nocioni i vendshërbesës, siç është cekur më përpara.

ç) Është e vërtetë se me prapashtesën -ORE dalin disa emërtime me të cilat nënkuptohet edhe koncepti i vendshërbesës së caktuar, siç dëshmojnë edhe shembujt nga pasqyra e sipërcekur. Meqenëse lidhur me kapërthyerjen e kësaj prapashtese me prapashtesën -TORE do të bëhet fjalë më gjerësisht në nëntitullin vijues këtu po ndalem vetëm aq sa të tërheq vërejtjen se identifikimi i formanteve -ORE/-TORE në shumicën e rasteve nuk është i drejtë, ngase jo vetëm se kanë mundësi, por ato i ndajnë a i kanë të ndara në njëfarë dore nënfushat semantike.

d) Lidhur me grupin e prapashtesave të tjera vlen të theksohen këto konstatime:

1) Prapashtesa -ATË si te emërtimet: gjykatë, shoqatë, gjyshatë etj. edhe pse origjina e tyre vendëse (edhe sa i përket temës fjalëformuese edhe nga prapashtesa fjalëformuese) në këto raste nuk kontestohet nuk ka përhapje të gjerë. Me një formant të tillë janë formuar vetëm disa raste periferike. Gjithsesi kur kemi parasysh tërë strukturën e emërtimeve të vendshërbesave kjo prapashtesë nuk del prodhimore.

2) Prapashtesa -NIK, ashtu si edhe prapashtesat e tjera si: -ESË, -OJË, -SË, -OR kanë gjetur përdorim vetëm në disa raste të vetmuara, prandaj për emërtimet e vendshërbesave mund të quhen si prapashtesa shterpe.

3) Prapashtesa -AT si te shembujt: sekretariat, dekanat, inspektorat etj, si dhe ajo -URË, siç janë shembujt: prefekturë, ekspoziturë etj, kanë origjinë transparente të huaj, përkatësisht ato mund të konsiderohen si pjesë përbërëse të fjalës së huazuar, prandaj si të tilla s' kanë pse të favorizohen për emërtime të reja.

4) Mbaresa dialektore gege e shumësit të disa emrave që në FGJSH 1954 sipas funksionit emërton vendshërbesën ku shitet a grumbullohet emri i cituar në temën fjalëformuese në FGJSSH si dhe FSHS 1984, nuk del fare. Konceptet e tilla ose shënohen tash me prapashtesën -(r)ishtë si plehërishte ose nuk dalin fare si b. elbnat, drithnat etj.

* * *

Nga sa u tha më sipër, lidhur me prapashtesat sinonime ndaj prapashtesës -TORE mund të nxirret konkluzioni se hiq prapashtesën -I, përkatësisht -ARI, e cila siç thonë Xhuvani - Çabej vetëm "nganjëherë" qëndron e mëvetësishme a në rivalitet me prapashtesën -TORE për emërtimin e vendshërbesave, kur si temë fjalëformuese shërben një emër vepruesi, asnjëra nga prapashtesat e tjera nuk del e denjë të qëndrojë si konkurrencte e fortë ndaj prapashtesës -TORE, për tipin e emërtimeve në shqyrtim mbi fjalë-temën prodhuese të shqipes.

Ku qëndron pra përparësia e prapashtesës -TORE ndaj konkurrenctes të tjera sinonimike?

Sipas mendimit tim dy janë arsytet që i japin përparësi prapashtesës -TORE ndaj prapashtesave të tjera sinonimike për emërtimin e vend-shërbesave:

e para, ka të bëjë me origjinën transparente e të ngjashme të huaj që ka akëcila prapashtesë dhe

e dyta, ka të bëjë me faktin se prapashtesat e tjera, nëse nuk janë shterpe a tejet dialektore, pothuajse të gjitha dalin së pari të angazhuara për nënfusha të tjera semantike dhe se nënfusha semantike e vendshërbesës për to paraqitet si detyrë e dorës së dytë.

Në anën tjetër prapashtesa -TORE, siç u theksua edhe më përpara, qysh herët u përvetësua për këtë nëntip emërtimesh dhe se del e shkarkuar funksionalisht për nënfusha të tjera semantike.

Ç`është e vërteta, prapashtesa -TORE, përkatësisht emërtimet njëfjalëshe të vendshërbesave me prapashtesën -TORE rivalitet e konkurrencë sinonimike të fortë kanë vetëm me formimet togfjalësha a me kompozitat barasvlerëse, të cilat dalin në raporte të qëndrueshme sinonimike, çështje kjo që do të preket paksa edhe në vijim të këtij punimi.

Gjithsesi dalja në skenë e formës sinonimike me -TORE, e cila ka abstraksion më të lartë në krahasim me togfjalëshin, nuk e rrezikon qëndrueshmërinë e tij, përkundrazi format eventuale të treshit sinonimikë: togfjalësh/kompozitë/ prejardhjezimi me -TORE, përplotësojnë më mirë nocionin e vendshërbesës dhe mundësojnë përzgjedhjen e termit adekuat për konceptin e caktuar varësisht nga natyra e lëndës që shprehet.

**(4) Raporti kundërvënës brenda
prapashtesave simotra:
-ATORE, -ORE dhe -TORE**

Për të pasur një ide sa më të qartë rreth raportit kundërvënës që del i theksuar gjithnjë e më shumë aktualisht brenda prapashtesave simotra: -ATORE, -ORE dhe -TORE që në fillim të këtij nëntitulli po japim numrin e tërësishëm të emrave me këto prapashtesa në pasqyrën vijuese, lëndë kjo e vjelë krejtësisht nga Fjalori i gjuhës së sotme shqipe (1980), sipas nënfushave të caktuara semantike në të cilat ndeshen këto emërtime: <\$F Sa i përket numrit të tërësishëm mund të jetë lënë jashtë ndonjë shembull, qoftë për arsye të kriterit rreth përcaktimit të mirëfillësisë (lidhur me shembujt më -ORE), qoftë për shkak të ndonjë lëshimi eventual gjatë numrimit, por kjo nuk ngre peshë aspak në konstatimet e dhëna në këtë punim.>

P a s q y r a
**e numrit tërësor të emrave me prapashtesat: -ATORE, -ORE dhe
-TORE në FGJSSH**

Nënfusha semantike	P r a p a s h t e s a t		
	-ATORE	-ORE	-TORE
1. Emërtimet e grave sipas veprimtarisë	7 (+3?)	2	3 (-3?)
2. Emërtimet nga bota bimore-shtazore	4	77	3
3. Emërtime të mjeteve a sendeve konkrete	7	116	5
4. Fjalë-terma gramatikorë	-	51	3
5. Emërtime të vendshërbesave (vendi?)	3+4 + -	(10-?) /87?	38 + (10-?)

Të dhënat nga pasqyra e mësipërme shtrojnë nevojën që të jepen sadopak sqarime, gjykime e interpretime të nevojshme, sipas nënfushave të caktuara semantike duke e vënë theksin në qëllimin që del nga vetë formulimi i nëntitullit që po trajtohet.

Në vazhdim, fillimisht do të bëjmë fjalë për emërtimet me -ATORE dhe pastaj do të marrin në shqyrtim emërtimet me

prapashtesën -ORE, gjithnjë duke u përpjekur që të shkoqisim sadokudo kapërthyerjen e krijimeve të tilla në raport me emërtimet me prapashtesën -TORE.

a) Siç po shihet nga pasqyra prapashtesa -ATORE del e angazhuar për formimin e emrave në tri nënfusha semantike dhe në të trija këto ka përparësi numri në raport me prapashtesën -TORE, ndërsa kundrejt prapashtesës -ORE ka përparësi numri vetëm te nënfusha e emërtimeve të grave sipas veprimtarisë, ku raporti del 7 me 2. Me fjalë të tjera, prapashtesa -ATORE ka përparësi numri vetëm për nënfushën semantike të emërtimit të grave sipas veprimtarisë e për nënfushat e tjera semantike jo. Ç`është e vërteta, numri i emërtimeve të grave me prapashtesën -ATORE në krahasim me prapashtesat simotra del në përparësi të theksuar, ndaj prapashtesës -ORE për tri herë, ndërsa ndaj prapashtesës -TORE për dy herë. Sipas një kriteri tjetër, nëse shembujt me -TORE njësohen, ashtu siç dalin funksionalisht me trajtat -ATORE si p.sh. vajtove vajatore, megjetore magjatore, frymëtove frymatore, atëherë raporti i numrit ndryshon në të mirë të prapashtesës -ATORE. Në tabelë këto raste janë shënuar: (+3?) dhe (-3?) sipas rubrikave përkatëse.

Rreth formimeve të fjalëve me prapashtesën -ATORE është me rëndësi të theksohet edhe një fakt tjetër me peshë jo të vogël. E kam fjalën për faktin se M. Halimi në punimin që e përmendën në fillim të punimit shënon nja 34, përkatësisht 44 shembuj të emërtimeve të njerëzve sipas veprimtarisë me prapashtesën -ATORE d.m.th. në gjininë përfaqësuese femërore. Nga shembujt e tillë edhe nëse ndonjëri pre tyre del me burim të diskutueshëm a me përhapje krahinore, mund të fitohet bindja se forma e tillë fjalëformuese ia vlen të përgjithësohet, përkatësisht të favorizohet nëpërmjet të gjuhës së shkrimit. Këtu është fjala për emërtime të pavarura nga forma e mashkullores.

Për formimin e emërtimeve të grave sipas veprimtarisë me prapashtesën -ATORE, po të vështrohet çështja në kontekst më të gjerë, ndjen nevojë edhe vetë gjuha jonë letrare kombëtare. Meqenëse emërtimet e njerëzve sipas veprimtarisë a profesionit në gjini përfaqësuese femërore me prapashtesën -ATORE do të jetë objekt i veçantë trajtimi në një punim tjetër, këtu nuk po zgjatëm më shumë, por s'mund ta lë pa e tërhequr vërejtjen në faktin që së paku në gjuhën e shkrimit sa herë që paraqitet e nevojshme për emërtimin e gruas sipas veprimtarisë (profesionit), pra kur nuk kemi të bëjmë me femërorëzimin e emrit të gjinisë mashkullore, po me formim të pavarur, në mes të prapashtesave simotra -ORE, -TORE e -ATORE, pangurrim duhet parapëlqyer prapashtesën e fundit atë -ATORE.

Me fjalë të tjerë prapashtesa -ATORE del jo vetëm si prapashtesë e mëvetësishme, por del edhe me prirje specializimi

ekskluzivisht për emërtimet e grave sipas veprimtarisë së tyre dhe se për këtë nënfushë ka traditë përdorimi, ngase kështu farkëtoheshin dikur por edhe tash emërtimet e grave sipas punës që bënin në "gjirin e familjes së madhe patriarkale", siç e cek M. Halimi. Mirëpo një mënyrëz e tillë fjalëformimi mund të shtrihet a të ripërtërihet edhe sot e kësaj dite jo vetëm në gjirin familjar, por edhe në degë të caktuara të ekonomisë, siç është veprimtaria artizanale, sidomos në të ashtuquajturën "ekonomi të vogël" si p.sh në veprimtaritë e caktuara që kanë lidhje me qëndistari, qepje, thurje me grep, vijëzimtari <§F Termi **vijëzim** është përdorur në vend të formës trakovatje (serb, trakovati, it. tracciare, fr. tracer = shq. vijëzoj (me vijëzue)) që po përdoret te ne si barbarizëm i vrazhdë.> , gjellëtari, punëdore etj. Kështuqë edhe sot mund të ripërtrihen emërtimet: telatore, vekatore, mbathatore, veshatore, pitatore, bukatore, vijëzatore, gjellatore, fliatore <§F Është fjala për emërtime të ripërtëritura a të reja të grave sipas veprimtarisë së tyre me prapashtesën -ATORE si p. sh. veshatore, mbathatore në institucionet parashkollore siç janë çerdhet (spitalet) e fëmijëve e të ngjashme, kurse fliatore quhet gruaja "specialiste" e paguar në motelet a gjellëtoret e caktuara e caktuara, e cila qet flia, d. m . th. gatuan një loj fërllie a palaniku, specialitet që bëhet me disa shtresa brumi të patëholluar, por që petëzohet në tepsi të lyer (mestitur) me yndyrë me pak kos a qumësht dhe piqet petë-petë ngapak dhe pastaj pa u ftohur piqet e tëra.> etj. qoftë në ndërmarrje prodhimi qoftë në punëtoritë private siç janë hotelet, motelet e caktuara ose çerdhet e fëmijëve, përkujdestoret (spitalet) e ku ta di.

Ç'është e drejta, siç mund t'i kemi specialitetet e caktuara shërbyese karakteristike vendëse, ashtu mund t'i kemi edhe emërtimet karakteristike të njerëzve sipas veprimtarisë a specialiteteve, siç u përmend paksa diçka më përpara.

Sidoqoftë, prapashtesa -ATORE funksionalisht del e diferencuar kundrejt prapashtesave simotra: -ORE dhe -TORE, sepse del më e angazhuar se ato të dyja për emërtimin e grave sipas veprimtarisë.

b) Siç po shihet nga pasqyra prapashtesa -ORE në rrafshin horizontal del më e ngarkuara nga sishoqet e veta, gjë që shihet edhe sipas nënfushave semantike që mbulon edhe sa i përket numrit të shembujve.

Siç u tha më sipër, prapashtesa -ORE nuk del prodhimtare jo vetëm në formimin e emërtimeve të grave sipas veprimtarisë të tipit stanore (m. stanar), por edhe në emërtimin e vendshërbesave. Ajo del aktive e prodhimtare për nënfusha të tjera semantike. Me këtë prapashtesë emërtohen:

- 1) *sende a mjete konkrete të ndryshme* si p. sh.:

- a) enë, tipi: çajore, piperore, pagëzore;
- b) vegla, tipi: kullore, harkore, brerore;
- c) veshje, tipi: grykore, barkore, mëngore;
- ç) mjete transporti, tipi: avulllore, tërkuzore;
- d) krijime skulpturore, tipi: shtatore, përmendore etj.

2) *emra nga bota-bimore shtazore:*

- a) emra bimësh, tipi: shpatore, mëllagore;
- b) emra kafshësh, tipi: vezullore, maknore etj.

Sa për kërshëri po e përmend faktin se në FGJSSH (1980) dy herë më shumë ndeshen emra bimësh sesa emra shtazësh me prapashtesën -ORE.

3) *terma gramatikore* e të tjerë zakonisht nga fusha e gjuhësisë. Kjo prapashtesë, me të vërtetë, pothuajse e ka zëvendësuar apo e ka mënjanuar në shumicën e rasteve prapashtesën -TORE në këtë nënfushë semantike që në periudhën e Pavarësisë. Ç'është vërteta, shumica e emërtimeve të kësaj nënfushe dalin nga emërimi i mbiemrave. Krahaso mënyra: dëftore, lidhore ... etj; bashkëtingëllore: buzore, qiellzore, dhëmbore etj.; fjalia: kushtore, mënyrore ... e kështu me radhë, mbiemra këta që në kontekste të caktuara dalin si emër-terma më -ORE të mëvetësishëm.

4) Për temën që po trajtohet këtu është me rëndësi të theksohet fakti se prapashtesa -ORE ka shtrirje përdorimi edhe në *emërtimin e koncepteve të vendit*. Në këtë kontekst emrat e tillë mund t' i ndajmë në tri grupe:

1. Emra më -ORE me të cilët tregohet vendi ku gjendet me shumicë sendi i emërtuar në temën fjalëformuese, por që lidhet kushtëzimisht me përdorimin (shitjen, përpunimin etj.) e tij, siç është tipi i emrave: peshkore, duhanore, grunore etj.

2. Emra më -ORE me të cilët shprehet kuptimi zvogëlues i sendit të emërtuar, siç është tipi i emrave: kopshtore, bregore, gropore etj.

3. Emra më -ORE me të cilët shprehen elemente të theksuara të vendshërbesës.

Pikërisht emrat e këtij grupi, d. m. th. për koncepte vendi me kuptim vendshërbese, do të jenë objekt trajtimi më i hollësishëm tashti mënjëherë. Dhe për t' i hyrë më në thelb çështjes në trajtim emrat e grupit të tretë më -ORE, sipas karakterit fundor të temës prodhuese, u ndanë në tri nëngrupe:

a) emrat më -ORE që kanë temë fjalëformuese një emër konkret si p. sh.: cingëlore (cingël + ORE), foshnjore (foshnje + ORE), djathore (djathë + ORE) e ndonjë tjetër;

b) emrat më -ORE që kanë për temë fjalëformuese një emër prejfoljor më - IM, si p. sh.: dështimore, këshillimore, ushqimore, ushtrimore dhe

c) emrat më -ORE që kanë për temë fjalëformuese një emër ose një trajtë foljore (pjesoren) që mbaron me bashkëtingëlloren -T, si p. sh.: bulmetore, farishtore, kashtore, bletore, avokatore, gjykatore; fjetore, përgatitore (gatitore), shëtitore e ndonjë tjetër, shembuj këta që në tabelën e sipërcekur u shënuan me numrin (10-) në rubrikat përkatëse. Sqarimi pse është vepruar kështu do të jepet në vazhdim, pasi të jepen sqarimet e duhura për të dyja nëngrupet e para.

1) Lidhur me emrat *cingëlore*, *djathore* e *foshnjore* dhe të ndonjë rasti të ngjashëm me to, shtrohet pyetja e mund të konsiderohen këta shembuj si emërtime të mirëfillta të vendshërbesave, kur forma dhe origjina e tyre mbart tipare të mbiemrit, i cili në të vërtetë del si mbiemër i emëruar, por që gjithsesi ruan elemente të tiparit mbiemëror dhe në anën tjetër, sipas FGJSSH, që të tria këto fjalë semantikisht dalin të goditura nga forma të tjera sinonimike, të cilat edhe janë më të favorizuara sesa këto më -ORE. Kështu p.sh. fjala **cingëlore** mbart etiketimin si term "i vjetëruar", ngase ashtu emërtohej dikur "dyqani ku shiteshin cinglat", për "**djathore**" si "**punishte djathi**" më tepër parapëlqehet sinonimi "**baxho**", ndërsa për "**foshnjore**" parapëlqehet togfjalëshi "**kopësht fëmijësh**".

Sipas mendimit tim, po të favorizoheshin që me kohë emërtimet në fjalë me prapashtesën -TORE: **cingëltore**, **djathëtore**, **foshnjëtore** - qëndrueshmëria e tyre do të kishte pasur mbështetje më të madhe. Sidoqoftë sipas kriterëve të sotme emrat e vendshërbesave më -ORE mbi këtë bazë nuk janë prodhimtarë as aktivë.

Formimet drekore, mëngjesore ashtu si edhe formimet metaanalizore si shenjtërore, hijerore e ështërore, më -(Ë)RORE, si terma kishtarë mund të mbesin si raste të veçanta, por edhe te këto të fundit mund të shihen elemente të semantikës së sendit konkret. Mendoj se shembujt si **cinkore** a **zinkore** për cinkara të serbokroatishtes që i ndeshin në fjalorët e H. Goranit, **ajkore** në FSHSK (1981) për mlekarica, më mirë do të qëndronin me prapashtesën -TORE: **cinktore** (**zinktore**), **ajkëtore** edhe për arsye se trajtat e tilla pa nevojë krijojnë homonimi me emrat e sendeve konkrete si p. sh. **cinkore** (pjatë), **ajkore** (gatesë). <§F Shih: FGJSSH (1980), **ajkore** f. 15., **cinkore** f. 226.>

2) E njëjta pyetje rreth mirëfillësisë dhe prejardhjes që u bë

për nëngrupin e mëparshëm vlen edhe për nëngrupin e dytë që janë formuar mbi një emër prejfoljor të veprimit më -IM, siç janë shembujt: dështimore, këshillimore, ushqimore, ushtrimore. Që të katër këta shembuj janë krijime librare dhe që të katër mund të quhen mbiemra të emëruar. Themi kështu me bindje, kur kemi parasysh togfjalëshat barasvlerës sinonimikë: repart dështimi (abortimi) - dështimore, zyrë këshillimi - këshillimore, ndërmarrje ushqimore - ushqimore, klasë (shkollë) ushtrimore - ushtrimore, sikurse shkollë fillore - fillore etj.

Është e vërtetë se mbi këtë bazë vërehet prirje shumimi të rasteve, si p. sh. kursimore për štationica, ditimore për obdanište (H. Gorani), pastrimore për _istionica (FSHS 1981) e ndonjë tjetër, mirëpo është e vërtetë njëherësh se edhe lidhur me formimet e tilla ekziston një tendencë që në vend të prapashtesës -ORE të përdoret prapashtesa -TORE, çështje kjo që sa po ceket këtu do të analizohet më hollësisht në nëntitullin vijues.

Gjithsesi format -ORE dhe -TORE kurrsesi nuk duhet të identifikohen. Duhet të vlerësohen drejt edhe ngjashmëritë, por edhe mospërkimet duke e vënë re edhe raportin e përgjithshëm kundërvënës në mes të tyre që priret të jetë gjithnjë e më i dallueshëm në krijimin e fjalëve të reja, që vjen si rrjedhojë e zhvillimit të gjuhës.

3) Kapërthyerja e formave -ORE dhe -TORE që në njëfarë dore, siç e pamë, del e hetueshme në dy nëngrupet e sipërcekura, edhe më e ndërlikuar del te nëngrupi i tretë që e kemi në shqyrtim. Siç u përmend më sipër në këtë nëngrup u përfshinë ato emërtime tema fjalë formuese e të cilave ka një -T fundore. Edhe këto, varësisht nga kuptimi semantik që sjell tema fjalëformuese, i ndajmë në tri grupëtime të vogla, nga zberthimi i të cilave sipas radhës kuptohet:

së pari, vendi ku përdorohet sendi i emërtuar në temën fjalëformuese: bulmetore, kashtore, farishtore; bletore;

së dyti, vendi ku kryhet veprimi i cekur në temën foljore fjalëformuese: fjetore, përgatitore (gatitore), shëtitore;

së treti, vendi ku punon veprimtari i emërtuar në temën fjalëformuese si p.sh. avokatore.

Sipas dy grupëtimeve të para në gjuhën tonë të përditshme të ne ndeshim edhe mjaft shembuj të tjerë që janë mjaft aktivë si p.sh. shiritore (trakara), kalitore (kalionica), qumështore (mlekara, mlekarnica), çimentore (cementara), shitore (prodavnica) etj., të cilat dalin me kuptim të mirëfilltë të vendshërbesës. Lidhur me këtë mund të konstatohet se, qoftë shembujt me temë emërore, qoftë ata me temë foljore dy grupëtimet e para shënojnë

rritje në realitetin tonë gjuhësor, kurse shembuj si në grupëtimin e tretë, siç është rasti avokatore, ku si temë fjalëformuese del një emërtim i njeriut si veprimtar (emër vepruesi), nuk ndeshim dot.

Edhe kjo dukuri e fundit do të diskutohet në nëntitullin tjetër në vazhdim, sepse këtu nuk e kemi ndërmend të thellohemi në përshtatshmërinë semantike të temave prodhuese, por këtu do të tërheqim vëmendjen te një çështje tjetër, gjithsesi mjaft të mprehtë dhe në dukje problemore. Pra ngremë çështjen se si do të trajtohen formimet e mësipërme: me prapashtesën -ORE a me prapashtesën -TORE?

Me sa di unë, kjo çështje nuk është përshoshur sheshazi e sa duhet asnjëherë nga gjuhëtarët tanë, por në bazë të burimeve të caktuara del se një palë gjuhëtarësh formimet e tilla i konsiderojnë si emra të prejardhur me prapashtesën -ORE, si p. sh. Xhuvani - Çabej, J. Kole e të tjerë, ndërsa një palë tjetër, shembujt e këtij nëngrupi nuk i ndajnë nga grupi i emërtimeve me prapashtesën -TORE (N. Veselaj, M. Halimi) <\$F Shih: N. Veselaj "Çështje të terminologjisë në ndërmarrje metalo-përpunuese", robleme aktuale të kulturës së gjuhës shqipe, Prishtinë 1983, f. 816, ku shembujt: kalitore, shitore, vrojtore jepen bashkë me shembujt e tjerë me prapashtesën -TORE, po ashtu vepron edhe M. Halimi në punimin "Mundësia e zgjerimit dhe e pasurimit të terminologjisë me prapashtesën fjalëformuese -TORE", GJendja e terminologjisë shqipe në Jugosllavi, IA, Prishtinë 1988, ku bashkë me shembujt më -TORE shënohen edhe: bulmetore, bujtore e vrojtore.> . Të parët kanë për mbështetje anën formale (shikimore) shkrimore e shqiptimore, por deri diku edhe traditën drejtshkrimore, ndërsa të dytët kanë parasysh anën praktike që mbështetet në semantikën e modelit të formëzuar, në bazë të specifikimit të prapashtesës përkatëse

-TORE, e cila del e angazhuar, siç u tha kryekëput vetëm për nënfushën semantike të vendshërbesave. Dhe vërtet, po të shikohen më në hollësi dhe thellësi këto emërtime më tepër anojnë të merendohen në grupin e emërtimeve të vendshërbesave më -TORE sesa më -ORE.

Siç u vërtetua më sipër, hiq ndonjë shembull më -IM+ORE, në gjuhën e sotme letrare, nuk del i padiskutueshëm asnjë emërtim i mirëfilltë vendshërbese më -ORE, qoftë me temë emërore (mbi bazë të një sendi konkret), qoftë me temë foljore (mbi bazë të ndonjë veprimi që kryhet), sepse të gjitha emërtimet e tilla priren të formohen me prapashtesën -TORE.

Lidhur me sa u cek vetvetiu shtrohet pyetja si mund të shpjegohet kjo dukuri, pse shembujt e tillë të vendosen në grupin e emërtimeve më -TORE, kur shihet mirëfilli prapashtesa -ORE? Përgjigja rreth kësaj dukurie nuk është edhe aq e vështirë të jepet. Në rastet e tilla kemi të bëjmë me procesin e shkrirjes a të

asimilimit të dy TT-ve në një, përkatësisht kemi të bëjmë me zhdukjen (elidimin) e T-së fundore të temës fjalëformuese duke e lënë të plotë a të ruajtur formën e prapashtesën -TORE. Me një fjalë, procesi i tillë pothuajse bëhet, si të thuash, menjëhershëm (automatikusht). Kështu që nga:

shirit + TORE del shirittore shiritore;
qumësht + TORE del qumështtore qumështore;
shëtiti(ë) + TORE del shëtittore shëtitore;

Ky fenomen me elemente haphologjie është i njohur edhe në gjuhë të tjera, ashtu si edhe në gjuhën tonë. Është prekur paksa si "ngjizje e mundshme e bashkëtingëlloreve T + T për rastet det+ TAR (detëtar) detar; kopsht + tar (kopshtëtar) kopshtar etj." në një kumtesë të botuar në "Seminar ... nr. 9/84. <\$F Shih: "Seminari ndërkombëtar për gjuhën, letërsinë dhe kulturën shqiptare" nr. 9/84, kumtesa N. Veselaj, "Çështje rreth emërtimit të njerëzve sipas profesionit", Prtishtinë 1984 f. 184.> Po ky fenomen ngjan edhe me bashkëtingëllore të tjera ose edhe me zanore të ngjashme siç janë rastet: kundër + rrymë kundërrymë kundërrymë; kimi +ist kimiis kimist, tenis + ist tenisist tenist, servis + ist servisist servist; dorë + ras (rënës) dorëras doras; <\$F Shih: Sh. Gjeçovi, Vepra 1, Kanuni i Lekë Dukagjinit", Prishtinë 1985, f. 81, 160.> , mineralo + logjik/e mineralologjik/e mineralogjik; ulli + ishtë ulliishtë ullishtë, djallëzi + or djallëzior djallëzor; nën+ndarje nënndarje nëndarje (FGJSH 1954) etj. Rasti i fundit **nënndarje** është prekur në Rregullat e drejtshkrimit, ku thuhet se "kur në formim fjalësh e trajtash takohen dy shkronja të njëjta (...) ato shkruhen të dyja". <\$F Drejtshkrimi i gjuhës shqipe, Prishtinë 1974 f. 89.>

Mund të shtrohet çështja lidhur me këtë pse, pra, në rregullat e drejtshkrimit të gjuhës sonë nuk është përfshirë edhe ndonjëri nga rastet që po përmenden në punimin tonë?

Për mendimin tim, kjo nuk ka ndodhur vetëm për arsye se problemi që po shtrohet këtu nuk ka qenë i prezentuar faqazi asnjëherë më përpara. Me një fjalë, nuk është paraqitur ky fakt si çështje e hapur. Madje as ne nuk e paraqesim tashti si çështje të tillë drejtshkrimore që patjetër duhet të përmendet në rregullat përkatëse, por këtu jemi të detyruar ta paraqesim për të përcaktuar më drejt kundërvënien e ndajshitesave përkatëse: -AR e -TAR, -ORE e -TORE etj. Megjithatë si rrjedhojë e kësaj që po paraqitet a po interpretohet këtu nuk do të thotë se në të ardhmen nuk do të kihet në konsideratë që edhe ndonjëri nga shembujt tanë të përfshihet në rregullat e caktuara si trajtë përfaqësuese. Qëllimi kryesor yni është të tërheq vërejtjen që farkëtuesit e fjalëve të reja ta kenë në dijeni këtë interpretim dhe mos të krijojnë emërtime vendshërbesash më -ORE pa nevojë por vetëm më -TORE. Fundi i fundit, për mua nuk do të jetë kurrfarë befasië nëse në drejtshkrimin e ardhshëm do të dalin në të shkruar format përkatëse

me dy TT si b. f. qumështore, kashtore, baruttore, shittore, shëtitore, përkundrazi një mënyrë e tillë do të pritej mirë për dy arsye:

e para, do të qartësohej më shumë modeli i formimit të vendshërbesave më -TORE dhe

e dyta, do të jetë edhe më e liruar prapashtesa -ORE për t'u angazhuar për emërtime të nënfushave të tjera semantike, ku, me të vërtetë, del mjaft e ngarkuar dhe e stërngarkuar.

Me fjalë të tjera, me një veprim të tillë do të lehtësohej konsolidimi i prapashtesës -ORE për nënfusha të tjera semantike, siç është cekur edhe më sipër.

Sa për ilustrim po i përmend këto dy raste: qumështore dhe kashtore:

a) Me fjalën **qumështore**, pra me prapashtesën -ORE, sipas FGJSSH, përveç që përdoret si mbiemër, është emërtuar një kafshë, përkatësisht një bimë. Te ne dihet se fjala qumështore përdoret si barasvlerës për mleknica të serbishtes, që do të thotë se kemi të bëjmë me një vendshërbesë dhe kështu me këtë trajtë vetëm sa është shtuar edhe një homonim, përkrah dy homonimeve të tjera. Për t'i ikur homonimisë dhe për të respektuar trajtën e plotë të fjalëndërtimit, atëherë vërtet s' ka arsye të mos shënohet emërtimi i vendshërbesës qumështore, d.m.th. me prapashtesën -TORE, ndërsa emri i kafshës si dhe ai i bimës të interpretohet si fjalë e formuar me prapashtesën -ORE, ashtu siç arsyetohet nga modeli fjalëformues.

b) Edhe tek emërtimi **kashtore** ngjan proces i ngjashëm. Po të shënohej kashtore a kashtëtore, për dy konceptet e para të kësaj fjale që sipas FGJSSH-së tregojnë nocione vendshërbesash, ngase nën 1. kuptohet një "kasolle kashtë" dhe nën 2. "plevicë kashte" do të mbetej e lirë trajta kashtore (d. m. th. me prapashtesën -ORE) për pesë kuptimet e tjera d. m. th. për emërtimin e sendeve konkrete siç janë: 1. shishe me bark, 2. kapelë dielli, 3. karrige prej kashte, 4. pjesë e kërcellit të misrit dhe 5. fshesë e vogël kashte, e kështu me radhë.

* * *

Nga krejt kjo që u tha në këtë nëntitull mund të nxirret si përfundim se vetë zhvillimi i gjuhës sonë kushtëzon, si të themi, do të kushtëzojë edhe më shumë në të ardhmen, specifikimin e prapashtesave simotra -ATORE, -ORE dhe -TORE për nënfusha të caktuara semantike. Madje prirja e tillë edhe tashti mund të vërehet mjaft mirë, kështu që:

- prapashtesa -ATORE del më e ngarkuar se të tjerat për emërtimin e grave sipas veprimtarisë së tyre,
- prapashtesa -ORE për emërtimin e mjeteve konkrete, përgjithësisht dhe për nocione të tjera dhe
- prapashtesa -TORE del me prirje specializimi kryekëput për emërtimin e vendshërbesave.

Kundërvënia midis prapashtesave simotra -ATORE, -ORE dhe -TORE që u theksua këtu, edhe pse në raste mund të duket hëpërhë pak me tepri, në të ardhmen sigurisht do të jetë edhe më e qartë dhe e konsoliduar, kështu që edhe ndonjëra nga çështjet që sapo u prekën këtu kalimthi do të jenë të tejkaluara, madje në një të afërme jo të largët nuk do të ketë nevojë as për sqarime plotësuese.

**(5) Prirja rreth përcaktimit të trajtës
së temës fjalëformuese edhe në
rastet e brishta të emërtimeve
të vendshërbesave me -TORE**

Rreth përcaktimit të trajtës së temës fjalëformuese, qoftë emërore, qoftë foljore, çështja del jo pak e ndërlikuar, ngase fare pak (për mos me thënë aspak) kjo çështje del e trajtuar nga gjuhëtarët tanë. Mirëpo kur kemi parasysh shembujt tashmë të përlogjur nga praktika si dhe në mbështetje të arsyeve morfologjike e të logjikës gjuhësore lidhur me këtë, mund të nxirren disa rregullsi, të cilat së paku pragmatikisht dalin të kapshme dhe kanë mundësi sendërtimi. Në bazë të komponenteve semantike të nocionit që mbulojnë, të gjitha emërtimet e vendshërbesave i ndajmë në dy grupe të mëdha:

së pari, ato të cilat tregojnë një vend (lokal) ku përdorohet (prodhohet, përpunohet, shitet, ruhet grumbullohet) sendi i emërtuar në temën fjalëformuese dhe

së dyti, emërtimet e vendshërbesave me të cilat tregohet vendi (lokali) ku kryhet një veprim a proces pune që lidhet kuptimisht me temën fjalëformuese emërore a foljore të cekur në temën fjalëformuese.

T'i sqarojmë më në hollësi veçoritë e këtyre dy grupeve.

1) Sipas vetë përkufizimit të dhënë më sipër që "lidhet me sendin e emërtuar" vetvetiu nënkuptohet fakti se si temë fjalëformuese në emërtimet e tilla patjetër del a duhet të dalë një emër konkret, i cili "zbulohet" qartë kur të hiqet prapashtesa -TORE, si p. sh. ajkëtores (ajkë), bukëtores (bukë) etj. Në FGJSSH 1980 mbi këtë bazë i ndeshim të regjistruar nja 20 shembuj, si p.sh.: ajkëtores, bukëtores, byrektore, çajtores, gëzoftore, këpucëtores, gjellëtores, qebaptore, artitore, copëtores, duhantore, pemëtores, pijetore, barnatore, armëtores, bimëtores, teshatore; ëmbëltores.

Nëse i shtojmë edhe shembujt që u diskutuan në nëntitullin e mëparshëm me T fundor + TORE si: bulmetore (bulmettores), farishtore (farishttores), kashtore (kashttores), bletore (bletttores) e ndonjë tjetër numri do të jetë më i madh. Mbase duke e pasur faktin e shumësisë si orientim, sigurisht edhe të shtyrë nga nevoja të ne dalin mjaft emërtime mbi këtë bazë, të cilat janë mishëruar aq shumë në përdorim sa që konsiderohen si të normëzuara, edhe pse ende nuk dihet se a kanë shtrirje në mbarë truallin shqipfolës, si p.sh.: avulltores, kazantore, birrëtores, mishtore, skriptore, farëtores, furkëtores, jorgantore, sheqertore, peshkëtores, lëkurëtores, gjalpëtores, gurëtores, dyfektore, papuçtores, akulltores, zhavorrtore, ngjyrëtores, pengtores a pengcëtores, pëlhurëtores, çoraptore, tullëtores, blloktore, litartore, pëllumbëtores, perimtores, zgjyrëtores, bërlloktore, mielltores, qymyrtores, zogëtores (brojler), vezëtores, leplebitore, shkresëtores, shkrimtores, çadërtore, fshisëtores, qelqëtores, xhamtores, pitetore etj. <§F Shembujt që u shënuan këtu mund të ndeshen në jetën tonë të përditshme, madje edhe në firma të caktuara vendshëbesash si p. sh. leplebitore, jorgantore etj. Në FSKSH (1974) ndeshim më shumë emërtime të tilla se në FSHSK (1981) si p. sh.: papuçtores, kazantore, dyfektore, mishtore, pëlhurtore, lëkurëtores; gjalpëtores (Fjalorth i kuptimeve të gjera gjeografike në shqipe të Q. Lleshit, Prishtinë 1985 f. 54); shkrestore (Fjalori terminologjik juridik serbokroatisht - shqip, Prishtinë 1979, f. 107) etj.>, pastaj: çimentore (çimenttores), qumështore (qumështtores) e të ngjashme, duke u paraqitur kjo mënyrë fjalëformimi si një vazhdim i një modeli vërtet të qëndrueshëm.

2) Në grupin e dytë, siç u tha, përfshihen të gjitha emërtimet e vendshëbesave më -TORE, të cilat tregojnë vendin ku kryhet një veprim a një proces pune apo aty ku bëhet një punë, e cila lidhet kuptimisht me temën e cekur fjalëformuese, e cila mund të jetë qoftë emër, qoftë folje.

Edhe sipas përkufizimit që u dha për shembujt e këtij grupi që ka të bëjë me vendin "ku kryhet a bëhet një punë a veprim" nënkuptohet se tema e emërtimit të caktuar duhet të jetë

zakonisht një folje a një emër prejfoljor i veprimit, por ka raste që si temë të shërbejë edhe një emër jo me prejardhje foljore, por që nga zërthimi paraqet kuptim të ngjashëm si p.sh. floktore, punëtore, tregtore, nevojëtore, shurrëtore, rrëfyestore, prestore, rrojtore - shembuj këta që i ndeshim të regjistruar në FGJSSH. Në realitetin tonë gjuhësor në stilin bisedor, por edhe në burime të caktuara të gjuhës së shkruar i ndeshim mjaft emra të këtij nëntipi, si p.sh: llogaritore, kumartore, bixhoztore, kurvëtore, vekëtore, farkëtore, libërtore (bibliotekë), këngëtore, kopjetore, gjyqtore, këshilltore e ndonjë tjetër.

Gjithashtu vihen re edhe emërtimet më -TORE nga emrat prejfoljorë, si p.sh.: lojëtare, blojëtare; kursimtare, këmbimtare, pushimtare, këshillimtare, fërgimtare, përkthimtare, freskimtare, shkrimtare etj. - nëntip ky që është gjithnjë më i vërejtshëm si strukturë e hapur dhe se një mënyrë e tillë fjalëformimi tregon tendencë shumëmi, d.m.th. bien në sy shembuj të rinj.

Para se të jap ndonjë vërejtje lidhur me emërtimet e mësipërme po i paraqes edhe shembujt mbi temë foljore që i ndeshim në FGJSSH si p.sh.: faltore, mbathtare, ngrohtore, pjektore, thertore, tjerretore, shtyptore, shpërngultore, bujtore, vrojtore, mësonjëtare, shkritore. Në jetën tonë të përditshme si në stilin bisedor ashtu edhe në gjuhën e shkruar ndeshim mjaft shembuj, ndër të cilët po veçoj këto emërtime: endëtore, folëtore, thurëtore, shkalëtore, mbushëtore, qethëtore, terëtore, qepëtore, grihëtore, derdhëtore, lindëtore, mjelëtore, pjellëtore, shprishëtore, shpleksëtore, ndezëtore, lidhëtore, zhdeshtëtare (deshëtore), njehëtore, majmëtore, pshurrëtore, rrëfyetore, gjuetore etj. <§F Shembuj të këtij grupi ndeshim në burime të caktuara si te punimi i M. Halimit: shkalëtore, pjellëtore, shprishëtore, shpleksëtore, lindëtore; H. Gorani, endëtore, te gazeta "Rilindja": lidhëtore, ngrohëtore, qethëtore, ndezëtore; në FSSH (1974): tertore, rrëfyetore, endëtore dhe në burime të tjera.>

Këtij grupi po t'i shtojmë edhe rastet që konsiderohen si -T+TORE si p.sh.: shëtittore (shëtitore), fjetttore (fjetore), shittore (shitore), përgatittore a gatittore (përgatitore a gatitore) e ndonjë tjetër numri i përgjithshëm i tyre sigurisht shënon rritje të konsiderueshme. Edhe kjo mënyrë e fjalëformimit për emërtimin e vendshërbesave më -TORE paraqitet me strukturë të hapur, madje mund të cilësohet, siç u tha, si një model i qëndrueshëm.

Në tabelën e mëposhtme po japim numrin e tërësishëm të emërtimeve të vendshërbesave sipas temave përkatëse

fjalëformuese.

T a b e l a
mbi numrin tërësor të emërtimeve të vendshërbesave
më -TORE sipas temës së caktuar fjalëformuese

Baza fjalëformuese	FGJSSH	Burime të tjera	Gjithsej
a) mbi temë emërore			
- sendi i emërtuar	22	44	76
- veprimi i emërtuar (i nënkuptuar)	7	20	27
b) mbi temë foljore (veprimi i shprehur)	12	27	39
Gjithsej:	41	81	132

Lidhur me përcaktimin e trajtës përkatëse përfaqësuese, qoftë nga tema emërore, qoftë nga tema foljore del e nevojshme të zgjidhen çështjet që mbahen pezull ose ato raste të brishta të cilat ende nuk e kanë gjetur sëndërtimin e duhur. Fjalën e kam edhe për rastet me temë emërore, edhe për ato me temë foljore.

Së pari, lidhur me të gjitha emërtimet e vendshërbesave me -TORE me temë emërore për të dyja grupet d.m.th. të atyre që tregojnë një vend ku përdorohet sendi i emërtuar, si dhe të atyre që tregojnë një vend ku kryhet një veprim që lidhet kuptimisht me temën fjalëformuese, shtrohet pyetja: cila trajtë do të parapëlqehet si trajtë përfaqësuese e temës prodhuese: njëjësi i pashquar, njëjësi i shquar, shumësi i pashquar i emërores apo të ndonjë rase tjetër? Përgjigjja del fare e thjeshtë. Përkundër ndonjë përjajshtimi të trashëguar, gjithsesi si trajtë përfaqësuese e temës sipas rregullit duhet të jetë njëjësi i pashquar i emërores. Kjo as që duhet të diskutohet për raste të reja. Nëse nuk vepronet kështu mund të shkaktohen paqartësi të panevojshme që do të sjellin ngatërresa të panevojshme. B.f. nëse vazhdon të favorizohet shumësi i emrit përkatës si te rastet: barnatore, teshatore, veglatore, faratore etj, krijohet homonimi mjaft e vrazhdë pa nevojë me emërtimet e grave sipas profesionit, kur dihet, siç u përmend më sipër, se prapashtesa -ATORE del e rezervuar kryesisht për emërtime të tilla. Për këtë arsye për emërtime të reja më duket më e drejtë forma pa -A-në e tillë mbështetëse si p.sh. vegeltore, farëtoe etj. Përveç kësaj lypset marrë qëndrim se si të shënohet tema: të respektohet morfologjikisht tema e plotë e fjalës apo të reduktohet zanorja e fundit të saj zakonisht zanorja -Ë ose -E fundore e patheksuar.

P.sh. të shënohet lëkurëtore a lekurtore, luletore a lulëtore apo lultore?

Nuk është punë e parëndësishme b.f. të dihet pra të shënohet apo jo zanorja e tillë, kur dihet se ajo është pjesë përbërëse e temës prodhuese e në disa raste të tjera lejohet a del e nevojshme të shënohet një -Ë mbështetëse, edhe pse dihet se elementi i tillë nuk është pjesë përbërëse e temës, p.sh. peshkëtore, tymëtore <§F Fjalën tymëtore e ndeshim në artikullin e cituar të M. Halimit në shënimin 21; ndërsa peshk(ë)tore si dhe këshilltore e pëllumbëtore i ndeshim të farkëtuara nga E. Sedaj (në Fjalorin e F. Bardhit, Prishtinë 1983).> etj.?!>

Së dyti, edhe tek emërtimet e vendshërbesave me -TORE me temë fjalëformuese foljore dalin çështje, të cilat duhen njohur më thellë dhe për zgjidhjen e tyre lypset mbajtur edhe qëndrim. Vërtet çështja që po trajtohet mund të cilësohet si çështje më e rreshqitshme, po që njëherësh mund të si njëra nga punët më të rëndësishme dhe frytdhënëse përgjithësisht. Është fjala, pra, për përzgjedhjen e temës fjalëformuese lidhur me konceptet foljore e prejfoljore që lidhen me kryerjen e procesit të caktuar në vendshërbesën përkatëse.

Kur kemi parasysh tërë sistemin foljor të shqipes, atëherë duke respektuar specifikën e temës që e kemi në shqyrtim në kuadër të gjuhës sonë të njësuar letrare, arritëm në përfundimin se çështja del e zgjidhshme, nëse të gjitha foljet i shohim të ndara në tri grupe jo aq homogjene:

a) në grupin e parë u përfshinë të gjitha foljet me -OJ, -EJ dhe -UAJ, të cilat në formimin e vendshërbesave përfqësohen me emrin e veprimit me -IM;

b) grupin e dytë që e përbëjnë të gjitha foljet me temë në bashkëtingëllore, të cilat në formimin e vendshërbesës përfaqësohen me temën e pjesores së gegërishtes me prapashtesën temëformuese -Ë dhe

c) grupin e tretë ku u përfshinë foljet me temë në zanore e togzanor që e formojnë pjesoren në shqipen e sotme letrare me prapashtesën temëformuese -R(Ë), formë kjo e cila mund të shërbejë si temë përfaqësuese fjalëformuese edhe për emërtimin e vendshërbesave me -TORE.

Veçoritë specifike si dhe kahet e zgjidhjes së çështjeve në shqyrtim do të vërehen më së miri në analizën e mëposhtme që bëhet për secilin grup veç e veç.

a) Siç dihet foljet më -OJ në shqipe e përbëjnë grupin më të madh të foljeve. Nga ky grup emri i veprimit pothuajse tërësisht del me prapashtesën -IM si p.sh. punoj punim, veproj veprim etj. Emrin e veprimit më -IM e formojnë edhe një shumicë e

konsiderueshme e foljeve më -EJ si dhe një grup i vogël i foljeve më -UAJ si p.sh. kursej kursim; shkruaj shkrim. Ky fakt është me rëndësi të theksohet ngase është i lidhur organikisht me emërtimet e vendshërbesave me -TORE, sepse si zgjidhje më e mirë për formimin e emërtimeve të vendshërbesave është të bëhet jo mbi trajtën përkatëse të drejtpërdrejtë foljore (nga e tashmja e dëftores apo nga trajta e pjesores), por pikërisht mbi bazë të emri prejfoljor përkatës të veprimit me -IM. Një prirje e tillë tashmë duket qartë në horizontin e të shqipfolurit. Në mbështetje të një prirjeje të tillë duke e cytur interesimin pse e si ndodh kjo, në çast vëmendja le të na përqëndrohet te këta tre shembuj përfaqësues:

1. pushim (pushoj/pushonj, pushue/pushuar)+TORE = pushimtore (jo pushojtore/pushonj(ë)tore, pushuetore/pushuartore);
2. këmbim (këmbej/këmbej, këmbe/këmbyer) +TORE = këmbimtore (jo këmbejtore/këmbënj(ë)tore, këmbyetore/këmbyertore);
3. shkrim (shkruej/shkruanj, shkruetore/shkruar) +TORE = shkrimtore (joshkruejtore, shkruanj(ë)tore, shkruetore/shkruartore).

Është e vërtetë se shembujt me -IM+TORE nuk ndeshen në FGJSSH, edhe pse format e tilla nuk janë pa traditë përdorimi. Të kujtojmë nga tradita rastet: arsimtore (P. N. Luarasi); mësimtore, shkrimtore (Josif Bageri) <\$F Shih: Sh. Berani, Gjuha e J. Bagerit, Prishtinë 1988, f. 51, ku shihet se J. Bageri dallon format: mësonjëtoare për shkollë, ndërsa mësimtore për klasë.> ; sundimtore (F.S. Noli), adhurimtore (L. Poradeci) si dhe aktualisht i ndeshim të regjistruara pikërisht si emërtime të vendshërbesave, p.sh.: këmbimtore (H. Gorani), kursimtore (gazeta "Rilindja", 28.XII.1984, f. 19), shkrimtore ("Rilindja", 6.VIII.1987, f. 12), fërgimtore (TVP, më 8.X.1984; më 23.VIII.1984); mundimtore (gazeta "Bujku", 2.IV.1994, f. V), freskimtore ("Fjala jonë", korrik 1995) etj.

Ndonëse numri i rasteve më -IM+TORE mund të jetë më i madh në praktikë nuk është i pabazë gjykimi se kjo mënyrë fjalëformimi hëpërhë duket se është e brishtë, ende e papërgjithësuar si te ne ashtu edhe në mbarë truallin e shqipes, prandaj lidhur me dukurine e tillë me të drejtë shtrohen këto dy pyetje:

E para, pse ia vlen dhe sa ia vlen të parapëlqehet emri i veprimit më -IM si temë fjalëformuese për të emërtuar vendin ku bëhet a kryhet një veprim e jo b.f. njëra nga trajtat përfaqësuese të foljes, qoftë njëjësi i së tashmes së dëftores veta e parë, qoftë trajta e caktuar e pjesores?

E dyta, pse ia vlen të favorizohet prapashtesa -TORE e jo prapashtesa -ORE, kur raste me -IM+ORE edhe me elemente kuptimore të vendshërbesës i ndeshim edhe në FGJSSH dhe në burime të tjera?

1. Lidhur me parapëlqimin e emrit të veprimit si temë fjalëformuese për këtë nëntip emërtimesh kanë ndikuar dhe mund të ndikojnë dy faktorë: së pari kemi të bëjmë me faktin se para njësimi të gjuhës letrare kombëtare asnjëra nga trajtat përfaqësuese të foljeve përkatëse më -OJ, -EJ dhe -UAJ nuk arriti të ketë shtrirje të gjerë sa që të mund të përgjithësohej edhe për emërtimin e vendshërbesave më -TORE, dhe së dyti, për arsye se edhe nevoja për emërtime të tilla mbase në fazat e caktuara nuk ka qenë aq e theksuar sa paraqitet sot.

Nga e kaluara formime të këtij nëntipi të shënuara në burimet e caktuara i ndeshim vetëm nja 2-3 raste të vetmuara mbi këtë bazë si p.sh. mësonjëtoje (mësojtore), e formuar mbi të tashmen e dëftores veta e parë njëjës dhe rrëfyetore e gjuetore, të formuara mbi bazë të pjesores geqe. Shembuj të tjerë nuk ndeshim, madje edhe dy shembujt e fundit nuk janë të shënuar në FGJSSH.

Si faktor tjetër me ndikesë mund të konsiderohet edhe vetë dallimi dialektor i formave përfaqësuese temëfjalëformuese të foljeve. Për këtë mjafton të krahasohen fundorët e së tashmes së dëftores: -OJ/ONJ, -EJ/ENJ, -UEJ/UANJ, përkatësisht fundorët e pjesores: -UE/UAR, -YE/YER, ndërsa trajtat e prejfoljorit më -IM dalin pa kurrfarë dallimi dialektor d.m.th. prapashtesa -IM është element i përbashkët ndër dialektor, ku e ka mbështetjen kryesore edhe letrarishtja e sotme e njësuar.

Pra përveç karakterit bashkues që sapo u përmend për formën më -IM, e cila për këtë qëllim shërben për mrekulli, në të mirë të parapëlqimit të temës fjalëformuese të emrit të veprimit më -IM ndikon edhe vetë semantika që shpreh emri i tillë prejfoljor, i cili përveç veprimit që ofrohet paksa me funksionin e foljes në mjaft raste tregon a ka mundësi të tregojë edhe rezultatin e veprimit të caktuar, d.m.th. elemente të një sendi a vendi konkret.

Nëse fakti i parapëlqimit të emrit të veprimit më -IM cilësohet i drejtë, atëherë mund të nxirret përfundimi se edhe trajtat e vetmuara të sipërcekura: mësonjëtoje, rrëfyetore e gjuetore duhet t'i përshtaten këtij kriteri. Kështu në vend të trajtës mësonjëtoje (mësojtore) për konceptin dhomë mësimi më drejt do të dilte **mësimtoje**. Po ashtu në vend rrëfyetore për konceptin: vend (kënd) rrëfimi (e regjistruar në FSSH 1974 dhe FSHS 1981), më drejt do të dilte **rrëfimtore** (në FGJSSH është trajta e diskutueshme: rrëfyetore). Rasti gjuetore <§F Shih: librin: "Tregime dhe pamje gjeografike të vendit tonë", Beograd 1964 f. 663 etj. (përkthyes: R. Jusufi e N. Veselaj).> që ka dalë në analogji me emrin gjuetar, sipas prirjes që do të theksohet në vazhdim, më drejt do të dilte **gjahtore**, ashtu siç del e favorizuar edhe trajta e emrit të veprimit gjahtar. Pra këtë

rast emërtimi i vendshërbesës rekomandohet të bëhet mbi temën emërore gjah gjahu.

2. Arsyetja pse ia vlen të favorizohet formanti -TORE kundrejt atij -ORE për këtë nëntip emërtime, edhe pse rastet më -IM+ORE i ndeshim në burime autoritative si p. sh. ushqimore, ushtrimore, dështimore, këshillimore (FGJSSH), pastrimore, pagëzimore (FSSH 1974), pushimore, strehimore, flijimore <§F Fjalën flijimore e ndeshim në librin "Kur`ani", Prishtinë 1985 f. 837. Edhe ky rast tregon për nevojën që ndjen gjuha jonë për emërtimin e vendshërbesave mbi bazë të emrit prejfoljor më -IM. Sipas mendimit tim më drejt do të dilte trajta më -IM/TORE: filijimtare sesa flijimore, për arsye që janë shtruar edhe në këtë punim, por edhe në një trajtesë tjetër.> e ndonjë tjetër në burime tona të ditës, qëndron në vetë funksionin, angazhimin dhe ngarkesën që ka prapashtesa -ORE në sistemin global të fjalëformimit, për nënfusha të caktuara semantike.

Siç e kemi përmendur edhe më përpara prapashtesa -ORE del shumë e ngarkuar dhe e angazhuar në disa nënfusha semantike e ndër to më kryesorja është nënfusha e emërtimit të mjeteve dhe të sendeve konkrete, por ajo dilte e ngarkuar edhe për emërtime vendesh, ku mbizotëron nocioni që lidhet me vendin ku gjendet me shumicë sendi i emërtuar në temën fjalëformuese, koncept ky që ka afërsi kuptimore me nocionin e vendshërbesës, por që dallon. Dallon ngase sendi i emërtuar te emërtimet më -ORE domosdo nuk del i përdorueshëm.

Përveç emërtimit të sendeve konkrete, ç`është e vërteta, me prapashtesën -OR/E, siç thuhet në doracakun normativ "Gjuha letrare shqipe për të gjithë" (1976), "kryesisht formohen mbiemra" dhe se pikërisht për këtë kategori leksikore "është shumë produktive, sidomos në terminologjinë shkencore - teknike" (Aty f. 214). Angazhimi i saj në formimin e mbiemrave njëfarë dore e stimulon këtë formant që të jetë i pranishëm në numër më të madh të mbiemrave të emëruar me prapashtesën -ORE.

Gjithsesi funksioni i prapashtesës -ORE në formimin e mbiemrave shprehet edhe sadokudo edhe në konceptet e emërtimeve të mjeteve a të termave tekniko-shkencorë, por kuptimisht del në nuanca edhe te emërtimet e njëfjalëzuara të vendshërbesave. Kjo tejdukshmëri mbiemërore bashkë me elemente të një vendi ku ndodhen sendet e emërtuar me shumicë si dhe elemente të gjësësendeve konkrete mund të shihet në njëfarë mënyre edhe te shembujt e sipërcekur. Kështu që:

- elemente të emërtimit të mbiemrit hetojmë tek emërtimet: ushqimore = ndërmarrje (industri) ushqimore; klasë (shkollë) ushtrimore;

- elemente të një vendi ku ndodhen me shumicë a një kompleks

i sendeve të emërtuara në temën fjalëformuese, si p.sh. pushimore = kompleks ndërtesash a objektesh për pushim e rekreacion, strehimore = kompleks objektesh (nëntokësore) për strehim e qëndrim etj, të cilat kanë ngjashmëri kuptimore me emërtimet si perimore (arë), jetimore (shtëpi jetimësh), duhanore (arë) etj.;

- elemente të sendeve konkrete si p.sh. pagëzimore, ushtrimore, pastrimore, fërgimore - të cilat edhe nëse nuk dalin momentalisht në hominimi me emërtimin e sendit të caktuar konkret, gjithsesi kryerja e veprimit ndër lidhet me një përdorëse, enë a makinë konkrete. <§F Kur është fjala tek emërtimet e sendeve a mjeteve konkrete duhet të shfrytëzohen rastet e mundshme si p. sh.: fërgore (mjet), fërgimore (aparaturë, pajisje teknike), ndërsa fërgimtare (vendshërbesë); kulllore (mjet), kullimore (aparaturë, pajisje teknike), ndërsa kullimtare (vendshërbesë) etj.>

Pra shikuar nga ky aspekt secila trajtë e emërtimit me -IM+ORE mund të jetë e prekur parësorisht me ndonjërin nga elementet e sipërcekura e pastaj do të mund të shprehin edhe emërtimin e vendshërbesës, ndërsa trajtat me -IM+TORE si p.sh. këmbimtare, pushimtare, kursimtare, strehimtare, fërgimtare etj. nuk dalin të ngatërruara sot për sot me koncepte përcjellëse, qoftë edhe pjesërisht, siç u cekën më sipër për format më -IM/ORE..

Edhe nja dy dukuri të tjera çojnë peshë në dobi të parapëlqimit të prapashtesës -TORE, e para ka të bëjë me pasivizimin e prapashtesës TOR/E për formimin e mbiemrave dukuri kjo që favorizon aktivizimin dhe produktivitetin e trajtave më -ore e së dyti, e pandarë nga kjo, kemi të bëjmë me pasivizimin i prapashtesës -OR/E si dhe -TOR/E për emërtimin e njerëzve sipas veprimtarisë së tyre. Për këtë qëllim d.m.th. për emërtimin e njerëzve sipas veprimtarisë së tyre më aktive dhe produktive dalin prapashtesat simotra -AR/E e -TAR/E dhe jo ato -OR/E dhe -TOR/E.

Si pikë të veçantë do të përmendim dukurinë e emërtimit të njerëzve sipas veprimtarisë me prapashtesën -TAR/E bazë të emrit të veprimit -IM. Kështuqë ndërsjelltas formimet me -IM+TAR(E) -IM+TORE asociacionisht e ushqejnë njëra tjetrën. Krahaso ndërndikimet paralele: kursimtar/kursimtare, këmbimtar/këmbimtare, shkrimtar/shkrimtare, gjyqtar/gjyqtore e kështu me radhë, <§F Lidhur me këtë krahaso zhvillimin e mundshëm: këmbëj: këmbyes, këmbor - këmbim, këmbimtar këmbimtare; faqoj: faques, faqore - faqim: faqimtar, faqimtare; vizoj: vizues, vizore - vijëzim: vijëzimtar, vijëzimtare etj. Po kështu në vargun fjalëformues ndeshim edhe emrat e sendeve konkrete si p.sh.: gardhore, freskore, harkore, dhëmbësore etj.> sikurse gjahtar gjahtore, ngruhtar ngruhtore, mbathtar mbathtore etj.

Prandaj qëndrueshmëria e emërtimeve të vendshërbesave me IM+TORE sforcohet nga struktura përcjellëse qoftë me pasivizimin e prapashtesës mbiemërore -TOR/E, qoftë me aktivizimin e formimeve të emrave të veprimtarëve me prapashtesën -TAR mbi bazën e njëjtë fjalëformuese si dhe emërtimet e vendshërbesave d.m.th. mbi bazë të emrit e veprimit a të rezultatit të veprimit me -IM.

Gjithsesi lindja e emrave të vendshërbesave me -IM+TORE nuk duhet konsideruar si shpifje që lëndon gjuhën, por duhet konsideruar si zgjidhje që imponohet nga vetë modeli që sfidon, prirje kjo që nëse kuptohet drejt dhe favorizohet ndërgjegjesisht me siguri do të ketë perspektivë të mbarë.

Vërtet, kur ndeshemi në dilemë se cilin formant duhet të zgjedhim -ORE apo -TORE për emërtimin e vendshërbesave, s'kemi arsye të hamendemi fare. Pa ngurrim duhet parapëlqyer prapashtesën -TORE. S'ka arsye të mos përgjithësohet zgjidhja siç është dhënë b.f. në FGJSSH 1980 për rastin **duhanore** (arë me duhan) ndërsa **duhantore** (dyqan ku shitet duhani), sipas kësaj analogjie pse mos të dalë b.f.: perimore (arë me perime) perimtoore (dyqan perimesh), pemore (kopësht me pemë), pemëtore (dyqan pemësh), po kështu: pushimore (kompleks ndërtesash) pushimtoore kënd (shtëpizë) pushimi që mund të jetë vendth i kufizuar edhe brenda atij kompleksi, por edhe në ndonjë vend tjetër.

Duke i lënë format -IM+ORE e -IM+TORE në konkurrencë lojale, edhe pse nuk gabohet që ndërgjegjesisht të anohet për format më -TORE, për arsyet që dihen, para se të kaloj në analizën e grupit tjetër të foljeve, po e cek një dukuri mjaft interesante që lidhet me emërtimin e vendshërbesave po ashtu mbi bazë të një emri prejfoljor.

Është fjala për një grupth foljesh me -UAJ, nga të cilat përveç emrit të veprimit me -JE është reflektuar edhe një formë e emrit prejfoljor me prapashtesën -OJ/Ë si p.sh. luaj lojë, rruaj rrojë, bluaj blojë, druaj drojë dhe pikërisht ky emër shërben si temë fjalëformuese për emërtimin e vendshërbesës më -TORE, si p.sh. lojëtoore, rrojëtoore, blojëtoore, drojëtoore (me kuptim figurativ). Po mbi këtë bazë kanë dalë edhe emrat përkatës të njerëzve sipas veprimtarisë, si p.sh. lojëtar, rrojëtar, blojëtar, drojëtar. Edhe pse emërtimet e tilla paraqiten në numër të kufizuar dhe herë-herë jo të favorizuar, ka rëndësi të dihet se po sipas kësaj arsyeje (ecurie) del i zërthyeshem emërtimi i vendshërbesës si b.f. rrojtore, si fjalë e prejardhur, më shumë ka gjasa të zërthëhet nga emër-tema rrojë + prapashtesa TORE <\$F Shih: J. Kole, Çështje të gramatikës së sotme II, Tiranë 1975, punimin "Rreth emrave të prejardhur në -ORE" f. 122.>, sesa nga trajta foljore. Kjo rregull vlen edhe për shembuj të tjerë të emrave të këtij nëntipi.

b) Përveç grupit të foljeve më -OJ që përka sasia dalin,

pothuajse në numër të pakufizuar, në shqipe grup mjaft të madh foljesh përbëjnë foljet me temë në bashkëtingëllore. Për temën që po trajtohet këtu është me rëndësi të ceket fakti se pothuajse të gjithë shembujt e regjistruar të vendshërbesave me temë foljore në FGJSSH (hiq katër sosh: shkronjëtoje, rrëfyestore, lajtore e shkritore) janë ndërtuar mbi temën fjalëformuese foljore të këtij grupi.

Kur kemi parasysh numrin relativisht të madh të emërtimeve më -TORE që arrin në afro 40 sosh, pra formime mbi këtë bazë me mundësi të hapur shumimi, atëherë mund të thuhet se sa herë që paraqitet e nevojshme sipas kontekstit të caktuar mund të formohen emra të vendshërbesave më -TORE mbi bazë të temës foljore (më saktë mbi bazë të pjesores me prapashtesën temëformuese -Ë) të grupit të foljeve me temë në bashkëtingëllore.

Mirëpo edhe në këtë proces fjalëformimi dalin çështje jo të vogla që kërkojnë sqarim, sidomos në raportin: temë fjalëformuese + prapashtesë fjalëformuese = emërtimi prejpjesor, ku bën pjesë edhe emri i vendshërbesës më -TORE.

Ky raport më së miri mund të shihet në skemën vijuese:

S k e m a
e raportit: tff + pff = epp *

Trajta Trajta e pjesores Emri i vepruesit Emërtimi
përfaqësuese letra- / gegë- e prapashtesën i
e foljes risht risht -S -TAR <\$F Emrat më -TAR
nuk janë mbizotërues mbi bazë të temës foljore, por nuk
përfundon prodhimtarie e tyre paralele (natyrisht me nuancime
të dalluara kuptimore) edhe mbi këtë bazë, sidomos kur tema e
tillë përfundon me bashkëtingëllore si p. sh. mihës mihtar,
ndezës ndezëtar, mbathës mbathëtar, falës falëtar, folës folëtar
etj. Rreth kësaj dukurie më gjerisht shih veprën e cituar në
shënimin 50.> vendshërbesës -----

1	2	3	4	5	6
1. mbath	mbathur	mbathë	mbathës	mbathtar	mbathtore
2. fal	falur	falë	falës	faltar	faltore
3. lind	lindur	lindë	lindës	lindëtar	lindëtore
4. njeh	njehur	njehë	njehës	njehëtar	njehëtore
5. shëtit (shëtis)	shëtitur	shëtitë	shëtitës	shëtitar	shëtitore shëtitëtore shëtitittore
6. shes	shitur	shitë	shitës	shitar? shitëtar shittar!	shitore shitëtore shittore.

- * Sqarim: tff - temëfjalëformuese;
- pff - prapashtesë fjalëformuese;
- epp - emërtimi prejpjesor.

Po mjaftohem vetëm me këta shembuj vetëm sa për të hyrë më lehtë në temën a në të paraqiturit e problemit. Këtu, ç`është e vërteta, nuk janë përfshirë prapashtesat e mënyrëzat e tjera fjalëformuese të prejfoljorëve përkatës me prapashtesa të tjera, si p.sh. mbathË, mbathJE, pjekËTARI, lindOR/E, njohËSI, prekSHMËRI, njehATORE, njehËSOR, të pjekURIT, e pjekUR/A etj, edhe pse dihet se secili shembull ka gjedhen e vet.

Qëllimi ynë këtu është të tërheqim vëmendjen te trajta e pjesores si temë fjalëformuese e jo të ndalem në përhollësi rreth formanteve të ndryshme ndajshitesore.

Siç po shihet nga skema e mësipërme si temë fjalëformuese për formimin e emrave merret trajta e pjesores së versionit gegë me prapashtesën temëformuese -Ë e jo versioni i trajtës së letrarishtes së sotme me prapashtesën temëformuese -UR. Ky fakt nuk kontestohet, por megjithatë lidhur me këtë dalin dy çështje të vërejtshme që kërkojnë sqarim. E para ka të bëjë me paqëndrueshmërinë e prapashtesës temëformuese -Ë dhe e dyta ka të bëjë me interpretimin e formës së caktuar.

Paqëndrueshmëria e prapashtesës -Ë të temës prodhuese shihet që në shembullin e parë te folja mbath (me mbathë).
Krahaso vargun: mbathë mbathës mbathtar mbathtore.

Me një fjalë, prapashtesa e tillë del e shënuar vetëm te hallka a emri më -S mbathËS, ndërsa te mbathtar mbathtore sipas FGJSSH-së del e zhdukshme. Kështu e ndeshim edhe në burimet e traditës të shkrimeve kryesisht në gegërishte.

Të ballafaquar me një traditë të tillë drejtshkrimore dhe meqenëse trajta e pjesores së gegërishtës me -Ë si formë e vetme edhe në kohët analitike, pothuajse u mënjanua nga norma letrare, pasi që në përdorim të përditshëm u favorizua si normë forma e pjesores (toskërishte) më -UR, atëherë doli edhe ndonjë interpretim i tillë që si temë prodhuese e emrave në fjalë të thuhet se është trajta e pjesores së letrarishtes pa prapashtesën -UR. <§F Për interpretimin e tillë shih edhe te "Gjuha letrare shqipe për të gjithë", Tiranë 1976, f. 211 si dhe te "Çështje të gramatikës së shqipes së sotme II, Tiranë 1975 (punimi i A. Dhrimos, Formimi i mbiemrave në gjuhën e sotme shqipe" f. 164, ku thuhet qart se për formimin e fjalëve të tilla shërben "si temë trajta e shkurtër e pjesores (pa -UR ose -R) së foljes".> Në këtë situatë, siç mund të shihet nga shembujt e mësipërm, forma e tillë pa -UR përkon plotësisht me trajtën përfaqësuese të foljes sot, d.m.th. me njëjësin e së tashmes së dëftores veta e parë. Së këtejmi doli edhe interpretimi tjetër se si temë prodhuese të

emrave të tillë të prejardhur shërben trajta e njëjësit të së tashmes së dëftores. Dhe vërtet, ndonjë rast mund të argumentohet se është formuar mbi këtë temë, siç është shembulli kam kamës, mirëpo të kundërtën, d.m.th. formimin mbi bazë të pjesores e argumentojnë prova të bollshme që janë edhe argumente bindëse mjaft të forta. Lidhur me këtë mjafton të përmendim shembullin: shes shitë (me shitë) - shitës; shëtit (shëtis) shëtitë (me shetitë) - shëtitës e të tjerë. Sidoqoftë trajta e gegërishtes me -Ë fundore në interpretim s` mund as që duhet të mohohet për arsye që u thanë më sipër.

Lidhur me këtë del edhe një çështje tjetër që kërkon përgjigje. Prapashtesa temëformuese -Ë e trajtës së pjesores temë fjalëformuese, së paku për arsye historike morfologjike a duhet të ruhet apo duhet të zhduket për arsye fonetike, sidomos me rastin e formimeve të fjalëve të reja. Ka mendime se lidhur me këtë çështje duhet të rishqyrtohet mënyra drejtshkrimore e formave në fjalë. Studiuesit F. Sulejmani dhe M. Nushi <F Lidhur me këtë shih te përmlledhje kumtesash: "Probleme aktuale të kulturës së gjuhës shqipe", Prishtinë 1983, F. Sulejmani, "Çështje të normës letrare", f. 91 dhe M. Nushi, "Për disa shkarje drejtshkrimore në literaturën gjuhësore", f. 257.> janë të mendimit se kjo prapashtesë për arsye morfologjike duhet të ruhet si te shembujt: lindëtar lindëtore, shkalëtar shkalëtore, mbathëtar mbathëtore etj. Me një veprim të tillë, siç shprehen ata, rregulla drejtshkrimore a drejtfjalëformuese do të jetë më e lehtë për t`u mbajtur mend dhe si e tillë ka përparësi për t`u sendërtuar në jetë, sidomos në gjuhën e shkrimit. Rishqyrtimi i kësaj dukurie në kuadër të shoshitjes së përgjithsme të drejtshkrimit a të drejtfjalëformimit të gjuhës sonë standarde mbase do të jetë me vlerë. Sidoqoftë diskutimi i çështjeve të tilla nuk do të sjellë asnjë të keqe. Në këtë kontekst mbetet për t`u vlerësuar edhe interpretimi i rasteve që pandehet se puqen bashkëtingëlloret e njëjta T+T siç janë rastet shitë +tore shittore; shëtitë+tore shëtittore, përkatësisht shitore, shëtitore.

Gjithsesi duhet pasur parasysh faktin se formimi i emërtimeve të vendshërbesave me prapashtesën -TORE mbi bazë të foljeve me temë në bashkëtingëllore aspak nuk del i diskutueshëm, sepse paraqitet me fizionomi të qartë të formëzuar dhe se një rregull e tillë është e qëndrueshme. Së këtejmi formimet e tilla mund të konsiderohen se janë të sanksionuara edhe në burimet tona përkatëse të gjuhës sonë standarde.

c) Te grupi i foljeve me temë në zanore a togzanor, të cilat e formojnë pjesoren në letrarishten e sotme me prapashtesën temëformuese -R(Ë), përkatësisht në gegërishte me prapashtesën zero, d.m.th. në trajtën e shkurtër të pjesores, çështja del e

një natyre paksa tjetër. Që të dyja versionet e pjesores konkurrojnë si tema fjalëformuese, mirëpo për arsye se forma e shkurtër e gegërishtes para njësimit të gjuhës sonë letrare nuk ka mundur të përgjithësohej a të kishte shtrirje të gjerë në formimin e emrave të tipit që po trajtohet këtu dhe se pas njësimit një formë e tillë në krahasim me trajtën normative del jo e favorizuar, atëherë për emërtimin e prejpjesorëve, versioni i letrarishtes së sotme pothuajse del me konkurrencë të fituar, edhe pse ka raste që ende konkurrenca vazhdon. Gjithsesi trajta e pjesores së letrarishtes së sotme del më aktive dhe prodhimore. Për të pasur një ide më të qartë rreth këtij zhvillimi po japim në vazhdim disa shembuj perfaqësues, sipas rubrikave të caktuara, ashtu siç bëme pak më sipër për grupin e foljeve me temë në bashkëtingëllore.

S k e m a
e zhvillimit të foljeve në zanore e togzanor sipas raportit:
pff + pff = epp

1	2	3	4	5	6
1. laj	larë	la	larës (las)	larëtar	lajtore larëtore
2. shkrij	shkrirë	shkri	shkrirës (shkris)	shkrirëtar	shkritore shkrirëtore
3. ndaj	ndarë	nda	ndarës (ndas)	ndarëtar	ndarëtore
4. ngrij	ngrirë	ngri	ngrirës	ngrirëtar	ngrirëtore
5. fryj	fyrë	fry	fryrës (frys)	fyrëtar	fyrëtore
6. ziej	zier	zie	zierës		ziertore
7. lyej	lyer	lye	lyerës (lyes)	lyertar (lyestar!)	lyertore
8. ngas	ngarë	nga	ngarës ngasës		ngarëtore
9. thaj	tharë	tha	tharës	tharëtar	tharëtore
10. prej	prerë	pre	prerës (pres)	prerëtar prestar	prerëtore prestore.

Lidhur me shembujt e mësipër del e nevojshme te jepen sqarime më të përhollësishme, gjë që i kalojnë përmasat e temës që po trajtohet këtu. Meqenëse kjo çështje është trajtuar më hollësisht në një vend tjetër, tashpërtash e shoh të nevojshme dhe të domosdoshme të cek atë që është më e domosdoshme për temën që po e trajtojmë.

Trajtat e emrave të prejpjesorëve me prapashtesën -TAR <\$F Vërejtja e dhënë në shënimin 80 vlen edhe për shembujt më -TAR dhe -S si p. sh.: prerës prerëtar, larës larëtar etj. Më

gjerësisht në veprën e cituar në shënimin 50.> janë të brishta jo aq në rubrikën e katërt sa janë të tilla në rubrikën e pestë dhe në atë të gjashtë, mirëpo prirja e emërtimeve të tilla si premisë nuk është e huaj për natyrën dhe strukturën fjalëformuese të gjuhës së sotme letrare shqipe.

Është fakt i pamohueshëm se në FGJSSH i ndeshim nja tre shembuj të emërtimeve të vendshërbesave të formuara mbi bazë të këtij grupi foljesh, siç janë: lajtore, shkritore dhe prestore, që të trija këto të formuara mbi bazë të trajtave foljore të gegërishtes, trajta këto që për arsyet që u thanë më sipër mbeten vetëm si raste të vetmuara, pa infuzion modeli.

Meqenëse sot për sot ata që merren me terminologji tekniko-shkencore e ndjejnë nevojën për të krijuar emërtime të vendshërbesave edhe mbi bazë të tipit të këtyre foljeve, me të drejtë shtrohet çështja se si duhet vepruar. Si mund të emërtohet b.f.:

servisi i larësit të veturave,
dyqani i lyerësit të makinave repulsore,
shërbimtorja e fryrësit të gomave?
etj. etj.

Kërkesat si këto në të ardhmen jo të largët padyshim do të jenë edhe më të theksuara. Për këtë mjafton të përmend huazimin neveritës për ne "lavazh" (për "auto-larje") që ka zënë të përdoret në Shqipëri.

Sipas mendimit tim formimet e vendshërbesave të kësaj natyre duhet të bëhen mbi bazë të pjesores së letrarishtes së sotme, si p.sh. larë larëtore, lyrë lyrëtore, fryrë fryrëtore, zier ziertore, prerë prerëtore etj. Them kështu, ngase format e tilla dalin të pranueshme pasi që edhe emrat e vepruesit si dhe emrat e veprimit formohen po mbi këtë bazë.

Gjithsesi nevoja për krijime të tilla ekziston edhe aktualisht, kurse përzgjedhja a parapëlqimi i trajtës së pjesores si temë fjalëformuese dotë varet edhe nga prestigji i gjuhës standarde. Tash për tash të normëzuara dalin trajta e pjesores me prapashtesën temëformuese -R(Ë), prandaj edhe prestigjin e gëzojnë trajtat e tipit: **larëtore prerëtore fryrëtore lyertore**, sepse gjuha letrare e favorizon vetëm këtë trajtë. Të rikujtojmë edhe njëherë vargun fjalëformues:

larë larës larje, i larë, të larat, larëtar, larëtore;
fryrë fryrës, fryrje, i fryrë, e fryra, të fryrat, fryrëtar
fryrëtore etj.

Krejt kjo që u tha deri këtu rreth përcaktimit të trajtës së temës fjalëformuese mbi bazë foljore mund të rrumbullakësohet në këto tri konstatime:

E para, për foljet e grupit më -OJ, -EJ, UAJ nga të cilat del emri i veprimit më -IM, pikërisht ky emër prejfoljor shërben si temë fjalëformuese për emërtimin e vendshërbesave me -TORE, si p.sh. pushimtore, këmbimtore, shkrimtore.

E dyta, për foljet me temë në bashkëtingëllore si temë prodhuese për emërtimin e vendshërbesave më -TORE, ashtu si edhe për prejpjesorët e tjerë shërben trajta e pjesorës së ish-gegërishtes letrare me prapashtesën temëformuese -Ë, si p. sh. lindëtore, njehëtore, mbath(ë)tore etj.

E treta, për foljet me temë në zanore dhe togzanor si temë prodhuese për emërtimin e vendshërbesave me -TORE ashtu si edhe për prejpjesorët e tjerë shërben trajta e pjesores së letrarishtes së sotme me prapashtesën temëformuese -R(Ë), si p.sh.: prerëtore, larëtore, lyertore, fryrëtore etj.

Kjo që u tha deri këtu besoj se mjafton së paku sa për të zgjuar interesimin edhe të studiuesve e faktorëve përkatës profilesh të ndryshme, në mënyrë që çështja e shtruar të çohet më tutje drejt zgjidhjes e sendërtimit të plotë.

Gjithsesi tërhiqet vërejtja se çdo përfitim rasti me prapashtesën -TORE i krijuar pa kriter d.m.th. në kundërshtim me sugjerimet e mësipërme, përkatësisht që nuk përputhet me semantikën e përkufizimit të kuptimit leksikor të fjalë-termit vendshërbesë, siç është cekur në formulimin përkatës, nuk duhet të favorizohet.

**(6) Semantika e përkufizimit aktual si
kriter vlerësues për qëndrueshmërinë
e disa emërtimeve të vendshërbesave
më -TORE**

Sipas përkufizimit të dhënë mbi kuptimin leksikor të vendshërbesës më -TORE del nocioni i këtij termi, siç është vënë re edhe më përpara, por që po e ritheksojmë edhe këtu shkurt fare me qëllim vetëm sa për t`i vënë në pah të dy komponentët përbërës që do të na shërbejnë si kriter vlerësues për përcaktimin e qëndrueshmërisë së emërtimeve të caktuara. Siç është përmendur më përpara dy janë komponentët bazë:

a) komponenti i parë ka të bëjë me përcaktimin e një vendi zakonisht të vogël "të kufizuar", në të cilin bëhet përdorimi i sendit të emërtuar në temën fjalëformuese të emërtimit dhe

b) komponenti i dytë ka të bëjë gjithashtu me një vendth të kufizuar, "një ndërtesë, lokal ... etj." por të destinuar për t`u kryer në të veprimi përkatës, i cili lidhet me kuptimin e "temës fjalëformuese të emërtimit të caktuar".

Siç është parë edhe nga shembujt e analizuar në nëntitujt e mëparshëm elementi bosht i procesit të fjalëformimit të emrave në shqyrtim mbetet fjalë-tema prodhuese, e cila del e shënueshme, qoftë me një emër konkret që lidhet me komponentin e parë semantik, qoftë me një trajtë foljore a me një emër prejfoljor ose një emër joprejfoljor, por që me të shprehet a nënkuptohet një veprim, i cili ka lidhje me komponentin e dytë semantik.

Përkufizimi i mësipërm del i qëndrueshëm edhe mund të konsiderohet si një kriter vlerësues për qëndrueshmërinë e emërtimeve konkrete të vendshërbesave, ngase shumica dërrmuese e emërtimeve që u analizuan më sipër ishin në suazat e këtij përkufizimi. Mirëpo në jetën tonë gjuhësore, si në të kaluarën edhe edhe në gjuhën tonë të sotme, qoftë për shkak të ndikimit të shtytësve të jashtëm (nga gjuhët e huaja), qoftë për shkak të analogjisë formale që imponohet nga shtytës të brendshëm gjuhësor apo për shkaqe të tjera, në situata të caktuara dalin a tentojnë të dalin edhe emërtime të vendshërbesave me -TORE, të cilat ose nuk përputhen ose bien ndesh me kriterin semantik të nocionit të vendshërbesës më -TORE, siç u cek më sipër.

Edhe pse dukuria e tillë del pothuajse periferike në krahasim me numrin e madh të emërtimeve më -TORE që përshtatin plotësisht me kriterin e sipërcekur, megjithatë janë nja katër çështje, të cilat

kërkojnë sqarim. Këto çështje do të përpiqem t'i zbërthej më poshtë në këtë nëntitull. Çështjet e tilla njëherëpërnjëherë po shtrohen prej nesh në formë pyetjesh:

e para, a ka mbështetje semantike tema mbiemërore dhe ajo ndajfoljore në formimin e vendshërbesave?

e dyta, çfarëdo emri a mund të shërbejë si temë fjalëformuese për emërtimet në shqyrtim?

e treta, sa mund të shërbejë një emër në cilësinë e emërtimit të njeriut sipas veprimtarisë si temë fjalëformuese për emërtimet e tilla dhe

e katërta, çfarë qëndrimi duhet mbajtur a si duhet kuptuar rastet kur emërtimet më -TORE, përdoren në fushën e krijimtarisë letrare. d.m.th. me kuptim të fytyruar?

Përgjigjet po përpiqem t'i jap më poshtë:

1) Është e vërtetë se në burime të caktuara, pa ndonjë vlerësim kritik thuhet se tema mbiemërore, madje edhe ajo ndajfoljore <§F Për këtë shih te Gramatika ... (sipas shënimit 52) dhe në punimin e M. Halimit (sipas shënimit 67), pa u futur thellë në analizë rreth përshtatshmërisë semantike.> shërben për formimin e vendshërbesave më -TORE, konstatim ky që ilustron me shembujt, si: sëmurëtole, pastërtore, ëmbëltole e ndonjë tjetër. Gjithsesi konstatimi i tillë duhet t'i shtrohet rivlerësimit. Kur kemi parasysh përkufizimin e mësipërm të nocionit të vendshërbesës, logjikisht paraqitet kontestuese qëndrueshmëria e temës mbiemërore si dhe të asaj ndajfoljore. Pse lidhur me këtë mund të thuhet se dyshimi del i bazuar? Përgjigja është fare e thjeshtë dhe lidhet me kuptimin kategorial që ka pjesa e caktuar e ligjëratës.

Dihet fakti se me kategorinë e mbiemrit shprehet vetëm "një tipar i sendit" e jo sendi vetë, me të cilin do të mund të manipulohej (të përdorohej), kurse me kategorinë e ndajfoljes shprehet vetëm "një tipar i veprimit" e jo vetë veprimi, i cili bëhet a mund të kryhet në një vend të caktuar, i cili si nocion është emërtuar me fjalë-termin: vendshërbesë.

Për të qenë më bindës konstatimi i mësipërm në vazhdim po i zbërthejmë rastet e sipërcekura: sëmurëtole, pastërtore dhe ëmbëltole.

a) Emri **sëmurëtole** (sot trajtë e pafavorizuar) përmendet nga A. Xhuvani që në vitin 1903. Kjo fjalë del e shënuar edhe në Fjalorin e "Bashkimit" ("smunntore" f. 401) si dhe në burime të tjera, madje në FSHSK (1981) del në dy versione: sëmurëtole dhe sëmutole <§F Shih: Fjalori shqip - serbokroatisht, Prishtinë 1981 f. 860.> . Me gjasë kjo fjalë është përfutuar kryehere si kalkim për fjalën hastahane (hastana) të turqishtes osmane (hasta = i sëmure

hastahane = sëmurëtore), me të cilën shprehet një vendshërbesë (spital) ku mjekohen e shërohen të sëmurët.

Sipas logjikës dhe rregullës fjalëformuese që po propagandohet edhe në këtë punim sot për sot për një "vend-mjekim" a "vend-shërim" të tillë më natyrshëm do të dilte përgjegjësi: **mjekimto**re a **shërimto**re e jo kurrësesi trajta sëmurëtore, sepse siç e pamë nga përkufizimi është fjala për vend ku kryhet mjekimi a shërimi e jo ku bëhet sëmurdje(?!), d. m. th. është çështja te tema e emërtuar fjalëformuese. Ç` është e drejta, trajta sëmurëtore (por mbi bazë të trajtës foljore d. m. th. mbi bazë të pjesores sëmure-) e jo të mbiemrit (i) sëmure, mund të jetë e lejueshme për t'u përdorur në rrethana të caktuara, por me kuptim figurativ, sidomos në krijimtarinë letrare për të treguar ironikisht një vend ku sëmuren a pësojnë njerëzit e shëndoshë e jo vendi ku shërohen me të vërtetë njerëzit e sëmure.

b) Emri në trajtën **pastërtore**, i cili në FGJSSH del si emërtim gruaje, në FSKSH (1974) si dhe në FSHSK (1981) ka kuptim tjetër, është shënuar si barasvlerës i fjalës "_istionica" të serbokroatishtes, d.m.th. vendi ku bëhet pastrimi. Edhe te ky rast kemi të bëjmë me kalkim (përkthim) jo aq të qëlluar. Krahaso serb. _ist = shq. pastër, ngase në serbokroatishte forma e tillë lidhet më shumë me pjesoren, përkatësisht mbiemrin foljor (glagolski pridev).

Edhe për këtë rast, kur është fjala për një "dyqan pastrimi", shqipërimi më natyrshëm do të dilte: **pastrimto**re b.f. pastrimto kimike - hemijska _istionica e jo: pastërtore kimike. Pra trajta pastrimto do të qëndronte si emërtim i mirëfilltë i vendshërbesës më -IM+TORE, gjithsesi më mirë sesa: pastërtore, pastrimore, pastrim a pastërti, që ndeshet aktualisht në burime të caktuara.

c) Rasti **ëmbëlto**re nuk duhet të na hutojë. Edhe qëndrueshmëria e emërtimit të tillë logjikisht gjen mbështetje jo te fjalë-tema mbiemërore: i(e)ëmbël" e aq më pak te ndajfolja "ëmbël", por te fjalë-tema emërore: "e ëmbla" a "tëmblat", të cilat janë sinonime të fjalës ëmbëlsirë. Pra **ëmbëlto**re quhet vendshërbesa a dyqani ku shiten (përdorohen) ëmbëlsirat a tëmblat si sende konkrete.

Nga sa u tha lidhur me këtë mund të nxirret përfundimi se emërtimet e vendshërbesave më -TORE, sipas rregullit semantik nuk formohen mbi bazë të një fjalë-teme mbiemërore, aq më pak mbi një temë ndajfoljore, por mbi bazë të një fjalë-teme emërore ose foljore. Nëse shfaqet ndonjë rast i vetmuar me temë mbiemërore a ndajfoljore ai nuk ka nevojë të sforcohet artificialisht, por duhet të zëvendësohet (përshtatet), qoftë me temë emërore, qoftë me temë foljore varësisht nga konteksti.

2) Në mbështetje të semantikës së përkufizimit aktual të cituar për vendshërbesat më -TORE dalin të diskutueshme edhe disa emërtime me temë emërore, siç janë shembujt: qarkëtoare, pylltoare, kopështore, gjykatore, vreshtore, lulishtore, gjumëtoare etj.

Ku qëndron papërshtashmëria e tyre nuk është vështirë të konstatohet po të rikujtohet përkufizim i nocionit të vendshërbesës, sidomos fakti që lidhet me temën fjalëformuese.

Siç mund të shihet nga shembujt e sipërshënuar asnjëra nga temat fjalëformuese të tyre nuk tregojnë një send a gjësend konkret, me të cilin do të mund të manipulohet. Për ta pasur edhe më të qartë këtë çështje në vazhdim po i zbërthejmë kalimthi tre shembujt e parë: qarkëtoare, pylltoare dhe gjykatore, por edhe ndonjë tjetër të ngjashëm.

a. Prof. A. Xhuvani e shënon emërtimin **qarkëtoare**, të cilin me të drejtë nuk e favorizon si emërtim vendi (vendshërbesë), përkatësisht si një emër me të cilin tregohet ndërtesa, ku është vendosur administrata e qarkut d. m. th. qendra e një ndarjeje administrative, sikurse janë qendrat administrative: rrethi, komuna, bashkia e të ngjashme.

Siç mund të kuptohet edhe nga shembujt e tjerë të ngjashëm emërtimi qarkëtoare i tejkalon kufijtë e një vendshërbesë, sepse në atë ndërtesë (qendër) mund të kryhen njëherazi shumë veprime, punë a shërbime, të cilat edhe i kanë emërtimet e veta si p.sh. kabineti, sekretaria, drejtorati, zyra e noterisë etj. dhese me fjalën qark (si emër vendi gjeografik administrativ) pasi që nuk është emër konkret nuk mund të manipulohet, kusht ky që e karakterizon përkufizimin e emërtimit të vendshërbesës. Me fjalë të tjera edhe forma qarkëtoare mbi bazë të fjalë-temës qark-, si emërtim vendshërbesë nuk qëndron, prandaj me të drejtë është flakur nga përdorimi.

b. Kam pasur rast të dëgjoj dhe ta ndesh të shkruar emërtimin **pylltoare** si barasvlerës të termit "šumaria" të serbokroatishtes d.m.th. për "shtëpinë e rojtarit të pyllit", përkatësisht për selinë administrative (ndërtesën) ku është vendosur drejtorati a seksioni i pylltarisë (pyjeve). Edhe kjo fjalë e prejardhur ndërtimisht nuk mund të kontestohet, madje kur kemi parasysh edhe emërtimin e njeriut sipas veprimtarisë **pylltar**, të formuar mbi bazë të emër-temës pyll- me të drejtë zgjon asociacione që edhe trajta pylltoare të qëndrojnë. Mirëpo në anën tjetër kur kemi parasysh faktin se fjala pyll nuk është send konkret a gjësend me të cilin do të mund të manipulohet dhe se nocioni i fjalës së tillë është shumë i gjerë dhe si i tillë nuk përkon me nocionin e vendshërbesës që lidhet me një vend a lokal destinimisht të kufizuar, atëherë edhe emërtimi i vendshërbesës **pylltoare** semantikisht nuk qëndron.

Siç e kemi përmend në një vend tjetër po në këtë punim, rastet siç është edhe ky që i referohet emrit **pyll pylltar** emërtimi i vendshërbesës ka gjetur zgjidhje jo me prapashtesën -TORE, po me prapashtesën -(tar)I: **pylltari**, sikurse sekretar sekretari, lulishtar lulishtari, zdrukthëtar zdrukthëtari, vreshtar vreshtari - prandaj edhe për fjalën në shqyrtim zgjidhja më e mirë do të dilte: pylltar pylltari, edhe pse forma e tillë ndeshet në hominimi të karakterit polisemik me emërtimin e degës së caktuar të veprimtarisë ekonomike.

c. Emrin **gjykatore** e ndeshim në FGJSSH si fjalë të vjetëruar, sinonim të fjalës gjykatë, ndërsa në FSKSH 1974 si dhe në FSHSK 1981 e ndeshim si barasvlerës për termin "sudnica" të serbokroatishtes, me kuptimin "sallë gjyqi" (Krahaso: sud - gjykatë, sudnica - gjykatore), pra me kuptim tjetër nga ai që është shënuar në FGJSSH.

Edhe kjo trajtë, mund të thuhet se semantikisht nuk del e lejueshme.

Pse ndodh kështu, ku qëndron papërshtatshmëria e saj?

Si përgjigje lidhur me këto pyetje del e nevojshme të përmenden këto dy vërjetje:

e para, ka të bëjë me faktin se për emërtimin e vendshërbesës është dyfishuar prapashtesa për të njëjtin koncept pa kurrfarë nevojë. Krahaso gjykatë (gjyk+ATË): gjyk/(oj) +AT(Ë)+TORE gjykattore gjykatore dhe

e dyta, lidhet me faktin se vetë fjalë-tema gjykatë- si emër i prejardhur (gjyk+ATË) nuk i plotëson kriteret e një emër-teme fjalëformuese për emërtimin e një vendshërbese, siç e ka nocionin togfjalëshi "**sallë gjyqi**", ashtu siç mund të përdoret normalisht, por edhe mund të njëfjalëzohet, por në mënyrë tjetër. Siç dihet nga fjala **gjyq** del emri **gjyqtar** e për konceptin "**sallë gjyqi**" d.m.th. vendi ku kryhet procesi i gjyqit (gjykimit) pa pengesa mund të dalë përftesa **gjyqtore**, trajtë kjo që herë - herë ndeshet në gjuhën tonë të shkrimit si p.sh. TVP, më 10. XI. 1985, ora 10.15, por që kemi pasur rast ta ndeshim edhe në burime të tjera, si në gazetën "Rilindja" etj.

Sipas kësaj që po rekomandohet në këtë punim për ne nuk do të ishte aspak befasi, nëse si sinonin i togfjalëshit "**sallë gjyqi**" përkrah fjalës **gjyqtore** të dalë edhe emërtimi **gjykimtore**. Që të dyja këto trajta: **gjyqtore** dhe **gjykimtore** mund të zberthehen: vendthi (salla) ku bëhet (mbahet) **gjyqi** a **gjykimi**.

Vërejtje të ngjashme mund të jepen edhe për shembujt e tjerë të këtij grupi emërtime, siç është edhe rasti kopështore që del

në FGJSSH me kuptimin kopësht i vogël, por edhe si barasvlerës i termit togfjalësh "kopësht fëmijësh". Edhe në FSHS (1981) del si barasvlerës për "de_ji vrti_" dhe për "de_je zabavište" të serbokroatishtes, d. m. th. çerdhe fëmijësh a kopësht fëmijësh.

Po e përmend edhe faktin se në parim del shumë i drejtë gjykimi i studiuesit M. Halimi <§F M. Halimi, artikulli i cituar në shënimin 67, i botuar te "Gjendja e terminologjisë shqipe në Jugosllavi, Prishtinë 1988 f. 41.> , i cili për emërtimin e **kazantore** të përdorur si barasvlerës për **kotlarnica** të serbokroatishtes (krahaso: kotao - kazan (kaldo)) thotë se nuk duhet përdorur, dhe në vend të tij propozon trajtën **avulltore**, pasi që është fjala për kazanat (vendshërbesën) ku prodhohet avulli për ngrohje. Është e vërtetë se semantikisht **avulltore** ashtu si edhe **ngrohtore** del më e zbërthyeshme për nocionin në fjalë sesa trajta kazantore. Do të shtonim lidhur me këtë se edhe emërtimi **kazantore** mund të qëndrojë si emërtim vendshërbesë, por vetëm në ato raste kur me të tregohet dyqani (vendshërbesa) në të cilin punohen (riparohen) a shiten kazanat, si mjete konkrete.

Po e përmend, edhe më kalimthi, emërtimin **pengtore** <§F H. Gorani, vepra e cituar në shënimin 49.> të regjistruar në fjalorët e H. Goranit si barasvlerës të termit **zalagaonica** të serbokroatishtes me kuptimin: "vendi ku lihen sendet peng". Pasiqë kuptimi i emrit peng del mjaft përgjithësues, ngase me një trajtë të tillë nuk tregohet vetëm një send konkret, sepse peng mund konsiderohet a kuptohet edhe një njeri (fjala e tij para dëshmitarëve) a diçka me vlerë monetare si çek që deponohet me firmosje si dhe me forma të ndryshme hipotekore etj., të cilat s` mund të lihen peng si sende konkrete b.f. në vendshërbesë për një kohë etj., mendoj se për konceptin e tillë më mirë do të qëndronte trajta **pengcëtore**, sepse sipas FGJSSH, pikërisht sendet që lihen peng quhen **pengcë/ pengca**. Prandaj vendshërbesa a "vendi ku lihen sendet peng" më tepër ka logjikë të emërtohet **pengcëtore**, sipas sendit konkret të emërtuar në temën fjalëformuese sesa pengtore.

Po kështu mund të zbërthehen edhe emërtimet e tjera të këtij nënllloji.

3) Janë të brishta sa i përket qëndrueshmërisë semantike edhe disa emërtime të vendshërbesave më -TORE, të formuara mbi bazë të një emri të vepruesit, siç janë shembujt: avokatore, rrëfyestore dhe prestore.

Lidhur me këtë me të drejtë mund të shtrohet pyetja: Pse trajtat e tillë i quajmë si trajta të brishta, përkatësisht të diskutueshme, kur ato i ndeshim të regjistruara në FGJSSH?

Dy janë faktet që e bëjnë të diskutueshme qëndrueshmërinë e tyre:

Së pari, është mënyra e tillë e fjalëformimit, e cila nuk përputhet me semantikën e përkufizimit të dhënë aktualisht për nocionin e vendshërbesës, sepse njeriu si veprues nuk paraqitet si mjet me të cilin përdorohet (manipulohet), por ai del si veprimtar që vetë, si të themi, manipulon. Pra te shembujt e tillë kemi të bëjmë me një segment të ri semantik, të ndryshëm nga dy segmentet bazë që e përkufizonin nocionin e vendshërbesës.

Së dyti, është zgjidhja praktike, ngase rastet e tilla, siç është cekur më përpara, kur si temë fjalëformuese të vendshërbesës qëndron një emër vepruesi nuk praktikohet prapashtesa -TORE, por prapashtesa -I. Po i rikujtojmë disa shembuj: drejtor drejtori, sekretar sekretari, vreshtar vreshtari, pylltar pylltari, zdrukthëtar zdrukthëtari etj. Sipas kësaj rregullsie edhe vendshërbesa mbi bazë të fjalë-temës prodhuese: "avokat-, rrëfyës-, pres- (prerës-)... " duhet të dilte me prapashtesën -I: avokati, rrëfyesi, presi (prerësi). Mirëpo sipas koncept-idesë që po lancohet në këtë punim jo pa arsye praktike dhe pa mbështetje logjike, dy rastet e fundit do ta gjenin zgjidhjen te tema prejfoljore a foljore: vend-rrëfim - rrëfimore, vend-prerje - prerëtoare (prerës, prerëtar). Nuk përjashtohet mundësia që në të ardhshmen qoftë edhe të ndihmuara nga ndonjë nuancim i ri semantik të paraqiten fituese të konkurrencës ndaj trajtave rrëfyestore a rrëfyetore, përkatësisht prestore trajtat përkatësisht: **rrëfimore, prerëtoare.**

Sido që të jetë, vetë prania e trajtave të tilla në FGJSSH si forma me prestigj norme flet së pari për nevojën që ndjen gjuha letrare për emërtimet përkatëse të vendshërbesave dhe së dyti flet për nevojën e diskutimit dhe vlerësimit të formave të tilla. Mendoj se hëpërhë emërtimet më -TORE mbi bazë të një emri të vepruesit nuk duhen parapëlqyer, ngase mënyrat e tjera të formimit të vendshërbesave dalin më të kapshme, siç është ajo me prapashtesën -I, por sidoqoftë kjo dukuri duhet të ndiqet.

4. Formimet me prapashtesën -TORE i ndeshim edhe në fushën e krijimtarisë letrare (artistike), d.m.th. koncepti i "vendshërbesës" del në mënyrë të fyturuar, përkatësisht i formëzuar në hapësirën krijuese imagjinatore të krijimtarit. Për këtë fakt nuk kam konsultuar shumë burime, por megjithatë shembuj të tillë kam vërejtur. Dihet fakti se stili poetik është stili që ka liri më të madhe manovrimi. Jo rrallë herë ka ndodhur që krijuesi i caktuar letrar të krijojë ndonjë emërtim (fjalë të re), e cila asociacionisht ka hapur shtigje të reja për t`u përdorur edhe në nënfusha të tjera semantike. Nuk janë të rrallë shembujt që nga stili letrar kanë kaluar në nënfusha të tjera semantike dhe si të

tilla të shërbejnë si mostër fjalëformimi edhe në stile të tjera përkatëse funksionale.

Kur kemi parasysh atë që paksa u cek, por që më shumë lë vend për t`u nënkuptuar aksiomativisht, këtu do të sjellë vetëm ndonjë shembull sa për ilustrim të nxjerrë nga burime letrare të caktuara. Nga vepra poetike L. Poradeci po kujtojmë fjalën: **adhurimto**. Në revisten letrare "Jeta e re" kam vërejtur emërtimin **fshehtore**. Te gazeta "Fjala": **mbyllto**, **shartore**. Te gazeta "Bujku": **mundimto** etj.

Siç u cek më përpara krijuesi letrar është i lirë të farkëtojë emërtime të tilla "vendshërbesash", të cilat nuk qëndrojnë semantikisht në përputhje me normën e caktuar në stilin neutral, si të thuash, në botën reale, por me kohë ato mund të përlligjen madje në disa nënfusha semantike. Ç`është e drejta, në gjuhën poetike çdo fjalë e tillë del e normëzuar, prandaj risimet e tillat duhet të vlerësohen nga ajo pikëpamje. Kështu që mund të thuhet se në stilin neutral nuk qëndrojnë si p.sh. leksemat: shkëlqimto, përdëllimto, çikërrimto, gogësimto, plojëto etj. por ato në stilin letrar (poetik) mund të qëndrojnë për bukuri, edhepse siç dihet nga tema fjalëformuese e tyre nuk tregohet asnjë gjësend konkret, përkatësisht asnjë veprim që kryhet dhe kuptimisht do të jetë i zbatueshëm për konceptin e vendshërbesës me -TORE sipas përkufizimit të dhënë në stilit asnjanes.

Më përpara, është zënë në gojë rasti i fjalëve sëmuretore, madje edhe mundimto, veçimto etj. si emërtime specifike, me kuptim asnjanes në zhargonin terminologjik të të burgosurve të ne, por që mund të përgjithësohet. P.sh. *mundimto* është përdorur si barasvlerës për *mu_ionica* të serbishtes d.m.th. "dhomë speciale mundimi" (Shih: të revista "Zëri" dt. 31.XII.94 f.16), ose **veçimto** për *samica* d.m.th. "dhoma veçimi" të cilat quhen edhe *biruca*, *qeli* e *vetmi* etj. <\$F Shih te gazeta "Fjala" nr. 14/85 f 13; 18. VII. 1993 f. 6; revista "Jeta e re" nr. 4/84 f. 620; gazeta "Bujku", 2. IV. 1994 f. V etj.>

Gjithsesi mënyra e tillë e fjalëformimit në fushën e krijimtarisë letrare ndihmon ravijëzimin e modelit fjalëformues të vendshërbesave me -TORE në fushën e terminologjisë teknike - shkencore të gjuhës sonë standarde kombëtare.

S`do mend se semantika e përkufizimit aktual të vendshërbesave me -TORE shërben dhe do të shërbejë si kriter vlerësues për qëndrueshmërinë e një sërë emërtimeve me -TORE, të cilat mund të favorizohen, por edhe mund të cilësohen si të paqëndrueshme, varësisht nga nevoja që ndjehet për to, por edhe varësisht nga rregullsitë e caktuara fjalëformuese që dalin të mbështetura, qoftë në aspektin e ndërtimit, qoftë në aspektin semantik.

**(7) Vendi i formantit -TORE në kuadër të
strukturës së prapashtesave speciale
në vargun e formimit të emrave nga
tema e njëjtë fjalëformuese**

Padyshim arsyeja e parë pse formimi i emërtimeve të vendshërbesave me prapashtesën -TORE gjeti dhe gjen truall të përshtatshëm për zhvillim e zbatim qëndron në faktin se për një gjë të tillë pati nevojë vetë gjuha, përkatësisht bashkësia folëse, nevojë kjo që vjen nga vetë jeta si rezultat i zhvillimit të përgjithshëm shoqëror e ekonomik, por edhe si rezultat i ngritjes së vetëdijes kombëtare e gjuhësore të kësaj bashkësie në rrethana të caktuara historike.

Mbështetja dhe pranimi relativisht i madh i emërtimeve të vendshërbesave më -TORE në gjuhën tonë mund të konsiderohet si një vazhdimësi e prirjes së mëhershme fjalëformuese e jo si një dukuri spontane, që ka ngjarë, si me thënë, brenda ditës. Pra parapëlqimi i mënyrës së formimeve të tilla sot mund të cilësohet si një sforcim i modelit ekzistues.

Është e vërtetë se sot për sot shumë krijime librore të vendshërbesave më -TORE janë përgjithësuar dhe mund të konsiderohen pamëdyshje si model e në anën tjetër disa shembuj ende paraqiten si trajta të brishta, por që edhe ato pritet të përgjithësohen në të ardhmen jo të largët, nëse nuk dalin pengesa e ledhe të papritura objektive jashtëgjuhësore që të ndërrojnë kahet e zhvillimit dhe të sendërtimit të prirjeve të tilla ekzistuese.

Mbi bazë të shumësisë së shembujve të vendshërbesave që dalin në jetën tonë të përditshme me prapashtesën -TORE dhe sipas prirjes për shumim të mëtejshëm të tyre mund të arrihet në përfundimin se prapashtesa -TORE mund të inkorporohet pa vështirësi në kuadër të strukturës së prapashtesave speciale për formimin e emrave të profilit të caktuar. Me fjalë të tjera mund të kontatohet se formanti -TORE del i arrirë për të qëndruar përkrah formanteve të tjera të specializuara brenda tufës a vargut fjalëformues për formimin e emrave, qoftë mbi bazë të temës së njëjtë emërore, qoftë mbi bazë të një teme foljore, por me profilim të qartë dedikuar nergut emërtimit të vendshërbesave më -TORE.

Më poshtë po paraqesim skemën përkatëse, me të cilën përpigëmi ta ilustruajmë sadopak atë që u tha më përpara rreth vendit të prapashtesës -TORE në kuadër të strukturës së prapashtesave të tjera speciale. Për këtë qëllim u zgjodhën disa fjalë-tema fjalëformuese si më poshtë:

- emra sendesh konkrete: vegël-, gjellë-, vegjë-;
- emra prejfolorë të veprimit: pushim-, këmbim-, lojë;
- pjesore të foljeve përkatëse: ndezë-, mbathë-, njehë-.

Shembujt e sjellë si fjalë konkretë ndajshtesore në skemën më poshtë ose janë në përdorim të përditshëm ose kanë mundësi të dalin pa pengesa në bazë të modeleve të gjalla, të cilat veprojnë sot në strukturës e emërformimit të gjuhës sonë standarde:

S k e m a

e zhvillimit të disa fjalë-temave sipas prapashtesave speciale

Prapashtesa speciale	Përkufizimi i nënfushës semantike	Shembujt ekzistues a të mundshëm
1. -TAR -Ë/S	Emërtime të njërëve sipas veprimtarisë (profesionit)	vegëltar, vegjëtar, harktar pushimtar, këmbimtar, lojëtar, ndezës e ndezëtar, mbathës e mbathëtar, njehës e njehëtar, gjellëtar.
2. -I/ -ARI, -TARI, -SI, -TI; -ULLI;	Emërtime të degëve të ekonomisë, të emrave kolektivë a	vegjëtari, vegëltari, gjellëtari, harkëtar, njehësi, mbathësi,

- | | | |
|---------|-----------|------------------------------------|
| -SHMËRI | abstraktë | mbathtari ndezulli,
ndëzshmëri, |
|---------|-----------|------------------------------------|
- këmbimësi.
3. -ORE, -OR, Emërtime të mjeteve vegjore, harkore, veglore,
 -(Ë)S, SOR, a të gjësendeve veglëri, pushimore, ndëzës,
 -SORE, -RI, konkrete ndezcë, njehësor,
 ndezësore,
 -CË, -URINA <\$F Të vihet re shumësia heterogjene e
 prapashtesave fjalëformuese për emërtimin e sendeve konkrete.>
 ndezurina, mbathurina.
4. -TORE Emërtime të vëndshërbesave vëgjëtore, hark(ë)tore,
 gjëllëtore, vegëltore,
 pushimtore, këmbimtore,
 lojëtare, ndëzëtore,
 mbathëtore, njehëtore.
-

Siç mund të shihet nga skema e mësipërme në bazë të prapashtesës speciale mund të përcaktohet edhe kuptimi a përkatësia e emrit përkatës sipas nënfushës së caktuar semantike. Edhe pse secila fjalë temë-prodhuese nuk ka zhvillim të njëjtë, siç ka p.sh. emër-tema **vegël-**: vegëltar, vegëltari, veglore, vegëltore ose pjesorja: **mbathë-**: mbathës, mbath(ë)tar, mbathëtari, mbathore a mbathurina, mbath(ë)tore - parimisht qëndron konstatimi se të gjithë shembujt e tjerë, dhe jo vetëm këta që janë cekur këtu, kanë mundësi të kenë zhvillim të tillë. Me një fjalë, mënyra e tillë fjalëformuese ka karakter të hapur dhe normalisht të lejueshëm, varësisht nga konteksti a nevoja që mund të shfaqet në situata a rrethana të caktuara ligjërimore.

Pra pa hyrë në profilime e degëzime të tjera ku formantet e caktuar dalin të specializuara a me mbizotërim të theksuar siç del b.f. prapashtesa -AS për emërtimin e njërëzve sipas vëndbanimit, prapashtesa -ATORE për emërtimin e grave sipas veprimtarisë (veprimtarisë artizanale etj.), prapashtesa -ISHTË për emërtimin e vendeve ku rritet a gjendet sendi me shumicë i cili emërtohet në temën fjalëformuese etj., mund të nxirret përfundimi se prapashtesa -TORE del si një formant specifik me prirje specializimi për emërtimin e vëndshërbesave, përkatësisht të një vëndthi a lokali ku përdorohet sendi i emërtuar në temën fjalëformuese ose tregohet një vënd ku kryhet a mund të kryhet veprimi i cekur në temën fjalëformuese të emërtimit përkatës.

Faktet që u paraqiten më sipër flasin mjaft bindshëm për karakterin specializues të prapashtesës -TORE për nënfushën e caktuar semantike në fjalë, Prandaj kuadrot tanë si dhe studiuësit

e hartuesit e burimeve normative dhe sidomos farkëtuesit e fjalëve të reja, ashtu si edhe zbatuesit e normës letrare në përgjithësi duhen të kenë parasysh pikërisht këto fakte të pamohueshme dhe mjaft bindëse.

Në gjuhësinë e përgjithshme është fakt i njohur se specializimi i formanteve të caktuara del si rezultat i formëzimit dhe i konsolidimit të modeleve të caktuara fjalëformuese, ndërsa krijimi i modeleve të tilla të qëndrueshme është karakteristikë e gjuhëve të zhvilluara dhe të përpunuara, prandaj me përlligjjen e prapashtesës -TORE si formant special për emërtimin e vendshërbesave jo vetëm se do të lehtësohet formimi i termave të rinj aktualisht shumë të nevojshëm, por kjo do të ndikonte njëherazi edhe në ngritjen e prestigjit të gjuhës sonë standarde.

(8) Rreth përcaktimit të disa rregullsive të përgjithshme për përdorimin e emërtimeve të vendshërbesave më -TORE në shqipen standarde kombëtare

Nga ajo që u shtrua dhe u konstatua në nëntitujt e mëparshëm, duke qenë i pozicionuar në suaza të vijës së lejueshme që del nga parimi ortologjik, i standardizimit të gjuhës sonë dhe në përputhje me politikën gjuhësore, përkatësisht "planifikimin gjuhësor" në fushën e fjalëformimit, mund të përcaktohen këto rregullsi të përgjithshme lidhur me konceptimin, drejtformimin dhe drejtpërdorimin e vendshërbesave më -TORE në shqipen standarde,

rregullsi këto që njëherazi mund të quhen edhe përfundime të përgjithshme dhe të veçanta, qoftë vetëm në ndonjë pikë, qoftë përgjirthësisht pasi dalin si rezultat i analizës së kësaj teme në mënyrë mjaft të përthelluar:

1) Me vërtetesën e mëvetësisë së prapashtesës -TORE në kuadër të strukturës së prapashtesave fjalëformuese të tjera të gjuhës sonë, konsiderohen si të plotësuar, si të thuash, të gjitha parakushtet e kriteret që prapashtesa -TORE të trajtohet pa ngurrim si prapashtesë e mëvetësishtme emërformuese, fakt ky që duhet të shënohet qartë në të gjitha burimet përkatëse të gjuhës sonë dhe mos të mbetet si deri tashti nën hijen e prapashtesave të tjera.

Madje duke e pasur parasysh aktivitetin dhe prodhimtarinë e saj si ndajshesë në formimin e vendshërbesave ajo meriton të perceptohet si një formant i arrirë me prirje të pamohueshme specializimi për emërtimet në fjalë.

2) Aktivizimi a dalja në jetën gjuhësore e prapashtesës -TORE për emërtimin e vendshërbesave vihet re që në etapën e Rilindjes sonë Kombëtare, kur edhe hetohet një qasje e re në përgjithësi ndaj elementeve vendëse të fjalëformimit. Ka shenja se që në atë etapë elementi -TORE del me fizionomi të formëzuar për formimin e emrave dhe të mbiemrave të shqipes përgjithësisht, por edhe në veçanti për të zëvendësuar prapashtesat a siprapashtesat përkatëse të gjuhëve të huaja, konkretisht për konceptin e vendshërbesave, siç është formanti **-hane** i turqishtes osmane, **-eria** të italishtes, **-tekë (-theke)** të greqishtes, më vonë të formantit **-nica** të serbishtes etj. Për suksesin a zhvillimin intensiv të një veprimi të tillë flet fakti i rritjes suksesive të numrit të emërtimeve të vendshërbesave më -TORE prej faze në fazë që nga periudha e Rilindjes e këndej. Ky fakt dëshmohet nga prania e tyre në burimet e caktuara leksikografike që nga Fjalori i K. Kristoforidhit (1904) deri FGJSSH (1980) si dhe në gjuhën tonë të shkrimit sot.

Me ndryshimin e sistemeve shoqërore ekonomike dhe me begatimin e jetës ekonomike e kulturore d.m.th. edhe me begatimin e formave të caktuara të degëve të ekonomisë, sidomos me rikthimin e aktivizimin e veprimtarisë private, të të ashtuquajturës "ekonomi e vogël" a "biznes i vogël", u rilind, si të themi edhe nevoja për emërtimin e vendshërbesave të caktuara, madje edhe të atyre më -TORE, që konsideroheshin të pasivizuara më përpara. Kështu përveç emërtimeve të reja doli dhe del e nevojshme të riaktivizohen edhe disa terma që në burime të caktuara i ndeshim të cilësuar me etiketën "të vjetëruara" si p. sh.: avokatore, shtyptore, djathtore, bukëtoare, shkresëtoare etj.

3) Aktualisht, në rrethanat e reja shoqërore, politike e

ekonomike që ndodhemi, kam parasysh raportin në marrëdhëniet ndërshqiptare, duhet shfrytëzuar rastin që edhe përvojat lidhur me gjuhën kemi mundësi t'i shfrytëzojmë dhe vlerësojmë në mënyrë më të qetë dhe pa paragjykime. Pra ato jo vetëm se duhen vlerësuar, por edhe duhet të favorizohet shtrirja e tyre për t'u përvetësuar në mbarë truallin e shqipes. Me fjalë të tjera s' ka arsye që të mos jenë të mbarë shqipes, së paku si sinonime përkrah formave togfjalësha e të tjera f.v. emërtimet e vendshërbesave si: mishtore, pëllumbëtoare, zogëtoare, avulltoare, mielltoare, skitore e skijimtoare, këmbimtoare, kursimtoare, mbushëtoare, ndezëtoare etj. Natyrisht përdorimi a shtrirja e tyre nuk duhet të paraqitet si njëfarë ofrimi i dhunshëm, por të fillojë të përdoret së pari pa teprime në përputhje me stilin funksional përkatës dhe në kontekst semantik që situatat dhe rrethanat e caktuara e lejojnë dhe pastaj gradualisht trajta përkatëse do të marrë "qytetarinë" e duhur.

4) Në terminologjinë teknike-shkencore është e njohur prirja që të njëfjalëzohen togfjalëshat dhe frazeologjizmat e caktuar. Kjo ndodh edhe për arsye praktike. Në shumicën e rasteve termi njëfjalësh ekonomikisht del më i përdorshëm, ngase më me lehtësi mund të futet në rubrikat e caktuara të evidencimit a të nomenklaturës dhe se në raste të tilla semantika nuk lëndohet. Ky fakt është më i vërejtshëm me rastin e kompilimit a të përpunimit analitik të të dhënave, në procesin e përkthimit si dhe të hartimit të dokumenteve të caktuara teknike në përgjithësi, siç është b. f. dokumentacioni teknik, elaboratet, skicat teknike, skemat e dokumentet e ngjashme, të nevojshme këto për punë praktike në ndërmarrje prodhimi etj. Për këtë arsye propozojmë që format më -TORE të jenë të lira në përdorim dhe të gjejnë vendin e caktuar në nomenklaturën përkatëse. Futja e tyre në jetë mund të bëhet, së paku, në formë sinonimie e pastaj mund të qëndrojnë edhe si të mëvetësishme, varësisht nga konteksti, siç u cek në pikën më sipër.

Në bazë të prirjeve fjalëformuese për emërtimin e vendshërbesave më -TORE, që u theksuan në këtë punim, duhet të kihet në konsideratë shembujt sinonimike si më poshtë: dhomë mësimi - mësimitore, qendër vëzhgimi - vëzhgimtoare, qendër rehabilitimi - rehabilitimtoare, vend dëgjimi - dëgjimtoare, kabinë përgjimi - përgjimtoare, qendër mjekimi - mjekimtoare, shtëpi pushimi - pushimtoare, shteg vrapimi - vrapimtoare, zyra e kontrollit - kontrollimtoare, depo - zgjyre - zgjyretore, shtëpi e lindjes - lindëtoare, arkë (bankë) kursimi - kursimtoare, shteg skijimi - skijimtoare, vend strehimi - strehimtoare, kënd për shlodhje - shlodhëtoare, shitore vezësh - vezëtoare e kështu me radhë.

Fundi i fundit sinonimia është një dukuri leksikore e pëlqyeshme, me të cilën zhvillohet gjuha përgjithësisht, por me një veprim të tillë edhe i jepet mundësi përdoruesit të bëjë specifikime dhe përzgjedhje sa më të larmishme të trajtës së

caktuar varësisht nga situata a rrethanat e caktuara, qoftë me profilimin e nënfushave të caktuara të terminologjisë tekniko-shkencore, qoftë për nuancime të caktuara në kuadër të stilit letrar.

Për rastet që u përmenden këtu, të cilat mund të shërbejnë më tepër edhe si orientim parimor mund të thuhet se si togfjalëshi ashtu edhe emërtimi njëfjalësh nuk rrezikojnë përdorimin e njëri tjetrit në ligjërimin përkatës, përkundrazi që të dyja trajtat përplotësojnë të shprehurit sa më të mirë e të plotë lidhur me nocionin e caktuar, por në rast nevojë ato edhe mund të zërthehen a të marrin kuptime të ndryshme d. m. th. të marrin kuptime të reja, varësisht nga kërkesat që shtrohen para ligjërimin.

5) Në rastet kur emërtimi njëfjalësh del shumëtrajtësh dhe është fjala për të njëjtin koncept është e udhës që për qëllime terminologjike e të tjera të parapëlqehet vetëm njëra trajtë a njëri version, si p. sh.: **bleto**re a **bletto**re për bletari, **sapunto**re për sapunishtë, **ajkëto**re për ajkore, **hekurto**re për hekurishtë, **djathëto**re për djathore, **llogarito**re për llogari a llogaritari, **këmishëto**re për këmishari, **peshkëto**re për peshkojë, **pastrimto**re për pastrim pastërtore a pastrimore, **strehimto**re për strehë strehim a strehimore, **rrëfimtore** për rrëfystore a rrëfyetore, **drekimto**re për drekore, **armëto**re për armëtari, **këngëto**re për këngëtari, **patinëto**re për patinore, **vrapimto**re për vrapore, **veçimto**re për vetmi (qeli, birucë), **drithto**re për drithore a drithnik etj. <§F Shembujt janë nxjerrë nga burimet përkatëse relevante.>

Meqenëse është fjala, siç u tha më sipër, për koncepte termash terminologjike, sipas mendimit tim, është e udhës që të favorizohet trajta me prapashtesën -TORE, si formë e vetme normative, ngase kjo mënyrë fjalëformimi plotëson të gjitha parakushtet që të ngrihet në model fjalëformimi, pikërisht për emërtimin e vendshërbesave dhe me një favorizim fare të vogël mund të përthithë në gjirin e vet edhe shembuj të tjerë të kësaj natyre.

6) Është mirë të lihen në konkurrencë të lirë (do me thënë jo urdhërisht) formimet më -TORE të shqipes përkrah fjalë-termave të huazuar të vendshërbesave nga gjuhët e huaja sigurisht për nevojë të kulturës së përgjithshme, për nevoja komerciale e profilizimesh të tjera, qoftë fjalë me cilësi ndërkombëtarizmi, qoftë pa atë cilësi, por që janë në përdorim të përgjithshëm. Sipas mendimit tim s' ka arsye të mos jenë të lejueshme në konkurrencë lojale edhe format e shqipes më -TORE, kundrejt atyre me origjinë të huaj. Në vazhdim do t'i përmend disa shembuj konkretë duke shënuar përballë fjalës së huaj trajtën korresponduese të gjuhës shqipe, të merenduara sipas origjinës a mbi bazë (formë) të gjuhës së huaj:

- a) turq.: han - fjetore a fjettore, kafehane - kafetore;
 b) greq.: kafene - kafetore, diskotekë - diskëtore;
 c) angl.: brojler - zogëtore, market - tregtore;
 ç) fr. : butik - shitore a shittore, kafe - kafetore, maternitet
 - lindëtore, servis - shërbimtore, restorant -
 gjellëtore, lavazh - larëtore (autolarje);
 d) ital.(lat.): gomesteri - gomëtore, farmaci - barnatore,
 pishinë - notimtore (freskimtore), korzo - shëtitorë
 a shëtittore, piceri - pitetore a pittore, senatorium
 - shërimtore, auditor - dëgjimtore, lamineri -
 pëtëzimtore, observator - vëzhgimtore, kazino -
 lojëtorë, kinkaleri - çikërrimtore;
 dh) serb.: kafiq - kafetore a kafaz (kafiq -formë serbe si
 duket refleks i gjermanishtes "Käfig" me kuptimin
 primitiv: "kafaz për kafshë a shpezë) etj. <§F Për
 këtë janë shfrytëzuar kryesisht fjalorët enciklopedikë si dhe
 fjalorët e fjalëve ndërkombëtare.>

Kam bindjen se po të përdoreshim së paku hera- hera si sinonime format e shqipes përkrah huazimeve të mësipërme për një kohë të shkurtër këto d.m.th. "shqipërimet" do të fitonin qytetarinë e nevojshme si trajta me prestigj të fituar normëzues.

Është e vërtetë se trajtat e gjuhës shqipe përkrah trajtave (reklamave) të njohura të huaja do të jenë edhe më atraktive për mysafirët e jashtëm dhe gjithsesi më joshëse edhe për mysafirët e klientët vendës. Kryesore në biznes (veprimësi), siç dihet, është fitimi (interesi), përkatësisht shërbimi i mirë, me korrektësi e me sjellje të kulturuar, madje edhe reklama do të jetë më magjepse nëse mbart në vete specifikën a specialitetet vendëse. Sidoqoftë format e gjuhës shqipe s' bën të hidhen apriori si diçka "jashtë mode" a të qiten në harresë.

Animi në favor të formave të shqipes, pa e dëmtuar kuptimin e përgjithshëm, është detyrë jo vetëm morale, por edhe më shumë është një detyrim a akt njerëzishmërie që ia kemi borxh të kaluarës, të tashmes dhe të ardhmes sonë historike kombëtare.

7) Formimet me prapashtesën -TORE me nocion vendshërbese që i ndeshim me kuptim figurativ në fushën e krijimtarisë letrare, janë dëshmi e vitalitetit të modelit të qëndrueshëm fjalëformues të përftimeve me këtë formant. Dihet se përftimi dhe përdorimi i tyre në fushën e krijimtarisë letrare është e drejtë e vetë krijuesit që del nga nevoja që ndjen ai për të shprehur nuanca të caktuara të koncepteve të botës së tij shpirtërore subjektive me të cilat pasqyron realitetin e ashtuquajtur objektiv. Sigurisht shembujt si: arsimitore nga P. N. Luarasi, mësimtore, shkrimtore nga J. Bageri, sundimtore nga F. S. Noli, etj. edhe tashti mund të përdoren në stilin letrar (poetik) ashtu si adhurimtore që e përdor L. Poradeci

etj. si dhe të tjerët siç janë fjalët: fshehtore ("Jeta e re"), mbylltore ("Fjala"), mundimtore ("Bujku") etj., të cilat nuk mund të quhen si raste të vetmuara a të pa model.

Kam bindjen se poetët e krijuesit në përgjithësi tash e në të ardhshmen do të dinë të shfrytëzojnë edhe më mirë këtë dhurëti si të drejtë dhe mundësi që ua dhuron vetë sistemi fjalëformues i gjuhës sonë kombëtare. Kultivimi i formave më -TORE, të cilat shprehin një vend të caktuar në hapësirën imagjinatore të botës së poetit i jep krahas modelit emërformues të emërtimit të vendshërbesave më -TORE, në kuadër të strukturës së përgjithshme të formimit të emrave prejfoljorë a të emrave për emrash në veçanti, me të cilët tregohet nocioni i një vendi (lokali) të kufizuar ku kryhet një veprim i caktuar ose të një vendi ku përdorohet sendi i emërtuar në temën fjalëformuese të emërtimit përkatës.

P ë r f u n d i m

Mëvetësia e formantit -TORE si prapashtesë e gjuhës shqipe, si parakusht për specifikimin e saj, vërtetohet me faktin se formanti i tillë pavarësisht nga përgjegjësi -TOR i gjinisë mashkullore, me të cilin lidhet prejardhjesisht, ndeshet i përdorur në disa nënfusha semantike siç janë:

- emërtimet e grave sipas veprimtarisë,
- emërtimet nga bota bimore-shtazore,
- emërtimet e sendeve dhe të mjeteve konkrete,
- fjalë-termat gramatikorë si dhe
- emërtimet e vendshërbesave.

Sipas burimeve të caktuara leksikografike të konsultuara del se në katër nënfushat e para semantike numri i emërtimeve të tilla është i kufizuar dhe fare i vogël për nga numri, ndërsa në nënfushën e pestë d.m.th. tek emërtimet e vendshërbesave numri shembujve të tillë më -TORE shënon rritje suksesive prej burimi në burim.

Që nga etapa e Rilindjes sonë Kombëtare del e vërejtshme prapashtesa -TORE edhe për emërtimin e vendshërbesave. Dhe në këtë nënfushë kjo del e përdorur, goftë në formimin e fjalëve të reja, goftë në zëvendësimin e formanteve barasvlerëse të gjuhëve të huaja me të cilat gjuha shqipe ishte nën ndikim a në kontakt, siç është formanti **-hane** i turqishtes, formanti **-eria** i italishtes, ai **-nica** i serbishtes e të tjerë. Kështu që formanti i tillë për nënfushën e emërtimeve të vendshërbesave gjatë etapës së Pavarësisë e më vonë, jo vetëm se ka arritur të formësojë fizionominë autonome të një prapashtese të mëvetësishme në shqipe, por ai në kohën tonë, ka arritur edhe të vijëzohet si një prapashtesë me prirje specializimi, pikërisht për emërtimet e nënfushës semantike në fjalë.

Në konkurrencë a në rivalitet me prapashtesat e tjera sinonimike si -I (-ARI, TARI, -TI, -SI), -ISHTË (-ISHTE), -ATË, -AT, -INË, -ORE, -URË e ndonjë tjetër, prapashtesa -TORE doli me konkurrencë të fituar pothuajse tërësisht. Kjo ndodhi, me sa duket, për dy arsye: së pari, prapashtesat e tjera, ato më prodhime të tejkshëm paraqiten me origjinë të huaj dhe së dyti, që të gjitha ato pothuajse parësorisht ose paraqiten si raste shterpe ose dalin të angazhuara për nënfusha të tjera semantike, ndërkaq prapashtesa -TORE mbron origjinën vëndëse dhe kryekëput mbetet e ngarkuar vetëpërvetëm për formimin e emërtimeve të vendshërbesave.

Prapashtesa -TORE në burime të caktuara në situata dhe rrethana përkatëse del e ndërlidhur me prapashtesat simotra: -ATORE dhe -ORE. Nga analiza kundërvënëse që iu bë këtyre prapashtesave doli se secila nga ato prieret të specializohet për nënfusha të ndryshme semantike, kështu prapashtesa -ATORE del më e angazhuar në nënfushën e emërtimit të grave sipas veprimtarisë, prapashtesa -ORE del e ngarkuar në disa nënfusha, por spikat angazhimi i saj në emërtimin e sendeve a të mjeteve konkrete si dhe në formimin e kategorisë së mbiemrave, kurse prapashtes -TORE, siç u tha më sipër, pothuajse krejtësisht del e angazhuar për emërtimin e vendshërbesave.

Lidhur me përcaktimin e trajtës së temës fjalëformuese, goftë emërore, goftë foljore, ende kanë mbetur çështje të brishta, mirëpo në bazë të prirjes që del nga shembujt tashmë të qëndrueshëm u konstruktuan disa rregullsi duke e pasur për mbështetje më tepër anën semantike të temës fjalëformuese.

Së këtejmi doli:

a) si temë e mirëfilltë e vendshërbesës konsiderohet një emër sendi konkret (zakonisht jo i prejardhur), i cili mund të përdorohet (përpunohet, shitet etj.), përkatësisht një emër me të cilin shprehet një veprim, siç janë emrat prejfoljorë të veprimit me -IM që dalin nga foljet më -OJ, -EJ dhe -UAJ, por edhe me ndonjë emër tjetër, prej të cilit mund të zërthehet koncepti i veprimit.

b) si temë e mirefilltë e emërtimit të vendshërbesës konsiderohet edhe një trajtë foljore. Mirëpo lidhur me trajtat foljore si temë fjalëformuese e emrit të vendshërbesës për grupin e foljeve me bashkëtingëllore del më e pëlqyeshme trajta e pjesores së ish-gegërishtes letrare me prapashtesën temëformuese -Ë, ose, siç po thuhet, trajta e letrarishtes së sotme pa prapashtesën temëformuese -UR, ndërsa për grupin e foljeve me temë zanore e togzanor më e parapëlqyer del trajta e pjesores së letrarishtes së sotme me prapashtesën temëformuese -R(Ë) e jo trajta e shkurtër e ish gegërishtes letrare. Edhe pse lidhur me këtë ende ka raste të brishta një parapëlqim i tillë ka gjasa objektive të jetë i pranueshëm dhe të përgjithësohet.

Temat mbiemërore e ndajfoljore për emërtimin e vendshërbesave me -TORE nuk janë të pëlqyeshme, sepse nuk e përmbushin kërkesën semantike që del nga përkufizimi aktual i vendshërbesës, ashtu si edhe disa emra jo konkretë e konkretë të cilët nga natyra e tyre janë të papërdorueshëm në raport me realien.

Në bazë të shembujve tashmë të përligjur të emërtimeve të vendshërbesave me -TORE, kjo prapashtesë mund të zërë vendin e vet të posaçëm në kuadër të strukturës së prapashtesave speciale për formimin e tufës a të vargut të emrave nga tema e njëjtë

fjalëformuese si p.sh. nga temë-emri: vegël-, përkatësisht nga temë-pjesorja mbathë- të cilat kanë këtë zhvillim:

- vegël: vëgëltar, vëgëltari, veglore, veglurina, vëgëltore;
- mbathë-: mbathtar e mbathës, mbathtari, mbathore, mbathurina, mbath(ë)tore.

Siç dihet prapashtesa -TAR si dhe ajo -(Ë)S dalin të specializuara për emërtimin e njerëzve sipas veprimtarisë, prapashtesa -TAR/I për emërtimin e degës së caktuar ekonomike etj., ajo -ORE për emërtimin e gjësendeve konkrete, ndërsa prapashtesa -TORE për emërtimin e vendshërbesave, prandaj kjo strukturë fjalëformuese duhet të kihet parasysh nga të gjithë, sidomos nga farkëtuesit e fjalëve të reja të gjuhës sonë standarde.

Duke u mbështetur nga një mundësi e tillë dhe në bazë të fakteve të mohueshme u nxorën disa rregullsi të përgjithshme mbi përdorimin e vendshërbesave me -TORE në shqipen e sotme standarde, të cilat mund të rrumbullakësohen si vijon:

1. Prapashtesa -TORE duhet të cilësohet si formant i mëvetësishëm në kuadër të strukturës së prapashtesave emërformuese me prirje specializimi për emërtimin e vendshërbesave e mos të mbetet nën hijen e prapashtesave të tjera si -TOR ose -ORE a -ATORE, siç qëndron në burimet e deritashme përkatëse fjalëformuese normative.

2. Formanti -TORE në formimin e vendshërbesave duhet të vazhdojë të favorizohet si barasvlerës i plotë ndaj formanteve speciale të gjuhëve të huaja si -HANE të turqishtes (osmane), -ERIA të italishtes, -TEKË (THEKE) të greqishtes (së vjetër), -NICA të serbishtes etj. Krahaso: turq.kasaphane, it. mehelleria, serb. kasapnica (mesarnica), shq. mishtore; turq. eczane, it. farmacia, serb. apoteka, shq. barnatore etj.

3. Të përkrahet përgjithësimi a shtrirja e shembujve më -TORE në mbarë truallin shqipfolës me anë të shqipes standarde, pavarësisht nga zona se ku janë krijuar dhe pa marrë parasysh cilësinë e neologjizmës së brishtë që mund ta mbartin hëpërhë, si p.sh.: mishtore, kursimtare, lojëtare, këmbimtare etj.

4. Të përdoren si sinonime trajtat më -TORE ndaj togfjalëshave të qëndrueshëm që shprehin formalisht të njëjtin koncept, P.sh. bankë-këmbimi - këmbimtare, dyqan tregtie - tregtare, dyqan-shërbimi - shërbimtare etj.

5. Të parapëlqehen trajta më -TORE ndaj trajtave të tjera sinonimike me prapashtesa a forma të tjera, p.sh. pastrimtare në vënd: pastrim, pastrim, pastrimore, pastërtore; kafetore në vënd: kafehane, kafe, kafeteri, kafiq etj

6. Të përdoren si sinonime trajtat më -TORE pranë fjalëve ndërkombëtare, të cilat në mjaft raste edhe mund t'i zëvendësojnë

ato, p.sh.: vëzhgimtare - observator, petëzimtare - lamineri, lojëtare - kazino , larëtare - lavazh etj.

7. Të ndiqen dhe të nxiten formimet e vendshërbesave më -TORE (me kuptim figurativ) në fushën e krijimtarisë letrare (artistike) të cilat s' mund të kenë kufizime si p. sh.: shkëlqimtare, adhurimtare, fshehtore, rrezimtare, përndëzëtare etj.

Me sëndërtimin e rregullsive të tilla gjithnjë në suazat e parimit ortologjik të gjuhës sonë standarde mbi respektimin e prirjeve fjalëformuese me mjete të brendshme vendëse, katërcipërisht besohet se do të sforcohet edhe prestigji i gjuhës sonë standarde kombëtare si në rrafshin mbarë shqiptarë, ashtu edhe në raport me gjuhët tjera në suaza ndërkombëtare, sepse formëzimi i modeleve fjalëformuese është karakteristikë e gjuhëve të njohura të zhvilluara dhe të përpunuara.

Gjithsesi me përvetësimin dhe favorizimin e emërtimeve të të vendshërbesave më -TORE gjuha jonë e standardizuar do të fitojë shumë sidomos në shumimin e numrit të termave të nevojshëm të nënfushës semantike, qoftë nga lëmi i shkencave ekonomike e të tjera, por ajo njëherazi do të fitojë edhe në prestigj, prandaj këto fakte duhet t'i kenë parasysh, jo vetëm gjuhëtarët, përkthyesit e specialistët e degëve të profileve të caktuara të veprimtarive përkatëse, por edhe faktorët e tjerë shoqërorë e shtetërorë, ndër të cilët do të përmendja ata të masmedia-s e në veçanti pushtetarët, zyrtarët e sidomos nëpunësit përgjegjës të angazhuar zyrtarisht për regjistrimin e ndërmarrjeve dhe të firmave përkatëse, qoftë të sektorit shtetëror, qoftë të atij privat, i cili fatmirësisht tashti ka filluar të lulëzojë dhe do të ketë perspektivë.

Me një fjalë, me rastin e regjistrimit a të titullimit të emërtimeve të caktuara duhet bërë edhe sugjerime, vërejtje, madje edhe intervenime të nevojshme gjuhësore.

Së fundi, nuk duhet lejuar të regjistrohen lloj lloj firmash e reklamash pa kriter, të cilat ia zënë frymën traditës pozitive të gjuhës sonë dhe si të tilla pengojnë frymëmarrjen e lirë të zhvillimit të gjuhës sonë kombëtare mbi bazë të prirjes që e shpjen përpara atë traditë pozitive.

Gjithsesi përkujdesja për gjuhën e ndaj gjuhës sonë letrare edhe në këtë pikë duhet të jetë më në nivel, me një fjalë ndërgjegjësimi ndaj pastërtisë së gjuhës gjuhës sonë në të gjitha sferat e jetës duhet të kuptohet intelektualisht si një detyrim a akt moral dhe qytetar në shkallë kombëtare.

Përmbyllje (rezyme)

Në punimin "Formanti -TORE si prapashtesë e mëvetësishme në shqipe me prirje specializimi për emërtimin e vendshërbesave" që në fillim sqarohet kuptimi leksikor i fjalë-neologjizmës *vendshërbesë*, me të cilën kuptohet "një vendth a lokal i kufizuar (i tregtisë a i shërbimit), ku përdorohet sendi i emërtuar në temën fjalëformuese të emërtimit, përkatësisht vendthi a lokali ku kryhet një veprim a destinim, i cili ka lidhje kuptimore me temën fjalëformuese të emërtimit të caktuar". Po ashtu në "hyrje" sqarohet gjendja se si është përfillur ky formant në sytë e gjuhëtarëve tanë dhe paraqiten kërkesat që shtrohen lidhur me këtë temë.

Në nëntitullin e parë për të dëshmuar kështu mëvetësinë e kësaj prapashtese analizohet përdorimi i saj sipas nënfushave të caktuara semantike ndër të cilat më e theksuar del nënfusha e emërtimit të vendshërbesave. Dalja e prapashtesës -TORE në këtë funksion mund të hetohet që nga etapa e Rilindjes e këndeje duke shënuar rritje suksesive të numrit.

Në punim në nëntitujt e tjerë, përveç raportit kundërvënës që ka formanti -TORE me prapashtesat e tjera rivale e konkurrenente si dhe me simotrat -ATORE dhe -ORE, ndaj të cilave kjo del mbizotëruese, ngase ato dalin të zëna për nënfusha të tjera semantike, zë vend të veçantë edhe analiza rreth përcaktimit të temës fjalëformuese të emërtimeve të vendshërbesave më -TORE, qoftë mbi temë emërore, qoftë mbi temë foljore. Në analizë zbulohen, si të themi, ligjësitë, prirjet dhe mundësitë për zgjidhjen e çështjeve të diskutueshme.

Në bazë të fakteve që rezultojnë nga analiza jepen ide të reja e propozime se si është më mirë të veprohet për të mbuluar tërë fushën semantike të vendshërbesave mbi bazë të temave fjalëformuese emërore e foljore. Në punim mbështetet prirja që si temë emërore të shfrytëzohet parësorisht emërorja njëjës e emrit në trajtën e pashquar si p.sh.: mishtore, qumështore, lëkurëtoje etj., madje edhe te foljet më -OJ -EJ dhe -UAJ të favorizohet si temë prodhuese përfaqësuese jo ndonjë trajtë foljore, por emri i veprimit më -IM, tipi: vezhgimtoje, këmbimtoje etj., ndërsa për foljet me temë në bashkëtingëllore si temë prodhuese e emërtimit të vazhdojë të shërbejë si trajtë përfaqësuese pjesorja e ish-gegërishtës letrare, tipi: ndezëtoje, pjekëtoje, mbathëtoje etj., kurse për foljet me temë në -R(Ë) si trajtë përfaqësuese të favorizohet pjesorja e letrarishtes së sotme, tipi: larëtoje, ngarëtoje, fryrëtoje.

Mbështetja në temat mbi bazë mbiemërore si dhe mbi bazë ndajfoljore konsiderohet e përjashtueshme për emërtimet e tilla, ashtu si edhe disa fjalë-tema emra josendorë (gjeografikë etj.) si dhe emra vepruesish të cilët dalin të pafavorizuar. Ç është e vërteta, për rastet e tilla del e parapëlqyeshme prapashtesa -I, (-ARI) si p. sh. pylltar pylltari, vreshtar vreshtari, avokat avokati etj.

Në bazë të semantikës së përkufizimit aktual të vendshërbesave më -TORE pasi analizohet motivimi që vjen nga vetë tema fjalëformuese dhe zbulohen si të themi, rregullsitë brendagjuhësore mbi këtë çështje, paraqitet edhe vendi i prapashtesës -TORE në kuadër të strukturës së prapashtesave speciale emërformuese mbi temë të njëjtë fjalëformuese duke u specifikuar secili formant sipas nënfushave të caktuara semantike, p.sh. vegël-: vegëltar, veglore, veglëri, veglurina, vegëltore; mbathë-: mbathës e mbathtar, mbathore, mbathurina, mbathëtoje dhe në fund jepen përfundimet si rezultat i analizës, të cilat për arsye se kjo temë nuk del e trajtuar më përpara në përhollësinë e nevojshme, ato paraqiten në formë kërkesash, të cilat mund të përmblihen përafërsisht në këto pika:

1. Prapashtesa -TORE duhet të cilësohet si formant i mëvetësishëm në kuadër të strukturës së prapashtesave emërformuese me prirje specializimi për emërtimin e vendshërbesave e mos të mbetet nën hijen e prapashtesave të tjera si -TOR ose -ORE a -ATORE, siç qëndron në burimet e deritashme përkatëse fjalëformuese normative.

2. Formanti -TORE në formimin e vendshërbesave duhet të vazhdojë të favorizohet si barasvlerës i plotë ndaj formanteve speciale të gjuhëve të huaja si -HANE të turqishtes (osmane), -ERIA të italishtes, -TEKË (THEKE) të greqishtes (së vjetër), -NICA të serbishtes etj. Krahaso: turq.kasaphane, it. mehelleria, serb. kasapnica (mesarnica), shq. mishtore; turq. eczane, it. farmacia, serb. apoteka, shq. barnatore etj.

3. Të përkrahet përgjithësimi a shtrirja e shembujve më -TORE në mbarë truallin shqipfolës me anë të shqipes standarde, pavarësisht nga zona se ku janë krijuar dhe pa marrë parasysh cilësinë e neologjizmës së brishtë që mund ta mbartin hëpërhë, si p.sh.: mishtore, kursimtare, lojëtoare, këmbimtare etj.

4. Të përdoren si sinonime trajtat më -TORE ndaj togfjalëshave të qëndrueshëm që shprehin formalisht të njëjtin koncept, P.sh.: bankë-këmbimi - këmbimtare, dyqan tregtie - tregtoare, dyqan-shërbimi - shërbimtare etj.

5. Të parapëlqehen trajta më -TORE ndaj trajtave të tjera sinonimike me prapashtesa a forma të tjera, p.sh.: pastrimtare në vend: pastrim, pastrim, pastrimore, pastërtore; kafetore në vend: kafehane, kafe, kafeteri, kafiq etj.

6. Të përdoren si sinonime trajtat më -TORE pranë fjalëve ndërkombëtare, të cilat në mjaft raste edhe mund t'i zëvendësojnë ato, p. sh.: vëzhgimtare - observator, petëzimtare - lamineri, lojëtoare - kazino etj.

7. Të ndiqen dhe të nxiten formimet e vendshërbesave më -TORE (me kuptim figurativ) në fushën e krijimtarisë letrare (artistike) të cilat s' mund të kenë kufizime si p. sh.: shkëlqimtare, rrezimtare, përndëzëtoare etj.

Gjithsesi me përdorimin dhe favorizimin ndërgjegjesisht të vendshërbesave më -TORE nuk plotësohet vetëm një nevojë që shtron koha para gjuhës sonë aktualisht, por njëherazi me një veprim të tillë do të ngritet më lartë prestigji i gjuhës sonë standarde si në planin kombëtar, ashtu edhe në raporte ndërkombëtare.

L i t e r a t u r a

1. A. Xhuvani, Vepra I, ASHSH. Tiranë 1980.
2. Çështje të gramatikës së shqipes së sotme II, Tiranë 1975.
3. Gjuha letrare shqipe për të gjithë, Tiranë 1976.
4. J. Thomaj, Prejardhja semantike në gjuhën shqipe, Tiranë 1989.
5. Fonetika dhe gramatika e gjuhës së sotme letrare shqipe II, Tiranë 1976.
6. Fjalori i gjuhës së sotme shqipe, Tiranë 1980.
7. Drejtshkrimi i gjuhës shqipe, Prishtinë 1954.
8. I. Ajeti, Studime gjuhësore në fushë të shqipes III, Prishtinë 1985.
9. Studime mbi leksikon dhe mbi formimin e fjalëve në gjuhën shqipe I, II (Tiranë 1972), III, Tiranë 1989.
10. Probleme aktuale të kulturës së gjuhës shqipe, Prishtinë 1983.
11. Gjendja e terminologjisë shqipe në Jugosllavi, Prishtinë 1988.
12. F. Sulejmani, Praktikum i gjuhës shqipe, Prishtinë 1981.

13. N. Veselaj, Struktura fjalëformuese e emërtimeve të njerëzve sipas profesionit në gjuhën shqipe (disertacion doktrate), Prishtinë 1991 (dorëshkrim).

PËRMBYLLJE (REZYME)

(vëll. I)

Në përmbledhjen (vëll. I) që ka titullin "**Rreth konsolidimit të modeleve të caktuara emërformuese mbi bazë të disa prapashtesave të specifikuara**" janë përfshirë 5 punime.

Ndërsa në punimin e parë "**Përsosja e shqipes standarde faktor integrues në jetën tonë kombëtare**" lënda del e përgjithësuar dhe më tepër i përgjigjet funksionalisht një parathënieje jo vetëm të këtij vëllimi, por edhe të vëllimeve të tjera që synohen të botohen, po nën mbititullin e përbashkët "**Çështje të shqipes standarde në fushë të leksikut dhe të fjalëformimit**", katër punimet e tjera i përgjigjen plotësisht temës së kësaj përmbledhjeje, pasi që vërtet në to trajtohet funksioni i prapashtesës a të prapashtesave përkatëse sipas nënfushave të caktuara semantike.

Në punim-kumtesën "**Rreth përcaktimit të të rregullës për formimin e emrave prejfoljorë të vepruesit më -ËS në shqipen letrare kombëtare**" pas analizës përkatëse del se ka mundësi të përcaktohet rregulla duke u mbështetur në temën fjalëformuese, qoftë mbi temë të pjesores së ish-gjuhës letrare mbi bazë të gegërishtes (nëntipat: mësues, mbrojtës, shkruar, ruajtës, shpërblyes, vërejtës,, mbrehës, bujtës, mbajtës, ngritës,, vajtës, matës, mpiksës,, pajisës, palosës, radhitës), qoftë mbi temë të pjesores së letrarishtes së sotme (nëntipat: shuarës, blerës, shkrirës, bërës, fryrës, larës, kryerës, zierës, vëns, dhënës, marrës).

Në punim-trajtesën "**Formanti -AS si ndajshitesë e specializuar për emërtimin e njerëzve sipas vendbanimit a prejardhjes**", pos konstatimit se vërtet kjo prapashtesë për këtë nënfushë semantike del mbizotëruese ndaj prapashtesave të tjera simotra, jepet mendimi se pangurrim të gjitha emërtimet e reja të kësaj nënfushë semantike mund të mbulojnë me këtë prapashtesë në kooperim me prapashtesën -JAN, që të dyja të burimit të shqipes dhe që të dyja të paangazhuara për nënfusha të tjera semantike.

Në punimin "**Rreth formimit të emërtimeve me prapashtesim të emrave të sendeve konkrete**" u trajtua një temë pothuajse pak e përpunuar si temë e veçantë në gjuhësinë tonë. Pas vjeljes së lëndës përkatëse nga dy burime leksikografike: Fjalori i gjuhës shqipe (1954) dhe Fjalori i shqipes së sotme (1984) dhe krahasimit

të 26 prapashtesave aktive, qoftë brenda burimit përkatës, qoftë në krahasim me njëri tjetrin dolën rezultate mjaft interesante dhe me interes. Ndërsa në FGJSH 1954 radhitja e prapashtesave sipas shumësisë së numrit dilte kështu: **-zë** (18.4%), **-ore** (11.5%), **-ë** (9.2%), **-s** e **-cë** (nga 6.9%), **-ull** (5.7%) etj. në FSHS 1984 radhitja del kështu: **-(ë)s** (17.0%), **-ore** (15.9%), **-zë** (15.8%), **-se** ((9.5), **-ë** (5.9%) etj. Kurse lidhur me shtimin e emërtimeve në fjalë, po sipas prapashtesave përkatëse, radhitja sipas përqindjes del kështu: **-se** (më shumë për 22 herë), **-je** (më shumë për 6.0 herë), **-or** (më shumë për 5.6 herë), **-(ë)s** (me shumë për 5.03 herë), **-IM** (më shumë për për 4.0 herë) etj.

Gjithsesi këto të dhëna vënë në pah më mirë specifikimin e prapashtesave përkatëse për këtë nënfushë semantike.

Në punimin monografik **"Formanti -TORE, prapashtesë e mëvetësishme në shqipe me prirje specializimi për emërtimin e vendshërbesave"**, i cili ndahet në tetë krerë, mjaft në hollësi trajtohet funksioni i kësaj prapashtese. Edhe pse jo i konstatuar aq në burimet tona teorike normative formanti në fjalë qysh herët dhe në mjaft raste del si barasvlerës i plotë ndaj formanteve përkatëse të gjuhëve në kontakt si p.sh. me formantin **-TEKE** të greqishtes (tipi: bibliotekë / biblëtore/, **-HANE** të turqishtes, **-ERIA** te italishtes dhe **-NICA** të serbishtes (tipi: kasaphane / mehelleria / mesarnica / mishtore/. Vend të veçantë në punim i është dhënë përcaktimit të nënfushës semantike të emërtimit "vendshërbesë" si lokal pune etj. si dhe veçoritë e tjera që dalin në kontekst të emërtimeve konkrete lidhur me këtë nënfushë semantike.

* * *

Gjithsesi duke u trajtua këto tema kaq të mprehta të gjuhës sonë letrare përveç grumbullimit të fakteve a kontatimeve që njiheshin më përpara janë dhënë edhe gjykime, konstatime madje edhe sugjerime të reja (origjinale) se si është më së miri të zgjidhen çështjet e shtruara të diskutueshme para gjuhësinë tonë në të mirë të përsosjes së shqipes sonë standarde kombëtare të njësuar.